

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Eruditi, juristi dhe komentuesi

NASER MEKARIM SHIRAZI

KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT

(Xhuzi i tetë)

TIRANË, 2016

Titulli: **KOMENTIM I PËRSOSUR I KUR'ANIT**

(Xhuzi i tetë)

Autori: **Eruditi, juristi dhe komentuesi**

Naser Mekarim SHIRAZI

Recensent: **Vullnet MERJA**

E përktheu nga arabishtja: **Vullnet MERJA**

E redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrektura letrare: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja grafike: **Sabrie FEZA**

Kapaku: **Sabrie FEZA**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

Copyright: **Shoqata "FLLADI"**

Shtypshkronja e shtëpisë botuese **LILLO**

Ajeti 111

﴿ وَلَوْ أَنَّا نَزَّلْنَا إِلَهُمُ الْمَلٰٓئِكَةَ وَكَلَّمَهُمُ الْمَوْتٰى وَحَشَرْنَا عَلَيْهِمْ
كُلَّ شَيْءٍ قُبْلًا مَّا كَانُوا لِيُؤْمِنُوْا اِلَّا اَنْ يَشَآءَ اللّٰهُ وَلٰكِنْ
اَكْثَرُهُمْ جٰهَلُوْنَ ﴾

"Edhe sikur t'u dërgonim atyre engjëjt, t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre dhe t'i tubonin të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, vetëm nëse All'llahu do të donte; por shumica e tyre janë të paditur."

Komentimi

Përse nuk pendohen kokëfortët?

Ky ajet është vazhdimi i ajeteve të mëparshme që sqaron po të njëjtën të vërtetë. Qëllimi i këtyre ajeteve është qartësimi i gënjeshtres së atyre që kërkuar realizimin e mrekullive të çuditshme e të habitshme ku realizimi i disa prej tyre është i pamundur, siç e cekëm edhe më parë (p.sh. shikimi i All'llahut me sy).

Ata mendojnë se, me kërkesën e tyre, të shfaqjes së këtyre mrekullive të çuditshme, do të lëkundin idetë e besimtarëve, do të tronditin ideologjitë e kërkuesve të së vërtetës e do t'i humbin vëmendjen atyre.

Kur'ani flet qartë në këtë ajet, duke thënë: **"Edhe sikur t'u dërgonim atyre engjëjt, t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre dhe t'i tubonin të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin..."**¹

Më pas, ajeti përforcon se nuk mund të besojnë veçse në një rast të vetëm që është: All'llahu t'i detyrojë me vullnetin e Tij: **"...vetëm nëse All'llahu do të donte..."** Mirëpo, një besim si ky nuk vlen në edukimin e tyre e as nuk ndikon në përsosmërinë e tyre. Në fund ajeti thotë: **"...por shumica e tyre janë të paditur."**

Ekzistojnë mendime të ndryshme midis komentuesve se kujt i drejtohet All'llahu në ajet me përemrin "hum", ata. Ka mundësi që mund t'u drejtohet besimtarëve, që ngulnin këmbë te i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) që të plotësojë kërkesat e politeistëve, duke paraqitur mrekullitë që kërkojnë. Kjo sepse, shumica e besimtarëve nuk e dinin falsitetin e mohuesve për kërkesat që bënin. Por All'llahu e dinte se ata janë gënjeshtarë. Prandaj nuk iu përgjigj kërkesave të tyre, pavarësisht se lutja e të Dërguarit të All'llahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) nuk mund të zhvishej prej mrekullisë. All'llahu, në rrethana të veçanta, ka realizuar mrekulli të ndryshme me dorën e Profetit.

Mundësia tjetër është se përemri "hum", "ata", mund të jetë për mohuesit, për ata që bënë kërkesat, pasi shumica e tyre nuk e njihnin fuqinë e All'llahut për realizimin e çdo çështjeje të

¹ "Hasherna alejhim kul-le shejjin do të thotë: I bëmë realitet të gjitha kërkesat e tyre. Tubim, me kuptimin e grumbullimit. Kubulen, me kuptimin para tyre dhe në prani të tyre. Por mund të jetë edhe me kuptimin e shumësit të fjalës kabijl, ku engjëjt dhe të vdekurit grumbullohen në grupe përpara tyre.

pazakontë. Ndoshta ata e kanë konsideruar fuqinë e All'llahut të kufizuar. Për këtë, ata i përshkruanin mrekullitë e të Dërguarit si magji. All'llahu i Lartësuar thotë: **“Edhe sikur Ne të hapnim një derë të qiellit dhe të ngjiteshin nëpër të, ata me siguri që do të thoshin: “Sytë tanë kanë qenë të shushatur, madje na kanë magjepsur!”**¹ Kështu që ata janë popull kokëfortë dhe injorant dhe askush nuk duhet t'i japë rëndësi fjalëve të tyre.

¹ Sure “El-Hixhr”, Ajeti 14-15.

Ajetet 112 - 113

وَكَذَٰلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيَاطِينَ الْإِنسِ وَالْجِنِّ يُوحِي بَعْضُهُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ زُخْرَفَ الْقَوْلِ غُرُورًا ۚ وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ ۖ فَذَرْهُمْ ۖ وَمَا يَفْتَرُونَ ﴿١١٢﴾ وَلِتَصْغَىٰ إِلَيْهِ أَفْعَدَةُ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ وَلِيَرْضَوْهُ وَلِيَقْتَرِفُوا مَا هُمْ مُقْتَرِفُونَ ﴿١١٣﴾

"Kështu, çdo Profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve, të cilët e frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe të zbukuruara për mashtrim. Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin kështu, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre."

"Lëri zemrat e atyre që nuk besojnë në Ditën e Kiametit, që të priren nga mashtrimi dhe të kënaqen me të e le të bëjnë gjynahet që kanë bërë."

Komentimi

Cytjet e djajve

Këto ajete na tregojnë se ekzistenca e këtyre kokëfortëve fanatikë e ekstremistë, për të cilët flasin ajetet e mëparshme, nuk kufizohet vetëm në kohën e Profetit të Islamit (Paqja dhe bekimi i

Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij), por edhe te profetët e mëparshëm kanë qenë të pranishëm armiq të djajve njerëz dhe xhinde, siç thotë edhe ajeti: **"Kështu, çdo profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve..."**. Ata armiq s'kishin punë tjetër përveç fjalëve të bukura e të trilluara, që hutonin me to njëri-tjetrin, i hidhnin ato në tymnajë ose i frynin në vesh njëri-tjetrit: **"...të cilët e frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe të zbukuruar për mashtrim..."**

Por: po të donte All'Ilahu, do t'i ndalonte ata djaj që u përballën me profetët: **"...Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin kështu..."**

Mirëpo, me sa duket All'Ilahu nuk e do një gjë të tillë, sepse Ai dëshiron që njerëzit të jenë të lirë dhe të ketë vend për sprovimin e tyre, për plotësimin dhe edukimin. Në të vërtetë, heqja e lirisë e dhuna nuk harmonizohen me këto qëllime. Për më tepër, prania e këtyre armiqve kokëfortë e fanatikë nuk i dëmtojnë aspak besimtarët e sinqertë, madje në forma të ndryshme ajo prani çon në forcimin e grupit të besimtarëve, sepse plotësimi vjen përmes kundërshtisë dhe prania e një armiku të fortë ndikon në mbledhjen e të gjitha forcave njerëzore e në forcimin e dëshirës. Kjo është arsyeja që All'Ilahu e urdhëron Profetin e Tij në fund të ajetit, që të mos ua vërë veshin shembujve të këtyre veprave djallëzore: **"...prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre."**

Hulumtime

Le t'i shikojmë me vëmendje pikat e mëposhtme:

1- Në këtë ajet, All'Ilahu ia atribuon vetes së Tij ekzistencën e djajve njerëz dhe të xhindeve, në përballje me Profetët ku thotë:

“...Kështu, çdo Profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindeve...”

Komentuesit kanë mendime të ndryshme për kuptimin e kësaj fraze. Por siç e shpjeguem edhe më parë, të gjitha veprat e njeriut mund t'i atribuohen All'llahut, sepse ajo që kanë njerëzit është prej All'llahut. Fuqia e tyre, liria e zgjedhjes dhe dëshira e tyre është prej All'llahut. Për këtë, të tilla fraza nuk mund të kenë kuptimin e zhveshjes së njerëzve nga liria dhe zgjedhja, as nuk ka kuptimin që All'llahu ka krijuar disa njerëz që të mbajnë qëndrim armiqësor ndaj profetëve. Po të ishte kështu, All'llahu nuk do t'u kërkonte atyre asnjë llogari për armiqësinë ndaj profetëve, sepse veprimi i tyre në këtë rast konsiderohet zbatim i mesazhit të tyre, ndërkohë që çështja nuk është e tillë.

Nuk mundet të mohohet se prania e të tillë armiqve, zgjedhës sigurisht e jo të imponuar, ndikon shumë dhe në formë jo të drejtëpërsëdrejti në përsosurinë e besimtarëve. Thënë ndryshe: Besimtarët e singertë mund të nxjerrin mësimë pozitive nga prania e armiqve, duke e marrë atë si mjet për të ngritur nivelin e vigjilencës, të grumbullimit të fuqive, të rritjes së vetëdijes dhe të përgatitjes për rezistencë ndaj kundërshtarëve, sepse prania e armikut është faktor i grumbullit të fuqive.

2- Fjala *shejatin* (është shumësi i fjalës shejtan- djall) dhe ka kuptim të gjerë, që përfshin çdo tiran, kundërshtar e keqbërës. Kur'ani e përdor këtë fjalë për përlulësin, të ndyrin e tiranin, siç vëmë re edhe në këtë ajet, ku përmenden shejtanë njerëz dhe jo njerëz, të cilët nuk i shohim. *Iblijs* është emri i veçantë i shejtanit, që kundërshtoi Ademin (*Paqja qoftë mbi të!*). Në të vërtetë, *iblijsi*

është kryetari i shejtanëve. Fjala *shejtan* është emër i përgjithshëm, ndërsa fjala *iblijs* është emër i përveçëm.¹

3- “Me fjalë të bukura lajkatare”, do të thotë fjalëmjaltë mashtruese, të cilat të habit e jashtëmja e tyre, ndërsa në brendësi janë të shëmtuara² e mburrëse.

4- Frazja “nxitnin njëri-tjetrin” përmban tregues interesant, se thëniet dhe veprat e tyre djallëzore vizatojnë plane të zymta, këmbajnë sekrete, në mënyrë që njerëzit të mos marrin vesh asgjë për punët e tyre deri sa t’i zbatojnë plotësisht ato. Nga kuptimet e fjalës el uahj është edhe pëshpëritja në vesh.

Ajeti tjetër tregon rezultatin e fjalëve të zbukuruara të djajve mashtrues: Në fund, ata që nuk besojnë, pra ata që nuk besojnë në Ditën e Ringjalljes, do t’i dëgjojnë ato fjalë dhe zemrat e tyre do të anojë drejt tyre: **“Lëri zemrat e atyre që nuk besojnë në Ditën e Kiametit, që të priren nga mashtrimi...”**³

Li tesga vjen nga fjala *sagv*, që do të thotë të anosh nga diçka. Por në të shumtën e rasteve është anim që vjen përmes rrugës së dëgjimit, kështu që, nëse dikush dëgjon fjalë me miratim, atëherë ky është *sagv* dhe isga-dëgjim me vëmendje dhe i përqendruar”.

¹ Për këtë shiko fundin e komentimit të ajetit 34 të sures “El-Bekare”.

² *Zukhruf* – të bukura, lajkatare nënkupton në thelb zbukurimin dhe floririn. Më pas është artikuluar për fjalët që në pamje të jashtme janë të bukura dhe të zbukuruara.

³ Komentuesit s’janë të një mendimi për analizën gramatikore të këtij ajeti, por edhe në atë se me çfarë lidhet fjalia “që të anojnë”. Por, gjithsesi, më afër logjikës është se fjalia lidhet me “nxitnin njëri – tjetrin” dhe se pjesëza *lam* e saj është ndëshkuese, pra çështja e ndëshkimit të shejtanëve, e cila do të jetë nxitja e njëri-tjetrit e që do t’u shërbejë atyre që do të anojnë drejt tyre e që nuk kanë besim. Gjithashtu, mund të ketë lidhje edhe me “mashtrimin”. Në këtë rast mund të jetë një kundrinor (ku njeriu mashtrohet fillimisht e më pas anohet nga ajo gjë për të cilën është mashtruar).

Më pas ajeti thotë: Fundi i këtij animi është kënaqësia e plotë me metodikat djallëzore **"...dhe të kënaqen me të..."**
Fund i gjithë kësaj ishte kryerja e llojeve të ndryshme të mëkateve e veprave të ndyra: **"... e le të bëjnë gjynahet që kanë bërë."**

Ajetet 114 - 115

أَفَعَيَّرَ اللَّهُ أَبْتَغَىٰ حَكَمًا وَهُوَ الَّذِي أَنْزَلَ إِلَيْكُمُ الْكِتَابَ
مُفَصَّلًا ۚ وَالَّذِينَ ءَاتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْلَمُونَ أَنَّهُ مُنْزَلٌ مِّن رَّبِّكَ
بِالْحَقِّ ۖ فَلَا تَكُونَنَّ مِنَ الْمُمْتَرِينَ ﴿١١٤﴾ وَتَمَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ
صِدْقًا وَعَدْلًا ۚ لَا مُبَدِّلَ لِكَلِمَاتِهِ ۚ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١١٥﴾

"Thuaj: 'Vallë, a të kërkoj tjetër gjykatës përveç All'lahut, kur është Ai që ju ka zbritur këtë Libër të hollësishëm?!' Ata që Ne u kemi dhënë Shkrimet e shenjta, e dinë se Kur'ani është me të vërtetë i zbritur nga Zoti yt. Prandaj, kurrsesi mos u bëj nga ata që dyshojnë."

"Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë."

Komentimi

Këto ajete, në realitet, janë vazhduese të ajeteve të mëparshme. Pas gjithë këtyre fakteve dhe argumenteve të qarta, që garantojnë njësimin, All'Ilahu i Lartësuar thotë: "Thuaj: 'Vallë,

a të kërkoj tjetër gjykatës përveç All'Ilahut..."¹ All'Ilahu është Ai që ka zbritur këtë libër madhështor, në të cilin gjenden të gjitha nevojat njerëzore, edukative, që bën dallimin ndërmjet të vërtetës e të pavërtetës, dritës e errësirës, besimit dhe mosbesimit: **"kur është Ai që ju ka zbritur këtë Libër të hollësishëm?!..."**

Jo vetëm i Dërguari dhe myslimanët e dinë se ky Libër ka zbritur nga All'Ilahu, por, gjithashtu, edhe ithtarët e Librit (jehuditët e kristianët), sepse shenjat e këtij Libri qiellor i kanë lexuar atë në librat e tyre dhe e dinë se ai ka zbritur nga All'Ilahu: **"...Ata që Ne u kemi dhënë Shkrimet e shenjta, e dinë se Kur'ani është me të vërtetë i zbritur nga Zoti yt..."**

Bazuar në këtë, nuk mbetet hapësirë për dyshim në të (Kur'anin), prandaj edhe ti, o Profet, mos dysho për këtë: **"...Prandaj, kurrësi mos u bëj nga ata që dyshojnë."**

Nga e gjithë kjo lind një pyetje: A ka pasur Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) qoftë edhe dyshimin më të vogël, në mënyrë që t'i drejtohej me këtë thënie?

Përgjigje: Është ajo që kemi thënë edhe më përpara. Në të tilla raste si kjo, fjala u drejtohej njerëzve, jo Profetit. Arsyeja e drejtimit është tërheqja e vëmendjes njerëzve.

Ajeti pasardhës thotë: **"Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë."**

¹ "El Hakemu" do të thotë gjykatës, prokuror. Disa të tjerë mendojnë se kjo fjalë, për nga kuptimi, është njësoj me fjalën guvernator. Por disa të tjerë, prej tyre shejkh Tusij, thotë se fjala "el Hakemu", është ai që nuk gjykon me të drejtë, ndërsa "el Hákimu", mund të gjykojë me të dyja. Disa të tjerë janë të mendimit, prej tyre autori i "El Menar", se kuptimi i fjalës "el Hakem" është ai që e zgjedhin dy palë për gjykim. Ndërsa kuptimi për fjalën "el Hákim" nuk është kështu.

Fjala "el kelime", këtu është me kuptimin thënia, përdoret për çdo fjali apo fjalë, qoftë e gjatë apo e shkurtër. Mund të thuhet edhe për një premtim, siç është te ajeti: "Thëniet e Zotit tënd të bukura u plotësuan për beni izraelitët, për arsye se ata u treguan të duruar"¹, sepse një person, kur premtim, shqipton disa fjalë që përshijnë kuptimin e premtimit. Por, mund të vijë edhe me kuptimin e fesë, dispozitës, urdhër për të njëjtin shkak.

Ndërsa, përsa i përket përdorimit të saj në këtë ajet, thuhet se ajo nënkupton Kur'anin, thuhet fenë e All'llahut, thuhet: premtimi i triumfit, me të cilin All'llahu i premtoi Profetit të Tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!). Mes tyre nuk ka kundërshtim sepse ka mundësi që ajeti ka dashur t'i thotë të gjitha këto kuptime së bashku. Përderisa ajetet e mëparshme flisnin për Kur'anin, atëherë qëllimi i fjalës "el kelimetu" për Kur'anin është më i afërt.

Atëherë kuptimi i ajetit është: Me të vërtetë, Kur'ani nuk është çështje dyshimi në asnjë prej formave, ai është i plotë në të gjitha drejtimet dhe në të nuk ka mangësi. Të gjitha lajmet e historitë e tij janë të vërteta, të gjitha dispozitat e ligjet e tij janë drejtësi.

Ndoshta kuptimi i fjalës "el kelimetu" këtu është premtimi, i cili ka ardhur në frazën pasardhëse: "**...fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë.**" sepse kjo frazë përsëritet në Kur'anin Fisnik, si p.sh.: "E tashmë fjala (premtimi) Jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata, pa dyshim do të jenë të ndihmuar."²

¹ Sure "'El A'raf'", Ajeti 137.

² Sure "Hud", Ajeti 119.

"Përveç atij që e mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata. Fjala e Zotit tënd: "Gjithsesi do ta mbushë Xhehennemin me të gjithë xhinët dhe njerëzit", ka marrë fund (është plotësuar)"¹

Bazuar në këtë, kuptimi i ajetit është: Vërtet, premtimi ynë u realizua me drejtësi e vërtetësi dhe askush nuk ka aftësi të ndryshojë dispozitat e All'llahut. Ajeti mundet t'i përfshijë të gjitha këto kuptime.

Nëse ajeti nënkupton Kur'anin, atëherë kjo nuk bie në kundërshtim me ekzistencën e Kur'anit, për të cilin nuk kishte përfunduar ende zbritja e plotë e tij. Ndërkohë qëllimi është se çfarë ka zbritur prej tij ka qenë e plotësuar dhe pa të meta.

Disa komentues mbështeten te ky ajet për konstatimin e mosdevijimit të Kur'anit, sepse fraza: "Nuk ka ndryshim ndaj fjalëve të Tij" nënkupton se asnjë nuk mund të modifikojë Kur'anin, ta ndryshojë atë, as në termin e tij, as në lajmet e tij dhe as në dispozitat e tij. Ky Libër qiellor do të qëndrojë deri në fund të kësaj bote udhërrëfyes i njerëzimit, do të ruhet nga qëllimet e tradhtarëve dhe të dashakeqësve.

¹ Sure "Es-Safat", Ajeti 171-172.

Ajetet 116 - 117

وَإِنْ تُطِيعْ أَكْثَرَ مَنْ فِي الْأَرْضِ يُضِلُّوكَ عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ ۚ إِنَّ
يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ هُمْ إِلَّا تَخْرُصُونَ ﴿١١٦﴾ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ
أَعْلَمُ مَنْ يَضِلُّ عَنْ سَبِيلِهِ ۖ وَهُوَ أَعْلَمُ بِالْمُهْتَدِينَ ﴿١١٧﴾

"Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e All'llahut. Ata ndjekin vetëm hamendjet. Ata vetëm gënjejnë."

"Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që i shmangen rrugës së Tij dhe i di më së miri ata që janë në rrugë të drejtë."

Komentimi

Ajetet e kësaj sureje kanë zbritur në Mekë në kohën kur myslimanët ishin të pakët në numër. Ndoshta numri i vogël i myslimanëve dhe shumica e politeistëve dhe e idhujtarëve, mund të ishte arsyeja që disa të hamendësonin se, nëse feja e politeistëve është e pavërtetë dhe e kotë, atëherë pse të ketë kaq shumë ithtarë?! Por, nëse feja islame është e vërtetë, cili është shkaku i pakicës së pasuesve të saj?

Për të shmangur këtë hamendësim, All'llahu, pasi i kujton të vërtetat e Kur'anit në ajetet e mëparshme, i flet Profetit të Tij:

"Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e All'Ilahut..."

Në fjalinë e dytë sqaron arsyen e kësaj thënieje që është se: Ata nuk ndjekin logjikën e shëndoshë, por supozimet e ngatërruara me epshet; gënjeshttrat e përziera me tradhti e hamendje: **"...Ata ndjekin vetëm hamendjet. Ata vetëm gënjejnë."**¹

Si rrjedhojë, kuptimi i ajetit është se shumica nuk mund të jetë në vetvete argument në rrugën e së vërtetës, edhe sikur ndjekësit e kësaj rruge të jenë të pakët në numër.

Argumentimi i një gjëje të tillë vjen në ajetin pasardhës, i cili përforcon se All'Ilahu është i Gjithëdijsëm për gjithçka dhe nuk ka vend për gabim në diturinë e Tij. Ai është më i njohur për rrugën e udhëzimit ashtu siç është më i njohuri për të humburit dhe për ata që ndjekin rrugën e udhëzimit. Ajeti thotë: **"Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që i shmangen rrugës së Tij dhe i di më së miri ata që janë në rrugë të drejtë."**

Këtu lind një pyetje: Nga ajeti kuptohet se All'Ilahu i Lartësuar është më i Ditur për rrugën e udhëzimit. A ka ndonjë që e di rrugën e udhëzimit pa udhëzimin e All'Ilahut, përderisa All'Ilahu qenka më i Dituri?!

Përgjigje: Padyshim, njeriu është i aftë, me logjikën e tij, të arrijë te disa të vërteta dhe të njohë rrugën e udhëzimit e të humbjes deri në një farë mase, pavarësisht se shtrirja e dritës së

¹ "El Khars" është çdo thënie supozuese dhe hamendësuese. Prejardhja e saj vjen nga hamendësimi i sasisë së frutave të pemëve të hurmave në dhënie apo marrjen me qera të plantacionit. Më pas është thënë për çdo supozim e iluzion dhe hamendje që mund ose jo të përputhet me realitetin. Kjo fjalë mund të përdoret, gjithashtu, për gënjeshtren. Por, në ajet mund të jetë me të dyja kuptimet.

mendjes ka një kufi dhe disa të vërteta mund të mbesin jashtë kornizave të këtij kufiri. Pastaj disa njohuri të njeriut mund ta shpien atë drejt gabimit e në këtë rast ai ka nevojë për këshilltar e udhëzues nga ana e All'llahut. Për këtë, fraza "All'llahu është më i Ditur" është e saktë, edhe pse është në shkallën krahasore me praninë e ndryshimit.

Hulumtime

Nuk ka rëndësi sasia numerike

Disa mendojnë se numri i madh i njerëzve që pranojnë diçka, përherë përputhet me të vërtetën. Kur'ani e mohon këtë në shumë ajete dhe nuk i jep asnjë peshë sasisë numerike. Ai thotë se shumica "cilësore" është kusht dhe jo shumica "sasiore", megjithëse shoqëritë e sotme, për menaxhimin e jetës shoqërore, mbështeten te shumica. Të mos harrojmë që edhe kjo, siç thamë, është një lloj detyrimi për të arritur rrugën e drejtë, ku, në një shoqëri materiale, nuk mund të gjejmë një mjet të saktë e të shëndoshë për të marrë vendimet e hartimet e ligjeve.

Për këtë arsye gjejmë që shumë dijetarë janë të detyruar të pranojnë idenë e shumicës, edhe pse ata e pranojnë se ky rregull, shpeshherë është i shoqëruar me gabimin. Kjo, se të metat e metodave të tjera janë më të shumta.

Megjithatë, shoqëritë që besojnë mesazhet e profetëve, nuk janë të detyruara të ndjekin teorinë e shumicës në hartimin e ligjeve, sepse metodikat e profetëve të sinqertë dhe ligjet e tyre të ardhur nga All'llahu, janë të zhveshura nga çdo e metë e mangësi

dhe nuk mund të krahasohen me atë që saktëson shumica e ekspozuar drejt gabimit.

Nëse shohim gjendjen e botës sot, qeveritë që ngrihen mbi bazën e mendimit të shumicës, ligjet e sëmura që anojnë nga epshet, që i vendos shumica, do të vërejmë se shumica numerike nuk e shëron plagën, madje është kjo shumicë që ka shkaktuar luftëra dhe shkatërrime.

Kolonializmi, shfrytëzimi, luftërat, gjakderdhja, liria e alkoolit, e bixhozit, e abortit, e shtëpive publike e të tjera si këto, që të djersitet balli nga turpi, i ka vendosur shumica në parlamentet e shumë vendeve, që e mbajnë veten si të përparuara, duke e konsideruar veten se reflekton dëshirën e shumicës së njerëzve. Ky është fakt për të vërtetën e asaj që themi.

Në aspektin shkencor pyesim veten. A është shumica e shoqërive e singertë? A është shumica besnike? A e shikon ajo veten e saj të frenuar nga sulmi i të drejtave të të tjerëve, nëse mundet? A i shikon shumica interesat e veta dhe interesat e të tjerëve me të njëjtin shikim?

Përgjigjet flasin me gjuhën e gjendjes aktuale e jo të thënies. Për këtë, ne duhet të pranojmë patjetër se mbështetja e botës së sotme të shumica është një lloj dhune e imponuar nga situatat aktuale dhe se kjo është një e keqe e imponuar mbi shoqëritë.

Sikurisht, nëse mendjet mendimtare, interesat e shoqërive të singerta, shkencëtarët udhërrëfyes, që janë të pakët, të hartojnë një paketë të plotë për ndritjen e mendimeve të njerëzve, ku shoqëritë të arrijnë drejtësinë nga vetëdija dhe udhëzimi ideologjik e shoqëror, atëherë konceptet e shumicës do të përafroheshin drejt së vërtetës.

Shumica e paudhëzuar dhe e pavetëdijshe, madje e prishur, e humbur, nuk mund të frenojë veten e jo më tjetrin! Për këtë, vetëm shumica nuk mjafton. Kurse shumica e udhëzuar është e aftë të zgjidhë problemet e shoqërisë me të njëjtën masë që mund ta zgjidhë atë njerëzia.

Nëse Kur'ani, në të shumtën e rasteve, e qorton shumicën, sigurisht, këtu synohet shumica e paudhëzuar.

Ajetet 118 - 120

فَكُلُوا مِمَّا ذُكِرَ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ إِنْ كُنْتُمْ بِآيَاتِهِ مُؤْمِنِينَ ﴿١١٨﴾
 وَمَا لَكُمْ أَلَّا تَأْكُلُوا مِمَّا ذُكِرَ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَقَدْ فَصَّلَ لَكُمْ
 مَا حَرَّمَ عَلَيْكُمْ إِلَّا مَا اضْطُرَرْتُمْ إِلَيْهِ ۗ وَإِنَّ كَثِيرًا لِّيُضِلُّوا
 بِأَهْوَاءِهِمْ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۗ إِنَّ رَبَّكَ هُوَ أَعْلَمُ بِالْمُعْتَدِينَ ﴿١١٩﴾
 وَذَرُوا ظَهَرَ الْآثِمِ وَبَاطِنَهُ ۚ إِنَّ الَّذِينَ يَكْسِبُونَ الْآثِمَ
 سَيُجْزَوْنَ بِمَا كَانُوا يَقْتَرِفُونَ ﴿١٢٠﴾

"Hani vetëm atë mish, gjatë therjes së të cilit është përmendur emri i All'Ilahut, nëse vërtet besoni në shpalljet e Tij."

"E përse të mos e hani atë që është therur me emrin e All'Ilahut, kur Ai tashmë jua ka shpjeguar ç'është e ndaluar, përveçse kur jeni në shtrëngesë?! Shumë njerëz i largojnë të tjerët nga rruga e drejtë nga padija dhe nga dëshirat e tyre të kota. Në të vërtetë, Zoti yt i njej më së miri ata që e kanë kaluar kufirin."

"Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar."

Komentimi

Duhet të zhduken patjetër gjurmët e politeizmit

Këto ajete, në të vërtetë, janë një prej rezultateve të kërkimeve të mëparshme, në lidhje me njësimin dhe politeizmin. Për këtë arsye, ajeti i parë fillon me germën "fe et tefriiji", pas së cilën vjen me një rezultat.

Ajetet e mëparshme cekën me metodika të llojllojshme, vërtetësinë e njësimin dhe vërtetimin e pasaktësisë së politeizmit e të adhurimit të idhujve.

Nga rezultatet e kësaj del se myslimanët nuk duhet të hanë nga mishi që theret në emër të idhujve. Madje ata duhet të hanë nga mishi i bagëtive që theren në emër të All'lahut. Tradita e arabëve ka qenë bërja kurban për t'u përafuar me idhujt e tyre dhe hanin nga mishi i tyre për t'u bekuar me të. Edhe kjo ka qenë pjesë e adhurimit të idhujve.

Kjo është arsyeja që Kur'ani fillon me thënien: "**Hani vetëm atë mish, gjatë therjes së të cilit është përmendur emri i All'lahut, nëse vërtet besoni në shpalljet e Tij.**" Pra, besimi nuk është thjesht thënie apo një pretendim ideologjik e teorik, por përkundrazi, duhet të shfaqet edhe me vepër, kështu që ai që beson në Zot, duhet të hajë vetëm nga ky mish.

Është e qartë se folja hani, nuk nënkupton obligim (uaxhib), por nënkupton lejimin e ngrënies së këtyre kafshëve që përmendet

emri i All'llahut gjatë therjes së tyre dhe ndalimin e ngrënies së kafshëve që nuk përmendet emri i All'llahut gjatë therjes së tyre.

Nga kjo del e qartë se ndalimi i prerjes së bagëtisë, ku nuk përmendet emri i All'llahut nuk është për arsye shëndetësore, përkundrazi ajo ka prapavijë morale e shpirtërore, sepse synohet qëndrueshmëria e bazave të njësimit dhe e adhurimit të All'llahut Një, të Vetëm e të Pashoq.

Ajeti pasardhës flet për të njëjtën temë, por me një shprehje ndryshe dhe me më shumë argumente ku thotë: **"E përse të mos e hani atë që është therur me emrin e All'llahut, kur Ai tashmë jua ka shpjeguar ç'është e ndaluar..."**

Edhe një herë përmendim se qortimi e përforcimi nuk kanë si qëllim lënien e ngrënies së mishrave të lejuar, por qëllimi i tyre është të thonë se kjo është ajo që duhet të hahet e jo tjetër. E thënë ndryshe: përforcimi këtu qëndron në pikën e kundërt të kuptimit të shprehjes. Kjo është argumentuar me thënien: **"...jua ka shpjeguar ç'është e ndaluar..."**

Gjithsesi, kjo temë është më e sqaruar te surja "El-Maide" dhe do të trajtohet te ajeti 145 i kësaj sureje. Përderisa kjo sure ka zbritur në Mekë dhe surja "El-Maide" ka zbritur në Medine dhe ajetet e mëpasshme të kësaj sureje nuk kishin zbritur ende, atëherë çdonjëra nga këto dy alternativa nuk është e saktë. Sepse tematika e saj ose të jetë verseti 115 i sures En-Nahl, në të cilën përmenden disa mishra që janë të ndaluar të hahen, e veçanërisht ato të cilët nuk përmendet emri i All'llahut gjatë therjes, ose të kihet si qëllim mësimet që sqaronte i Dërguari i All'llahut (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në lidhje me

mishrat, sepse Profeti nuk ka folur ndryshe veçse me anë të shpalljes ose të frymëzimit.

Më pas përjashtohet nga këto një rast i vetëm: **"...përveçse kur jeni në shtrëngesë?!..."**, qoftë ky detyrim si rezultat i pranisë së njeriut në një vend të shkretë, apo nën trysninë e urisë së fortë, apo nën presionin e politeistëve duke e detyruar atë të hajë mishin e tyre.

Më pas ajeti thotë se shumë njerëz përpiqen të çojnë në humbje të tjerët nga injoranca apo nga ndjekja e epsheve: **"...Shumë njerëz i largojnë të tjerët nga rruga e drejtë nga padija dhe nga dëshirat e tyre të kota..."** Megjithëse ndjekja e egos shoqërohet përherë me injorancë. All'Ilahu i lartësuar e përsërit këtë për përforsim, duke thënë: **"...nga padija dhe nga dëshirat e tyre të kota..."**

Nga kjo frazë përftohet, gjithashtu, se dituria e saktë nuk krahasohet me ndjekjen e egos dhe të imagjinatës dhe, sa herë që të krahasohet, ajo është injorancë e jo dituri.

Duhet të themi se fjalia që përmendëm ndoshta na tregon atë që ka ekzistuar ndërmjet politeistëve arabë në atë kohë, të cilët ia lejonin vetes së tyre ngrënien e mishit të kafshëve të ngordhura me thënien: A është e lejuar të konsiderohen mishërat e kafshëve që vrasim ne vetë të lejuara dhe mishërat e kafshëve që vret All'Ilahu të konsiderohen të ndaluara?

Sigurisht, kjo nuk është gjë tjetër veçse sofizëm bosh, sepse kafsha e ngordhur nuk është kafshë që e ka prerë All'Ilahu, që të mund të krahasohet me një kafshë që është prerë kurban, sepse

kafsha e ngordhur është burim sëmundjesh e mishi i saj është i prishur. Kjo është arsyeja përse All'illahu e ka ndaluar ngrënien e mishit të saj.

Së fundi, thotë: **"...Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që e kanë kaluar kufirin."** ata që me këto argumente boshe e të pabaza, përpiqen të shtrembërojnë të vërtetën.

Ajeti pasardhës përmend një ligj të përgjithshëm, ku, disa prej tyre, shtyhen të bëjnë mëkate në fshehtësi. Për këtë thotë: **"Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta..."**

Thuhet se në kohën e injorancës, kanë pasur bindjen se, nëse bënin kurvëri në mënyrë të fshehtë, nuk kishte ndonjë gjë, ndërsa nëse bëhej haptas, ai ishte mëkat! Edhe sot, gjithashtu, gjejmë njerëz që shkojnë sipas kësaj logjike të injorancës. Kanë frikë të bëjnë mëkate haptazi, por fshehtazi bëjnë çfarë të duan, pa i vrarë ndërgjegjja për mëkatet.

Ky ajet nuk ndëshkon vetëm këtë logjikë, por ai pëmban kuptime të gjëra. Në shtesë të asaj që thamë më parë, ajeti përfshin shumë komentime, të cilat janë transmetuar për mëkatin e fshehur e të hapur, p.sh. thënia e tyre se: mëkati i hapur është ai që bëhet përmes organeve të trupit, ndërsa mëkati i fshehur është ai që bëhet me zemër, qëllim dhe vendosmëri.

Pastaj, si kërcënim ndaj mëkatarëve për atë se çfarë i pret ata në të ardhmen e tyre fatkeqe, ajeti ua kujton duke thënë: **"...ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar."**

Fraza "**...ata që kanë bërë gjynahe...**" është një përshkrim i mahnitshëm që tregon se njeriu në këtë botë është i ngjashëm me kapitalistët, të cilët hyjnë në një treg të madh dhe kapitali i tyre është: zgjuarsia, mendja, mosha, rinia, kapacitetet e ndryshme, të cilat janë dhurata të All'llahut. Kështu që mjeran është ai që "bën mëkate" me këto dhunti, në vend që të fitojë lumturinë, personalitetin njerëzor, devotshmërinë dhe afrimin te All'llahu.

Fraza "**do të ndëshkohen**" do të thotë se ata do të marrin ndëshkimin në të ardhmen e afërt... Mund të tregojë për Ditën e Gjykimit, edhe pse për dikë duket e largët, ajo në realitet është shumë afër, sepse ditët e kësaj bote kalojnë sa hap e mbyll sytë dhe vjen takimi i premtuar.

Mund të jetë tregues se pjesa më e madhe e njerëzve marrin në këtë botë atë që e meritojnë, si rezultat i veprave të tyre të këqija, në formën e reaksionit individual e shoqëror.

Ajeti 121

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذَكَّرْ أَسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَإِنَّهُ لَفِسْقٌ ۖ وَإِنَّ
 الشَّيْطَانَ لِيُوحِيَ إِلَىٰ أَوْلِيَآئِهِمْ لِيُجَدِّلُوكُمْ ۖ وَإِنْ أَطَعْتُمُوهُمْ
 إِنَّكُمْ لَشُرَّكُونَ ﴿١٢١﴾

"Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e All'Ilahut, sepse kjo është gjynah! Në të vërtetë, djajtë i nxisin miqtë e vet që t'ju kundërshtojnë ju. E nëse ju u bindeni atyre, me siguri që edhe ju do të ishit idhujtarë."

Komentimi

Në ajetet e mëparshme u fol rreth aspektit pozitiv të çështjes së mishit, pra, ngrënia e mishit të lejuar. Në këtë ajet kemi përforcimin e aspektit negativ të çështjes: "**Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e All'Ilahut...**" Më pas, me një fjali të vetme, e dënon këtë vepër: "...sepse kjo është gjynah...", mëkat e dalje nga rruga e adhurimit dhe e bindjes ndaj All'Ilahut.

Në mënyrë që disa myslimanë të thjeshtë të mos mbesin nën ndikimin e cytjeve të shejtanit, ajeti u thotë: "...**Në të vërtetë, djajtë i nxisin miqtë e vet që t'ju kundërshtojnë ju...**" Shejtanët ju pëshpëritin në fshehtësi për t'i ndjekur ata, në mënyrë që të futen me ju në kontradiktë e debat, kështu që jeni të kujdesshëm e

mos iu bindni atyre: "...E nëse ju u bindeni atyre, me siguri që edhe ju do të ishit idhujtarë."

Ndoshta kjo polemikë e kjo cytje është tregues i asaj që ka ekzistuar në atë kohë te politeistët, për ngrënien e të ngordhurës (e disa thonë se arabët politeistë e kanë marrë atë nga Mexhusi). Ata thonin: 'Ne e hamë të ngordhurën, sepse All'llahu e ka ngordhur atë dhe kjo është më e mirë se sa ta mbysim me duart tona.' Ata besonin se mosngrënia e ngordhësirës është një lloj refuzimi i veprës së All'llahut! Ata ishin të pavëmendshëm se kafsha e ngordhur është burim sëmundjesh, për shkak të mosrrjedhjes së gjakut, shkëputjes së venave të qafës, pasi ky gjak i prishur e prish edhe mishin e bagëtisë. Kjo është arsyeja që All'llahu urdhëroi mosngrënien e këtij mishi, por të hahet vetëm mishi i kafshëve të therura në mënyrë të veçantë, ku gjaku rrjedh jashtë trupit të bagëtisë.

Nga ky ajet përftohet, përgjithësisht, ndalimi i therjes jo islame, sepse, përveç anëve të tjera negative që ka kjo vepër, therja e bagëtisë është bërë pa përmendur emrin e All'llahut.

Ajete 122 - 123

أَوَمَنْ كَانَ مِيتًا فَأَحْيَيْنَاهُ وَجَعَلْنَا لَهُ نُورًا يَمْشِي بِهِ فِي
النَّاسِ كَمَنْ مَثَلُهُ فِي الظُّلُمَاتِ لَيْسَ بِخَارِجٍ مِّنْهَا ۚ كَذَلِكَ زُيِّنَ
لِّلْكَافِرِينَ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ﴿١٢٢﴾ وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا فِي كُلِّ قَرْيَةٍ
أَكْبَرَ مُجْرِمِيهَا لِيَمْكُرُوا فِيهَا ۖ وَمَا يَمْكُرُونَ إِلَّا بِأَنْفُسِهِمْ
وَمَا يَشْعُرُونَ ﴿١٢٣﴾

"A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj?! Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë."

"Kështu, Ne kemi bërë në çdo qytet që keqbërësit më të mëdhenj të ngrenë kurthe. Mirëpo, kurthet ia ngrenë vetëm vetvetes e nuk e ndiejnë."

Shkaku i zbritjes

Shkaku i zbritjes së ajetit të parë është për Ebu Xhehlin, i cili ka qenë një ndër armiq të më të egër të Islamit dhe të Dërguarit të All'llahu (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Një ditë ai e lëndoi shumë rëndë të Dërguarin e All'llahut.

Aty ndodhej Hamzai, xhaxhai i Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ky burrë trim, nuk e kishte pranuar ende Islamin, madje ishte i lëkundur. Atë ditë doli si zakonisht, në shkretëtirë, për gjueti. Kur u kthye, dëgjoi se çfarë kishte ndodhur ndërmjet Ebu Xhehlit dhe djalit të vëllait të tij. U mërzit jashtë mase dhe shkoi te Ebu Xhehli. E goditi atë me grushte, derisa gjaku rrodhi nga hunda e tij. Edhe pse Ebu Xhehli kishte një pozitë më të lartë se Hamzai, nuk iu kundërpërgjigj atij, sepse e njihte shumë mirë trimërinë e tij.

Hamzai u kthye te i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe shpalli pranimin e Islamit. Që atë ditë, u bë ushtar i ushtrisë së Islamit dhe e mbrojti atë derisa ra dëshmor në duart e të Dërguarit të All'lahut. Ky ajet ka zbrit për këtë ndodhi dhe sqaon pranimin e Islamit nga ana e Hamzait dhe këmbënguljen e Ebu Xhehlit në mosbesim.

Ndërsa nga disa transmetime të tjera lexojmë se ky ajet ka zbritur për Amar ibn Jasir, që pranoi Islamin, dhe këmbënguljen e Ebu Xhehlit në mosbesim.

Cilido që të jetë shkaku i zbritjes, ky ajet, ashtu sikurse ajetet e tjera, nuk është i posatshëm vetëm me ndodhinë e zbritjes së tij, por ai ka kuptim të gjerë që vlen për çdo besimtar të singertë dhe për çdo kundërshtar kokëfortë.

Komentimi

Besimi dhe vizioni i qartë

Ky ajet lidhet me ajetet e mëparshme nga që ato të mëparshmet na treguan për dy grupe njerëzish: besimtarë të singertë dhe mohues kokëfortë. Këta mohues kokëfortë, nuk

mjaftohen me humbjen e tyre, por përpiqen të humbasin edhe të tjerë. Këtu trupëzohet pozicionimi i këtyre dy grupeve nëpërmjet prurjes së shembullit të qartë.

Një grup njerëzish që kanë qenë të humbur e më pas ndryshuan, duke përqafuar Islamin. Në këtë drejtim ata janë të ngjashëm me të vdekurit, të cilët i ringjalli All'llahu me dëshirën e Tij: **"A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj?!..."**

Kur'ani i përdor shpesh fjalët jetë dhe vdekje me kuptim figurativ, duke simbolizuar me to besimin dhe mosbesimin. Kjo tregon se besimi nuk është thjesht bindje e thatë apo ritual, por është si shpirti, që futet te qeniet e vdekura jobesimtare e ndikon në të gjitha çështjet e tyre: syve u jep shikimin, veshëve aftësinë e dëgjimit, gjuhës forcën e elokuencës e gjymtyrëve qëndresë për kryerjen e aktiviteteve dobiprurëse. Besimi ndryshon individët dhe ky ndryshim përfshin të gjitha aspektet e jetës. Ndikimet e këtij ndryshimi shihen jo vetëm në lëvizje, por edhe në qetësi.

Nga fraza **"...Ne e ngjallëm..."** përfitohet se njeriu, edhe nëse kërkon ta arrijë besimin, nuk e plotëson atë veçse me udhëzim nga All'llahu! Më pas ajeti vazhdon **"...dhe i dhamë dritë me të cilën ecën midis njerëzve..."**

Edhe pse ka mendime të ndryshme rreth komentimit të fjalës "nur", "dritë", por mesa duket synimi këtu nuk është vetëm Kur'ani dhe mësimet e fesë, por më shumë se kaq, sepse besimi te All'llahu i jep njeriut një perceptim të ri, i jep një vizion të qartë, ia zgjeron atij horizontin, në mënyrë që të kapërcejë kufijtë e jetës së tij materiale, muret e botës së ngushtë materiale, drejt një bote më të kënaqshme e më të gjerë.

Meqenëse besimi e fton njeriun të ndërtojë vetveten, ai largon nga sytë e tij perdet e egoizmit, të fanatizmit, të arrogancës e të epsheve dhe i shfaq atij të vërteta që s'ka qenë i aftë t'i shohë më parë.

Me të vërtetë, në dritën e këtij besimi, njeriu mund të dallojë ecurinë e jetës së tij në mesin e njerëzve, të përmirësujë veten e tij e ta mbrojë atë nga rreziqet makute e të babëzitura dhe nga idetë e kufizuara materiale të të tjerëve, duke qëndruar përballë epsheve të tij dhe duke mbajtur nën kontroll kapriçiot e tyre.

Ajo që ne lexojmë në hadithet islame se “Besimtari shikon me nurin e All'llahut” tregon për këtë të vërtetë. Thjesht përshkrimi nuk ka mundësi të sqarojë të veçantat e këtij vizioni të besimit, të dhuruar nga All'llahu. Madje është e domosdoshme që njeriu ta shijojë shijen e besimit, në mënyrë që të perceptojë thelbin e kësaj thënieje dhe ta ndiejë atë.

Më pas ajeti bën një krahasim ndërmjet njeriut të gjallë, aktiv, me një njeri pa besim e kundërshtar: “...**me atë që është në errësi e nuk mund të dalë prej saj...**” pra, kurrë nuk mund të barazohet ai që ecën në dritë me atë që është në errësi.

Vëmë re këtu se ajeti nuk thotë “Si ai në errësi”, por: “Si ai i tillë në errësi” Disa thonë se qëllimi i përdorimit të kësaj fraze është për të treguar se këta individë janë zhytur aq thellë në errësira e fatkeqësi sa që i ka bërë shembull që t'i njohin ata që kuptojnë.

Ky mund të jetë tregues për një kuptim edhe më të hollë, që është se: Nga ekzistenca e këtyre individëve nuk ka mbetur asgjë, përveç fantazmës apo statujës. Ata kanë qenie të zbrazët nga shpirti dhe mendje jashtë funksionit.

Duhet të themi se fjala "nur", "dritë", me të cilën udhëzohen besimtarët, është në numrin njëjës, ndërsa fjala "dhulumaat", "errësirat", në të cilën jetojnë mohuesit, është në numrin shumës. Arsyeja e përdorimit në këto numra është se besimi është një e vërtetë e vetme, ai simbolizon njëshin dhe njësimin, ndërsa mohimi dhe mosbesimi fton në përçarje e në ndarje.

Ajeti mbyllet duke na treguar finalizimin e këtyre fatkeqëve: **"...Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë."**

Kemi thënë më lart se veçoria e përsëritjes së një vepre të keqe është se e keqja e saj zbehet në sytë e vepruesit, derisa bëhet e bukur e shndërrohet si zinxhiri që tërheq anët e tij dhe e ndalon atë të dalë nga gracka. Thjesht, nëse do të vëmë re gjendjen e kriminelëve, do ta zbulojmë me lehtësi këtë realitet. Heroi i këtyre dukurive negative ishte Ebu Xhehli, një nga politeistët më të mëdhenj kurejsh.

Ajeti pasardhës tregon gjendjen e këtyre liderëve të humbur, komandantëve mohues e shkatërrimtarë: **"Kështu, Ne kemi bërë në çdo qytet që keqbërësit më të mëdhenj të ngrenë kurthe..."**

E kemi thënë edhe më parë se shkakut i atribuimit të këtyre veprave tek All'llahu, është qenia e Tij "Shkaku" i shkaqeve dhe burimi i të gjitha mundësive dhe fuqive. Njeriu i përdor ato mundësi që i ka dhuruar All'llahu, në kryerjen e veprës së keqe apo të veprës së mirë.

Fraza "...të ngrenë kurthe..." tregon fundin e veprave të tyre dhe nuk nënkupton qëllimin e krijimit të tyre,¹ pra është fundi i kundërshtimit të tyre dhe mëkatet e shumta të tyre u bënë pengesë për ata që të ecin në rrugën e drejtë, u bënë shkaktarë të largimit të njerëzve nga rruga e vërtetë. Kuptimi origjinal i fjalës "mekrun", është "dinakëri, intrigë". Më pas është përdorur për çdo vepër të devijuar, e shoqëruar me fshehje.

Në mbyllje ajeti thotë: "...**Mirëpo, kurthet ia ngrenë vetëm vetvetes e nuk e ndiejnë.**"

A ka mashtrim e tradhti më të madhe për ata që përdorin gjithë kapitalin e tyre, duke përfshirë idetë, shpikjet, mundin, kohën, pasurinë, për një marrëveshje që nuk i sjell asnjë fitim?! Përkundrazi, gjithë kjo peshë e rëndon kurrizin e tyre me barrën e mëkateve e gabimeve të rënda.

Ajo që kuptohet nga ky ajet është se katastrofat dhe mjerimi që godasin shoqëritë, vijnë nga liderët e tyre, sepse "strehohen" tek intriga, djallëzia e hileja për ndryshimin e "shenjave" të rrugës së All'Ilahut, duke fshehur fytyrën e vërtetë nga njerëzit.

¹ Pjesëza *lam* këtu është "ndëshkuese" dhe jo finalizuese. Në këtë mënyrë është transmetuar shpesh në Kur'an.

Ajeti 124

وَإِذَا جَاءَتْهُمْ آيَةٌ قَالُوا لَنْ نُؤْمِنَ حَتَّى نُؤْتَىٰ مِثْلَ مَا أُوتِيَ رُسُلُ اللَّهِ
 اللَّهُ أَعْلَمُ حَيْثُ يَجْعَلُ رِسَالَتَهُ سَيُصِيبُ الَّذِينَ أَجْرَمُوا صَغَارٌ عِنْدَ
 اللَّهِ وَعَذَابٌ شَدِيدٌ بِمَا كَانُوا يَمْكُرُونَ ﴿١٢٤﴾

"Kur atyre u vjen ndonjë mrekulli, thonë: 'Ne nuk do të besojmë deri sa të mos na jepet diçka, si ajo që u është dhënë të dërguarve të All'Ilahut'. All'Ilahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet. Atyre që kanë bërë gjynahe, do t'u vijë një poshtërim nga ana e All'Ilahut dhe ndëshkim i ashpër për shkak të kurtheve që ngrenin."

Shkaku i zbritjes

Dijetari i shquar Tabarisij, në komentimin e tij "Mexhmaul Bejjan", thotë: Ky ajet ka zbritur për Uelijd ibn El Mugijreh (ka qenë nga liderët e adhuresve të idhujve dhe mendimtar i madh i tyre). Ky i thoshte të Dërguarit të All'Ilahut (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Nëse profetësia

jote është e vërtetë, atëherë unë e meritoj më shumë për moshën time të madhe dhe për pasurinë e shumtë që kam.”¹

Thuhet se ajeti ka zbritur për Ebu Xhehlin, ngaqë ai thoshte: “Pozita e Profetit duhet të jetë konkurruese, kështu që ne dhe fisi Abdul Menaf (fisi i të Dërguarit të All’liahut) konkurronim për çdo gjë, bënim hipizëm sup më sup e venim bast, derisa thanë: “Një Profet ka ardhur te ata. Atij i zbret shpallja. Kështu që ne nuk i besojmë atij, vetëm nëse neve na zbret shpallje siç i zbret atij.”²

Komentimi

All’liahu e di më së miri se kujt ia jep mesazhin e Vet

Ky ajet tregon shkurtimisht mënyrën e mendimit të atyre “të mëdhenjve kriminelë e të padrejtë” dhe pretendimet e tyre qesharake e të pavërteta. Ai thotë: **“Kur atyre u vjen ndonjë mrekulli, thonë: ‘Ne nuk do të besojmë deri sa të mos na jepet diçka, si ajo që është dhënë të dërguarve të All’liahut’...”**

Fjalët e këtyre “të mëdhenjve” të lënë të kuptosh se pozita e profetësisë dhe udhëzimi i njerëzve mbështetet te mosha e personit apo te pasuria e tij. Ose është fushë konkurruese fëmijërore ndërmjet fisesh! Po ashtu nënkuptohet se All’liahu duhet të kujdeset për këto çështje qesharake, të pavërteta, të cilat nuk tregojnë gjë tjetër veçse fundin e dekadencës ideologjike dhe mosperceptimin e kuptimit të udhëheqjes së njerëzve!

¹ Komentimi “Mexhmaul Bejjan”, vëll. 4, f. 155, fundi i ajetit 124 të sures “En’am”.

² Burim i mëparshëm.

Kur'an i ua kthen atyre me qartësi: **"...All'illahu e di më mirë se kujt ia jep mesazhin e Vet..."**

Është e sigurtë dhe e padiskutueshme se Mesazhi nuk ka lidhje as me moshën, as me pasurinë dhe as me pozitën e fiseve, sepse kushti i tij i parë është përgatitja shpirtërore, pastrimi i ndërgjegjes, natyra njerëzore, mendimi i lartë, vizioni i drejtë e më pas devotshmëria e lartë deri në gradën e pagabueshmërisë. Këto cilësi, e veçanërisht përgatitja për gradën e pagabueshmërisë, nuk e di tjetërkush përveç All'illahut. Sa dallim i madh është ndërmjet këtyre kushteve dhe atyre që vërtitej në mendjet e tyre!

Gjithashtu, edhe zëvendësi i Dërguarit të All'illahut (Paqja dhe bekimi i All'illahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) detyrimisht duhet t'i ketë të gjitha këto cilësi, me përjashtim të profetësisë dhe shpalljes, pra, ai zëvendës është mbrojtës i Sheriatit dhe i ligjeve të tij si dhe udhëheqës për çështjet materiale e shpirtërore për njerëzit. Si rrjedhim, duhet të jetë i pagabueshëm, në mënyrë që të jetë i aftë të transmetojë mesazhin dhe qëllimet e tij, të jetë udhëheqës i bindur e shembull ku të mbështeten të tjerët.

Bazuar mbi këtë, edhe zgjedhja e zëvendës të Profetit, gjithashtu, është nga All'illahu, pasi Ai është i vetmi që e di se kujt ia lë këtë pozitë, sepse nuk mund t'i lihet kjo njerëzve, as votimeve e as konsultimit.

Në fund ajeti tregon fundin që i pret këta udhëheqës kriminelë, të cilët pretendojnë të pavërtetën: **"...Atyre që kanë bërë gjynahe, do t'u vijë një poshtërim nga ana e All'illahut dhe ndëshkim i ashpër për shkak të kurtheve që ngrenin."**¹

¹ Fjala "El Ixhram", vjen nga folja "xhereme" dhe rrënja e saj vjen nga fjala "el kat'u", prerje. Krimineli është ai që pret besën dhe lidhjen e tij me All'illahun,

Këta egoistë, me qëndrimin e tyre armiqësor, dëshironin të ruanin pozitat e tyre, por All'llahu do t'i zbresë ata në gradat më të ulëta e poshtëruese, ku ata do të torturohen me një dënim të ashpër shpirtëror në këtë jetë dhe ata i pret dënim akoma më i rëndë në Botën Tjetër, sepse përpjekjet e tyre në rrugën e pavërtetë kanë qenë gjithashtu të ashpra.

duke mos iu bindur Atij. Kjo është arsyeja që fjala "el xhurmu", krimi, përdoret për fajin dhe mëkatin. Këtu ka një tregues interesant se tek njeriu ekziston një marrëveshje me të drejtën, të pastrën dhe drejtësinë dhe se "el ixhramu", krimi, është ndërprerësi i kësaj marrëveshjeje të vednosur nga All'llahu në natyrën e krijuar të njeriut (el fitratu).

Ajetet 125 - 127

فَمَنْ يُرِدِ اللَّهُ أَنْ يَهْدِيَهُ يَشْرَحْ صَدْرَهُ لِلْإِسْلَامِ ۖ وَمَنْ يُرِدْ أَنْ
يُضِلَّهُ يَجْعَلْ صَدْرَهُ ضَيِّقًا حَرَجًا كَأَنَّمَا يَصَّعَّدُ فِي السَّمَاءِ ۚ
كَذَلِكَ يَجْعَلُ اللَّهُ الرِّجْسَ عَلَى الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ ﴿١٢٥﴾
وَهَذَا صِرَاطُ رَبِّكَ مُسْتَقِيمًا ۖ قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَذْكُرُونَ
﴿١٢٦﴾ هُمْ دَارُ السَّلَامِ عِنْدَ رَبِّهِمْ ۖ وَهُوَ وَلِيُّهُمْ بِمَا كَانُوا
يَعْمَلُونَ ﴿١٢٧﴾

"Atë që do All'Ilahu ta udhëzojë ia zgjeron kraharorin për Islamin, ndërsa atë që dëshiron ta lërë në humbje, ia shtrëngon kraharorin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, All'Ilahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë."

"Kjo është rruga e drejtë e Zotit tënd. Ne ua kemi shpjeguar shpalljet Tona njerëzve që ua vënë veshin."

"Ata do të kenë Shtëpinë e shpëtimit të Zoti i tyre. Ai do të jetë Mbrojtësi i tyre, si shpërblim për veprat që kanë bërë."

Komentimi

Furnizimet Hyjnore

Pas ajeteve të mëparshme që flitnin rreth besimtarëve të sinqertë dhe jobesimtarëve kokëfortë, vijmë këto ajete që shpjegojnë begatitë që i presin besimtarët e sinqertë dhe fatkeqësitë e mohuesve kundërshtarë e kokëfortë. Ajetet tregojnë se All'Ilahu begaton me udhëzim atë që do, duke ia hapur kraharorin për pranimin e Islamit, ndërsa atë që nuk dëshiron, për shkak të veprave të tij të këqija, ia ngushton kraharorin, saqë atij i duket sikur po ngjitet drejt qiellit: **"Atë që do All'Ilahu ta udhëzojë ia zgjeron kraharorin për Islamin, ndërsa atë që dëshiron ta lërë në humbje, ia shtrëngon kraharorin si të jetë duke u ngjitur në qiell..."**

Për të përforcuar mendimin, ajetin thotë: **"...Kështu, All'Ilahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë."**

Hulumtime

Këtu duhet të vështrojmë me kujdes pikat e mëposhtme:

1- Çfarë synohet me udhëzim dhe me humbje?

E kemi thënë disa herë më parë se qëllimi me fjalët *udhëzim* dhe *humbje nga ana e All'Ilahut*, është siguri i situatave dhe premisave që çojnë drejt udhëzimit ata që janë të gatshëm për një gjë të tillë, si dhe heqjen e të drejtës atyre që nuk janë të gatshëm për një gjë të tillë, duke pasur parasysh veprat e tyre.

Për ata që ndjekin rrugën e vërtetë, për kërkuesit e besimit dhe të eturit për të, All'llahu vendos në rrugën e tyre fenerë ndriçues, që të mos humbin në errësirat e rrugës, por të arrijnë te burimi i ndritur dhe i lumtur i jetës. Ndërsa ata që neglizhojnë të ecin në drejtim të këtyre të vërtetave, janë të privuar nga këto furnizime të All'llahut. Gjatë rrugës së tyre do të ndeshen me shumë probleme dhe nuk do të mbarësohen për udhëzim.

Bazuar mbi këtë, as grupi i parë s'është i detyruar të ecë në këtë rrugë, as grupi i dytë në veprat e tyre. Në realitet, udhëzimi e humbja plotësohen nga ajo që dëshirojnë e zgjedhin anëtarët e secilit grup.

2- Cili është qëllimi i fjalës "*es sadr*"?

Qëllimi i fjalës "*es sadru*", që përmendet këtu është për shpirtin dhe të menduarit. Kjo metonimi përsëritet shpesh. Qëllimi i frazës: "**ia zgjeron**" "*jeshrehu*", është për kënaqësinë e shpirtit dhe zgjerimin e horizonteve të mendjes njerëzore, sepse pranimi i së vërtetës kërkon të hiqet dorë nga shumë interesa personale, të cilën nuk e bën dot njeri, me përjashtim të atyre që kanë shpirtira e ide të larta.

3- Çfarë është "*el harexhu*"?

Fjala "*el harexhu*" ka kuptimin e ngushtimit të fortë. Kjo është gjendja e kokëfortëve dhe e humbësve të besimit. Mendimi i tyre është i shkurtër dhe shpirti i tyre është i vogël dhe i ngushtë. Ata nuk heqin dorë nga asgjë gjatë jetës së tyre.

4- Mrekulli shkencore kur'anore

Krahasimi i përdorur në këtë ajet me ngjitjen në qiell për ata që nuk i besojnë të vërtetat, është bërë sepse ngjitja drejt qiellit është shumë e vështirë, gjithashtu, e njëjta gjë është edhe pranimi i të vërtetës nga ana e tyre.

Edhe ne kur flasim sot e përdorim këtë ngjashmëri. Kur themi se arritja në një çështje është e vështirë themi: "Më lehtë është të ngjitesh në qiell, se sa zgjidhja e kësaj çështjeje."

Sigurisht, në atë kohë fluturimi në qiell për njerëzit ishte vetëm një përfytyrim. Edhe pse sot shkenca ka bërë shumë përparime, përsëri ngjitja në qiell është shumë e vështirë, po nuk pate mjetet e nevojshme. Edhe astronautët hasin probleme në fluturimet e tyre.

Është vërtetuar sot shkencërisht se ajri në afërsi të tokës është i ngjeshur, është i vlefshëm për frymëmarrjen e njeriut. Sa më shumë që të ngrihemi lart, pakësohet dendësia e ajrit dhe përqindja e oksigjenit në të. Nëse ngrihemi disa kilometra, frymëmarrja vështirësohet. Nëse vazhdojmë akoma ngjitjen, nuk do të mund të marrim frymë e do të na bjerë të fikët.

Si përfundim, përmendja e këtij krahasimi, në atë kohë, para se të vërtetohej shkencërisht ky fakt, konsiderohet një nga mrekullitë shkencore kur'anore.

5- Çfarë është zgjerimi i kraharorit?

Në këtë ajet "*sherhu sadr*", zgjerimi i kraharorit, konsiderohet një nga begatitë e mëdha të All'llahut, ndërsa "*dhijku sadr*", ngushtimi i kraharorit, konsiderohet prej ndëshkimit të All'llahut.

Kjo gjë është përmendur nga All'llahu i Lartësuar në ajetin 1 të sures "El-Inshirah": "**Vallë, a nuk ta zgjeruam ty (Muhammed) kraharorin** (për të pranuar besimin)."¹ Kjo sqarohet edhe më shumë me studimin e personave. Ti shikon disa njerëz me kraharor të gjerë që kanë arritur deri në atë shkallë sa që kuptojnë dhe përceptojnë shumë të vërteta, sado të mëdhaja të jenë. Gjithashtu, shikon të kundërtën e tyre me kraharor të ngushtë, në të cilët nuk depërton asnjë e vërtetë. Horizontet e të menduarit të tyre janë shumë të kufizuar dhe të ngushta për çështjet e jetës. Nëse atyre u sigurohen të ngrënit dhe të pirët, çdo gjë është në rregull për ata, nëse ky sistem nuk funksionon jeta e tyre shkatërohet e tëra.

Në momentin që zbriti ajeti i sipërpërmendur, u pyet i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kuptimin e zgjerimit të kraharorit. Ai u përgjigj: "Është dritë që All'llahu e hedh në zemrën e atij që do, duke ia zgjeruar kraharorin."

Më pas e pyetën të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "A ka për këtë ndonjë shenjë dalluese?"

I Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u përgjigj: "Po, është delegimi drejt Xhennetit (*Parajsës së përhershme*), izolimi ndaj shtëpisë së dinakërisë dhe përgatitja për vdekje para zbritjes së vdekjes."²

Ky hadith thekson se si duhet të ecet në rrugën e All'llahut, me besim, përpjekje e vepër të mirë.

¹ Sure "El Inshirah", ajeti 1.

² Komentimi "Mexhmaul Bejjan", vëll.4, f. 157. "Biharul Enuar", vëll. 65, f. 236.

Ajeti pasardhës përforcon hulumtimin e mëparshëm dhe thotë se mirësitë e All'llahut që përfshijnë rrugëtuesit në rrugën e besimit dhe të adhurimit të All'llahut, u zhvishen atyre që nuk ecin në rrugën e All'llahut. Ajeti përforcon se rruga e vetme është ajo e All'llahut, ku thotë: **"Kjo është rruga e drejtë e Zotit tënd..."** Me të vërtetë, ky është një ligj i drejtë e i qëndrueshëm hyjnor, që s'ka ndryshim.

Përemri dëftor *ky* ka mundësi të jetë tregues për Islamin ose për Kur'anin.

Në fundin e ajetit ka një përforcim tjetër: **"...Ne ua kemi shpjeguar shpalljet Tona njerëzve që ua vënë veshin."**

Ajeti i tretë prej ajeteve në fjalë, tregon për dy mirësi prej mirësive më të mëdhaja, të cilat All'llahu ua jep atyre që kërkojnë të vërtetën. E para është: **"Ata do të kenë Shtëpinë e shpëtimit të Zoti i tyre..."** E dyta: **"...Ai do të jetë Mbrojtësi i tyre..."**, pra, Përkrahësi dhe Mbrojtësi i tyre. Këto dhurata do t'u jepen nga All'llahu i Lartësuar falë veprave të mira që kanë bërë, siç thotë ajeti: **"...si shpërblim për veprat që kanë bërë."**

A ka krenari më të madhe e më të lartë se sa All'llahu të mbrojë çështjet e njeriut, ta garantojë atë e të jetë Mbrojtësi e Mbikëqyrësi i tij?! A ka begati më madhështore se sa të ketë Xhennetin, vendin e sigurt, ku s'ka luftë, gjakderdhje, kontradikta, armiqësi, dhunë, konkurrencë, vrasës e të vdekur, as përplasje e as interesa, as gënjeshtër e as shpifje, as akuza mëri e smirë, as stres e as ankth, përkundrazi qetësi, rehati e lumturi?!

Këto mrekulli nuk vijnë thjesht me fjalë. Ato dhurohen në këmbim të veprës së mirë dhe punëve të begata!

Ajetet 128 - 129

وَيَوْمَ نَحْشُرُهُمْ جَمِيعًا يَمْعَشَرِ الْجِنَّ قَدْ اسْتَكْثَرْتُمْ مِّنَ الْإِنسِ ۖ
 وَقَالَ أَوْلِيَائُهُم مِّنَ الْإِنسِ رَبَّنَا اسْتَمْتَعَ بَعْضُنَا بِبَعْضٍ وَبَلَغْنَا
 أَجَلَنَا الَّذِي أَجَلْتَ لَنَا ۖ قَالَ النَّارُ مَثْوَاكُمْ خَالِدِينَ فِيهَا إِلَّا
 مَا شَاءَ اللَّهُ ۗ إِنَّ رَبَّكَ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿١٢٨﴾ وَكَذَلِكَ نُؤَلِّي بَعْضَ
 الظَّالِمِينَ بَعْضًا بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ ﴿١٢٩﴾

"Ditën kur Ai do t'i tubojë të gjithë, do të thotë: 'O tog i xhindeve! Ju keni mashtruar shumë njerëz!'- Ithtarët e tyre midis njerëzve do të thonë: 'O Zoti ynë! Ne u kënaqëm me njëri-tjetrin dhe arritëm në afatin tonë, të cilin na e pate caktuar Ti'. All'llahu do të thotë: 'Zjarri është vendbanimi juaj. Atje do të qëndroni përherë, veç nëse All'llahu dëshiron ndryshe. Zoti yt është vërtet i Urtë e i Gjithëdijshtëm.'"

"E kështu, Ne u japim pushtet disa keqbërësve mbi të tjerët, si dënim për veprat e tyre të këqija."

Komentimi

Këto dy ajete sqarojnë fundin e kriminelëve, duke u kujtuar ditën që do të rrinë ballë përballë me shejtanët, prej të cilëve u frymëzuan. Në këtë vend nuk ka gjë tjetër veçse pikëllim e mërzitje. Këto janë për t'i tërhequr vërejtjen njeriut, në mënyrë që të mos shohë vetëm në ditët e tij të numëruara në tokë, por është detyrë e tij që të mendojë edhe për fundin e jetës dhe për atë që e pret pas vdekjes.

Në fillim ajeti u kujton atyre Ditën kur do të grumbullohen njerëzit dhe xhindet. Më pas do t'u thuhet: O ju të humburit prej xhindeve keni çuar në humbje shumë nga njerëzit, siç e thotë edhe ajeti: **"Ditën kur Ai do t'i tubojë të gjithë, do të thotë: 'O tog i xhindeve! Ju keni mashtruar shumë njerëz!'..."**

Xhindet këtu janë shejtanët, sepse fjala *xhin*, siç e kemi thënë edhe më parë, përfshin çdo qenie të padukshme. Ajeti 50 i sures "Kehf" përmend kryetarin e shejtanëve, Iblijsin, **"Ka qenë nga xhindet."** Edhe ajetet e mëparshme na folën për cytjet e shejtanëve dhe pëshpëritjet e tyre: **"Me të vërtetë, shejtanët cytin e pëshpëritin përkrahësit e tyre"**. Gjithashtu, edhe ajeti pasardhës që flet për pushtetin e disa të padrejtëve mbi të tjerët, mund të jetë tregues për të njëjtën temë.

Duket qartë se shejtanët e humbur nuk kanë përgjigje në dorë për këtë pyetje dhe qëndrojnë në heshtje. Mirëpo, ndjekësit e tyre prej njerëzve thonë: Zoti ynë ato përfituan nga ne, ashtu sikurse edhe ne përfituam nga ata, derisa na erdhi fundi: **"...Ithtarët e tyre midis njerëzve do të thonë: 'O Zoti ynë! Ne u kënaqëm me njëri-tjetrin dhe arritëm në afatin tonë, të cilin na e pate caktuar Ti'..."**

Pra, shejtanët kanë qenë të gëzuar nga pushteti i tyre mbi ne dhe ne i kemi ndjekur ata të dorëzuar. Kemi shijuar bukuritë e kësaj jete, të palidhur me ndonjë gjë, as duke e kthyer kokën prapa, për të parë shpejtësinë e ikjes së saj, ngaqë shejtanët na pëshpëritnin në vesh, duke na e shfaqur këtë botë me pamje të bukur e tërheqëse.

Mendimet e komentuesve ndryshojnë për qëllimin e fjalës *exhel* se: A është ai fundi i jetës së njeriut apo Dita e Ringjalljes? Ajo që mund të themi është se kjo fjalë ka kuptimin e përfundimit të jetës, sepse fjala *exhel* është përmendur shpeshherë në Kur'an me këtë kuptim.

Mirëpo, All'llahu u drejtohet pasuesve e ndjekësve shkatërrimtarë e të shkatërruarve së bashku: **"...All'llahu do të thotë: 'Zjarri është vendbanimi juaj. Atje do të qëndroni përherë, veç nëse All'llahu dëshiron ndryshe'..."**

Fjala përjashtuese **"veç nëse All'llahu dëshiron ndryshe"**, ose është tregues për qëndrimin e tyre të përhershëm në ndëshkim e dënim, (në këto raste nuk mohohet aftësia e All'llahut për ndryshimin e vendimit, sepse All'llahu është i aftë ta ndryshojë vendimin në çdo kohë që do, edhe nëse e lë përherë një grup prej tyre), ose është tregues për ata që nuk e meritojnë qëndrimin e përhershëm në torturë, ose për ata që e meritojnë faljen e All'llahut, kështu që është i domosdoshëm përjashtimi i përhershëm i tyre nga ndëshkimi.

Në mbyllje ajeti thotë: **"...Zoti yt është vërtet i Urtë e i Gjithëdijshëm."** kështu që ndëshkimi i Tij bazohet mbi një llogari të hollësishme. Gjithashtu edhe falja e Tij, sepse All'llahu e di më së miri se cili e meriton atë.

Ajeti i fundit, prej ajeteve në fjalë, tregon ligjin e qëndrueshëm të All'llahut, në lidhje me këto persona dhe deklarën se, për tiranët e të padrejtë, pozita e tyre në Botën Tjetër, do jetë ashtu siç ka qenë në këtë botë, duke çuar njëri-tjetrin në shkatërrim, përfundim të keq e devijim: **"E kështu, Ne u japim pushtet disa keqbërësve mbi të tjerët, si dënim për veprat e tyre të këqija."**

Ashtu siç kemi përmendur në studime të veçanta, në lidhje me Ditën e Ringjalljes, ajo Ditë do të jetë një skenë rrëqethëse dhe pamja madhështore dhe nuk ka ndryshim të veprave tona që kemi bërë në këtë botë.

Duhet të përmendim këtu, se të gjithë së bashku janë përshkruar me padrejtësi në këtë ajet. Nuk ka dyshim se padrejtësia, me kuptimin e saj të gjerë, i përfshin të tërë. A ka padrejtësi më të madhe se sa të nxjerrë njeriu veten e tij nga sipërmarrja e All'llahut e të hyjë në sipërmarrjen e mendjemëdhenjve, t'i ndjekë ata e në Botën Tjetër të jetë me ata i poshtëruar?!

Për më tepër, ky përshkrim si dhe fraza: **"...për veprat e tyre të këqija."** tregojnë se përfundimi i keq është për shkak të veprave të tyre. Ky, pra, është ligji i All'llahut dhe ligj i krijimit që gjykon, se ata që ecin në errësirë, patjetër që do të bien në humnerën e mjerimit e të fatkeqësisë.

Ajetet 130 - 132

يَمَعَشَرَ الْجَنِّ وَالْإِنْسِ أَلَمْ يَأْتِكُمْ رُسُلٌ مِّنْكُمْ يَقُصُّونَ عَلَيْكُمْ
 ءَايَاتِي وَيُنذِرُونَكُمْ لِقَاءَ يَوْمِكُمْ هَٰذَا ^ج قَالُوا شَهِدْنَا عَلَىٰ أَنْفُسِنَا
^ط وَغَرَّتْهُمْ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَشَهِدُوا عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ أَنَّهُمْ كَانُوا
 كَافِرِينَ ﴿١٣٠﴾ ذَٰلِكَ أَن لَّمْ يَكُن رَّبُّكَ مُهْلِكَ الْقُرَىٰ بِظُلْمٍ
 وَأَهْلُهَا غَافِلُونَ ﴿١٣١﴾ وَلِكُلِّ دَرَجَةٍ مِّمَّا عَمِلُوا ^ج وَمَا رَّبُّكَ
 بِغَافِلٍ عَمَّا يَعْمَلُونَ ﴿١٣٢﴾

“O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t’ju treguar shpalljet Tona dhe për t’ju paralajmëruar takimin me këtë ditë?’ Ata do të thonë: ‘Ne dëshmojmë kundër vetes sonë’. Vërtet, jeta e kësaj bote i mashtroi ata, kështu që ata do të dëshmojnë kundër vetes se kanë qenë mohues.”

"Kjo ndodh sepse Zoti yt nuk e shkatërron asnjë vend për padrejtësinë e tyre, ndërkohë që banorët e tij janë të pavëmendshëm. "

"Secili do të ketë shkallën e tij, sipas veprave që ka bërë. Zoti yt nuk është i paditur për veprat e tyre."

Komentimi

Plotësimi i argumentimit

Në ajetet e mëparshme u bë përshkrimi i përfundimit të të padrejtëve e të ndjekësve të shejtanëve në Ditën e Ringjalljes. Me qëllim që askush të mos mendojë se kanë qenë të pavëmendshëm për ato që vepruan, këto ajete sqarojnë se paralajmërimi i tyre mbaroi, po ashtu u plotësuan për ta argumentet. Për këtë, u thuhet atyre në Ditën e Ringjalljes: **"O tog i xhindeve dhe i njerëzve, a nuk ju patën ardhur të dërguar nga mesi juaj, për t'ju treguar shpalljet Tona dhe për t'ju paralajmëruar takimin me këtë Ditë?..."**

Fjala *ma'sher* vjen nga numri dhjetë. Përderisa numri dhjetë konsiderohet i plotë, atëherë *ma'sher* është një grup i plotë që përfshin grupacione e lloje të ndryshme. Ndërsa përsa u përket të dërguarve që u dërguan te xhindet, lind pyetja: A kanë qenë prej tyre apo prej njerëzve? Në lidhje me këtë ka shumë mendime ndërmjet komentuesve. Por, nga ajetet e sures "El Xhin" shfaqet dukshëm se Islami dhe Kur'anit është për të gjithë, duke përfshirë edhe xhindet dhe se Profeti i Islamit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është i Dërguari i All'llahut për të gjithë. (Shpjegimi i kësaj do të vijë me detaje, gjithashtu edhe kuptimi shkencor i fjalës "*el xhinn*", në xhuzin e 29-të të Kur'anit Fisnik).

Por, duhet të dimë se "*minkum*", "*prej jush*", nuk nënkupton se Profetët e çdo lloji (race) janë nga i njëjti lloj e racë, sepse kur ne themi "*një prej jush...*", mundet që ata të jenë nga një grup i vetëm ose nga shumë grupe.

Më pas ajeti thotë: **"...Ata do të thonë: 'Ne dëshmojmë kundër vetes sonë'..."**, sepse Dita e Ringjalljes nuk është ditë e fshehtë, madje argumentet e çdo gjëje janë haptazi në sy të të gjithëve. Askush nuk mund të fshehë asgjë. Që të gjithë e pranojnë këtë pyetje të All'llahut, duke thënë se ne po dëshmojmë kundër vetes sonë dhe e pranojmë që të dërguarit na kanë ardhur dhe na e kanë transmetuar mesazhin Tënd, por ne e kundërshtuam atë.

Sigurisht, ata kanë pasur argumente e fakte të shumta nga All'llahu. E dallonin të drejtën nga e gabuara, mirëpo jeta e kësaj bote, me të ndriturat e dukuritë e saj, i mashtroi dhe i humbi ata: **"...Vërtet, jeta e kësaj bote i mashtroi ata..."**

Ky ajet tregon qartë se pengesa e madhe në rrugën e lumturisë njerëzore është dashuria e pakufi e botës materiale dhe nënshtrimi ndaj saj pa pengesa e pa kushte. Është ajo dashuri, e cila e prangos njeriun me zinxhirët e robërimit dhe e shtyn atë që të veprojë të gjitha llojet e padrejtësisë, armiqësisë, egoizmit e tiranisë.

Edhe njëherë tjetër Kur'ani përforcon se ata kanë dëshmuar vetë me gojën e tyre se kanë ecur në rrugën e mohimit dhe kanë qëndruar në krah të mohuesve të All'llahut: **"...kështu që ata do të dëshmojnë kundër vetes se kanë qenë mohues."**

Ajeti pasardhës përsërit përmbajtjen e mëparshme në formën e një ligji të përgjithshëm e të qëndrueshëm që është se: All'llahu nuk i dënon njerëzit në qytete e në zona të banuara me padrejtësinë e tyre, kur janë të painformuar, por vetëm pasi u ka

çuar atyre të dërguar, në mënyrë që t'i lajmërojë për veprat e tyre të këqija dhe për pasojën e atyre veprave. Ajeti thotë: **"Kjo ndodh sepse Zoti yt nuk e shkatërron asnjë vend për padrejtësinë e tyre, ndërkohë që banorët e tij janë të pavëmendshëm."**

Fraza **"për padrejtësinë e tyre"** mund të jetë me kuptimin se All'Ilahu nuk ndëshkon njeri për shkak të padrejtësisë së tij kur ai ëshë i pavetëdijshtëm ndaj asaj padrejtësie dhe para se t'i dërgojë të dërguar. Gjithashtu, mund të jetë me kuptimin se All'Ilahu nuk i bën padrejtësi njeriu e ta ndëshkojë për atë që ka vepruar, duke qenë i painformuar, sepse ndëshkimi i tyre në këtë formë konsiderohet padrejtësi dhe se All'Ilahu është më i Lartë se të ndëshkojë ndonjërin.¹

Ajeti i fundit prej ajeteve në fjalë përmend në formë të përmbledhur fundin e çdo njeriu duke përcaktuar për secilin qoftë punëmirë apo punëkeq, i bindur apo i pabindur, kërkues i drejtësisë apo i padrejtë, grada e pozita Ditën e Ringjalljes, natyrisht për veprat e tyre. Zoti nuk është i painformuar për veprat e tyre, madje i di ato të gjitha, duke shpërblyer gjithsecilin me masën e merituar: **"Secili do të ketë shkallën e tij, sipas veprave që ka bërë. Zoti yt nuk është i paditur për veprat e tyre."**

Ky ajet përforcon edhe njëherë tjetër realitetin e thënë se "gradët e larta" dhe "shkallët e ulëta", të cilat i meriton njeriu, janë pjellë e veprave të tij.

¹ Në rastin e parë, vepruesi i "padrejtësisë" janë mohuesit. Ndërsa në rastin e dytë i mohohet padrejtësia All'Ilahut të Lartësuar.

Ajetet 133 - 135

وَرَبُّكَ الْغَنِيُّ ذُو الرَّحْمَةِ ۚ إِنْ يَشَأْ يُذْهِبْكُمْ وَيَسْتَخْلِفْ مِنْ
 بَعْدِكُمْ مَا يَشَاءُ كَمَا أَنْشَأَكُمْ مِنْ ذُرِّيَّةِ قَوْمٍ ءَاخِرِينَ
 ﴿١٣٣﴾ إِنْ مَا تُوعَدُونَ لَآتٍ ۖ وَمَا أَنْتُمْ بِمُعْجِزِينَ ﴿١٣٤﴾
 قُلْ يَنْقُومِ أَعْمَلُوا عَلَىٰ مَكَانَتِكُمْ إِنِّي عَامِلٌ ۖ فَسَوْفَ
 تَعْلَمُونَ مَنْ تَكُونُ لَهُ عَقِيبَةُ الدَّارِ ۚ إِنَّهُ لَا يُفْلِحُ
 الظَّالِمُونَ ﴿١٣٥﴾

"Zoti yt është i Vetëmjaftueshmi dhe Zotëruesi i mëshirës. Nëse do, ju zhduk dhe sjell pas jush çfarë të dojë, ashtu si ju ka krijuar nga pasardhësit e popujve të tjerë."

"Ajo që ju është premtuar, me të vërtetë do t'ju arrijë e ju nuk mund t'i ikni asaj."

"Thuaj: 'O populli im, punoni në drejtimin tuaj, ndërkohë që edhe unë bëj timen. Së shpejti do ta merrni vesh se për kë do të jetë fundi i mirë. Njëmend, keqbërësit nuk do të shpëtojnë.'"

Komentimi

Ajeti i parë prej ajeteve në fjalë argumenton ajetet e mëparshme që thanë se All'llahu nuk bën padrejtësi. Ai përforcon se All'llahu nuk i bën padrejtësi askujt, sepse kush bën padrejtësi, patjetër që do të jetë nevojtar, ose zemërthyer e i ngushtë. All'llahu nuk ka nevojë për asgjë, është i Butë e i Mëshirshëm: **"Zoti yt është i Vetëmjaftueshmi dhe Zotëruesi i mëshirës..."** Gjithashtu, Ai s'ka nevojë për bindjen dhe adhurimin e njerëzve, nuk ka frikë nga mëkatet e tyre, madje Ai është i aftë t'i zhdukë të gjithë njerëzit e të sjellë të tjerë në vend të tyre, ashtu siç ka bërë me grupet e mëparshme: **"Nëse do, ju zhduk dhe sjell pas jush çfarë të dojë, ashtu si ju ka krijuar nga pasardhësit e popujve të tjerë."** Bazuar mbi këtë, All'llahu është i Pasuri absolut. Nuk ka nevojë për asgjë, është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Është Mëshirues, kështu që s'mund ta përfytyrojmë atë të padrejtë.

Nëse e perceptojmë fuqinë e Tij të pakufizuar, bëhet e qartë, se ajo që ka premtuar, në lidhje me Ditën e Gjykimit, sigurisht që do të realizohet pa asnjë mëdyshje: **"Ajo që ju është premtuar, me të vërtetë do t'ju arrijë..."**

Gjithashtu, njeriu nuk mund të dalë nga korniza e gjykimit të Tij dhe as nuk mund të ikë nga kapja e drejtë e Allahut: **"...e ju nuk mund t'i ikni asaj."**¹

Më pas e urdhëron të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që t'i kërcënojë ata: **"Thuaj: 'O populli im, punoni në drejtimin tuaj, ndërkohë**

¹ Fjala *mu'xhizijn-të paaftë*, vjen nga fjala *a'xheze - pamundësi dhe paaftësi*. Kështu që ajeti thotë se ju nuk mund ta bëni All'llahun të paaftë për ringjalljen e njerëzve dhe realizimin e drejtësisë. E thënë ndryshe: Ju nuk keni mundësi të përballeni me aftësinë e All'llahut të Madhëruar.

që edhe unë bëj timen. Së shpejti do ta merrni vesh se për kë do të jetë fundi i mirë. Njëmend, keqbërësit nuk do të shpëtojnë."

Këtu përsëri vëmë re se fjala "*kufr*", *mohim* është zëvendësuar me fjalën "*dhulm*", *padrejtësi*. Kjo do të thotë se mohimi dhe mosnjohja e All'Ilahut është një lloj i qartë padrejtësie, është padrejtësi ndaj vetvetes dhe padrejtësi ndaj shoqërisë. Përderisa padrejtësia është e kundërta e drejtësisë së përgjithshme, në botën ekzistuese, atëherë ajo është e dënuar me dështim e disfatë.

Ajeti 136

وَجَعَلُوا لِلَّهِ مِمَّا ذَرَأَ مِنَ الْحَرْثِ وَالْأَنْعَامِ نَصِيبًا فَقَالُوا هَذَا لِلَّهِ بِزَعْمِهِمْ وَهَذَا لِشُرَكَائِنَا^ص فَمَا كَانَ لِشُرَكَائِهِمْ فَلَا يَصِلُ إِلَى اللَّهِ^ص وَمَا كَانَ لِلَّهِ فَهُوَ يَصِلُ إِلَى شُرَكَائِهِمْ^ق سَاءَ مَا يَحْكُمُونَ ﴿١٣٦﴾

"Ata kanë caktuar për All'llahun pjesë nga drithi dhe kafshët shtëpiake, të cilat i ka krijuar Ai dhe thonë sipas hamendjes së tyre: 'Kjo është për All'llahun, ndërsa kjo është për idhujt tanë'. Mirëpo ajo pjesë që është për idhujt e tyre, nuk arrin te Zoti, kurse ajo që ata e kanë caktuar për All'llahun - ajo arrin te idhujt e tyre. Sa gjykim të shëmtuar bëjnë ata!"

Komentimi

Për shkuljen e rrënjëve të politeizmit nga mendjet, Kur'ani përmend zakonet, traditat dhe adhurimet mitike, që ekzistonin asokohe ndërmjet politeistëve, duke e vërtetuar me një elokuencë të qartë se ato janë mitologjike e të pabaza. Në atë kohë, mohuesit e Mekës dhe politeistë të tjerë ndanin për hir të All'llahut një pjesë nga të mbjellat e bagëtitë e tyre, ashtu siç ndanin edhe për idhujt e

tyre, duke thënë se kjo pjesë i takon All'lahut dhe kjo i takon bashkëpronarëve tanë, pra idhujve: **"Ata kanë caktuar për All'llahun pjesë nga drithi dhe kafshët shtëpiake, të cilat i ka krijuar Ai dhe thonë sipas hamendjes së tyre: 'Kjo është për All'llahun, ndërsa kjo është për idhujt tanë'..."**

Pavarësisht se ajeti tregon vetëm për pjesën e All'lahut, fjali të tjera tregojnë se ata kanë lënë një pjesë edhe për idhujt. Ky fakt ka ardhur në disa transmetime: Atë pjesë që e ndanin për All'llahun, e shpenzonin për fëmijë e miq, ndërsa atë që ndanin për idhujt, si të mbjella e bagëti, e shpenzonin për shërbyesit e idhujve, për ata që qëndronin në faltoret e tyre, për kurban dhe për veten e tyre.¹

Shkaku i konsiderimit të idhujve ortakë të tyre është se ata i shihnin idhujt si ortakë në pasurinë dhe në jetën e tyre.

Fraza "*mimma dhere*", që janë krijuar, i bënë të pavlera pretendimet e tyre sepse pasuritë e tyre dhe çdo gjë që zotëronin janë të krijuara nga All'llahu. Atëherë si e bëjnë një pjesë për All'llahun dhe një për idhujt?!

Më pas ajeti tregon një nga gjykimet e tyre të çuditshme: Ajo që kanë planifikuar për bashkëpronarët e tyre, nuk mbërrin te All'llahu, por ajo që kishin planifikuar për All'llahun, arrin te bashkëpronarët e tyre: **"...Mirëpo ajo pjesë që është për idhujt e tyre, nuk arrin te Zoti, kurse ajo që ata e kanë caktuar për All'llahun - ajo arrin te idhujt e tyre..."**

¹ Komentimi "El Menar", vëll. 8, f. 122.

Komentuesit kanë mendime të ndryshme për qëllimin e këtij ajeti, por të gjitha idetë e tyre sillen rreth një të vërtete të vetme: Nëse pjesa e All'lahut dëmtohej nën ndikimin e ndonjë ndodhie, ata thoshin se nuk ka rëndësi fare, sepse All'lahu nuk ka nevojë për të. Por nëse dëmtohej pjesa e ndarë për idhujt, e kompensonin atë nga pjesa e All'lahut, duke thënë se idhujt kanë më shumë nevojë se All'lahu.

Gjithashtu, nëse mbaronte uji që kalonte nga ferma e All'lahut për te ferma e idhujve, thoshin se nuk ka problem, pasi All'lahu nuk është nevojtar. Por nëse ndodhte e kundërta, e ndalonin ujin që rridhte te ferma e All'lahut, duke thënë se idhujt kanë më shumë nevojë për ujë.

Në mbyllje ajeti i dënon këto mitologji: **"...Sa gjykim të shëmtuar bëjnë ata!"**

Veprat e tyre të këqija, përveç të keqes së adhurimit të idhujve, sqarohen në çështjet e mëposhtme:

1- Megjithëse çdo gjë është krijesë e All'lahut, Ai është gjykatës mbi të gjitha qeniet, Rregullatori e Ruajtësi i tyre, ata planifikonin një pjesë nga pasuria e tyre për All'lahun, sikur ata ishin poseduesit realë, sikur e drejta e ndarjes të ishte në dorën e tyre. (Fjalja **"nga ajo që krijoi Ai"** tregon për këtë që thamë.)

2- Në këtë ndarje ata planifikonin një pjesë për idhujt dhe i jepnin përparësi mbi atë të All'lahut. Ata nuk i jepnin rëndësi se ç'ndodhte me dëmin e pjesës së All'lahut, duke shlyer çdo dëm që i ndodhte pjesës së idhujve nga pjesa e All'lahut. Ky ishte një favorizim për pjesën e idhujve kundër All'lahut!

3- Sqarohet nga disa transmetime se ata i kanë dhënë shumë rëndësi pjesës së idhujve. Shërbëtorët e idhujve, ata që qëndronin në faltore, gjithashtu edhe politeistët, hanin nga pjesa e putave, ndërkohë që pjesën e All'lahut e planifikonin për fëmijë e miq. Krahasimi na tregon se bagëtitë e majme dhe të ardhurat e mira të fermës ishin pjesë e idhujve, pra, për interesa personale.¹

E gjitha kjo tregon se ata, më këtë ndarje, nuk e kanë konsideruar All'lahun as në pozitë të barabartë me pozitën e idhujve.

A ka gjykim më të keq e më të turpshëm se sa njeriu të konsiderojë një copë gur apo dru, i cili nuk ka vlerë, më të lartë se sa Krijuesi i botës ekzistuese?! A ka rënie më të madhe ideologjike se sa kjo!?

¹ "Biharu Enuar", vëll. 9, f. 92 dhe 207. Komentimi "El Ajashij", vëll. 7, f. 89.

Ajeti 137

وَكَذَلِكَ زَيْنَ لِكَثِيرٍ مِّنَ الْمُشْرِكِينَ قَتَلَ أَوْلَادِهِمْ
شُرَكَاءُهُمْ لِيُرْذُوهُمْ وَلِيَلْبِسُوا عَلَيْهِمْ دِينَهُمْ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا
فَعَلُوهُ فَذَرَهُمْ وَمَا يَفْتَرُونَ

"Shumë paganëve, idhujt e tyre ua kanë bërë t'u duket e bukur vrasja e fëmijëve të tyre, për t'i shkatërruar dhe për t'ua pështjelluar besimin. Sikur të donte All'llahu, ata nuk do ta bënë atë. Lërin ata dhe trillimet e tyre."

Komentimi

Ne këtë ajet Kur'ani na tregon për një vepër tjetër të shëmtuar nga veprat e shëmtuara të adhuruesve të idhujve dhe krimet e tyre të turpshme. Atyre u dukej se ndarja e pjesëve ndërmjet All'llahut e idhujve është vepër e mirë. Këtë vepër të shëmtuar e mitike, madje qesharake, e konsideronin të lavdëruar.

Gjithashtu, në sytë e shumë politeistëve ishte zbukuruar vrasja e fëmijëve ku shumë prej tyre e konsideronin vrasjen e fëmijëve një lloj mburrjeje e adhurimi: **"Shumë paganëve, idhujt e tyre ua kanë bërë t'u duket e bukur vrasja e fëmijëve të tyre, për t'i shkatërruar dhe për t'ua pështjelluar besimin..."**

Fjala "shureka", në këtë ajet janë idhujt. Idhujtarët, në shumë raste u dhuronin ortakëve-idhujve, fëmijët e tyre, që të

afroheshin me ta, ose u zotonin se, nëse u lind një djalë, do të prisnin kurban për idhujt e tyre. Në historinë e vjetër të adhurimit të idhujve ka ardhur se zbukurimi i tyre për idhujt tregon lidhjen e fortë të tyre me idhujt, dashuria e tyre për ta i ka çuar në kryerjen e këtij krimi të shëmtuar. Duke u bazuar tek ky komentim, vrasja e fëmijëve që përmendet në ajet nuk ka lidhje me varrosjen e gjallë të vajzave apo vrasjen e fëmijëve nga frika e varfërisë.

Ka mundësi që këtë krim, zbukurimin e idhujve e të faltoreve, e kanë kryer personat që kujdeseshin për to, duke e konsideruar si gjuhën thirrëse të njerëzve drejt adhurimit të tyre.

Historia na tregon se arabët, nëse vendosnin të udhëtonin ose kishin ndonjë punë të rëndësishme, kërkonin leje nga "Hebeli", idhulli më i madhe i tyre. Varnin një qese në anë të Heblit. Në qese kishte shtiza, doreza e të cilave ishte e shkruar "bëje" ose "mos e bëj". I përzierin shtizat e më pas tërhiqnin një prej tyre. Ajo që ishte e shkruar mbi të, ishte urdhri i dalë nga Hebeli. Me anë të kësaj metode ata zbulonin mendimet e idhujve të tyre. Kështu që nuk është për t'u habitur se ata, në vrasjen e fëmijëve të tyre, për t'u afruar me idhujt, i drejtoheshin parisë së faltoreve, që të jepnin një urdhër të idhujve.

Gjithashtu, këtu mund të thuhet se varrosja për së gjalli e vajzave, e cila ka qenë e përhapur te fisi beni Temijm për shmangien e turpit, ka qenë një urdhër i lëshuar nga idhujt. Historia transmeton se Nuaman ibn El Mundhir sulmoi disa arabë dhe zuri rob gratë e tyre. Bashkë me to ishte edhe vajza e Kajs ibn Asimit.

Pas bisedimeve ndërmjet tyre, të gjitha gratë u kthyen te familjet e tyre, përveç vajzës së Kajsit, e cila parapëlqeu qëndrimin te armiqtë se ndoshta do të martohej me ndonjë të ri prej tyre. Por kjo ishte gjë e rëndë për Kajsin. Ai u betua te idhujt se, në qoftë se do t'i lindte një vajzë tjetër, ai do ta varroste atë të gjallë. Më pas nuk kaloi shumë kohë e kjo vepër u bë rrugë ndërmjet tyre. Në emër të mbrojtjes së personalitetit ndërmorën krimet më të shëmtuara, duke vrarë fëmijët e tyre të pafajshëm.¹

Bazuar mbi këtë, varrosja e vajzave të gjalla mund të jetë e përfshirë në konceptin e këtij ajeti.

Ka një mundësi tjetër për komentimin e këtij ajeti, edhe nëse s'i ka shkuar mendja komentuesve. Arabët e kohës së injorancës respektonin idhujt e tyre. Ata shpenzonin pasuritë e tyre për këta idhuj, për shërbyesit e tyre, duke qëndruar në varfëri të thellë, deri në atë pikë sa që kjo varfëri e uri i çonte në vrasjen e vajzave të tyre. Kjo lidhje e fortë me idhujt ia zbukuronte atyre këtë vepër të shëmtuara.

Mirëpo, komentimi i parë, flijimi i fëmijëve të tyre, për t'u afruar me idhujt është më i afërt me paragrafin e ajetit.

Më pas Kur'ani sqaron se rezultati i këtyre veprave të këqija është se idhujt dhe shërbyesit e tyre i hodhën politeistët në greminat shkatërrimtare dhe i bënë ata të dyshojnë në fenë e All'lahut, duke i ndaluar të arrijnë te feja e vërtetë: **"...për t'i shkatërruar dhe për t'ua pështjelluar besimin..."**

¹ Disa mendojnë se fjala *eulad-fëmijë* në këtë ajet nuk përputhet me këtë komentim. Pavarësisht se për këtë fjalë ka kuptim të gjerë, që përfshin djemtë dhe vajzat, siç ka ardhur në ajetin 233 të sures "El Bekare": **"Nënat i ushqejnë fëmijët e tyre me gjë dy vite të plota."** Komentimi "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 171, në fund të ajetit për të cilin ne po flasim.

Megjithëkëtë, All'llahu është i aftë t'i ndalojë ata në kufirin e tyre me dhunë. Por dhuna është në kundërshtim me ligjet e All'llahut, sepse Ai dëshiron që robtë e Tij të jenë të lirë, në mënyrë që përpara tyre të përgatitet rruga e edukimit dhe e plotësimit. Nuk ka dhunë në edukatë: **"Sikur të donte All'llahu, ata nuk do ta bënë atë..."** Përderisa ata janë të zhytur në kotësitë e mitologjitë e tyre, pa e kuptuar shëmtinë e tyre, madje më e fëlliqur se kjo është se nganjëherë ia atribuonin këto All'llahut, atëherë lëri ata e akuzat e tyre dhe kthehu te edukimi i zemrave të përgatitura: **"...Lëri ata dhe trillimet e tyre."**

Ajetet 138 - 139

وَقَالُوا هَذِهِ أَنْعَمُ وَحَرْتُ حِجْرًا لَا يَطْعَمُهَا إِلَّا مَنْ نَشَاءُ
 بِزَعْمِهِمْ وَأَنْعَمُ حُرِّمَتْ ظُهُورُهَا وَأَنْعَمُ لَا يَذْكُرُونَ أَسْمَ اللَّهِ
 عَلَيْهَا افْتِرَاءً عَلَيْهِ ۚ سَيَجْزِيهِمْ بِمَا كَانُوا يَفْتُرُونَ ﴿١٣٨﴾
 وَقَالُوا مَا فِي بُطُونِ هَذِهِ الْأَنْعَمِ خَالِصَةٌ لِّذُكُورِنَا وَمُحَرَّمٌ
 عَلَىٰ أَزْوَاجِنَا ۖ وَإِنْ يَكُن مَّيْتَةً فَهُمْ فِيهِ شُرَكَاءُ ۚ سَيَجْزِيهِمْ
 وَصَفَهُمْ ۚ إِنَّهُ حَكِيمٌ عَلِيمٌ ﴿١٣٩﴾

"Ata thonë sipas hamendjes së tyre: 'Këto bagëti shtëpiake dhe këto e këto bimë janë të ndaluara, nuk mund t'i hajë askush, përveç atyre që ua lejojmë ne'. Disa kafshë shtëpiake ata i kanë bërë të ndaluara për ngarkim, ndërsa disa bagëti i therin pa e përmendur emrin e All'llahut, duke trilluar gënjeshtër për Të. Ai do t'i ndëshkojë ata për gënjeshtër të trilluara."

"Ata thonë gjithashtu: 'Ajo që gjendet në barkun e këtyre bagëtive, u përket vetëm meshkujve tanë, kurse për gratë tona janë të ndaluara'. Por, nëse lindin të ngordhura, ata të gjithë (burra e gra) janë pjesëmarrës në të. All'llahu do t'i ndëshkojë

ata për çfarë i veshin Atij. Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm."

Komentimi

Këto ajete tregojnë për disa dispozita mitologjike të adhuruesve të putave, të cilat vërtetojnë vizionin e tyre të shkurtër e intelektin e ngushtë, duke plotësuar atë që u tha në ajetet e mëparshme.

Në fillim përmendin thëniet e politeistëve, në lidhje me ata që kanë të drejtë në pjesën e prodhimeve bujqësore dhe të bagëtive. E sqaron se ata e shikonin të ndaluar, me përjashtim të një grupi të caktuar: **"Ata thonë sipas hamendjes së tyre: 'Këto bagëti shtëpiake dhe këto e këto bimë janë të ndaluara, nuk mund t'i hajë askush, përveç atyre që ua lejojmë ne'..."**

Qëllimi i tyre ishte për ata që kujdeseshin për idhujt dhe faltoret. Politeistët mendonin se vetëm ata kishin të drejtë në pjesën e idhujve.

Nga kjo sqarohet se pjesa e parë e këtij ajeti na tregon mënyrën e veprimit të tyre për pjesën që ndanin për idhujt prej produkteve bujqësore e blegtorale.

Fjala "el hixhr" ka kuptimin e ndalimit. Ndoshta ajo është marrë, siç thotë Er Ragib El Esfahanij, në librin e tij "El Mufredat", nga fjala haxher-gur, të ndërtosh rreth vendit me gur, për të penguar atë që është pas tij. Edhe guri i Ismailit u quajt kështu, sepse ai është i ndarë nga pjesët e tjera të xhamisë me mur guri. Nganjë herë fjala "hixhr" përdoret për "mendjen", sepse mendja e ndalon njeriun nga veprimi i veprave të këqija. Nëse një njeri vendoset nën mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e tij, thuhet: "Me të

vërtetë, ai është në gurin e tij. "El mehxhur" është ai që ndalohet të prekë pasurinë e tij."¹

Më pas ajeti na tregon për një tjetër mitologji të tyre, ndalimi i hipjes te disa kafshë: **"...Disa kafshë shtëpiake ata i kanë bërë të ndaluara për ngarkim..."** Mesa duket, kafshë janë ato që u përmendën më parë në komentimin e ajetit 103 të sures "El Maide". (Shih komentim e këtij ajeti.)

Më pas ajeti tregon për pjesën e tretë të dispozitave të kota: **"...ndërsa disa bagëti i therin pa e përmendur emrin e All'Ilahut..."**

Ndoshta kjo është tregues për kafshët që u është përmendur vetëm emri i idhujve të tyre gjatë therjes, ose janë kafshë shale, që i kanë bërë të ndaluara për të hipur e për të shkuar me to në Haxh, siç ka ardhur edhe në komentimin "Mexhmaul Bejjan", "Et Tefsijr El Kebijr", "El Menar", "El Kurtubij", të transmetuara nga disa komentues. Në të dy rastet është gjykuar si mitologji që s'ka bazë për të.

Dhe më e çuditshmja është se ata nuk janë kënaqur me këto dispozita boshe, por ia mvëshën All'Ilahut të gjitha këto gënjeshtra: **"...duke trilluar gënjeshtra për Të..."**

Në mbyllje të ajetit, pas përmendjes së këtyre dispozitave artificiale e të kota, All'Ilahu thotë: **"...Ai do t'i ndëshkojë ata për gënjeshttrat e trilluara."**

Nëse njeriu dëshiron, me mendimin e tij të mangët e të shkurtër, të vendosë ligje e dispozita, padyshim se çdo grup do të vendosë ligje që përshtaten me epshet e shijet e tij, duke ia ndaluar vetes begatitë e All'Ilahut pa shkak, apo i lejojnë vetes së tyre

¹ "Hixher", "pengues", "frenues". Në këtë ajet është përshkruese, me kuptimin e frenimit dhe të përmbyturit. Në këtë rast është i barabartë si mashkulli, ashtu edhe femra.

veprat e këqija. Ky është shkaku i thënies sonë se All'llahu është i vetmi që vendos ligjet, sepse Ai është në dijeni të gjithçkaje, i di hollësitë e çështjeve, është i zhveshur nga epshet (I Lartësuar dhe i pastër është All'llahu).

Ajeti pasardhës tregon për një gjykim tjetër mitologjik, në lidhje me mishrat e kafshëve. Bën fjalë për ndërzimin e barrën e këtyre kafshëve, që është vetëm për meshkujt. Ai është i ndaluar për femrat. Por, nëse del nga barku i tyre i ngordhur, që të gjithë janë pjesëmarrës në të: **"Ata thonë gjithashtu: 'Ajo që gjendet në barkun e këtyre bagëtive, u përket vetëm meshkujve tanë, kurse për gratë tona janë të ndaluara'.** Por, nëse lindin të ngordhura, ata të gjithë (burra e gra) janë pjesëmarrës në të...."

Patjetër duhet të tregojmë se "këto bagëti" janë kafshët që i kemi përmendur më përpara.

Disa komentues e shohin se shprehja: **"Ajo që gjendet në barkun e këtyre bagëtive"** përfshin qumështin e këtyre kafshëve, por fraza **"Por, nëse lindin të ngordhura"** sqaron se synimi është këlyshi se, nëse lind i gjallë, është për meshkujt e, nëse lind i ngordhur, s'është i dëshiruar për to, në këtë rast të gjithë janë pjesëmarrës në mënyrë të barabartë.

Ky gjykim, së pari, nuk mbështetet në asnjë argument; së dyti, ai është i keq e i shëmtuar, përse i përket këlyshit të ngordhur, sepse mishi i kafshës së ngordhur, në të shumtën e rasteve, është i prishur e i dëmtuar; së treti, është një lloj dallimi e diskriminimi ndërmjet burrit dhe gruas, që e bën të mirën vetëm për burrat dhe e bën gruan pjesëmarrëse vetëm për të fëlliqurën. Kur'ani e dënon dhe e ndëshkon këtë gjykim injorant dhe vërteton se All'llahu do t'i ndëshkojë ata për këto përkrahje: **"...All'llahu do t'i ndëshkojë ata për çfarë i veshin Atij..."**

Fjala "el uasf" tregon për ato që ia atribuonin All'llahut, pra, ia mveshnin Atij ndalimin e këtyre mishrave, pavarësisht se synimi është cilësimi apo situata që bie mbi mëkatarin, menjëherë pas përsëritjes së mëkatit dhe e bën atë ta meritojë ndëshkimin.

Në mbyllje ajeti thotë: **"...Ai është vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm."** Vërtet Ai është i ditur për veprat, thëniet dhe akuzat e rreme të tyre, ashtu siç i ndëshkon ata me gjykim të mençur.

Ajeti 140

قَدْ خَسِرَ الَّذِينَ قَتَلُوا أَوْلَادَهُمْ سَفَهًا بِغَيْرِ عِلْمٍ وَحَرَّمُوا مَا رَزَقَهُمُ
 اللَّهُ افْتِرَاءً عَلَى اللَّهِ قَدْ ضَلُّوا وَمَا كَانُوا مُهْتَدِينَ ﴿١٤٠﴾

"Të humbur janë ata që i vrasin fëmijët e tyre nga mendjelehtësia dhe padija dhe i bëjnë të ndaluara ato që ua ka dhuruar All'llahu, duke trilluar kështu gënjeshtër rreth All'llahut. Ata janë të devijuar dhe aspak të udhëzuar."

Komentimi

Në vijim të ajeteve të mëparshme, të cilat flasin për disa dispozita boshe e tradita të këqija, të përhapura në epokën e injorancës, si: vrasja e fëmijëve si kurban, përafrim ndaj idhujve, varrosjen për së gjalli të vajzave nga frika e turpit, ndalimin e disa begative të lejuara nga All'llahu, ky ajet i ndëshkon me forcë të gjitha këto vepra në shtatë fraza e në fjali të shkurtra.

Në fillim ajeti thotë: **"Të humbur janë ata që i vrasin fëmijët e tyre nga mendjelehtësia dhe padija..."** Vepra e tyre cilësohet dështim jo vetëm në optikën njerëzore e morale, por edhe në optikën emocionale e shoqërore. Dështimi i madh është dështimi shpirtëror në Botën Tjetër. Kështu që në këtë ajet, vepra e tyre konsiderohet fillimisht si humbje, mendjelehtësi e më pas injorancë. Çdo cilësi është e mjaftueshme për pasqyrimin e veprave të tyre të këqija. Cila mendje ia lejon babait të vrasë

fëmijët me duart e tij? A nuk është budallallëk e mendjelehtësi ky veprim? A nuk ka turp nga kjo vepër, që e konsideron krenari e adhurim? Cila dituri ia lejon njeriut që t'i konsiderojë këto vepra si ligje civile?

Që këtu e kuptojmë thënien e ibn Abasit, për vlerën e leximit të sures "En'am", për atë që dëshiron të dijë ekstremet e prapambetjes së popujve injorantë.

Më pas Kur'ani përmend se ata ia ndaluan vetes gjërat që i furnizoi All'llahu. Ata gënjen ndaj All'llahut dhe ia mvëshën Atij këto ndalime: **"...dhe i bëjnë të ndaluara ato që ua ka dhuruar All'llahu, duke trilluar kështu gënjeshtër rreth All'llahut..."**

Në këtë frazë ka një ndëshkim tjetër për veprat e tyre, kështu që ato, së pari, ia ndaluan vetes begatitë që All'llahu "i furnizoi ata" dhe i lejoi për ta, që ishin të domosdoshme për jetën e tyre, duke revokuar e duke anuluar ligjin e Allahut.

Ata, së dyti, shpifën ndaj All'llahut, duke thënë se All'llahu e ka urdhëruar një gjë të tillë.

Në mbyllje të ajetit dhe në dy fraza të shkurtra, ka një dënim tjetër për ta, kështu që **"...Ata janë të devijuar..."** Për më tepër, ata nuk kanë ndjekur asnjë ditë rrugën e drejtë: **"...dhe aspak të udhëzuar."**

Ajeti 141

* وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَ جَنَّاتٍ مَّعْرُوشَاتٍ وَغَيْرَ مَعْرُوشَاتٍ وَالنَّخْلَ
 وَالزَّرْعَ مُخْتَلِفًا أُكْلُهُ وَالزَّيْتُونَ وَالرُّمَّانَ مُتَشَبِهًا وَغَيْرَ
 مُتَشَبِهٍ ۚ كُلُوا مِنْ ثَمَرِهِ إِذَا أَثْمَرَ وَءَاتُوا حَقَّهُ يَوْمَ
 حَصَادِهِ ۚ وَلَا تُسْرِفُوا ۚ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ ﴿١٤١﴾

"Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani prej frutave të tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se All'Ilahu nuk i do ata që e teprojnë!"

Komentimi

Mësim madhështor në rrugën e njësimi

Në këtë ajet flitet për disa tematika. Çdonjëra prej tyre është e ndarë nga tjetra.

Së pari, All'Ilahu i Lartësuar thotë se Ai i krijoi kopshtet dhe fermat që mbartin lloje të ndryshme pemësh e bimësh. Prej tyre ka të tilla që mbështeten në shtylla e boshte, të cilat mbartin fruta të shijshme e që tërheqin magjishëm sytë e zemrat e njerëzve.

Ka prej tyre që nuk kanë nevojë për shtylla, por që qëndrojnë mbi trungjet e tyre, bëjnë hije e përmbushin me frutet e tyre nevojat e ndryshme të njerëzve: **"Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara..."**

Komentuesit, për komentimin e fjalëve "ma'rushat" dhe "gajru ma'rusht", kanë dhënë tre alternativa:

1- Siç thamë edhe pak më parë, "el ma'rushat", është për pemët dhe bimët, të cilat nuk qëndrojnë mbi trungun e tyre, por kanë nevojë për shtylla e çati. Ndërsa "gajru ma'rushat" është për pemët dhe bimët që qëndrojnë në trungun e tyre, që s'kanë nevojë për shtylla e çati. (Fjala "Arsh" tregon për lartësinë e diçkaje. Kjo është arsyeja që çatisë së shtëpisë i thuhet "arsh". Edhe shtratit të ngritur, i thuhet "arsh").¹

2- Qëllimi i fjalës "al ma'rushat" është për pemët e shtëpisë e ato që mbjellin njerëzit, që ruhen duke i rrethuar me gardhe kopshtet. Dhe "gajru ma'rushat" është për pemët e egra, bimët shkretinore e malore dhe çfarë mbin në pyje.²

3- "El ma'rush" janë ato që qëndrojnë mbi trungun e tyre, pemët, ose të ngritura mbi tokë dhe "gajru ma'rusht" janë ato pemë që zgjaten në tokë.³

Por duket se kuptimi i parë është më i saktë. Ndoshta përmendja e fjalës *të ngritura* është për arsye të ndërtimit e strukturës së këtyre pemëve të çuditshme. Kështu p.sh. hardhia e rrushit, bistakët e rrushit, trungjet e përdredhura, të çuditshme, të pajisura me kanxha përdredhëse e kapëse të veçanta, si dhe

¹ "Biharul Enuar", vëll. 62, f. 119. Komentimi "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f 177.

² "Biharul Enuar", vëll. 62, f. 119. Komentimi "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f 177.

³ Burimi i mëparshëm.

mënyra e përdredhjes së saj me çdo gjë, derisa të lulëzojë e të bëjë fruta, është dëshmia më e mirë për këtë pohim.

Më pas ajeti tregon për dy lloje kopshtesh e fermash: **“...hurma dhe bimë...”**

Përmendja e këtyre dy llojeve në veçanti është për rëndësinë e tyre të veçantë në jetën e njeriut, rolin e tyre në sistemin ushqimor (duhet ditur se Xhenneti thuhet për kopshtin, gjithashtu thuhet edhe për tokën të cilën e mbulon bimësia).

Më pas All'illahu i Madhëruar thekson se këto pemë janë të ndryshme e të shumta për nga frutat e shija, pavarësisht se të gjitha mbijnë nga një tokë e vetme, ujiten me një ujë të vetëm e për secilën prej tyre ka erë të veçantë, aromë e shije të caktuar, veçori që dallohen nga njëra-tjetra: **“...me shije të ndryshme...”**¹

All'illahu i Lartësuar na tregon për dy lloje frutash, me vlerë madhështore e dobi të lartë në aspektin e ushqyerjes: **“...ullinj e shegë...”**

Në të vërtetë, përzgjedhja e këtyre dy pemëve, ndërmjet pemëve të shumta, është se këto dy pemë (pema e ullirit dhe pema e shegës) pavarësisht ngjasimit të tyre nga pamja e jashtme, kanë një ndryshim shumë të madh, përse u përket frutave e veçorisë ushqyese. Kjo është arsyeja që All'illahu thotë: **“...të ngjashme dhe të ndryshme...”**²

Dhe pas përmendjes së gjithë këtyre begative, All'illahu i Lartësuar thotë: **“Hani prej frutave të tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!”**

¹ “El-Ukul” me zanoren *u* te rrokja e parë dhe me zanoren *u* ose pa zanore te germa e dytë *kef*, do të thotë gjithçka që hahet.

² Na ka paraprirë neve sqarimi i këtij aspekti të komentimi i ajetit 99 të po kësaj sureje.

Në përfundim ajeti flet për shpërdorimin: **“Por mos e teproni, se All'llahu nuk i do ata që e teprojnë!”**

Tepria është tejkalim i kufirit të balancës në çdo vepër që vepron njeriu. Kjo fjali mund të jetë tregues për shpërdorimin në të ushqyer, ose shpërdorimin në shpenzim e përpjekje, sepse disa mund ta teprojnë në përpjekje e shpenzim derisa japin gjithçka. Si përfundim ai, fëmijët e të afërmit e tij mbetin në vështirësi, varfëri e humbje.

Hulumtime

1- Lidhja e këtij ajeti me ajetet e mëparshme

Në ajetet e mëparshme të kësaj sureje flitej për dispozitat mitologjike, të praktikuara te politeistët, që jepnin një pjesë të produkteve bujqësore e bagëtive për All'llahun. Ata besonin se kjo pjesë duhet të shpenzohet në një drejtim të veçantë. Ndalonin hipjen te disa kafshë dhe i bënë fëmijët e tyre kurban për disa idhuj e puta!!

Ajeti në fjalë dhe ajeti më pas mbartin kundërpërgjigje për të gjitha këto dispozita e vendime mitologjike të kohës së injorancës dhe thonë qartë se All'llahu i Lartësuar është Krijuesi i të gjitha këtyre begative, Ai i krijoi të gjitha këto pemë, kafshë e bimë. Gjithashtu, po Ai urdhëroi që të përfitohet prej tyre dhe të mos shpërdorohen. Mbi këtë bazë, askush nuk ka të drejtë, përveç All'llahut, as në ndalim dhe as në lejim.

2- Çfarë synohet nga “frutat e Tij”?

Çfarë do të thotë togfjalëshi “**...kurdo që të prodhojnë...**”, megjithëse përmendet para kësaj togfjalëshi “**prej frutave të tyre**”? Për këtë ka thënie të ndryshme ndërmjet komentuesve. Por në pamje të parë, kjo fjali sqaron se me dukjen e frutave të pemët, apo të kallinjve të gruri, lejohet përfitimi prej tyre edhe nëse nuk i është dhënë akoma e drejta e fukarenjve. Mirëpo është detyrë që e drerjta e atyre që u takon nga frutat e të mbjellat e tjera të jepet kur vilen dhe korren, ashtu siç thotë All'llahu i Lartësuar: “**...dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre...**”

3- Çfarë synohet me të drejtën, e cila domosdoshmërisht duhet dhënë?

Disa e mendojnë se ai është zekati i detyrueshëm, pra e dhjeta ose gjysma e së dhjetës të të ardhurave që arrijnë kuotën legjitime.

Por ajo që tërheq vëmendjen është se kjo sure ka zbritur në Mekë dhe dispozita e Zekatit ka zbritur në vitin e dytë të Hixhri, në Medinen e Ndritur, kështu që duket se kjo mundësi është e largët.

Kjo e drejtë është sqaruar në transmetimet të shumta që na kanë ardhur nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) gjithashtu edhe në transmetime të ndryshme që janë transmetuar në burimet e Ehli Syneetit për Zekatin.

Në ato transmetime përmendet se qëllimi i të drejtës është dhënia e të ardhurave të varfërve, në kohën e korres apo të vjeljes

së prodhimeve dhe nuk ka për të një kufi të caktuar e të qëndrueshëm.¹

Në këtë rast: A është kjo dispozitë e detyrueshme apo e pëlqyeshme?

Disa mendojnë se është dispozitë e detyrueshme, pra, dhënia e kësaj të drejte ka qenë e detyrueshme për myslimanët, para legjitimitetit të Dispozitës së Zekatit. Por ai u abrogua pas zbritjes së ajetit të Zekatit, e kështu që Zekati mori vendin e tij real.

Mirëpo nga hadithet e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) përftohet se kjo dispozitë nuk është abroguar, por ka mbetur në formën e dispozitës së pëlqyer. Kjo do të thotë se është e pëlqyeshme t'u japësh diçka të varfërve nga të ardhurat bujqësore në kohën e korrjes apo vjeljes së tyre.

4- Cili është qëllimi i shprehjes me fjalën "ditë"?

Shprehja me fjalën "*jeumun*", "*ditë*", mund të jetë tregues që korrja e drithërave apo vjelja e frutave të bëhet gjatë ditës, që t'u jepet diçka prej saj edhe të varfërve dhe jo gjatë natës, siç veprojnë disa koprracë, në mënyrë që të mos e marrë vesh njeri.

Këtë fakt e kanë përforcuar transmetimet që kanë mbërritur te ne nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*) në lidhje me këtë çështje.²

¹ Hadithet e sipërpërmendura i ka cekur botuesi i librit "El-Uesail" te P. "Zekati", K. "Zekatul Gulat", çështja 13, si dhe Bejhakui te libri "Es-Sunen", vëll. 4, f. 132.

² Në lidhje me këtë, ktheju librit "Uesailu-Shija", vëll. 6, f. 136, P. "Zekati", Kapitulli "Zekatul Gulat", Kapitulli "Kerahetul Hisad uel Xhedhadh bil lejli".

Ajetet 142 - 144

وَمِنَ الْأَنْعَمِ حَمُولَةً وَفَرْشًا ۚ كُلُوا مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ وَلَا
تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۚ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ ﴿١٤٢﴾ ثَمَنِيَّةٌ
أَزْوَاجٌ مِّنَ الضَّأْنِ اثْنَيْنِ وَمِنَ الْمَعَزِ اثْنَيْنِ قُلْ^ط
ءَالْذَّكَرَيْنِ حَرَّمَ أَمِ الْأُنثَيَيْنِ أَمَّا اشْتَمَلَتْ عَلَيْهِ أَرْحَامُ الْأُنثَيَيْنِ
نَبِّئُونِي بِعِلْمٍ إِن كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴿١٤٣﴾ وَمِنَ الْإِبِلِ اثْنَيْنِ
وَمِنَ الْبَقَرِ اثْنَيْنِ قُلْ^ط ءَالْذَّكَرَيْنِ حَرَّمَ أَمِ الْأُنثَيَيْنِ أَمَّا
اشْتَمَلَتْ عَلَيْهِ أَرْحَامُ الْأُنثَيَيْنِ أَمْ كُنْتُمْ شُهَدَاءَ إِذْ وَصَلَكُمُ
اللَّهُ بِهَذَا ۚ فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا لِّيُضِلَّ
النَّاسَ بِغَيْرِ عِلْمٍ ۚ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿١٤٤﴾

"Ai ka krijuar disa bagëti për ngarkim dhe për ushqim. Hani nga ato që ua ka dhuruar All'Ilahu dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Ai është për ju armik i hapur."

"Ai ju ka dhënë tetë lloje bagëtish në çifte. Merr dy llojet për dhentë dhe dy për dhitë. Thuaju: 'A i ka ndaluar All'Ilahu dy

meshkujt ose dy femrat, ose atë që mbajnë në bark dy femrat?’ Lajmëromëni mua me dije të saktë, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"

"Merr dy llojet për devetë edhe dy për lopët. Thuaju: ‘A i ka ndaluar All'Ilahu meshkujt apo femrat ose atë që e mbajnë në bark dy femrat? Apo mos keni qenë të pranishëm kur All'Ilahu ju ka urdhëruar për këtë? Atëherë, kush është më keqbërës se ai që shpif gënjeshtër rreth All'Ilahut, për t'i shpënë njerëzit në humbje nga padija?’ Pa dyshim, All'Ilahu nuk i çon në rrugë të drejtë keqbërësit."

Komentimi

Këto ajete, siç kemi treguar edhe më parë, hedhin poshtë dispozitat mitologjike të injorancës, ku politeistët i përdornin ato në aspektin e drithërave e bagëtive.

Në ajetin e mëparshëm bëhej fjalë rreth llojeve të drithërave e frutave që i ka krijuar All'Ilahu. Në këto ajete bëhet fjalë për kafshët që u lejohet ngrënia e mishit, për shërbimet që ato kryejnë dhe për dobitë që ato sjellin.

Në fillim ajeti thotë se All'Ilahu ka krijuar për ju kafshë të mëdha, për mbartje e transporte dhe kafshë të vogla: **"Ai ka krijuar disa bagëti për ngarkim dhe për ushqim..."**

Fjala "humuletu" përdoret vetëm në numrin shumës dhe nuk ka njëjës, siç thonë gjuhëtarët. Ajo ka kuptimin e kafshëve të

mëdhaja, të cilat përdoren për mbartje dhe transport, si deveja, kali dhe të ngjashme me to.

Kuptimi i fjalës "fershun", është ai i njohuri, pra shtrim. Por këtu është komentuar me kuptimin e deles e të ngjashme me të. Arsyeja e përdorimit të kësaj fjale është se këto kafshë janë të vogla, të ulëta, shumë afër sipërfaqes së tokës. Kur këto kafshë dalin në kullotë, duken si shtroje, dyshek. Këtë përshtypje nuk e japin kafshët e larta, si deveja, kali apo kafshë të tjera që përdoren për transport.

Për më tepër, antonimi i këtyre dy fjalëve e mbështesin këtë kuptim.

Disa komentues mendojnë një alternativë tjetër, duke thënë se qëllimi i kësaj fjale është për shtrojat, dyshekët që njerëzit i bartin nga këto bagëti e kafshë. Kjo do të thotë që shumë nga këto kafshë përdoren për transport. Po ashtu, prej tyre përfitohet prodhimi i shtrojave (dyshekëve). Alternativa e parë është më afër kuptimit të ajetit.

Ajeti përfundon me thënien se, përderisa këto kafshë i ka krijuar All'Ilahu i Lartësuar dhe dispozita e tyre është në dorën e Tij, Ai ju urdhëron, duke ju thënë: "**...Hani nga ato që ua ka dhuruar All'Ilahu...**" Këtu lind pyetja: Pse nuk thotë hani nga këto bagëti, por thotë: "**...Hani nga ato që ua ka dhuruar All'Ilahu...**"?

Thuhet kështu sepse kafshët që u është lejuar ngrënia e mishit janë më shumë se ato që përmenden në këto ajete.

Për të përforcuar këtë thënie, si dhe për të hedhur poshtë mendimin pagan të politeistëve, ajeti thotë: **"...dhe mos ndiqni gjurmët e djallit. Ai është për ju armik i hapur."** Djalli i shpalli luftë Ademit që në fillim të krijimit.

Kjo frazë tregon se këto dispozita e vendime, të zhveshura nga argumentet, të cilat burojnë vetëm nga epshi e injoranca, janë cytje djallëzore. Qëllimi i tyre është t'ju shmangë juve nga e vërteta e t'ju shpjerë në greminat e iluzioneve e të humbjes.

Këtë frazë e kemi sqaruar më shumë në komentimin e ajetit 168, të sures "El-Bekare".

Ajeti pasardhës prej ajeteve në fjalë përmend disa kafshë që lejohen për të ngrënë dhe për transport: **"Ai ju ka dhënë tetë lloje bagëtish në çifte. Merr dy llojet për dhentë dhe dy për dhitë..."**

Pas përmendjes së këtyre katër çifteve, All'Ilahu i Lartësuar e urdhëron Profetin që t'i pyesë ata menjëherë: **"Thuaju: 'A i ka ndaluar All'Ilahu dy meshkujt ose dy femrat...?!'"** Apo u ka ndaluar atyre çfarë gjendet në barqet e femrave prej deleve dhe dhive?! **"...ose atë që mbajnë në bark dy femrat...?"**

Më pas shton se, nëse jeni të sinqertë se All'Ilahu ka ndaluar ndonjë gjë nga ato që pretendoni dhe keni në dorë argumentimin e ndalimit të cilësdo nga këto kafshë, atëherë sillni argumentin tuaj për këtë: **"...Lajmëromëni mua me dije të saktë, nëse ajo që thoni është e vërtetë!"**

Në ajetin pasardhës (144), Kur'ani sqaron katër çiftet e tjera të bagëtive që ka krijuar All'Ilahu për njeriun ku thotë se krijo i nga deveja mashkullin dhe femrën dhe nga lopa mashkullin e femrën.

Cilën prej këtyre çifteve jua ndaloi All'llahu, meshkujt apo femrat? Apo ka ndaluar ato që gjenden në barqet e femrave të deveve dhe lopëve? Ajeti thotë: **"Merr dy llojet për devetë edhe dy për lopët. Thuaju: 'A i ka ndaluar All'llahu meshkujt apo femrat ose atë që e mbajnë në bark dy femrat'?..."**

Përderisa dispozita për lejimin apo për ndalimin e këtyre kafshëve është në dorën e All'llahut, Krijuesit të tyre, Krijuesit të njeriut dhe Krijuesit të gjithë botës, është e detyrueshme për këdo që pretendon lejimin apo ndalimin e diçkaje, ose ta vërtetojë këtë përmes rrugës së dëshmisë mendore e logjike, ose të jetë i frymëzuar për këtë, ose të jetë i pranishëm te Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në momentin e nxjerrjes së kësaj dispozite prej tij.

Ai e bëri të qartë në ajetin e mëparshëm (143) se politeistët nuk kishin në dorë asnjë argument shkencor apo logjik për ndalimin e këtyre kafshëve. Ata nuk kanë pretenduar zbritjen e shpalljes mbi to, ose të profetësisë. Duke u nisur nga kjo, mbetet vetëm mundësia e tretë, të pretendojnë se kanë qenë të pranishëm te Profetët e All'llahut ditën që janë nxjerrë këto dispozita. Kjo është arsyeja që All'llahu në ajet thotë: **"...Apo mos keni qenë të pranishëm kur All'llahu ju ka urdhëruar për këtë?..."**

Përderisa përgjigjja për këtë pyetje është mohuese, vërtetohet se ata kanë shpifur dhe kanë gënjyer.

Në përfundim ajeti thotë: **"...Atëherë, kush është më keqbërës se ai që shpif gënjeshtër rreth All'llahut, për t'i shpënë**

njerëzit në humbje nga padija? Pa dyshim, All'llahu nuk i çon në rrugë të drejtë keqbërësit."¹

Nga ky ajet përfitohet se shpifja ndaj All'llahut është ndër mëkatet më të mëdha. Ajo është padrejtësi ndaj All'llahut të Lartësuar dhe pozitës Madhështore të Tij sunduese, padrejtësi ndaj robëve të All'llahut dhe padrejtësi ndaj vetvetes.

Nga ky ajet përfitohet, gjithashtu, se udhëzimi e humbja hyjnore nuk janë me detyrim, sepse për to ka parakushte dhe shkaqe që fillojnë nga vetë njeriu dhe realizohen nga vetë vepra e tij. Kështu që, kur dikush e bën me qëllim e me zgjedhjen e tij ushtrimin e padrejtësisë e të mizorisë, All'llahu ia ndalon atij mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e Tij dhe e lë atë të humbë në greminat e iluzioneve e të humbjes.

¹ Ka shpjegime të shumta për thënien e All'llahut: "*me pa dituri*". Por gjithsesi, shpjegimi më i afërt për togfjalëshin *çon në humbje*, është se ata, për shkak të injorancës së tyre, çojnë në humbje njerëzit.

Ajeti 145

قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلَّا أَنْ
يَكُونَ مَيْتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ لَحْمَ خِنْزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ
أَوْ فِسْقًا أُهِلَّ لِغَيْرِ اللَّهِ بِهِ ۚ فَمَنِ اضْطُرَّ غَيْرَ بَاغٍ وَلَا عَادٍ
فَإِنَّ رَبَّكَ غَفُورٌ رَحِيمٌ ﴿١٤٥﴾

“Thuaj: ‘Unë nuk gjej në atë që më është shpallur mua, asgjë që e ndalon njeriun të hajë çfarë të dojë, përveç kafshëve të ngordhura, gjakut të derdhur, mishit të derrit – se këto janë të ndyta – dhe mishit që është therur në emër të dikujt tjetër në vend të All'Ilahut. Por kushdo që detyrohet nga nevoja të hajë ndonjë gjë prej këtyre, pa dashur të bëjë gjynah dhe pa e kaluar kufirin, nuk do të fajësohet. Vërtet, All'Ilahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”

Komentimi

Disa kafshë të ndaluara

Me qëllim që të dallojë të ndaluarat nga risitë e politeistëve që i futën në fenë e vërtetë, All'Ilahu i Lartësuar urdhëron Profetin Muhamed (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi

familjen e tij!) në këtë ajet që t'u thotë qartë politeistëve: **“Thuaj: ‘Unë nuk gjej në atë që më është shpallur mua asgjë që e ndalon njeriun të hajë çfarë të dojë, përveç kafshëve të ngordhura, gjakut të derdhur, mishit të derrit- se këto janë të ndyta...”**”. Pra, nuk shoh në sheriat asnjë kafshë të ndaluar, nga mashkulli apo femra, i madh apo i vogël, me përjashim të atyre që përmend ajeti, dhe se të gjitha këto gjëra janë të ndyra dhe burim sëmundjesh të ndryshme.

Përemri "hu", ai, që gjendet te fraza "fe innehu", edhe pse është në numrin njëjës, duke u bazuar në mendimin e shumicës së komentuesve, përfshin tre pjesët që përmenden në ajet (e ngordhura, gjaku dhe mishi i derrit). Si rrjedhim, del kuptimi i fjalisë së fundit: Të gjitha ato që u përmenden janë të ndyra.¹ Kjo i përshtatet anës së jashtme të ajetit, ku përemri ai përfshin të gjitha konceptet që thuhën në ajet. Nuk ka dyshim se e ngordhura e gjaku janë të ndyta si mishi i derrit.

Më pas All'Ilahu i Lartësuar na tregon për një lloj të katërt, ku thotë: **“...dhe mishit që është therur në emër të dikujt tjetër në vend të All'Ilahut...”**,² pra, kur nuk përmendet emri i All'Ilahut gjatë therjes së saj.

Duhet medituari se All'Ilahu ka përmendur termin "fiskan" në vend të fjalës "el hajvan", kafshë.

¹ Në fakt kuptimi i fjalës “vërtet ai” është “vërtet, çfarë përmendet.”

² Originalitetit i fjalës “uh'hile” është "el-ihlal". Kjo fjalë vjen nga fjala "hilal", "hëna e re". "El ihlal" do të thotë ngritja e zërit në momentin e shikimit të hënës së re. Më pas u përdor për çdo zë të ngritur. Gjithashtu, përdoret edhe për qarjen e fëmijës së vogël e të porsalindur. Meqenëse ata përmendnin emrat e idhujve të tyre me zë të lartë gjatë prerjes, therjes e bërjes kurban të bagëtive, kjo vepër e tyre është perifrazuar me termin "ihlal".

Fjala "el fisku", siç kemi thënë edhe më përpara, do të thotë dalje nga bindja e All'Ilahut e nga korniza adhuresë. Për këtë arsye, për çdo gabim të bërë thuhet shthurje.

Ndërsa përmendja e këtij termi, në këtë kontekst, përballë së ndyrës, e cila është përdorur për tre gjërat e përmendura më parë, mund të jetë tregues se mishrat e ndaluar janë dy llojesh:

Mishrat e ndaluar, si rezultat i pislëkut të tyre, u kanë ikur vlerat ushqimore, shkaktojnë dëme trupore, të cilat cilësohen si të ndyra (pra, të pista).

Mishrat që konsiderohen të ndyrë, por që nuk shkaktojnë dëme trupore e shëndetësore, janë për nga aspekti moral e shpirtëror, tregojnë largimin nga All'Ilahu e nga realiteti i njësimi. Për këtë arsye u bë i ndaluar.

Bazuar në këtë, nuk duhet të mendojmë përherë se mishrat e ndaluar përmbajnë dëme shëndetësore, por ndoshta janë ndaluar për arsye të dëmeve morale e shpirtërore. Këtu bëhet e qartë se kushtet islame, të vendosura për therje, janë dy llojesh:

Disa prej tyre – si prerja e katër damarëve të qafës dhe dalja e sasisë së mjaftueshme të gjakut nga e therura, kanë aspektin shëndetësor.

Dhe disa të tjera, si drejtimi i pjesës së përparme të kafshës që duam të therim nga Kibla, përmendja e emrit të All'Ilahut, si dhe qenia e kasapit mysliman, kanë aspektin moral.

Në fund të ajetit, All'Ilahu i Lartësuar përjashton atë që detyrohet të hajë diçka nga mishrat e ndaluara, sepse nuk gjen ushqim tjetër.

Për këtë thotë: **“Por kushdo që detyrohet nga nevoja të hajë ndonjë gjë prej këtyre, pa dashur të bëjë gjynah dhe pa e kaluar kufirin, nuk do të fajësohet. Vërtet, All'illahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”**¹

Që do të thotë se kush detyrohet të hajë diçka nga të ndaluarat për t’u ushqyer, për të ruajtur jetën e tij, jo për ta shijuar, jo për ta bërë të lejuar atë që ka ndaluar All'illahu, apo ta kalojë kufirin e domosdoshmërisë, ai nuk bën gjynah. Për këtë ajeti thotë: **“...Vërtet, All'illahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë...”**

Këto dy kushte janë vendosur në mënyrë që të mos marrin shkas të detyruarit nga ky lejim e ta kalojnë kufirin e asaj që ka vendosur All'illahu me argumentin e detyrimit, që ta injorojnë e ta neglizhojnë përkrahjen e mbështetjen e ligjeve hyjnore.

Transmetimet e ardhura rreth kësaj çështjeje tregojnë se detyrimi në ngrënien e mishrave të ndaluar në të shumtën e rasteve përputhet me udhëtimet që nuk kanë qëllime të këqija. Nëse dikush udhëton për të përkrahur padrejtësinë, për të vjedhur e për të uzurpuar, atij nuk i lejohet të hajë mishërat e ndaluar për të ruajtur jetën e tij. Përkundrazi ai dënohet për këtë vepër të tij, sepse ai e kërkoi vetë këtë udhëtim të ndaluar (haram). Transmetimet e ardhura për këtë temë përputhen plotësisht me konceptin e përgjithshëm të këtij ajeti.

¹ "El-Bágij" vjen nga fjala "el-beg'ju", që do të thotë kërkesë. "El-Ädij" vjen nga fjala "el-advu", që do të thotë teprim dhe tejkalim i kufirit.

Përgjigja rreth një pyetjeje

Nga të gjitha këto që thamë më lart, lind pyetja: Si u kufizuan të gjitha këto të ndaluara nga All'illahu, në aspektin e ushqimeve, vetëm në katër gjëra? Ndërkohë që ne e dimë se ushqimet e ndaluara nuk kufizohen vetëm te këto gjëra, si p.sh. mishrat e kafshëve të egra, mishrat e kafshëve të detit (me përjashtim të peshqve që kanë luspa) e të ngjashëm me to. Të gjitha këto janë të ndaluara, por që në ajet asgjë nga këto nuk përmendet. Përse janë përkufizuar të ndaluarat me këto katër gjëra?!

Si përgjigje për këtë pyetje disa kanë thënë se këto ajete kanë zbritur në Mekë, ndërsa gjykimi apo dispozita për ushqime të tjera të ndaluara nuk kishte zbritur ende.

Mirëpo kjo përgjigje nuk duket e saktë. Dëshmitar për këtë është po e njëjtja shprehje, apo të ngjashme me të, e cila gjendet në suret që kanë zbritur në Medine, siç është ajeti 173 i sures Bekare.

Është e qartë se ky ajet është analog vetëm për mohimin e dispozitave mitologjike, të cilat kanë qenë të përhapura ndërmjet politeistëve, kështu që kufizimi është “kufizim suplementar” e jo real”.

Thënë ndryshe: Duket sikur ajeti thotë: Këto janë të ndaluarat nga All'illahu dhe nuk janë ato që thurin imagjinatat tuaja.

Në mënyrë që të sqarohet kjo e vërtetë, po marrim një shembull:

Na pyet dikush: “A kanë ardhur Hasani e Husejni?”

I përgjigjemi: “Jo! Ka ardhur vetëm Hasani.”

S'ka dyshim se me këtë përgjigje ne dëshirojmë të mohojmë këtu mosardhjen e të dytit, pra të Husejnit. Por nuk ka problem që të jenë edhe të tjerë, prej atyre të cilëve nuk është boshti i bisedës sonë në thelb, të kenë ardhur gjithashtu. Kjo është ajo e cila quhet me kufizim suplementar (ose relativ).

Sigurisht, duhet patur vëmendja për një pikë të rëndësishme, se pamja e jashtme e kufizimit, zakonisht është kufizim real, me përjashtim të vendeve në të cilat ka argumente që anashkalojnë treguesin e jashtëm, siç është rasti ynë tani.

Ajete 146 - 147

وَعَلَى الَّذِينَ هَادُوا حَرَّمْنَا كُلَّ ذِي ظُفْرٍ ^ط وَمِنَ الْبَقَرِ
وَالْغَنَمِ حَرَّمْنَا عَلَيْهِمْ شُحُومَهُمَا إِلَّا مَا حَمَلَتْ ظُهُرُهُمَا أَوْ
الْحَوَايَا أَوْ مَا اخْتَلَطَ بِعَظْمٍ ^ج ذَلِكَ جَزَيْنَهُمْ ^ط بِبَغْيِهِمْ ^ط وَإِنَّا
لَصَادِقُونَ ﴿١٤٦﴾ فَإِنْ كَذَّبُوكَ فَقُلْ رَبُّكُمْ ذُو رَحْمَةٍ وَاسِعَةٍ
وَلَا يُرَدُّ بَأْسُهُ ^ج عَنِ الْقَوْمِ الْمُجْرِمِينَ ﴿١٤٧﴾

"Ne ua ndaluam hebrenjve (të hanin) të gjitha kafshët që kanë kthetra (ose njëthundrakët), ndërsa nga lopët e delet, atyre ua ndaluam dhjamin e brendshëm të tyre, me përjashtim të dhjemit të shpinës ose të zorrëve, ose atë që është i lidhur me eshtra. Me këtë, Ne i ndëshkuam ata për shkak të mosbindjes së tyre. Ne, pa dyshim, themi të vërtetën."

"Prandaj, nëse ata të quajnë gënjeshtar, thuaju: 'Zoti juaj është zotërues i mëshirës së gjerë, por ndëshkimi i Tij nuk do të prapësohet nga populli keqbërës.'"

Komentimi

Çfarë u ndalua për jehudinjtë?

Në ajetet e mëparshme kafshët e ndaluara për t'u ngrënë u kufizuan në katër kafshë. Mirëpo këto dy ajete tregojnë për disa gjëra që u ndaluan për jehudinjtë, në mënyrë që të sqarojnë se dispozitat pagane, mitologjike të injorancës nuk përputhen me dispozitat islame dhe as me fenë e jehudinjëve (madje as me fenë e Mesihut (Isait), e cila në të shumtën e dispozitave ndjek fenë e jehudinjëve).

Në këto ajete thuhet qartë se këto lloj ndalimesh për jehudinjtë kanë pasur karakter ndëshkues. Sikur jehudinjtë të mos kishin bërë krime, atyre nuk do t'u ndaloheshin këto gjëra. Bazuar në këtë, dikush ka të drejtë të pyesë paganët: "Nga i sollët këto dispozita të prodhuara?"

All'llahu i Lartësuar thotë në fillim: **"Ne ua ndaluam hebrejve (të hanin) të gjitha kafshët që kanë kthetra (ose njëthundrakët)..."**

Origjina e fjalës "*edh dhufu*", *thundra* është "*el makhleb*", *kthetra*, por përdoret gjithashtu edhe për thundrat e kafshëve thundrake (kafshët që kanë thundra të pahapura si gishtat, si kali e jo si delja e lopa, që kanë thundra të hapura), sepse thundrat e tyre i ngajnë thoit. Gjithashtu thuhet edhe për thundrën e devesë (gamiles), që fundin e saj e ka si thoi dhe nuk ka në të hapje as çarje e ndarje si puna e ndarjes së gishtave.

Mbi këtë bazë, ajo që përftohet nga ajeti është se të gjitha kafshët që nuk kanë thundra, qofshin kafshë apo shpendë, kanë qenë të ndaluara te jehudinjtë.

Kjo gjë, në mënyrë të përmbledhur, del edhe te Levitiku nga Teurati, kapitulli "Shkrimet e Shenjta", vargu 11: "Zoti e urdhëroi Moisiun dhe Harunin: Këshillojini beni israilët: Këto janë kafshët që duhet të hani nga të gjitha kafshët e tokës: Hani çdo kafshë me thundra të çara e ripërtypëse, ndërsa vetëm kafshët ripërtypëse ose vetëm me thundër të çarë, mos i hani. Kështu që gamilja nuk është e pastër për ju, sepse ajo është ripërtypëse, por me thundër jo të çarë."¹

Gjithashtu, nga fraza pasardhëse e ajetit që flet për delet e lopët, kuptohet ndalimi i mishit të devesë te jehudinjtë, në një formë të përgjithshme.

Më pas All'illahu i Lartësuar thotë: **"...ndërsa nga lopët e delet, atyre ua ndaluam dhjamen e brendshëm të tyre..."**

Më pas bën përjashtim për tre raste: E para, dhjamërat që gjenden në pjesën e kurrizit të këtyre dy kafshëve: **"me përjashtim të dhjamt të shpinës..."**

E dyta, dhjamërat që ndodhen ndërmjet dy anëve të saj ose ndërmjet zorrëve të tyre: **"...ose të zorrëve..."**²

E treta, dhjamërat e përziera me kockat, ose të ngjitura me to **"...ose atë që është i lidhur me eshtra..."**

Në fund të ajetit All'illahu sqaron se këto çështje u ndaluan te jehudinjtë për shkak të padrejtësisë e despotizmit të tyre, pasi këto mishra e dhjamëra i kanë dashur shumë: **"...Me këtë, Ne i ndëshkuam ata për shkak të mosbindjes së tyre..."**

Për të vërtetuar këtë të vërtetë, All'illahu ka shtuar: **"...Ne, pa dyshim, themi të vërtetën."**, vërtetë ajo që themi është nëna e së vërtetës.

¹ Libri i Shenjtë, Eksodi, "El-Is'hah" 11, f. 142.

² "El-hauaja" është shumësi i fjalës "hauije", është gjithçka që gjendet në barkun e kafshës e që është në formën e një topi. Në këtë rast përfshihen edhe zorrët.

Hulumtime

1- Çfarë kanë bërë beni izraelitët?

Duhet të shohim se çfarë padrejtësish kanë bërë beni israilët, që All'illahu i Lartësuar ua ndaloi atyre këto begati, të cilat i kanë dashur shumë?!

Ka medh'hebe të ndryshme të komentuesve për këtë temë. Nga ajetet 160 dhe 161 të sures "En Nisa" përftohet se shkak i ndalimit është bërë për disa çështje, si: Padrejtësia e tyre ndaj të dobtëve, kundërshtimi i Profetëve, ndalimi i udhëzimit të njerëzve, kamata, ngrënia e pasurisë së njerëzve me pa të drejtë. Ajetet thonë: **"Ne ua ndaluan atyre disa ushqime të mira, të cilat ishin të lejuara për ta, për shkak të prapësive që bënë, për shkak se ata pengonin shumë njerëz nga udha e Allahut. Për shkak se merrnin kamatë, megjithëse kjo ishte e ndaluar për ta dhe për shkak se përvetësonin padrejtësisht pasurinë e njerëzve. Jobsimtarëve midis tyre, Ne u kemi përgatitur një dënim të dhembshëm."**

2- Çfarë do të thotë "Me të vërtetë ne jemi të singertë"?

Fraza **"Me të vërtetë ne jemi të singertë"**, e cila ka ardhur në fund të ajetit të parë prej ajeteve në fjalë, mund të jetë treguese se singëriteti dhe e vërteta, në çështjen e ndalimit të këtyre ushqimeve, është ajo që kemi thënë Ne dhe jo ajo që kanë thënë jehudinjtë, se ndalimi i këtyre ushqimeve e mishrave ka qenë nga ana e izraelitëve (Jakubi), sepse Jakubi, siç është transmetuar në

ajetin 93 të sures “Ali Imran”, nuk ka gjykuar ndalimin e këtyre gjërave. Kjo është një akuzë që jehudinjtë ia kanë mveshur atij.

Përderisa kokëfortësia e jehudinjve politeistë ishte e dukshme dhe ata mund të shkonin deri në përgënjeshttrimin e të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), All'Ilahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij në ajetin tjetër që t’u thotë atyre se nëse e gënjejnë apo e përgënjeshtrojnë, Zoti juaj është shumë i Mëshirshëm dhe Ai nuk nxiton në dënimin tuaj, madje jua ngadalëson se ndoshta pendoheni te Ai dhe ktheheni nga gabimet tuaja, pendoheni për veprat tuaja e ktheheni te All'Ilahu. **"Prandaj, nëse ata të quajnë gënjeshtar, thuaju: 'Zoti juaj është zotërues i mëshirës së gjerë'..."**

Por nëse e keqkuptojnë përdorimin e këtij ngadalësimi të All'Ilahut dhe vazhdojnë me armiqësi, ata duhet ta dinë se nuk kanë shpëtim nga ndëshkimi i All'Ilahut e do t’i mbërrijë së shpejti zemërimi i Tij: **"...por ndëshkimi i Tij nuk do të prapësohet nga populli keqbërës."**

Ky ajet zbulon me qartësi madhështinë e mësimave të Kur'anit. Sepse, pas sqarimit dhe qartësimit të këtyre kundërshtimeve që bënin jehudinjtë dhe politeistët, Kur'ani nuk bazohet menjëherë te kërcënimi e ndëshkimi, por e lë rrugën e kthimit të hapur. Këtë e bën duke përdorur fjalë e fraza që përmbajnë dashuri e butësi si: “Zoti juaj”, “posedues i mëshirës”, e gjerë”. Edhe sikur të ekzistojë mundësia më e vogël për t’u kthyer, këto fraza e nxisin për kthimin drejt rrugës së drejtë.

Por, me qëllim që kjo mëshirë e gjerë e All'llahut të mos keqpërdoret për të vazhduar në gjynahet e tyre, as të mos shkaktojë shtimin e guximit të tyre për padrejtësi e tirani dhe që të ndalen nga armiqësia e arroganca, Kur'ani i kërcënon ata në fund të fjalisë së ajetit, me një ndëshkim që nuk mund të prapësohet.

Ajetet 148 - 150

سَيَقُولُ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا أَشْرَكْنَا وَلَا ءَابَاؤُنَا وَلَا
 حَرَمْنَا مِنْ شَيْءٍ ۚ كَذَلِكَ كَذَّبَ الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ حَتَّىٰ
 ذَاقُوا بَأْسَنَا ۖ قُلْ هَلْ عِنْدَكُمْ مِنْ عِلْمٍ فَتُخْرِجُوهُ لَنَا ۖ إِنْ
 تَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَإِنْ أَنْتُمْ إِلَّا تَخْرُصُونَ ﴿١٤٨﴾ قُلْ فَلِلَّهِ
 الْحُجَّةُ الْبَلِيغَةُ ۖ فَلَوْ شَاءَ لَهَدَيْكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿١٤٩﴾ قُلْ هَلَمْ
 شُهِدَآءُكُمْ الَّذِينَ يَشْهَدُونَ أَنَّ اللَّهَ حَرَّمَ هَذَا ۖ فَلِنْ شَهِدُوا
 فَلَا تَشْهَدْ مَعَهُمْ ۚ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَ الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا
 وَالَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ وَهُمْ بِرَبِّهِمْ يَعْدِلُونَ ﴿١٥٠﴾

“Idhujtarët do të thonë: ‘Sikur të donte All'lahu, nuk do të adhuronim tjetër veç Tij as ne, as baballarët tanë dhe ne nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë’. Kështu mohonin edhe ata para tyre, derisa shijuan dënimin tonë. Thuaju: ‘A keni ndonjë provë të na paraqitni? Ju mbështeteni vetëm në hamendje dhe jeni vetëm gënjeshtarë.’”

“Thuaju: ‘All'lahu ka argumentin më bindës dhe, po të donte Ai, të gjithëve do t’ju përudhte në rrugë të drejtë!’”

"Thuaj: 'Sillni dëshmitarët tuaj që dëshmojnë se All'llahu e ka ndaluar këtë!' E, nëse dëshmojnë (duke gënjyer), ti mos dëshmo me ata. Mos i ndiq dëshirat e kota të atyre që hedhin poshtë shpalljet Tona, nuk besojnë në Botën e Përtejme dhe sajojnë zota të tjerë të barabartë me Zotin e tyre!"

Komentimi

Shmangia nga përgjegjësia me argumentin e detyrimit

Ajetet e mëparshme flisnin për politeistët dhe për dënimin që do të kishin ata për shmangien nga rruga e drejtë. Gjithashtu, flisnin për veprimet e trashëguara të politeistëve.

Në këto ajete flitet për disa argumenta të pabaza të tyre me gjithë përmendjen e përgjigjes së atyre argumenteve. Së pari, Kur'anit thotë se politeistët si përgjigje për kundërshtimet e tua ndaj tyre rreth shirkut (vënies shok apo ortak All'llahut) dhe ndalimit të ushqimeve të lejuara do të thonë: Sikur të donte All'llahu që të mos ishim politeistë, baballarët tanë të mos ishin paganë dhe të mos ndalonim ato që ndaluam, Ai do të vepronte: "Idhujtarët do të thonë: 'Sikur të donte All'llahu, nuk do të adhuronim tjetër veç Tij as ne, as baballarët tanë dhe ne nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë'..."

E njëjta thënie gjendet edhe në dy ajete të tjera në Kur'an. Në suren "Nahl", ajeti 35, i cili thotë: **"Ata që i shoqërojnë All'llahut zota të tjerë, thonë: 'Sikur të donte All'llahu, as ne, as të parët tanë nuk do të adhuronim gjë tjetër, përveç Tij dhe, nuk do të kishim ndaluar asgjë, pa dëshirën e Tij'..."** Dhe në suren

“Zuhruf”, ajeti 20, i cili thotë: "Dhe ata thonë: ‘Sikur të kishte dashur i Gjithëmëshirshmi, ne nuk do t’i kishim adhuruar ata’...”

Nga këto ajete përftohet se politeistët, si shumë mëkatarë që dëshirojnë t’i shmangen përgjegjësisë së mosbindjes nën perden e detyrimit, besonin se njeriu është i detyruar dhe thoshin se gjithçka që bëjnë, ishte me dëshirën e All'llahut dhe ecurinë e Tij, se përndryshe nuk do të bënin vepra të tilla.

Në realitet donin shfajësimin e vetes së tyre nga të gjitha mëkatet. Porse, ndërgjegjja e çdo njeriu me mend e me logjikë, dëshmon se njeriu është i lirë në veprat e tij dhe jo i detyruar dhe për këtë, nëse dikush i bën padrejtësi, bezdiset prej tij, e qorton atë, madje e dënon atë nëse ka mundësi.

Gjithë këto reagime tregojnë se ai e shikon kriminelin të lirë në veprën e tij dhe zgjedhës dhe ai nuk është i gatshëm që të heqë shikimin nga këto reagime, me argumentimin se padrejtësia që i është bërë atij nga ky person është në përputhje me dëshirën e All'llahut. Nga politeistët mund të kuptohet ndryshe ky ajet sepse pretendonin se: Heshtja e All'llahut ndaj adhurimit të idhujve e ndalimi i një grupi kafshësh është argument për dakortësinë e Tij, se, sikur All'llahu të mos ishte i kënaqur me këtë, do t’i detyronte, në një mënyrë ose në një tjetër, të ndaleshin nga këto veprime.

Me përmendjen e frazën **“as baballarët tanë”** dëshironin të ngjyrosnin besimin e tyre të kotë e të zbrazët me ngjyrën e hershmërisë e të vazhdimësisë duke thënë se këto veprime kanë qenë gjithmonë dhe nuk janë pretendime të reja.

Por Kur’ani e sfidoi përgjigjen e tyre, dialogoi me ta në formë të prerë se nuk janë vetëm ata që shpifin për All'llahun

gënjeshtër të tilla: **"...Kështu mohonin edhe ata para tyre..."**,¹ por ata shijuan shpërblimin e shpifjeve të tyre: **"...derisa shijuan dënimin tonë..."**

Ata kanë gënjyer me fjalët e tyre, ashtu siç përgënjeshtrojnë edhe Profetët, sepse Profetët i kanë ndaluar hapur njerëzit nga paganizmi, politeizmi dhe ndalimin e asaj që ka lejuar All'llahu. Jo vetëm ata, por as baballarët e tyre nuk i kanë dëgjuar këto fjalë të Profetëve.

Nga këto fjalë të tyre lind pyetja: Si mund të jetë dakord All'llahu me veprat e tyre?

Sikur All'llahu i Lartësuar të ishte dakord me këto çështje, atëherë pse i dërgoi Profetët e Tij për t'i thirrur në njësim?! Në të vërtetë, thirrja e Profetëve është argumenti më i fortë për lirinë, dëshirën dhe zgjedhjen të njeriut.

Më pas All'llahu i Lartësuar thotë: O Muhamed! U thuaj atyre: A keni argument të saktë e të prerë për ato që pretendoni? Nëse keni sillini: **"Thuaju: 'A keni ndonjë provë të na paraqitni'?..."** Në fund shton: Ajo që ndiqni ju nuk është gjë tjetër veçse iluzion e imagjinatë boshe: **"...Ju mbështeteni vetëm në hamendje dhe jeni vetëm gënjeshtarë."**

Në ajetin pasardhës prej ajeteve në fjalë, Kur'ani përmend një argument tjetër për të hedhur poshtë pretendimet e politeistëve ku thotë se All'llahu solli argumente të larta dhe fakte të qarta e të sakta mbi njësimin e Tij. Po kështu ngriti dispozitat e të lejuarës e të ndaluarës, qoftë me anë të Profetëve të Tij apo përmes logjikës, ku nuk mbetet asnjë justifikim për të justifikuarit: **"Thuaju: 'All'llahu ka argumentin më bindës...'"**

¹ "Kedhdhebe", në gjuhën arabe vjen me dy kuptime: Të gënjeshtër dhe vepër e gënjeshtërt.

Mbi këtë bazë, askush nuk mund të pretendojë se All'llahu ka qenë dakord me ideologjitë e veprat e tyre të padrejta duke heshtur. Gjithashtu nuk pranohet kurrë mendimi se ata kanë qenë të detyruar, sepse, sikur ata të ishin të detyruar, atëherë sjellja e argumentit dhe dërgimi i Profetëve për lajmërimin e thirrjes së tyre do të ishin të kota. Kështu që në të vërtetë sjellja e argumentit është argument për lirinë e dëshirës.

Duhet patur parasysh këtu se fjala "*el huxhxbetu*", *argument*, vjen nga fjala "*haxhxbun*", do të thotë *synim, qëllim*. Fjala "*huxhetun*" përdoret për rrugën që synon njeriu. Kjo përdoret edhe për faktin e argumentin, gjithashtu, sepse thënësi synon vërtetimin e asaj që kërkon për të tjerët përmes rrugës së tij.

Duke parë termin "*baligah*", *e arrirë, e plotë*, sqarohet se argumentet që ka sjell All'llahu për njerëzit përmes rrugës së mendjes, përmes transmetimit, duke dërguar Profetë, përmes diturisë e mendimit, janë të forta, të qarta. Nuk ka asnjë perde, nuk mbetet asnjë hapësirë për lëkundje e dyshim për asnjë. Për të njëjtin shkak All'llahu i zhveshi të Dërguarit e Tij nga të gjitha gabimet, që t'i largojë ata nga çdo lloj lëkundje e dyshimi në thirrje e transmetim.

Në fund të ajetit thuhet: Sikur të donte All'llahu t'ju udhëzonte të gjithëve së bashku me detyrim, do ta bënte: **"...dhe, po të donte Ai, të gjithëve do t'ju përudhte në rrugë të drejtë!"**

Kjo fjali tregon për aftësinë e All'llahut të Lartësuar, t'i detyrojë të gjithë bijtë e Ademit në udhëzim, ku asnjëri të mos kishte mundësi ta kundërshtonte Atë. Por, shembulli i kësaj forme nuk do të ishte besimi dhe as veprat që rrjedhin nga ky besim i detyruar, i ashpër, pa asnjë vlerë. Kështu që zgjedhja e njeriut dhe

plotësimi i tij është të ndjekë rrugën e udhëzimit e të devotshmërisë, me dëshirën tij, me zgjedhjen e tij, me këmbët e tij. Si rrjedhim, nuk ka kontradiktë ndërmjet kësaj fjalie dhe ajetit të mëparshëm, ku u transmetua mohimi i detyrimit (*el xhebru*).

Kjo fjali thotë: Me të vërtetë, detyrimi i njerëzve, që pretendoni, është çështje e mundur për All'llahun e Lartësuar, por Ai nuk e bën në asnjë mënyrë, sepse detyrimi bie në kundërshtim me urtësinë dhe mohon interesin njerëzor.

Politeistët u kapën te fuqia dhe dëshira e All'llahut për zgjedhjen e medh'hebit të detyrimit (xhebrit), ndërkohë që fuqia dhe dëshira e All'llahut janë të vërteta, s'ka dyshim në to. Porse rezultati i tyre nuk është detyrimi e ashpërsia. Përkundrazi, All'llahu i Lartësuar don që të jemi të lirë, të ndjekim rrugën e vërtetë me dëshirën tonë.

Në librin "El-Kafij", është transmetuar nga Imam El Kadhim (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: "Në të vërtetë, All'llahu ka dy argumente për njerëzit, argumentin e jashtëm dhe argumentin e brendshëm. Përsa i përket të jashtëmit ato janë të Dërguarit, Profetët dhe Prijësit, ndërsa përsa i përket të brendshmit ato janë mendjet."¹

Në librin "Amalij Suduk", është transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), se kur u pyet për komentimin e thënies së All'llahut të Lartësuar, lexojmë: "**All'llahu ka argumentin më të plotë**", ka thënë: "All'llahu i Lartësuar i thotë robit Ditën e Ringjalljes: 'Robi im, a ishe në dijeni?' Nëse i thotë: 'Po', All'llahu e pyet: 'Përse nuk veproje sipas asaj që dije?' Dhe nëse thotë se isha i paditur, e pyet sërish: 'Përse nuk mësove që të veproje? E kështu pra triumfon mbi të. Ky pra është argument i plotë.'"²

¹ Komentimi "Nuruth-Thekalejn", vëll. 1, f. 776.

² Burimi i mëparshëm.

Sigurisht, qëllimi në hadithin e mësipërm është se argumenti i plotë nuk është i kufizuar në dialogun e All'Ilahut të Lartësuar me robtë e tij Ditën e Ringjalljes, por All'Ilahu i Lartësuar ka më shumë argumente se sa jepen te ai hadith, pasi argumentet e Tij përfshijnë këtë botë dhe Botën e Përtejme.

Në ajetin vijues, në mënyrë që të bëhet e qartë pavërtetësia e thënieve të politeistëve dhe për të mbrojtur bazat e gjykimit dhe dispozitat e sakta, Kur'ani i fton politeistët që të sjellin dëshmitarët e tyre, nëse kanë, në mënyrë që të dëshmojnë se All'Ilahu është Ai që i ka ndaluar kafshët e të mbjellat për të cilat pretendojnë ndalimin e tyre: **“Thuaj: ‘Sillni dëshmitarët tuaj që dëshmojnë se All'Ilahu e ka ndaluar këtë!’...”**

Më pas shton se, nëse kanë dëshmitarë të tillë, le t'i sjellin. Por ata përkrahin me dëshminë dhe pretendimin e tyre vetëm vetveten e tyre, kështu që ti mos dëshmo me ta dhe as mos i përkrah në pretendimin e tyre: **“...E, nëse dëshmojnë (duke gënjer), ti mos dëshmo me ata...”**

Nga ajo që u tha më lart, u sqarua se nuk ka kurrfarë përplasjeje në ajet, nëse vërehet i tëri. Ndërsa, kërkesa e tyre me dëshmitar, në fillim, e më pas urdhri i All'Ilahut të Lartësuar, për të mos pranuar dëshminë e tyre, nuk përbën ndonjë problem.

Qëllimi është që ata të ndihen të paaftë në sjelljen e dëshmitarëve që të dëshmojnë prerazi e me bindje, sepse ata nuk kanë asnjë argument nga Profetët e nga Librat qiellorë, që vërtetojnë ndalimin e këtyre çështjeve. Si rrjedhim, janë vetë ata që pretendojnë se këto çështje do t'i dëshmojnë. Dihet se si është e refuzuar puna e kësaj dëshmie.

Për më tepër, të gjitha argumentet dëshmojnë se këto dispozita janë dispozita të prodhuara, të shpikura, që burojnë nga

epshi i pastër dhe tradita e verbër. Këto dispozita nuk merren kurrë në konsideratë.

Për këtë, në frazën pasardhëse All'llahu thotë: **"...Mos i ndiq dëshirat e kota të atyre që hedhin poshtë shpalljet Tona, nuk besojnë në Botën e Përtejme dhe sajojnë zota të tjerë të barabartë me Zotin e tyre!"**¹

Kjo do të thotë se paganizmi, mohimi i ringjalljes nga ana e tyre, mitologjitë, ndjekja e epsheve, janë dëshmi të gjalla se dispozitat e tyre janë të fabrikuara dhe se pretendimet e tyre, në çështjet e ndalimit të këtyre tematikave, nga ana e All'llahut, nuk kanë vlerë, as bazë e as saktësi.

¹ "Ja'dilun" vjen nga lënda "adl", me kuptimin ortak dhe i ngjashëm. Bazuar mbi këtë, kuptimi i fjalisë "Ato me Zotin e tyre bëhen të njëjtë." është se ata kanë pretenduar se janë ortakë dhe të ngjashëm me All'llahun e Lartësuar.

Ajetet 151 - 153

* قُلْ تَعَالَوْا أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبُّكُمْ عَلَيْكُمْ ^ط أَلَّا تُشْرِكُوا بِهِ
 شَيْئًا ^ط وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا ^ط وَلَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ مِمَّنْ إِمْلَقِ ^ط
 نَحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ ^ط وَلَا تَقْرَبُوا الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا
 وَمَا بَطَنَ ^ط وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَ الَّتِي حَرَّمَ اللَّهُ إِلَّا بِالْحَقِّ ^ج
 ذَٰلِكُمْ وَصَّيْتُكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٥١﴾ وَلَا تَقْرَبُوا مَالَ الْيَتِيمِ
 إِلَّا بِالَّتِي هِيَ أَحْسَنُ حَتَّىٰ يَبْلُغَ أَشُدَّهُ ^ط وَأَوْفُوا بِالْكَيْلِ
 وَالْمِيزَانَ بِالْقِسْطِ ^ط لَا نُكَلِّفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا ^ط وَإِذَا قُلْتُمْ
 فَاعْدِلُوا وَلَوْ كَانَ ذَا قُرْبَىٰ ^ط وَبِعَهْدِ اللَّهِ أَوْفُوا ^ج ذَٰلِكُمْ
 وَصَّيْتُكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿١٥٢﴾ وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي
 مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ ^ط وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَن سَبِيلِهِ ^ج
 ذَٰلِكُمْ وَصَّيْتُكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ ﴿١٥٣﴾

"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar All'Ilahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën All'Ilahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.'"

"Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë All'Ilahut! Këto ju porosit Ai që ju të kujtoni."

"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai që të jeni të devotshëm."

Komentimi

Dhjetë urdhëresat:

Pas mohimi të dispozitave të ndryshme të politeistëve të cilat i përmendëm në ajetet e mëparshme, këto tre ajete tregojnë për parimet e gjërave të ndaluara në Islam. Ato përmendin mëkatet kryesore të mëdhaja në dhjetë pjesë në mënyrë të përmbledhur, të thellë e të veçantë. I ftojnë politeistët që të shkojnë tek Profeti e të dëgjojnë atë që u lexohet atyre rreth të

ndaluarave reale të All'Ilahut dhe të lënë ndalesat e ndryshme në anën tjetër.

Ajeti thotë: **"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar All'Ilahu'..."**

1- **"...që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)..."**

2- **"...që të silleni mirë me prindërit..."**

3- **"...që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë..."**
pra për arsye të varfërisë e ngushticës **"...sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata..."**

4- **"...që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta..."**, pra mos ju afroni atyre së bashku me mos ndermarrjen e tyre.

5- **dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën All'Ilahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia...**. Pra, mos derdhni gjak të pafajshëm, mos i vrisni qëniet njerëzore, të cilat All'Ilahu e ndaloi vrasjen e tyre, vetëm në rast se janë brenda ligjeve dënuese të All'Ilahut, vetëm në këtë rast ju lejohet të vrisni atë të cilin e ka lejuar All'Ilahu për ju vrasjen e Tij. Më pas, pas përmendjes së këtyre pesë pjesëve, për ta përforcuar më shumë, All'Ilahu thotë: **"...Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni."** Kështu që mos i veproni ato.

6- **"Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë..."**, pra, mos ju afroni pasurisë së jetimit, vetëm me qëllim ndreqeje a pajtimi deri sa të arrijë pjekurinë e tij.

7- **"...Kryejeni drejt matjen dhe peshimin..."** pra, mos mos matni mangët e as mos peshoni mangët kur shisni. Ka raste që njeriu, sado i saktë të jetë në matje e në peshë, mund të shtojë ose lërë mangut dhe nuk mund t'i saktësojë matjet e peshat, për këtë

ajeti thotë në vijim: **"...Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij..."**

8- **"...Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj..."** Mos devijoni nga rruga e drejtë në dëshmi, gjykim apo çështje tjetër edhe nëse është një i afërm i juaji, kështu që dëshmoni të vërtetën dhe gjykoni me drejtësi.

9- **"...Plotësojani besën e dhënë All'Ilahut..."** Mos e thyeni atë. Por, çfarë është besa e All'Ilahut që përmendet në këtë ajet? Komentuesit kanë dhënë disa mundësi për të, por kuptimi i ajetit përmbledh të gjitha besët "krijuese", (me besën krijuese nënkuptohet besa që njeriu i ka dhë All'Ilahut që në krijim), "legjislative", urdhrat e All'Ilahut dhe ç'do premtim, zotim e betim. Më pas, në mbyllje të këtyre katër pjesëve dhe si përforcim, i Lartësuari thotë: **"... Këto ju porosit Ai që ju të kujtoni."**

10- **"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij..."** Pra, All'Ilahu thotë në këtë ajet se: rruga Ime është rruga e njësimi, rruga e vërtetë dhe e drejtë, rruga e pastërtisë dhe e devotshmërisë, kështu që ecni në të, pasojeni dhe ndiqeni atë. Mos ndiqni rrugët e devijuara e të ndara që t'ju largojnë nga All'Ilahu dhe t'ju çojnë në mosmarrëveshje, përplasje, përçarje e ndarje, e të mbjellin tek ju farën e ndarjes e të hipokrizisë.

Më pas i përmbyll të gjitha këto pjesë duke përsëritur për herë të tretë, me qëllim përforcimi, thënien e Tij: **"...Kjo është ajo që ju porosit Ai që të jeni të devotshëm."**

Hulumtime

Këtu janë disa pika që duhet të ndalemi tek ato. Ato janë:

1- Fillimi me njësim dhe fundi me heqjen dorë nga kontradikta

Në këto ajete vihet re se ato dhjetë mësimet e urdhëresat fillojnë me ndalimin e politeizmit (*shirkut*), i cili në realitet është burimi kryesor i përhapjes së të gjitha të këqijave shoqërore dhe i të ndaluarave të All'llahut. Ato përfunduan, gjithashtu, me thirrjen për heqjen dorë nga përçarja e mosmarrëveshja, që konsiderohen si një lloj politeizmi praktik.

Kjo çështje zbulon rëndësinë e çështjes së njësimit (teuhidit) në të gjitha bazat dhe degët islame, si dhe zbulon se njësimi nuk është thjesht vetëm një bazë ideologjike, por ai përfaqëson shpirtin e mësimëve islame në tërësi.

2- Përforcimet e njëpasnjëshme

Fraza **"...Kjo është ajo që ju porosit Ai..."** është përsëritur për përforcim në përfundim të çdo ajeti nga tre ajetet në fjalë, natyrisht me ndryshime në përmbajtje. Ajeti i parë përfundon me thënien **"...me qëllim që të kuptoni"**. Ajeti i dytë mbyllet me fjalinë: **"...që ju të kujtoni."** Dhe ajeti i tretë përfundon me fjalinë: **"...që të jeni të devotshëm."**

Me sa duket këto përshkrime të ndryshme tregojnë se: Faza e parë kur merret një dispozitë prej dispozitave është etapa **"e të logjikuarit"**, pra kuptimi dhe perceptimi i asaj dispozite.

Faza e dytë është faza *“e të kujtuarit”*, që është bluarja e kësaj dispozite, përthithja e dobive të saj dhe asimilimi i përmbajtjes së saj.

Faza e tretë që është edhe e fundit, e cila është edhe faza e praktikimit dhe e zbatimit të cilën Kur’ani e ka quajtur atë faza e *“devotshmërisë.”*

Është e vërtetë se secila nga këto fraza (dhe faza) ka ardhur pas përmendjes e disa mësimave nga ato dhjetë mësim. Mirëpo, është e qartë se këto faza nuk i përkasin dispozitave të caktuara, sepse çdo dispozitë prej dispozitave dhe çdo direktivë prej direktivave ka nevojë për *“mendim”*, *“kujtesë”*, *“devotshmëri dhe veprim”*. E gjithë kjo për ruajtjen e anëve të letërsisë e retorikës, në bazë të të cilave u bë shpërndarja e këtyre përforcimeve (dhe fazave) përgjatë këtyre dhjetë urdhresave.

3- Direktivat dhe urdhërat e përhershme

Ndoshta nuk është e nevojshme të përmendim së këto dhjetë mësim e urdhëra nuk i përkasin vetëm fesë islame, sepse të ngjashme me to kanë qenë në të gjitha legjislacionet e mëparshme, pavarësisht se në fenë islame u është kushtuar më shumë vëmendje.

Në realitet këto dhjetë direktiva i përceptojnë ashtu mendja e ekuilibruar dhe ndërgjegjja e shëndoshë. Thënë ndryshe: Ato janë prej: *“të pavaruarave logjike”* dhe për këtë, ashtu siç përmenden në Kur’an, ato vihen re në një formë apo në një tjetër edhe në legjislacionet e Profetëve të tjerë.¹

¹ Sure "Shura", ajeti 13.

4- Rëndësia e mirësjelljes ndaj prindërve

Përmendja e bamirësisë kundrejt prindërve - menjëherë pas luftimit të politeizmit dhe para përmendjes së direktivave e mësimave të rëndësishme si: ndalimi i vrasjes së njeriut dhe urdhëri për zbatimin e drejtësisë - tregon për rëndësinë e madhe që ka e drejta ndaj prindërve në mësimet islame.

Kjo çështje sqarohet më tepër kur shohim se Kur'ani Fisnik ka përmendur në vend të ndalimit të bërjes keq prindërve, i cili përshtatet me rrjedhën e këtij ajeti që prezanton gjërat e ndaluara, ai përmend mirësjelljen ndaj prindërve, do të thotë se jo vetëm shqetësimi i prindërve dhe keqbërja ndaj tyre janë të ndaluara, por duhet të sillemi mirë me ata.

Dhe më e bukra nga të gjitha këto është se fjala "*ihsan*" në këtë ajet është e shoqëruar me germën "*be*", *me*, ku ka thënë: "**...që të silleni mirë me prindërit...**". Dihet që fjala "*ihsan*", në gjuhën arabe, mund të shoqërohet me germën "*be*", dhe me germën "*ila*". Nëse shoqërohet me germën "*ila*", që do të thotë "*për*", kuptimi i saj është: Mirësi për tjetrin qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. Por kur ajo shoqërohet me "*be*", që do të thotë "*me*", kuptimi i saj është: Mirësia të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa ndërmjetësim.

Bazuar në këtë, ky ajet përforcon se çështja e mirësjelljes ndaj prindërve është shumë e rëndësishme dhe e obligon njeriun që ai vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë të jetë i sjellshëm ndaj prindërve.

5- Vrasja e fëmijëve për shkak të varfërisë e urisë

Përftohet nga këto ajete se arabët në kohën e injorancës (para Islamit) nuk janë mjaftuar vetëm me vrasjen e vajzave dhe varrosjen e tyre të gjalla, por ata kanë vrarë edhe djemtë e tyre që konsideroheshin një thesar madhështor në shoqërinë e asaj kohe. Këtë e bënin për shkak të fukarallëkut e frikës nga varfëria. All'Ilahu i Lartësuar ua kthen shikimin atyre tek tryeza e gjerë e begative të Tij, nga e cila përfitojnë prej saj madje edhe krijesat më të dobëta.

Për fat të keq kjo vepër e injorancës përsëritet edhe sot në kohën tonë në një formë tjetër, ku vërejmë se si njerëzit qëllimisht i vrasin fëmijët e tyre të pafajshëm, e ata janë embrione, me anë të abortit me argumentin e mangësisë së mundshme të ushqimeve. Kjo çështje dhe çështje të tjera të ngjashme me to na tregojnë se koha e injorancës përsëritet në një formë tjetër dhe se “injanca e shekullit të njëzetë” është më e egër se injoranca para Islamit.

6- Çfarë synohet me fjalën "fauahish"?

“El Fauahish” është shumësi i fjalës “fahishe” që nënkupton madhësinë e së keqes së mëkateve. Bazuar mbi këtë, thyerja e premtimit, matja dhe peshimi mangut, politeizmi e të ngjashme me këto, edhe pse janë prej mëkateve të mëdhaja, porse përmendja e tyre përballë veprave të shëmtuara është për arsye të ndryshimit konceptual ndërmjet tyre.

7- Mos ju afroni këtyre mëkateve

Në ajetet në fjalë, fraza "**dhe mos ju afroni**" përmendet në dy vende. Kjo tematikë (ky ndalim) është përsëritur në Kur'an edhe për disa mëkate të tjera gjithashtu, si kurvëria, pasuria e jetimëve e të ngjashme me to. Për këtë, Kur'ani paralajmëron njerëzit që të mos u afrohen këtyre mëkateve në mënyrë që të mos bien nën ndikimin e tyre.

8- Mëkatet e jashtme dhe të brendëshme

S'ka dyshim se fjalia: "**...që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta...**" përfshin të gjitha mëkatet e shëmtuara të dukshme dhe të fshehta. Por ka ardhur në disa hadithe nga Imam Bakir (*Paqja qoftë mbi të!*) se ka thënë: "Të jashtmet është kurvëria dhe e brëndshmjia është tradhëtia bashkëshortore"¹ (pra të kesh të dashura e mikesha në mënyrë sekrete e të fshehtë). Është e qartë se përmendja e këtyre transmetimeve është sqarim i vërtetimit të qartë dhe nuk nënkupton kufizimin e këtyre mëkateve.

9- Dhjetë këshillat tek Jehudinjtë

Vëmë re në Teurat, në kapitullin e njëzetë të "Seferul Khuruxh" dhjetë dispozita që njihen tek jehudinjtë si këshillat. Ato fillojnë nga fjalia e dytë dhe përfundon tek fjalia e shtatëmbëdhjetë e këtij kapitulli.

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 191, fundi i ajetit në fjalë.

Por duke krahasuar dhjetë këshillat me ato që kanë ardhur në ajetet në fjalë, sqarohet se ka një dallim të madh dhe diferencë të gjerë ndërmjet këtyre dy programeve dhe për më tepër nuk mund të jeshë i sigurtë që Teurati i sotëm nuk është devijuar në këtë aspekt, ashtu siç është devijuar në pjesët e tjera. Por ajo që duhet të pranojmë është se dhjetë këshillat ekzistuese në Teurat, edhe pse janë të përmbledhura tek çështjet e domosdoshme, ato janë në një nivel shumë të ulët – për nga gjerësia dhe largësia morale, shoqërore e ideologjike – me përtimin e ajeteve në fjalë.

10- Si i ndryshuan këto ajete imazhet në Medinen e Ndritur?

Është transmetuar në librin "*Biharul Enuar*" dhe në librin "*E'alamul Uera*", një tregim i bukur që tregon për ndikimin e këtyrë ajeteve në shpirtërat e dëgjuesve. Këtu ne po e paraqesim këtë tregim shkurtimisht, ashtu siç ka ardhur në librin "*Biharul Enuar*" të përcjellë nga Ali ibn Ibrahim:

Es'ad ibn Zurareh dhe Dhekuan ibn Abdu Kajs shkuan në Mekë në një sezon prej sezoneve arabe dhe që të dy ishin nga fisi Khazrexh. Ndërmjet fisit Eus dhe fisit Khazrexh kishte luftë ku qëndruan në këtë luftë një periudhë shumë të gjatë. Nuk i linin armët e tyre as natën dhe as ditën dhe lufta e fundit ndërmjet tyre ka qenë ditën e Buathu¹ dhe ishte për Eusët kundra Khazrexhëve.

Es'ad ibn Zurareh dhe Dhekuan shkuan në Mekë duke kërkuar marrëveshje me Eusët. Es'ad ibn Zurareh ishte shok me Utbe ibn Rabiun, kështu që shkoi tek ai dhe i tregon atij se për

¹ "Kamilun", i ibn El Ethijr, vëll.1, f. 443. (Është një prej zonave të Medines. Në të është zhvilluar lufta e fundit mes El Eus dhe El Khazrexh pesë vjet para emigrimit të Profetit në Medine.)

çfarë kishte ardhur. Utbe ibn Rabi'u i kthen përgjigje Es'adi: Janë larg shtëpitë tuaja nga shtëpitë tona dhe ne jemi të zënë me punë e s'kemi kohë. I thotë Es'adi: Ç'farë pune keni dhe ju jeni në vendin e sigurinë tuaj? I thotë Utbe: Ka dalë prej nesh një burrë i cili pretendon se është i dërguari i All'Ilahut, idiotizon ëndrrat tona, shan idhujt tanë, shkatërron të rinjtë tanë dhe përçan shoqërinë tonë.

I thotë atij Es'adi: Kush është ai prej jush? Tha: Ibn Abdullah ibn Abdul Mutalib, nga më fisnikët ndër ne dhe me shtëpi më të madhe.

Kur e dëgjoj Es'adi dhe Dhekuani këtë filluan të mendojnë për të dhe ra në zemrën e tyre ajo që kishin dëgjuar nga jehudinjtë që kjo është koha e Profetit që do lindë në Mekë e do emigrojë në Medinë.

Es'adi i thotë: Ku është ai?

I thotë Utbe: Ulur mbi gur (guri i Ismailit) dhe se ata (pra myslimanët) nuk dalin nga strofa e tyre veçse në sezona, kështu që mos dëgjo prej tij, mos i fol, sepse ai është magjistar të bën magji me fjalët e tij. Kjo ishte në kohën e embargos që ju bë Beni Hashimit në Shuab.

I thotë Es'adi Utbes: Atëherë si të veprojmë se unë kam ardhur për Umre dhe patjetër që duhet të bëj tavaf rreth shtëpisë?

I thotë: Vendos në veshët e tu pambuk.

Kështu që hyri Es'adi në xhami. Ai i mbushi veshët e tij me pambuk, u rrotullua rreth Shtëpisë dhe i Dërguari i All'Ilahut qëndronte ulur mbi gur me banorë të Beni Hashimit. Ai e pa atë me një vështrim dhe e kaloi.

Në momentin që ishte në rrethrotullimin e dytë thotë me veten e tij: Nuk ka më injorant se unë. A ndodh një gjë e tillë në Mekë të

mos e njoh atë derisa të kthehem tek populli im e t'i lajmëroj ata? Kështu që e hoqi pambukun nga veshët dhe e flaku dhe i tha të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*): Një mëngjes sa më të mrekullueshëm.

I Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*) e ngriti kokën drejt tij dhe i tha: Na e ka ndërruar All'Ilahu me një më të mirë sesa kjo që është përshëndetja e banorëve të Xhenetit: Es selamu alejkum; Paqja qoftë mbi ju.

Es'adi i thotë: Për çfarë thërret o Muhammed?

I thotë Profeti (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*): Për dëshminë se s'ka Zot tjetër përveç All'Ilahut dhe unë jam i Dërguari i Tij, dhe ju thërras ju (më pas recitoi tre ajetet të cilat përfshijnë dhjetë direktivat).

Në momentin që e dëgjoi Es'adi këtë i tha: Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç All'Ilahut dhe se me të vërtetë ti je i Dërguari i All'Ilahut. O i Dërguari i All'Ilahut, ti je babai im dhe nëna ime. Unë jam nga banorët e Jethribit (Medines) nga Khazrexhët dhe ndërmjet nesh dhe vëllezërve tanë Eus ka litarë të këputur (pra në armiqësi), kështu që ndoshta All'Ilahu i lidh ato nëpërmjet teje dhe askush nuk është më i lavdishëm sesa ti. Me mua është edhe një burrë nga populli im, në qoftëse futet në këtë çështje dëshiroj që All'Ilahu ta plotësojë çështjen tonë me ty.

Pasha All'Ilahun! O i dërguari i All'Ilahut kemi dëgjuar për lajmin tënd nga jehudinjtë, na përgëzonin me ardhjen tënde, na lajmëruan për cilësitë e tua. Uroj që të jetë shtëpia jonë shtëpia e emigrimit tënd tek ne. Këtë na e kanë mësuar jehudinjtë. E falënderoj All'Ilahun që më mundësoi udhëtimin drejt teje. Pasha All'Ilahun! Nuk kam ardhur për gjë tjetër veçse të kërkoj aleat për

popullin tonë. Na ka dhënë All'llahu nga gjërat më të mira që jepen.

Më pas pas shoku i Es'adit, Dhekuani, gjithashtu e pranoi Islamin. Më pas kërkuan nga i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*) që të dërgojnë bashkë me ta një burrë që t'i mësojë atyre Kur'anin, e të thërrasë njerëzit në çështjen e tij e të shuajë luftrat. Kështu që i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij*) dërgoi me ata të dy në Medine "Mus'ab ibn Umejr". Që në atë kohë u themeluan bazat e Islamit në Medine dhe ndryshoi fytyra e Jethribit (Medines).

Ajetet 154 - 157

ثُمَّ ءَاتَيْنَا مُوسَى الْكِتَابَ تَمَامًا عَلَى الَّذِي أَحْسَنَ وَتَفْصِيلًا
 لِّكُلِّ شَيْءٍ وَهُدًى وَرَحْمَةً لَّعَلَّهُمْ بِلِقَاءِ رَبِّهِمْ يُؤْمِنُونَ ﴿١٥٤﴾
 وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مُبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٥٥﴾
 أَنْ تَقُولُوا إِنَّمَا أَنْزَلَ الْكِتَابُ عَلَى طَائِفَتَيْنِ مِنْ قَبْلِنَا وَإِنْ كُنَّا
 عَنْ دِرَاسَتِهِمْ لَغَافِلِينَ ﴿١٥٦﴾ أَوْ تَقُولُوا لَوْ أَنَّا أُنْزِلَ عَلَيْنَا
 الْكِتَابُ لَكُنَّا أَهْدَى مِنْهُمْ ۖ فَقَدْ جَاءَكُمْ بَيِّنَةٌ مِنْ رَبِّكُمْ
 وَهُدًى وَرَحْمَةٌ ۖ فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ كَذَبَ بِآيَاتِ اللَّهِ وَصَدَفَ
 عَنْهَا ۖ سَنَجْزِي الَّذِينَ يَصْدِفُونَ عَنْ ءَايَاتِنَا سُوءَ الْعَذَابِ بِمَا
 كَانُوا يَصْدِفُونَ ﴿١٥٧﴾

"Ne i dhamë Musait Librin si plotësim (të mirësisë Sonë) për atë që vepron mirë, si shpjegim për çdo gjë dhe si udhërrëfyes e mëshirë, që ata (hebrenjtë) të mund të besonin në takimin me Zotin e tyre."

"Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni."

"dhe që të mos thoni: 'Shkrimet e shenjta u janë shpallur vetëm dy sekteve para nesh, ndërsa Ne nuk kemi ditur gjë çfarë mësonin ata.'"

"Ose që të mos thoni: 'Sikur Shkrimet e shenjta të na ishin shpallur neve, ne do të ishim më të udhëzuar se ata'. Pra, ju ka ardhur nga Zoti juaj provë e qartë, udhërrëfim dhe mëshirë! Atëherë, kush është më keqbërës se ai që i përgënjeshtroi shpalljet e Allahut dhe largohet nga ato? Ne, do t'i ndëshkojmë me dënim të rëndë ata që shmangen nga shpalljet Tona, për shkak se u larguan."

Komentimi

Kundërpërgjigje e prerë ndaj debatuesve dhe mutealilinëve

Në ajetet e mëparshme u fol për dhjetë urdhëresat bazë të Islamit, të cilat, në realitet, përbëjnë bazën dhe themelin e shumë rregullave islame. Nga thënia e Allahut të Lartësuar **"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni..."** e të ngjashme me të, përftohet se këto rregulla nuk kanë qenë të posaçme për një fe të caktuar apo për një Sheriat të veçantë, e sidomos kur ato janë baza dhe parime që gjykon mendja e mirë dhe i përkrah ato pa u lëkundur. Për këtë, përmbajtja e ajeteve të mëparshme është sqarimi i rregullave të cilat nuk kanë qenë të posaçme për Islamin, por ato ishin të pranishme dhe të pranuar nga të gjitha fetë.

Pas ajeteve të mëparshme, Kur'ani thotë: **"Ne i dhamë Musait Librin si plotësim (të mirësisë Sonë) për atë që vepron mirë..."**, kështu pra, ne ia plotësuam begatitë Tona punëmirëve të cilët ju dorëzuan urdhërit të tij (Musait) dhe e ndoqën atë.

Nga ajo që u tha sqarohet se nga fjala *"thumme"*, e cila përdoret zakonisht në gjuhën arabe si "lidhëse që tregon vonim" në këtë ajet ka kuptimin: Ne, ia dhamë këto mësimë e këshilla të përgjithshme Profetëve të mëparshëm fillimisht, pastaj i dhamë Musait Librin qiellor dhe sqaruam në të këto mësimë e programe e të tjera prej mësimëve dhe programeve të domosdoshme.

Me këtë nuk ka nevojë për atë që kanë thënë nga njëherë disa komentues prej direktivave të ndryshme e të dobëta në këtë fushë.

Kjo çështje, gjithashtu, sqarohet se shprehja **"...për atë që vepron mirë..."** tregon për të gjithë punëmirët, të cilët i përgjigjen të vërtetës dhe i pranojnë urdhrat e All'Ilahut.

"...si shpjegim për çdo gjë...", sepse në të ka gjithçka që ka nevojë shoqëria e që ndikon në plotësimin e njeriut e udhëzimin e tij.

"...dhe si udhërrëfyes e mëshirë..." pra, në këtë Libër, i cili i zbriti Musait, në shtesë të atyre që u tha më lart, ka udhëzim e mëshirë.

Të gjitha këto programe s'janë gjë tjetër veçse për të besuar në Ditën e Ringjalljes dhe në takimin me All'Ilahun në mënyrë që të pastrojnë mendimet dhe thëniet e tyre: **"...që ata (hebrenjtë) të mund të besonin në takimin me Zotin e tyre."**

Mund të thuhet: Nëse sheriat i Musait ka qënë i plotë (ashtu siç përftohet nga fjala *"temamen"*, e plotë), atëherë, cila ishte nevoja për sheriatin e Isait dhe për sheriatin Islam?

Patjetër që duhet të dihet se çdo shariat nga shariatet është një shariat përmbledhës dhe i plotë përsa i përket kohës së tij dhe

është e pamundur të zbresë një sheriat i mangët nga ana e All'lahut të Lartësuar.

Ka mundësi që ky sheriat, i cilai është i plotë për një kohë të caktuar, mund të jetë i mangët dhe jo i plotë për një kohë të mëpasshme, ashtu siç është programi i plotë e përmbledhës i përgatitur për një periudhë mësimore filloreje, i mangët përsa i përket ciklit mësimor të mesëm. Ky është sekreti i dërgimit të Profetëve të shumtë me libra qiellorë të ndryshëm e të llojllojshëm deri sa çështja përfundoi tek Profeti i fundit, Muhammedi dhe te mësimet e fundit, që janë ato islame.

Sigurisht, nëse njerëzija përgatitet për marrjen e mësimëve përfundimtare dhe atyre u vijnë ato mësimet e urdhëresa, - pas kësaj - nuk është nevoja për një fe të re. Çështja e tyre është si puna e të diplomuarve të cilët kanë mundësi me njohuritë që kanë fituar të arrijnë sukseshme të mëtejshme në fushën e shkencës përmes leximit dhe meditimit.

Vërtet, ndjekja e këtij sheriatit dhe kësaj feje (përmbyllëse), nuk do të ketë kurrë nevojë për një fe të re, sepse energjinë e lëvizjes së tyre dhe përparimin e tyre do ta fitojnë nga vetë kjo fe e All'lahut (Islami).

Nga ky ajet, gjithashtu, përftohet, se çështjet e lidhura me Ringjalljen janë transmetuar mjaftueshëm në Teuratin origjinal. Nëse nuk vërejmë tregues të çështjeve të Ringjalljes e të tubimit në Teurat e në librat e tanishëm, apo përmenden rrallë, kjo është për shkak të devijimit të jehudinjëve e fetarëve të cilët nuk dëshironin shumë të flisin për Ringjalljen dhe për shkak të dëgjuesve të pakët për të (Ringjalljen).

Në Teuratin e sotëm gjenden tregues kalimthi e në formë të përmbledhur për Ringjalljen, por ato janë të pakët deri në atë

shkallë saqë disa thonë se: Me të vërtetë jehudinjtë nuk besojnë fare në Ringjallje e tubim. Mirëpo, në të vërtetë dhe realisht kjo thënie ngjason me ekzagjerimin.

Gjithashtu, duhet të bëjmë me dije lexuesit se qëllimi i takimit të All'Ilahut, i cili është përmendur në ajetet e Kur'anit, nuk është takim material dhe pamje me sy, por qëllimi këtu është për një lloj shikimi të brendshëm (batinij) e takim shpirtëror, i cili realizohet në Ditën e Ringjalljes për shkak të përsosjes që arrihet tek disa persona. Ose qëllimi i atij takimi është: shikimi i veprave të mira, shpërblimeve e ndëshkimeve në Botën Tjetër.

Ajeti i mëpasshëm tregon për zbritjen e Kur'anit dhe për direktivat e tij me vlerë. Me këtë plotësohet hulumtimi i parashtruar në ajetin e mëparshëm. Thotë i Lartësuari: **"Ky Libër që kemi shpallur, është i bekuar...."** Pra, ky Libër, të cilin e zbritëm, është një Libër me vlerë madhështore e begati të mëdhaja, ai është burimi i të gjitha llojeve të mirësive e bereqeteve.

Përderisa çështja është e tillë, ai Libër duhet të ndiqet në formë të plotë. Duhet të furnizoheni me devotshmëri dhe të shmangni kundërshtimin e tij në mënyrë që t'ju përfshijë mëshira e All'Ilahut dhe mirësia e Tij **"....prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni."**

Në ajetin e tretë i Lartësuari hedh poshtë të gjitha justifikimet e argumentimet si dhe ia mbyll të gjitha rrugët e dredhive e shmangjeve politeistëve. Ai u thotë atyre fillimisht: Ne e kemi zbritur këtë libër me këto veçori në mënyrë që të mos thoni: Kanë zbritur librat qiellorë tek dy grupet e mëparshme (jehudinjtë e të krishterët) mirëpo nuk na shkoi mendja që t'i studionim. Rrebelim i yni ndaj urdhërave të All'Ilahut ishte për

arsye të prezencës së tyre tek popujt e tjerë dhe nuk na ka arritur asgjë prej tyre: **"dhe që të mos thoni: 'Shkrimet e shenjta u janë shpallur vetëm dy sekteve para nesh, ndërsa Ne nuk kemi ditur gjë çfarë mësonin ata.'"**

Më pas i Lartësuari, përcjell nga ata – në ajetin pasardhës – po të njëjtat argumente por në formë më të gjerë, të shoqëruar këtë rradhë me një lloj më të ashpër arrogance e mburrjeje dhe ajo është se: Kur'an i Fisnik nëse nuk ka zbritur tek ata do të ishte e mundur që të pretendonin se ata kanë qenë të gatshëm më shumë se çdo komb tjetër për pranimin e urdhërit të All'Ilahut: **"Ose që të mos thoni: 'Sikur Shkrimet e shenjta të na ishin shpallur neve, ne do të ishim më të udhëzuar se ata'..."**

Ajeti i mëparshëm, në të vërtetë, e pasqyroi këtë argumentim që është: Mosudhëzimi ynë është për shkak të pavëmendshmërisë dhe paditurisë tonë ndaj librave qiellorë. Kjo pavëmendshmëri dhe kjo padituri kanë ardhur se këto libra kanë zbritur tek të tjerët e nuk kanë zbritur tek ne.

I njëjtë me këtë kuptim është përmendur edhe në suren "Fatir" ajeti 42, me gjuhën e politeistëve në formën e një çështjeje të prerë dhe jo si çështje kushtore, kur Ai thotë: **"Ata (paganët e Mekës) janë betuar solemnisht për Allahun që, nëse u vjen ndonjë (Profet) paralajmërues, ata do të ndjekin udhëzimin e tij më shpejt se çdo popull tjetër. Por, kur u erdhi paralajmëruesi, kjo vetëm ua shtoi largimin prej rrugës së drejtë."**

Sido që të jetë, si përgjigje ndaj këtyre pretendimeve, Kur'an i thotë se All'Ilahu i Lartësuar ua mbylli juve çdo rrugë dredhie e shmangieje, duke hedhur poshtë të gjitha pretendimet e justifikimet, sepse All'Ilahu ju solli juve të gjitha argumentat dhe

faktet të shoqëruara me udhëzimin e All'lahut e me mëshirën e Tij për ju: **"Pra, ju ka ardhur nga Zoti juaj provë e qartë, udhërrëfim dhe mëshirë..."**

Ajo që tërheq vëmendjen është përdorimi i frazës termi "el bejjine" në vend të librit qiellorë. Kjo tregon se ky libër qiellor ka direktiva të qarta, sqaron të vërtetat nga të gjitha aspektet dhe përmban argumente të prera e fakte të ndritura.

he me gjithë këtë: **"...Atëherë, kush është më keqbërës se ai që i përgënjeshtroi shpalljet e Allahut dhe largohet nga ato?..."**

Fjala "*sadefe*" vjen nga "*es sadfu*" që do të thotë kundërshtim i fortë i diçkaje pa u mendur. Ajo tregon se ata jo vetëm që kanë kundërshtuar argumentet e All'lahut, por, gjithashtu, janë larguar prej tyre pa menduar aspak për to. Ndoshta është përdorur kjo fjalë me kuptim tjetër dhe ai është ndalimi i të tjerëve, gjithashtu, në rrugën e udhëzimit.

Në fund të këtij ajeti All'lahu i Lartësuar sqaron ndëshkimin e dhimbshëm i cili është përgatitur për ata armiq kundërshtarë, të cilët refuzojnë të vërtetat dhe i mohojnë ato pa u menduar fare e pa i studiuar sadopak ato. Madje, ata nuk mjaftohen me refuzimin e tyre, por qëllimisht pengojnë edhe të tjerët që t'i dëgjojnë dhe t'i përceptojnë ato. E gjitha kjo sqarohet në thënien e Tij të përmbledhur e retorike: **"...Ne, do t'i ndëshkojmë me dënim të rëndë ata që shmangen nga shpalljet Tona, për shkak se u larguan."**

Fraza "**dënim të rëndë**" edhe nëse është me kuptimin ndëshkim i keq, por ngaqë ndëshkimi i keq është ndëshkim i ashpër e shumë i dhimbshëm në vetvete, kjo është arsyeja që disa komentues e kanë komentuar me ndëshkim të ashpër.

Përsëritja e thënies “*jesdifune*”, që *shmangen*, tek sqarimi i ndëshkimit të atyre që u shmangen argumenteve të All'Ilahut, është për arsye të sqarimit të kësaj të vërtete: Të gjitha fatkeqësitë e sprovat që godasin këtë grup e kanë zanafillën te qenia e tyre të kundërshtarëve të të vërtetave pa i menduar e pa i studiuar fare ato. Sikur ata t'ia kishin lejuar vetes së tyre që të mendojnë e të studiojnë – si një kërkues i së vërtetës e dyshues që kërkon të sigurohet –, nuk do të goditeshin me të tilla ndëshkime të dhembshme dhe nuk do të kishin këtë përfundim të keq e të lënduar.

Ajeti 158

هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا أَنْ تَأْتِيَهُمُ الْمَلَائِكَةُ أَوْ يَأْتِيَ رَبُّكَ أَوْ يَأْتِيَ
بَعْضُ آيَاتِ رَبِّكَ ^{قَدْ} يَوْمَ يَأْتِي بَعْضُ آيَاتِ رَبِّكَ لَا يَنْفَعُ نَفْسًا
إِيمَانُهَا لَمْ تَكُنْ ءَامَنَتْ مِنْ قَبْلُ أَوْ كَسَبَتْ فِي إِيمَانِهَا خَيْرًا ^{قَدْ}
قُلْ أَنْتَظِرُوا إِنَّا مُنْتَظِرُونَ ﴿١٥٨﴾

"A mos vallë presin ata t'u vijnë engjëjt ose të vijë Zotit yt, ose të vijnë disa shenja të Zotit tënd? Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij! Thuaju: 'Pritni, se edhe ne po presim!'"

Komentimi

Pritje të kota dhe kërkesa të pamundura

Në ajetet e mëparshme u sqarua kjo e vërtetë, që është: Ne e plotësuam argumentin mbi politeistët, u dhamë atyre Librin qiellor (pra Kur'anin) për udhëzimin e të gjithëve në mënyrë që të mos kenë asnjë justifikim që të shfajsojnë me të kundërshtimin që i bënin mesazhit dhe thirrjes islame.

Ky ajet thotë: Por, këta persona armiqësor e kokëfortë arritën me kundërshtinë dhe kokëfortësinë e tyre deri në atë masë

ku tek ata nuk ndikonte as edhe ky program i qartë e i saktë. Dukej sikur ata prisnin të shihnin shkatërrimin e tyre, apo ikjen e shansit të fundit, ose prisnin çështje të pamundura.

Fillimisht ajeti thotë: **"A mos vallë presin ata t'u vijjë engjëjt..."** për t'u marrë shpirtat atyre.

"...ose të vijë Zotit yt..." tek ata që ta shohin Atë, në mënyrë që të besojnë.

Qëllimi i kësaj fjalie në të vërtetë është se ata presin çështje të pamundura, se ardhja e All'Ilahut të Lavdishëm e të Lartësuar apo shikimi i Tij nuk janë çështje të mundura.

Ky lloj sqarimi i kësaj thënieje është i ngjashëm me atë të një personi kriminel e kokëfortë, të cilit edhe pse i tregohen faktet e mjaftueshme që i vënë vulën, ai përsëri e mohon krimin e tij dhe atëherë i thuhet: Nëse ti nuk i pranon të gjithë këto fakte, ndoshta ti prët që të kthehet i vrari në jetë e të vijë në gjykatë dhe të dëshmojë se ti e ke vrarë atë.

Më pas thotë: Ju ose po prisni që të realizohen disa shenja të veçanta në Ditën e Kiameti dhe fundin e botës; ose prisni ditën kur mbyllen të gjitha portat e pendimit: **"...ose të vijjë disa shenja të Zotit tënd..."**

Mbi këtë bazë shprehja **"shenja të Zotit tënd"** edhe pse ka ardhur në një formë përgjithësuese e të përgjithshme, por ajo mund të jetë e ngjashme me frazat e mëparshme për të cilat do të vijë komentimi i tyre, me kuptimin e shenjave të Kiametit, si përshebull: termetet e frikshme, shuarja e dritës së diellit, e dritës së hënës dhe e dritës së yjeve, e të ngjashme me këto.

Ose qëllimi është për kërkesat e palogjikshme, të cilat i kërkojnë nga i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ku prej tyre ishte se ata nuk

besojnë vetëm nëse nga qielli të biejnë gurë ose shkretëtira e varfër dhe e thatë e Hixhazit të mbushet me burime e me palma!!

Më pas shton duke thënë: **"...Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij..."** Portat e pendimit në atë kohë janë të mbyllura para atyre që nuk kanë besuar deri në atë orë, sepse pendimi në atë orë është i detyruar, kështu që ka humbur lirinë e besimit me zgjedhje dhe vlerën e pendimit të singertë.

Nga ajo që u tha bëhet e qartë se thënia: **"...ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij..."** do të thotë se vetëm besimi nuk ka dobi në atë ditë.

Në pjesën e fundit të ajetit u drejtohet me një kërcënim të ashpër atyre personave kokëfortë e të pabindur duke u thënë me një ton të ashpër: **"...Thuaju: 'Pritni, se edhe ne po presim!'"**

Hulumtime

Nuk ka dobi besimi pa vepër

Nga pikat e rëndësishme të cilat përfitojmë nga ajeti në fjalë është se ajeti e konsideron rrugën e shpëtimit të kufizuar me besimin. Atë besim me të cilin njeriu përfiton të mira e vepron nën hijen e tij me vepra të mira.

Mund të shtrohet kjo pyetje: A mjafton vetëm besimi pa e shoqëruar atë me vepra të mira?

Përgjigjemi: Është e vërtetë që besimtari mund të gabojë ndonjëherë e mund të bëjë mëkate e gjynahe e më pas pendohet për veprimin e tij duke i vënë detyrë vetes ndreqjen e tij. Porse ai

që nuk ka bërë asnjë vepër të mirë gjatë jetës së tij e nuk ka shfrytëzuar shanset e shumta e të mjaftueshme për këtë, përkundrazi ai ka vepruar çdo të keqe, mëkat, e gjynah, në këtë rast ai duket shumë larg që të jetë nga të shpëtuarit dhe prej atyre të cilëve u sjell dobi besimi i tyre. Nuk është e mundur të besojmë se një person i përket një feje, por ai nuk vepron asgjë nga direktivat e asaj feje qoftë edhe një herë në jetën e tij, madje ka ndërmarrë të kundërtën e saj përherë. Kështu që kjo gjendje e tij dhe kjo situatë e tij janë argument i prerë dhe i qartë i mosbesimit dhe i mosbindjes së tij.

Bazuar mbi këtë duhet që besimi të shoqërohet, edhe sikur në kufirin minimal, me veprën e mirë që të vërtetohet prania e besimit.

Ajetet 159 - 160

إِنَّ الَّذِينَ فَرَقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا لَّسْتَ مِنْهُمْ فِي شَيْءٍ ۚ إِنَّمَا
أَمْرُهُمْ إِلَى اللَّهِ ثُمَّ يُنَبِّئُهُم بِمَا كَانُوا يَفْعَلُونَ ﴿١٥٩﴾ مَنْ جَاءَ
بِالْحَسَنَةِ فَلَهُ عَشْرُ أَمْثَالِهَا ۖ وَمَنْ جَاءَ بِالسَّيِّئَةِ فَلَا تُجْزَىٰ إِلَّا
مِثْلَهَا وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿١٦٠﴾

"Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Te All'Ilahu është puna e tyre e pastaj Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar."

"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish. Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie."

Komentimi

Refuzimi i përçarësve të rradhëve dhe mohimi i tyre

Pas dhjetë urdhëresave, të cilat u përmendën në ajetet e mëparshme, ku në fund të saj urdhërohej për ndjekjen e rrugës së drejtë të All'Ilahut dhe luftimi i çdo lloji prej llojeve të hipokrizisë e përçarjes, vjen ky ajet, i cili përmban përforcimin e kësaj të vërtete si dhe komentimin dhe shpjegimin e saj.

I Lartësuar fillimisht thotë: **"Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte..."**¹ pra, ata të cilët patën mosmarrëveshje në fe dhe u përçanë në rryma e fraksione nuk kanë kurrëfarë lidhjeje me ty. Po ashtu, nuk kanë kurrë lidhje me fenë, sepse feja jote është feja e njësimi, feja e rrugës së vërtetë dhe rruga e drejtë është vetëm një e jo më shumë.

Më pas, All'Ilahu i Lartësuar, duke i kërcënua dhe duke i qortuar ata të përçarë, thotë: **"...Te All'Ilahu është puna e tyre e pastaj Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar."** Pra, All'Ilahu është Ai i cili do t'i ndëshkojë ata për veprat e tyre. Ai është i Gjithëditur për ata dhe asgjë nuk i fshihet Atij.

Hulumtime

1- Kush janë ata të cilët synohen në ajet?

Një grup komentuesish besojnë se ky ajet ka zbritur për jehudinjtë dhe të krishterët të cilët patën mosmarrëveshje dhe u përçanë në rryma e fraksione të ndryshme duke u urreyer, grindur e konfliktuar ndërmjet tyre.²

¹ Fjala "*esh shijea*" nga ana gjuhësore ka kuptimin e grupeve dhe sekteve të ndryshme dhe ndjekjen e personave të ndryshëm. Bazuar në këtë, njëjësi i kësaj fjale do të thotë që të ndjekësh një shkollë apo një person të caktuar. Ky është kuptimi gjuhësor i fjalës "*esh shiatu*". Por, fjala "*esh shiatu*" ka kuptim tjetër në terminologji. Ai përdoret për ata që ndjekin prijësin e muslimanëve, Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e pason atë. Nuk është e rregullt që të bëjmë përzierje mes dy kuptimeve, atij gjuhësor dhe terminologjik.

² "Biharul Anuar", vëll. 9, f. 93.

Disa të tjerë mendojnë se ky ajet tregon për ata të cilët përçajnë radhët e këtij ymeti (islam) të shtyrë nga fanatizmi, kryelartësia dhe dashuria për pasuri e pozitë.

Por përmbajtja e këtij ajeti përfaqëson një dispozitë të përgjithshme që përfshin të gjithë ata që përçajnë radhët dhe këdo që mbjedh farën e hipokrizisë dhe mosmarrëveshjes ndërmjet robëve të All'llahut me përhapjen e bidateve, qofshin prej atyre në kombet e mëparshme apo nga ky ymet.

Ajo që vërejmë nga transmetimet e ardhura nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), gjithashtu, edhe nga transmetimet e Ehli Synetit, të cilët flasin qartë se ky ajet tregon për përçarësit e radhëve dhe për bidadçinjtë e këtij ymeti dhe është sqarues i së vërtetës¹, sepse nëse nuk do të ishte përmendur ky konfirmim, disa do të supozonin se ky ajet synon vetëm të tjerë të veçantë dhe se përemri pronor është për të tjerët e kështu do të justifikoheshin me të idenë e tyre.

Në një transmetim të përcjellë nga imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) në fund të këtij ajeti, siç është në komentimin e Ali ibn Ibrahim, i cili ka thënë në komentimin e këtij ajeti: "U ndanë nga prijësi i besimtarëve (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe u bënë parti."³

Ka hadithe të tjera të transmetuara nga i dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) rreth përçarjes së këtij ymeti, ndarjes dhe grupimit të tij në grupacione të cilat i ka përmendur si mënyrë paralajmëruese. Të gjitha përkrahin këtë të vërtetë, gjithashtu.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 783.

2- Shëmtia e përçarjes dhe e mbjelljes së mosmarrëveshjes

Ky ajet përsërit edhe njëherë tjetër, duke shtuar përforcimin, këtë të vërtetë që është se Islami është feja e njësisë dhe e bashkimit. Ai refuzon çdo ngjyrë prej ngjyrave të përçarjes dhe përhapjen e mosmarrëveshjes në rradhët e ymetit. Ai i thotë të Dërguarit e All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): "Vërtet, puna jote dhe programi yt kurrë nuk janë të ngjashëm me veprën e përçarësve të rradhëve dhe përhapësve të mosmarrëveshjeve. Madje, ata nuk kanë asnjë lidhje me ty e as ti nuk ke asnjë lidhje me ata. All'Ilahu është Ndëshkues dhe i Plotfuqishëm dhe do t'i ndëshkojë ata e do t'i tregojë atyre dënimin e veprave të këqija që ata vepruan.

Njësimi i vërtetë nuk është vetëm një nga parimet e Islamit, por të gjitha parimet e Islamit dhe degët e tij, të gjitha janë programet e llojllojshme që sillen rreth boshtit të njësimit. Të gjitha nisin nga ai dhe përfundojnë tek ai. Njësimi është shpirti udhëtues në qenien e direktivave islame në tërësi. Njësimi është baza e civilizimit mbi të cilin ngrihen parimet e përgjithshme islame.

Por kjo fe, që përbëhet nga të gjitha anët e saj nga elementë të bashkimit, - për fat të keq-, sot ka rënë pre në duart e përçarësve të rradhëve e nxitësve të mosmarrëveshjeve dhe e ka humbur pamjen e saj reale.

Kështu që nga një ditë në tjetrën krakëllin një sorrë duke kompozuar një melodi të re e të shëmtuar, ngrihet një i sëmurë psiqik, një idiot apo një budalla e i kundërvihet një dispozite prej dispozitave të Islamit, një programi prej programeve të tij ku

grumbullohen rreth tij një grup injorantësh e mendjelehtë dhe hedh një përçarje të re.

Sigurisht, padituria, nga e cila vuan një grup nga masa e njerëzve, ka një ndikim shumë të madh në përçarje e mosmarrëveshje dhe nuk është më e pakët se zgjuarsia e armiqve, intriga e vigjilenca e tyre në futjen e përçarjes së brendshme.

Ndoshta disa kanë parashtruar çështje që i ka ngënë e pirë koha, krijuan me anë të saj një rrëmujë idiote në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e njerëzve. Por Islami, siç e qartëson ajeti, është larg veprave të tyre dhe veprat e tyre janë larg Islamit. Të gjitha përpjekjet e përçarësve të rradhëve do të dështojnë në të ardhmen, do i marrë era e nuk do të korrin prej saj veçse humbjen e dështimin.

3- Sulmet e padrejta të autorit të librit “El Menar” ndaj Shiizmit

Autori i komentimit "El Menar" vuan nga një paragjykim e mendim i keq në lidhje me shiizmin dhe po në të njëjtën masë vuan edhe nga padituria në lidhje me ideologjitë e shiitëve dhe historinë e tyre.

Në fund të këtij ajeti i ka kushtuar një kapitull shiave nën mbulesën e thirrjes për t'u bashkuar. Ai i përshkruan ata se përçajnë rradhët e kundërshtojnë Islamin, punojnë kundër Islamit, kryejnë aktivitete politike shkatërrimtare nën mbulesën e medh'hebit e ideologjisë fetare. Me sa duket praninë e fjalës “shijean” në ajetin në fjalë, i cili nuk ka kurrfarë lidhjeje me shiizmin dhe shiat, ai e përmend në këto çështje të kota dhe nxitet të akuzojë këta besimtarë pa u përmbajtur fare.

Shkrimet e tij janë përgjigjja më e mirë për thëniet e tij. Dëshmitari më i mirë i mosnjohjes së parimeve shiite e të historisë së tyre nga ana e tij është se:

1- Ai bën lidhjen mes shiitëve dhe “Abdulla ibn Sebe”, jehudiu i dyshimtë në origjinën e ekzistencës së tij nga këndvështrimi historik, i cili – duke supozuar në ekzistencën e tij – nuk ka as rolin më të vogël në historinë e shiizmit dhe të shiitëve! Nga ana tjetër shohim se ai bën lidhje mes shiitëve dhe “el batinijeh”, madje edhe mes shiitëve dhe bahaijëve, të cilët janë armiq të më të përbetuar të shiitëve. Në këtë rast, edhe ai që ka njohuritë më të pakta rreth historisë shiite e di se këto rrëfime e pretendime nuk janë gjë tjetër veçse pretendime e rrëfime imagjinare e iluzioniste, madje absolutisht janë shpifje, akuza e sajesa.

Më e çuditshmja nga të gjitha këto është se ky autor bën lidhjen mes grupit të “gulatëve”¹ dhe shiitëve, ndërkohë që jurisprudenca (fikhu) shiite përmban një kapitull për “gulatët” dhe i quajnë ata një nga fraksionet e rrymat mohuese e jobesimtare. Ai i akuzon shiitët se ata adhurojnë Ehli Bejtin, e të tjera si këto atribuime të pavërteta e të pa vlera.

Është e vërtetë se autori i librit “El Menar”, sikur të mos ishte i ndikuar nga vendime të nxituara e fanatizma të verbëra dhe t'i lejonte vetes së tij të dëgjonte besimin e shiitëve nga vetë goja e tyre, t'i marrë ato prej tyre e t'i kërkojë ato në librat e tyre e jo në librat e armiqve të tyre, do ta mësonte më së miri se ato që ia ka veshur shiitëve nuk janë gjë tjetër veçse shpifje e gënjeshtër, madje ato janë farsa qesharake.

¹ Janë ata të cilët e ngrenë Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) në një gradë hyjnore, pra e quajnë zot (All'llahu na ruajtë!)

Dhe më e çuditshmja nga të gjitha këto është se ai ia atribuon përhapjen e shiizmit iranianeve, ku përkrahësit kanë qenë të përhapur në Irak, Hixhaz dhe Egjipt para se të përhapen në Iran me disa shekuj dhe se dëshmitë historike janë dëshmitare të gjalla të kësaj të vërtete.

2- Vërtet, mëkati i shiitëve është se ata kanë vepruar me atë që ka thënë i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në mënyrë të prerë dhe që është transmetuar, gjithashtu, në burimet më të besueshme të synitëve. Ajo thënie është: “Unë do t’u lë juve dy gjëra të rëndësishme, nëse kapeni me ato të dyja nuk do humbisni kurrën e kurrës, Libri i All'Ilahut dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejtin tim.”¹

Me të vërtetë mëkati i shiitëve është se ata e konsiderojnë Ehli Bejtin më të diturit e më të njohurit me fenë e Profetit dhe me mesazhin e tij. Ata e bënë Ehli Bejtin strehë e referencë të problematikave fetare duke marrë prej tyre të vërtetat e Islamit. Mëkati i shiitëve është se ata hapën portën e “ixhtihadit”, përpjekja për të arritur në gradën e lartë të dijes, duke u mbështetur në Kur’an, në Sunnet, në logjikë dhe në Ixhmaun. Me këtë i dhuruan jurisprudencës islame forcën lëvizëse duke mos e kufizuar atë vetëm me “katër persona” e më pas të detyrojnë njerëzit që t'i ndjekin ata.

A nuk janë thëniet dhe thirrjet e Kur’anit dhe të synetit të drejtuara për të gjithë besimtarët në të gjitha epokat dhe kohërat? A mos vallë bashkëkohësit (as'habët) Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë ndjekur persona të caktuar në kuptimin e Librit dhe Sunnetit?

¹ Shih: "Sahihu Termidhij", vëll. 3, f. 100; "Sunenu Bajhakij", vëll. 1, f. 13 dhe vëll. 2, f. 431; "Kenzul Ammal", vëll. 1, f. 153 dhe 159. "Et Tabakatul Kubra", i ibn Sa'ad, vëll. 2, f. 2, e të tjerë.

Atëherë përse ta kufizojmë Islamin me kufizim të vjetër e ta kufizojmë në emër të “katër medh’hebeve – shkollave juridike) Hanefij, Hanbelij, Malikij dhe Shafiiq?!

Mëkati i shiitëve është se ata thonë: Në të vërtetë bashkëkohësit e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) janë si të gjithë myslimanët e tjerë e duhet të vlerësohen me masën e besimit të tyre e në dritën e veprave të tyre. Veprat e atij që janë në përputhje me Librin dhe me synetin, është punëmirë dhe veprat e atij që janë në kundërshtim me Librin e synetin, pavarësisht se ka qenë në kohën e Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), apo pas tij, refuzohet e përjashtohet. Nuk mjafton thjesht shoqërimi në mënyrë që të mbulohen me të kriminelët e punëkëqijtë. Nuk lejohet shenjtërimi e respekti i burrave si Muaviju, i cili i shkeli me këmbë të gjitha vlerat e i injoroi të gjitha rregullat islame dhe kundërshtoi Imamin e kohës së tij, të cilin e donte kombi islam të paktën në atë kohë [dhe kemi si qëllim këtu Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*)] dhe që derdhi shumë gjak! ... Nuk lejohet shenjtërimi i atij personi, e i të tillëve si ai, thjesht se është shoqëruar me të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

Po, këto janë mëkatet e shiitëve dhe ata i pranojnë ato. Por, a keni gjetur në botën e sotme më të privuar se sa shiitët, ku pikat më të forta të historisë dhe të besimit të tyre të konsiderohen pika të dobëta e të akuzohen me rrebeshe akuzash e gënjeshttrash?! Jo vetëm kaq, atyre nuk u lejohet të përhapin besimin e tyre në mesin e myslimanëve me liri, ashtu siç bëjnë rrymat dhe fraksionet e tjera, por i marrin bindjet e tyre nga të tjerët.

Vallë, nëse një grup vepron me urdhërin e Profetit të tyre, ndërkohë që të tjerët nuk punojnë me të, a konsiderohet vepra e këtij grupi përçarje e rradhëve e ndarje kundër ymetit? A duhet të shmanget ky grup nga ecuria e tij që të realizohet bashkimi e të forcohet një grup tjetër që nuk ndjek rrugën e besimtarëve?

3- Historia e shkencave islame dëshmon se shiitët kanë qenë të parët në shumicën e këtyre shkencave e njohurive deri në një shkallë saqë u konsideruan Shiitët ndërtuesit themelorë të shkencave islame.¹

Librat që kanë botuar dijetarët shiitë në fushat e komentimit, historisë, hadithit, bazat e jurisprudencës, biografia e transmetuesve e filozofi islame nuk janë çështje që mund të injorohen, mohohen e të fshihen. Ato libra janë të pranishëm në të gjitha bibliotekat (veçse në disa biblioteka të Ehli Syneetit të cilët nuk lejojnë futjen e librave të shiitëve në bibliotekat dhe libraritë e tyre, ndërkohë që ne i lejojmë futjen e botimeve të tyre në bibliotekat dhe në libraritë tona që prej shumë shekujsh). Këto libra janë dëshmi e gjallë për ato që përmendëm.

Vallë, të gjithë ata që kanë shkruar e botuar gjithë këto libra rreth Islamit e mësimëve të tij, në rrugën e përhapjes, përçimit e thellimit të tyre, a janë armiq të Islamit?!

A mundet që dikush t'i shërbejë Islamit të pastërt me këtë shërbim të madh nëse ai nuk është i dashuruar, i singertë e i apasionuar pas tij?

Në mbyllje të bisedës sonë themi: Nëse dëshironi t'i shmangim të gjitha këto mosmarrëveshje e përçarje hajdeni të veprojmë diçka tjetër në vend që të hedhim akuza. Të njihemi me njëri-tjetrin e të mirëkuptohemi me njëri-tjetrin, sepse këto

¹ Shih: "Te'sisu shiah lil ulumil islamijeh" dhe librin "Aslu shiati ue usuluha"

atribuime të pabaza e këto shpifje të kota nuk çojnë në realizimin e bashkimit islam, përkundrazi i jep një goditje ekzekutuese bazave të bashkimit e të unitetit islam.

Shpërblim më shumë, ndëshkim më pak:

Në ajetin pasardhës tregohet për mëshirën e gjerë të All'lahut dhe për shpërblimin e Tij të madh që i pret individët punëmirë. **"Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish..."** Më pas ajeti thotë: **"Kush bën një vepër të keqe, do të dënohet vetëm sipas gjynahut që ka bërë..."**

Dhe për përforcim shton edhe këtë fjali gjithashtu: **"...dhe nuk do t'i bëhet kurrfarë padrejtësie."**, por do të ndëshkohen me masën e veprave të tyre.

Por çfarë synohet me *"e mira"* dhe *"e keqja"* në këtë ajet, a janë këto të dyja veçori e *"njësimit"* dhe *"politeizmit"* apo kanë kuptim më të gjerë? Ndërmjet komentuesve ka mendime të ndryshme për këtë. Por në aparençë duket se ajeti përmbledh çdo vepër të mirë, çdo mendim të mirë dhe çdo ideologji të mirë apo të keqe dhe nuk ka argument për kufizimin e të mirës dhe të keqes.

Hulumtime

Këtu janë disa pika që duhet të ndalemi në to:

1- Cili është qëllimi i thënies së Tij "xhae bihi"?

Siç përftohet nga kuptimi i fjalisë është që të vijë me vepër të mirë e të keqe së bashku, domethënë kur të paraqitet njeriu

para gjykatës së drejtë të All'Ilahut në Ditën e Ringjalljes, ai nuk paraqitet me duar bosh e i zbrazët nga besimi e vepra e mirë apo vepra e keqe, madje ato janë me të përherë që nuk ndahen nga ai asnjëherë. Ato janë shoqërueset e tij në jetën e përhershme e do të tubohen bashkë me të.

Është përdorur shpesh kjo shprehje në shumë ajete të tjera të Kur'anit me këtë kuptim. Kështu që në ajetin 33 të sures "Kaf" lexojmë thënien e All'Ilahut të Lartësuar: **"Ai që i frikësohet të Gjithëmëshirshmit në fshehtësi, e që ka ardhur me zemër të kthyer. (të penduar)..."** Në të vërtetë Xhenneti është për atë të cilin beson tek All'Ilahu përmes rrugës së besimit në gajb, që i frikësohet Atij dhe vjen në Ditën e Ringjalljes me zemër të penduar e të mbushur me ndjenjën e përgjegjësisë.

2- Shpërblimi i të mirës me dhjetëfish

Në ajetin në fjalë lexojmë se e mira shpërblehet me dhjetëfishin e saj, ndërkohë që në disa ajete të tjera të Kur'anit përftohet se ajo është përkufizuar me frazën "Shumëfish më shumë", pa përmendur numrin e shumëfishimit, siç thuhet në ajetin 245 të sures "Bekare". Në disa ajete arrin shpërblimi i disa veprave, si shpenzimi, në shtatëqindfish, siç thuhet në ajetin 261 të sures "Bekare". Madje më shumë se kaq siç thotë i Lartësuari në suren "Zumer", ajeti 10: **"...Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë."**

Është e qartë se nuk ka aspak kundërshti ndërmjet këtyre ajeteve, ku më e pakta që u jepet punëmirëve është dhjetëfishi i të mirës. Masa e shpërblimit rritet me madhësitinë e rëndësisë së veprës së mirë, me madhësitinë e gradës së sinqeritetit, me

shtimin e sasisë së përpjekjes në rrugën e veprës së mirë deri sa arrin çështja që të thyhen kufinj të masat. Askush nuk e di kufirin e shpërblimit dhe masën e tij përveç All'Ilahut të Lartësuar.

Përshebull: Shpenzimi, i cili gëzon një rëndësi të madhe në Islam, shpërblimi i tij e kalon kufirin e njohur për veprën e mirë, i cili është dhjetëfishi i së mirës, dhe arrin në "shumfish më shumë" ose "shtatëqindfish" e ndoshta më shumë se kaq.

Lëvizja e njeriut në rrugën e drejtë është baza e tërë sukseseve e lumturive. Për atë Kur'ani përmend një shpërblim jashtë kufinjve të statistikave e llogaritjeve. Nga këtu, gjithashtu, sqarohet moskontradikta ndërmjet këtij ajeti dhe transmetimeve të tjera që përmenden për disa vepra të mira e të shpërblyera më shumë se dhjetëfishi.

Gjithashtu, ajo që lexojmë në ajetin 84 të sures "El Kasas": **"Kush bën një të mirë, do të ketë shpërblim më të mirë se ajo..."** nuk bie në kundërshtim me ajetin në fjalë saqë të kemi nevojë të themi në këtë rast kemi të bëjmë me agrogimin e ajetit, sepse e mira ka kuptim të gjerë dhe, gjithashtu, përshtatet me dhjetëfishin.

3- Përse shpagimi i një dite të vetme është me gjashtëdhjetë ditë?

Ndoshta dikush mund të përfytyrojë se detyrimi i agjërimit "gjashtëdhjetë ditë" si shpagim i prishjes së një dite të agjërimit në muajin e Ramazanit me qëllim, e dënimet tjera në këtë botë e në

Tjetrën të kësaj natyre nuk përputhen me ajetin në fjalë i cili thotë:
E keqja ndëshkohet po me atë masë.

Por po të kthejmë vështrimin në një pikë të vetme do të bëhet e qartë përgjigjja e kësaj kontradikte dhe ajo është se qëllimi i barazisë ndërmjet “mëkatit e ndëshkimit” nuk është barazia numerike, por patjetër që duhet të merret në konsideratë edhe mënyra e veprimit.

Prishja e një dite prej ditëve të muajit të Ramazanit, me gjithë rëndësinë e tij, ndëshkimi i tij nuk është agjërimi i një dite të vetme, siç është tek rasti i mësipërm, por ai duhet të agjërojë disa ditë derisa të barazohet shuma respektive e kësaj dite të muajit të madhëruar të Ramazanit. Për këtë në disa transmetime lexojmë se ndëshkimi i mëkateve në muajin e Ramazanit është më i ashpër e më i madh nga ndëshkimi i mëkateve në ditët e muajve të tjerë. Po ashtu, shpërblimi i veprave të mira gjatë këtyre ditëve është më i shumtë e më i tepërt dhe arrin deri në atë gradë saqë këndimi i plotë i Kur'anit në muajin e Ramazanit është i barabartë me këndimin e plotë të Kur'anit shtatëdhjetë herë në muajt e tjerë.

4- Pafundësia e mirësisë së All'llahut

Pika më e bukur në këtë rast është se ajeti në fjalë mishëroi pafundësinë e mirësisë e të mëshirës së All'llahut në të drejtat e njeriut.

A njeh ndonjë që ka në dorë njeriun dhe çështjet e tij, siç është i rrethuar me të gjitha veprat e çështjet e tij, që të dërgojë udhëheqës e udhëzues të pagabueshëm për udhëzimin e tij, në

mënyrë që të ketë sukses e të bëjë vepra të mira bazuar në udhëzimin e të Dërguarve të Tij, duke përfituar nga fuqia që i është dhuruar nga Ai? E me gjithë këtë, Ai e shpërblen për të mirat e tij me dhjetëfishin, madje Ai nuk e ndëshkon atë për të keqen veçse me të njëjtën e saj, e më pas portën e pendimin dhe arritjen e faljes e lë të hapur para tij?!

Thotë Ebu Dherri: Ka thënë i sinqerti, besniku (pra i Dërguari i All'llahut): *"Me të vërtetë All'llahu ka thënë se e mira është me dhjetë ose më shumë dhe e keqja është me një ose e fal. Mjer për atë që njëshat e tij triumfojnë ndaj dhjetëshve të tij."*¹

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 205.

Ajetet 161 - 163

قُلْ إِنِّي هَدَانِي رَبِّي إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ دِينًا قِيَمًا مِّلَّةَ إِبْرَاهِيمَ
 حَنِيفًا ۚ وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ ﴿١٦١﴾ قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي
 وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١٦٢﴾ لَا شَرِيكَ لَهُ ۚ وَبِذَلِكَ
 أُمِرْتُ وَأَنَا أَوَّلُ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٦٣﴾

"Thuaj: 'Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë, në fenë e vërtetë, fenë e pastër të Ibrahimit besimdrejtë, i cili nuk ka qenë adhurues i idhujve.'"

"Thuaj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All'Ilahut, Zotit të botëve.'"

"Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij."

Komentimi

Kjo është rruga ime e drejtë

Ky ajet dhe ajetet të cilat do t'i lexojmë më pas, me të cilët mbyllet edhe surja "En'am", konsiderohen përmbledhëse të kërkimeve të paraqitura në këtë sure, e cila filloi e mbaroi me

luftimin e politeizmit dhe të paganizmit dhe thëniet e saj përqëndroheshin në sqarimin e kësaj çështjeje. Kjo sure filloi me thirrjen në Njësime dhe në luftimin e politeizmit dhe u mbyll me po me të njëjtën tematikë e hulumtim.

Në fillim e urdhëroi të Dërguarin e All'lahut (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) që të thotë në përballje me politeistët e paganët, me pretendimet e tyre të kota e të turpshme dhe larg llogjikës së shëndoshë: **“Thua: ‘Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë’...”** pra, në rrugën e Njësimit (teuhidit) dhe në refuzimin e të gjitha formave të politeizmit e paganizmit.

Ajo që duhet përmendur është se ky ajet e shumë të tjerë të mëparshëm e të mëpasshëm, fillojnë me thënien: “thua”. E ndoshta nuk gjendet në Kur'an sure që të jetë përsëritur kaq shumë kjo fjalë në këtë sure. Në realitet kjo reflekton ashpërsinë e përballjes ndërmjet të Dërguarit të All'lahut (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe llogjikës së politeistëve.

Gjithashtu, ajo thënie i mbyll të gjitha portat e justifikimit para tyre, sepse përsëritja e fjalës “thua” është tregues se çdo gjë që u thotë atyre i Dërguari i All'lahut (*Paqja dhe bekimi i All'lahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është me urdhër të All'lahut, madje është vetë fjala e All'lahut dhe nuk janë idetë e të Dërguarit të All'lahut, as mendimet dhe bindjet e tija personale.

Është e qartë se përmendja e fjalës “thua” në këto ajete, e në ajete të tjera si këto, në tekstet e Kur'anit, është për ruajtjen e autenticitetit të Kur'anit dhe për të vërtetuar se ajo që vjen pas tyre janë të njëjtat fjalë të cilat i janë shpallur të Dërguarit të All'lahut.

Thënë ndryshe: Qëllimi i tyre është argumentimi se i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk bën në këto ajete asnjë ndryshim në thëniet që i janë shpallur atij, deri edhe fjalën “thua”, e cila i drejtohet atij, e përmend atë siç është.

Më pas i Lartësuari në këtë ajet e në dy ajetet pasardhës sqaron “rrugën e drejtë”.

Ai thotë fillimisht: Me të vërtetë ajo është feja e drejtë e cila është plotësisht e saktë dhe e vërtetë. Ajo është e përhershme e qëndrueshme, garantuese për çështjet e fesë e të jetës, të trupit dhe të shpirtit: “... në fenë e vërtetë...”¹

Arabët kishin një dashuri të veçantë për Ibrahimin (*Paqja qoftë mbi të!*), madje besimet dhe fenë tyre e përshkruanin se është fe e Ibrahimit. Kjo është ajo në të cilën ju thërras juve dhe jo ajo që ju pretendoni: “...fenë e pastër të Ibrahimit...”

Ibrahimi (*Paqja qoftë mbi të*) i refuzoi bindjet mitologjike që ishin përhapur në kohën e në mjedisin e tij dhe ju drejtua Njësimit (teuhidit) për të ardhur në njësim “...besimdrejtë...”

Fjala “*hanijf*” do të thotë personi ose gjëja e cila anon në një drejtim të caktuar. Ndërsa në terminologjinë e Kur’anit ky përshkrim përdoret për atë që refuzon besimet e kota të kohës dhe kthehet nga feja dhe ideologjia e vërtetë.

Kjo frazë duket se është përgjigje e thënies së politeistëve të cilët e ofendonin të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për shkak se kundërshtoi ideologjinë pagane, e cila ka qënë feja e të parëve të tyre arabë. Profeti, si përgjigje e thënies së tyre, u tha se

¹ Fjala “*kajjimen*” mund të vijë me kuptimin “*el istikamet*”. Mund të vijë me kuptimin e qëndrueshmërisë e të vazhdimësisë. Po ashtu mund të vijë me kuptimin e mbikqyrësit e të ngarkuarit për çështjet e fesë e të jetës.

kundërshtimi i zakoneve të kohës para Islamit dhe e ideologjive mitologjike të përhapura në atë mjedis, nuk është vetëm veprimi im, por, gjithashtu, ka qenë edhe veprimi i Ibrahimit, të cilin e respektojmë të gjithë.

Më pas, për përforcim, ajeti shton duke thënë: **"...i cili nuk ka qenë adhures i idhujve."** madje ai është hero i luftës kundër paganizmit e bëri luftë kundër politeizmit. Ai nuk ka qëndruar asnjë moment të vetëm pa i luftuar e sulmuar ato paganizma e idhujtari.

Përsëritja e fjalisë **"...besimdrejtë, i cili nuk ka qenë adhures i idhujve"** në ajete të Kur'anit Fisnik e shoqëruar me thënien e Tij "mysliman" ose pa të, është për përforcimin e kësaj çështjeje se Ibrahim, me të cilin krenohen me të arabët injorantë, është i pafajshëm dhe i pastër nga të gjitha ideologjitë dhe veprat e gabuara.¹

Ajeti pasardhës tregon se është detyrë e Profetit që të thotë: Në të vërtetë unë nuk jam monoteist vetëm me ideologjinë, por për më tepër unë veproj çdo vepër të mirë: **"Thuj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All'Ilahun, Zotit të botëve.'"** Kështu që unë jetoj për All'Ilahun, për Atë vdes, sakrifikoj çdo gjë për hir të Tij, i gjithë qëllimi im, e gjithë dashuria ime, madje e gjithë ekzistenca ime janë për Atë.

Fjala *"en nusuk"* në origjinalitet do të thotë adhures (ibadet). Për këtë edhe adhuresit (*el aabidu*) i thuhet *"en nasik"*. Por kjo fjalë në të shumtën e rasteve përdoret për veprat e haxhit, kështu që thuhet: *menasikul haxh*, ritualet e haxhit.

¹ Sure "Bekare", ajeti 135. Sure "Ali Imran", ajeti 67 dhe ajeti 95.

Disa thonë se qëllimi i fjalës “nusuk” këtu mund të jetë për kurbanin. Mirëpo në dukje ajo përfshin çdo adhurim dhe përmend së pari namazin, si adhurimi më i rëndësishëm, më pas adhurimet e tjera në mënyrë të përgjithshme. Domethënë që namazi im dhe të gjitha adhurimet e mia, madje edhe vdekja e jeta ime, të gjitha këto janë për Atë të Lartësuarin.

Më pas në ajetin e tretë shton për përforsim dhe hedh poshtë çdo lloj nga llojet e politeizmit e paganizmit duke thënë: **"Ai nuk ka asnjë ortak..."**

Në mbyllje ajeti thotë: **"...Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij."**

Si ka qenë Profeti i pari mysliman?

Në ajetin në fjalë i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përshkruhet si ka qenë myslimani i parë.

Ka shumë fjalë ndërmjet komentuesve në lidhje me këtë çështje, sepse ne e dimë se në qoftëse synimi është për “Islamin” me kuptimin e gjerë të kësaj fjale, atëherë ai përfshin të gjitha fetë qiellore. Për këtë fjala mysliman përdoret edhe për Profetët e tjerë, gjithashtu. Kështu që ne lexojmë rreth Nuhut (*Paqja qoftë mbi të*) **"Dhe jam urdhëruar që të jem nga myslimanët"**¹

Lexojmë rreth Ibrahimit, mikut të All'llahut, dhe birit të tij Ismailit: **"Zoti ynë na bëj neve myslimanë ndaj teje."**²

¹ Sure "Junus", ajeti 72.

² Sure "Bekare", ajeti 128.

Në lidhje me Jusufin (Paqja qoftë mbi të) thuhet: **“Më vdis mua mysliman.”**¹

Kështu që “mysliman” ka kuptimin e atij që dorëzohet e nënshtrohet përpara urdhërit të All'llahut. Ky kuptim vërtetohet për të gjithë Profetët e All'llahut dhe popujt e tyre besimtarë.

Megjithatë, qenia e të Dërguarit të Islamit i pari i myslimanëve ose është në aspektin e mënyrës së Islamit të tij dhe rëndësisë së tij, sepse grada e islamit të tij dhe e dorëzimit të tij është më e lartë dhe më e mirë nga të gjithë, ose ngaqë ai ka qenë individi i parë i këtij ymeti i pari që pranoi Islamin dhe Kur'anin.

Në disa transmetime, gjithashtu, thuhet se ai (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është i pari që iu përgjigj besëlidhjes në botën e atomit, kështu që islami i tij i paraprin islamit të të gjitha krijesave së bashku.¹²

Sidoqoftë, ajetet në fjalë sqarojnë shpirtin e Islamit dhe pasqyrojnë vërtetësinë e direktivave kur'anore që janë: thirrja në rrugë të drejtë, thirrja në fenë e Ibrahimit duke shkatërruar idhujt, thirrja në refuzimin e çdo lloji nga llojet e politeizmit e paganizmit ... kjo nga ana e ideologjisë e besimit.

Ndërsa nga ana praktike: Thirrja për sinqeritet, për dëlirësi në qëllim, për veprimin e çdo gjëje për All'llahun e Lartësuar, jeta për hir të Tij, vdekja në rrugë të Tij, kërkimi i çdo gjëje prej Tij, dashurinë ndaj Tij, të larguarit nga armiqtë e Tij, t'i lutemi vetëm Atij, etj.

¹ Sure "Jusuf", ajeti 101.

² Tefsiri "Safij", vëll. 2, f. 177, fundi i ajetit në fjalë.

Sa dallim i madh që është ndërmjet thirrjes së qartë islame dhe veprave të disa njerëzve që shfaqen me islam dhe nuk kuptojnë nga Islami vetëm sa të duken me fe dhe nuk mendojnë në adhurimet e tyre veçse nga jashtë, nuk interesohen për anën shpirtërore e për të vërtetën. Për këtë, jeta e tyre, vdekja e tyre, tubimet e tyre, krenaria e tyre dhe liria e tyre nuk janë gjë tjetër veçse lëvozhga boshe e asgjë tjetër.

Ajeti 164

قُلْ أَغْيِرَ اللَّهُ أْبْنِي رَبًّا وَهُوَ رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ ۚ وَلَا تَكْسِبُ كُلُّ
 نَفْسٍ إِلَّا عَلَيْهَا ۚ وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَىٰ ۚ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُم
 مَّرْجِعُكُمْ فَيُنَبِّئُكُم بِمَا كُنتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ ﴿١٦٤﴾

“Thuaj: ‘A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç All'Ilahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje? Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit. Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t’ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush.’”

Komentimi

Vërtet, përforcimet e njëpasnjëshme dhe argumentimet e llojllojshme në këtë sure në sferën e Njësimit dhe të luftës ndaj politeizmit tregojnë për rëndësinë e madhe të kësaj tematike.

Ky ajet kritikon logjikën e politeistëve në një mënyrë tjetër ku i Lartësuar i thotë Profetin të Tij: Thuaj atyre dhe pyeti ata: A është e rregullt të kërkoj një Zot përveç All'Ilahut të Vetëm ndërkohë që Ai është Poseduesi e Zotëruesi, Ai është Zoti i gjithçkaje dhe në dorën e Tij janë çështjet e të gjitha qenieve dhe gjykimi dhe sundimi i Tij përfshin të gjitha atomet e ekzistencës

pa përjashtim? **"Thuaj: 'A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç All'llahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje?'..."**

Më pas ai u përgjigjet një grupi politeistësh zemërgurë, të cilët i kanë thënë Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): Na e paso ne dhe e mbartim gjynahun tënd nëse ndjekja jonë është gabim, duke thënë: **"...Kushdo që bën diçka, punon për vete dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit..."** Pra, çdo njeri punon për veten e tij dhe askush nuk mbart barrën e tjetrit.

"...Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t'ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush." Kthimi juaj është tek Ai dhe ju lajmëron juve për gjithçka që kishit mosmarrëveshje e kundërshti.

Dy hulumtime

Këtu janë pika që duhet të qëndrojmë e t'i hedhim një vështrim atyre.

1- Ndoshta kemi mbartur barrën e të tjerëve.

Mund të iluzohet se ajeti në fjalë, i cili sqaron dy baza logjike të pranuar nga të gjitha fetë e legjislacionet, që janë: çdo kush punon për veten e tij dhe askush nuk ndëshkohet me mëkatën e tjetrit, bie në kundërshtim me ajetet e tjera të Kur'anit. Po ashtu ai nuk përputhet me transmetimet që kanë ardhur në këtë fushë, sepse All'llahu i Lartësuar thotë në suren "En Nahl", ajeti 25: **"(Le të thonë kështu, me qëllim) që t'i mbajnë gjynahet e veta të plota në Ditën e Kiametit, si dhe pjesën e gjynaheve të**

atyre që i çuan në humbje nga padijenja; sa e keqe është barra që do të bartin ata."

Nëse askush nuk mbart barrën e tjetrit, atëherë si e mbartin ata të humburit barrën e të humburve?!

Po ashtu, hadithet që lidhen me "synetin e mirë" dhe "synetin e keq" të transmetuara nga Shiitët e Synitët, bien në kundërshtim me kuptimin e ajetit në fjalë, siç është thënia e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): *"Ai që ligjëron një vepër të mirë ka shpërblimin edhe prej atij që vepron atë, pa i munguar nga shpërblimi i tyre asgjë. Ai i cili ligjëron një vepër të keqe, ai do të mbartë edhe barën e atij që e vepron, pa i munguar nga barra e tyre asgjë."*¹

Mirëpo, përgjigja për këtë pyetje është e qartë, sepse ajeti në fjalë thotë: Askush nuk e mbart barrën e tjetrit pa shkak. Ndërsa ajetet dhe transmetimet e përmendura më parë thonë: Nëse një njeri ligjëron (vendos) një vepër të mirë apo të keqe dhe të tjerët i veprojnë ato, kjo do të thotë se ai është shkaktari dhe pa dyshim është pjesmarrës me ta në shpërblim e ndëshkim, sepse – në të vërtetë – ajo konsiderohet vepër dhe punë e tij, sepse është ai i cili me dorën e tij ka vendosur bazën mbi të cilën u ngrit ajo vepër.

2- Po veprat e mira të tjerëve a na sjellin dobi neve?

Një iluzion tjetër i cili mund të pushtojë mendjen rreth këtij ajeti është se: Ajeti thotë: Me të vërtetë vepra e çdo njeriu nuk vlen veçse për të. Bazuar mbi këtë, veprat e mira të cilat i dhurohen të vdekurve, madje edhe të gjallëve nganjëherë, nuk mund t'i vlejnë

¹ "Usulul Kafij", vëll. 5, f. 9.

atyre, ndërkohë që lexojmë në transmetime të shumta, të transmetuara nga Shiitët dhe Synitë, nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nga imamët e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*) se të tilla vepra mund t'i vlejnjë të tjerëve. Kjo i përfshin të gjithë dhe nuk kufizohet me veprën e fëmijës për dy prindërit e tij, madje përfshin këdo që bën një vepër dhe e dhuron shpërblimin e tij për të tjerët.

Këtu shtojmë se ne e dimë që shpërblimi është i lidhur me ndikimin e veprës së mirë që bëhet për shpirtin e njeriut dhe me rolin e asaj vepre në plotësimin dhe përsosjen e tij. Vallë, si mund të ndikojë shpirtërisht një vepër e mirë tek një person i cili kurrë nuk ka bërë një vepër të mirë, madje as nuk ka pjesë në kryerjen e saj?

Disa janë marrë me këtë problematikë në mënyrë të detajuar dhe nuk ishin vetëm individët e zakonshëm të cilët e parashtruan këtë, madje u ndikuan me të disa komentues e shkrimtarë, si përshembull autori i librit “El Menar”, deri në atë gradë sa që harruan shumë nga hadithet e transmetimet e sakta. Por nëse kthejmë shikimin tek dy pika sqarohet problematika:

1- Është e vërtetë se vepra e çdo njeriu është shkaku i plotësimit dhe i përsosjes së tij në veçanti dhe se rezultatet e veprave të mira dhe ndikimet e tyre reale i kthehen vepruesit të këtyre veprave të mira njësoj siç është “fiskultura” dhe “mësimi e edukimi” ku çdonjëra nga këto është shkak i forcimit të trupit të vepruesit të tyre, i shpirtit të tij dhe përsosjes së trupit dhe shpirtit. Por, kur dikush vepron një vepër të mirë për dikë tjetër, ai e kryen një vepër të tillë për arsyen se ky person padyshim që posedon veçanti nga të tjerët dhe cilësi të mirë, ose ka qenë edukues i mirë, ose nxënës i mirë, ose shok i mirë, ose komshi besnik, ose dijetar në shërbim të shoqërisë, ose besimtar i singertë, ose tërheq

vëmendjen e të tjerëve e bëhet shkaktar që ata të kryejnë vepra të mira dhe ja dhurojnë ato atij.

Bazuar mbi këtë, ajo vepër – në realitet – është si rezultat i atij dallimi dhe si rezultat i cilësisë së mirë të përmendur, për pikën e ndritur në personalitetin e tij dhe jetën e tij.

2- Shpërblimet, të cilat ua jep All'llahu i Lartësuar njerëzve janë dy llojesh:

Shpërblime që përshtaten me përsosjen e tyre shpirtërore dhe me dobitë e tyre, që do të thotë se shpirtat dhe vetat e tyre mund të rriten e të lartësohen shumë më tepër për shkak të kryerjes së veprave të mira e të ngjisin sa më lart shkallët e plotësimit e të përsosjes deri në atë gradë që vlejnë për jetesë në botra më të larta e më të mira. Kështu që ngrihen me produktivitetin e tyre mbi krahët e besimit dhe të veprës së mirë.

Por, përderisa çdo vepër e mirë është bindje ndaj urdhërit të All'llahut të Lartësuar dhe se ai që i bindet urdhrave të urdhëruesit e meriton shpërblimin, atëherë ai ka mundësi që t'ia dhurojë këtë shpërblim dikujt tjetër me dëshirën dhe vullnetin e tij të plotë njësoj si një profesor i specializuar në një degë të rëndësishme të shkencave që jep mësim në një nga universitetet, i cili padyshim se do të arrijë me mësimdhënien në dy rezultate:

Ai nga njëra anë arrin – në dritën e mësimdhënies së tij – në grada shkencore më të plota e më të forta, nga ana tjetër ai merr para në këmbim të shërbimit të tij. Nuk ka dyshim se ai nuk mund t'ia dhurojë rezultatin e parë askujt sepse ai është i veçantë për atë, por ai mund t'ia dhurojë rezultatin e dytë atij që dëshiron.

Me të vërtetë dhurimi i (shpërblimit) veprave të mira nga ana e vepruesve të tyre për të vdekurit, madje edhe për të gjallët nganjëherë, është brenda kësaj kornize e këtij lloji.

Dhe me këtë largohet dhe bie çdo paqartësi që ka lidhje me këto thënie.

Por duhet të dimë se shpërblimet që arrijnë tek të tjerët nëpërmjet kësaj rruge nuk mund të garantojnë lumturinë e tyre, por ata përfitojnë pak prej tyre dhe se thelbi e baza e shpëtimit të tyre është besimi i tyre dhe bërja e veprave të mira nga vetë ata.

Ajeti 165

وَهُوَ الَّذِي جَعَلَكُمْ خَلَائِفَ الْأَرْضِ وَرَفَعَ بَعْضَكُمْ فَوْقَ بَعْضٍ
دَرَجَاتٍ لِّيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ ۗ إِنَّ رَبَّكَ سَرِيعُ الْعِقَابِ وَإِنَّهُ

لَغَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٦٥﴾

"Ai ju ka bërë pasardhës të njëri-tjetrit në Tokë dhe ka ngritur në shkallë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju provuar në atë që ju ka dhënë. Sigurisht që Zoti yt është i shpejtë në dënim, por, në të vërtetë, Ai është edhe Falës e Mëshirëplotë."

Komentimi

Në këtë ajet, i cili është ajeti i fundit i sures "En'am", tregohet rëndësia e pozitës së njeriut dhe vendi e tij në këtë botë me qëllim që të plotësohen kërkimet e mëparshme në aspektin e forcimit të shtyllave të Njësimit dhe të luftimit të politeizmit. Pra, që njeriu ta njohë vlerën e vetes së vet, si krijesa më e lartë dhe më e mirë në botën e krijesave, e të mos i përulet drurit e gurit, e mos të përulet përpara idhujve të ndryshme e të mos qëndrojë në robërinë e tyre, madje të jetë prijës e gjykatës mbi to në vend që të jetë rob dhe i sunduar prej tyre.

Për këtë, i Lartësuari në fillim të fjalës së Tij ka thënë: **"Ai ju ka bërë pasardhës të njeri-tjetrit në Tokë..."**¹

Në të vërtetë, njeriu i cili është mëkëmbësi i All'llahut në tokën e Tij, për të cilin janë vënë në shërbim të gjitha burimet e kësaj bote dhe i është dhënë nga ana e All'llahut të Lartësuar qeverisja e të gjitha krijesave ekzistuese, nuk duhet t'i lejojë vetes së tij të bie në gradën e përuljes e të nënshtimit ndaj gjërave të ngurta.

Më pas i Lartësuari tregon për ndryshimin e dhuntive e aftësive shpirtërore e trupore që posedojnë njerëzit dhe qëllimin e këtij ndryshimi e diferencimi, ku thotë: **"...dhe ka ngritur në shkallë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju provuar në atë që ju ka dhënë..."** nga dhuntitë e llojllojshme e të diferencuara duke ju sprovuar me to.

Më pas, në mbyllje të ajetit, tregon për lirinë e njeriut në zgjedhjen e rrugës së lumturisë dhe të rrugës e vuajtjes, si rezultat i provimeve dhe i sprovave ku thotë: **"...Sigurisht që Zoti yt është i shpejtë në dënim, por, në të vërtetë, Ai është edhe Falës e Mëshirëplotë."** Vërtet, Zoti yt është i shpejtë në ndëshkim me ata të cilët dështojnë në këtë provim dhe Falës e Mëshirues për ata të cilët e kalojnë me sukses këtë provim dhe nxitojnë për ndreqjen e gabimeve të tyre.

¹ Fjala "*khalaiifu*", siç thuhet në librin "El Mufredat" i Ragibit, është shumësi i fjalës khalifetun. Fjala "*khulefaa*" është shumësi i fjalës "*khalijfun*", zëvendës. Ato kanë kuptimin e një person që merr pozitën e një tjetri pas tij. Germa "te" që gjendet pas kësaj fjale përfton hiperbolizim. Një grup gjuhëtarësh kanë thënë se fjala "*khalaiifu*" është shumësi i fjalës "*khalijfun*" dhe "*khalijfetun*".

Dy hulumtime

1- Ndryshimi ndërmjet njerëzve dhe parimi i drejtësisë

Nuk ka dyshim se ndërmjet njerëzve ka një grumbull diferencimesh e dallimesh artificiale, të cilat janë si rezultat i padrejtësive që ushtrojnë disa njerëz ndaj të tjerëve. Përshembull: Ka njerëz që posedojnë pasuri marramëndese e të tjerë vuajnë nga varfëria ekstreme, ka njerëz që vuajnë nga padituria e analfabetizmi për shkak të mospasjes mundësi të sigurojnë gjërat më të domosdoshme për mësim, nga ana tjetër një grup njerëzish arrijnë në shkallën e lartë të kulturës e diturisë për shkak të mundësisë që kanë për sigurimin e të gjitha mjeteve të domosdoshme për mësim e studim.

Ka njerëz që vuajnë nga sëmundje për shkak të kequshqyerjes dhe mospasurimit të mjeteve shëndetësore, ndërkohë që individë të pakët gëzojnë paqe e shëndet për shkak të mundësive që kanë.

Shembulli i këtyre ndryshimeve e diferencimeve si: Pasuria e varfëria, dituria e injoranca, shëndeti dhe sëmundja, janë shpeshherë pjellë e kolonializimit dhe e shfrytëzimit. Ato janë fenomene të ndryshme skllavërimi e padrejtësi të dukshme e të fshehta.

Duhet pranuar se këto çështje nuk mund të konsiderohen si dëshirë e All'llahut dhe nuk është e vërtetë absolutisht mbrojtja e këtyre diferencimeve të pajustificueshme esencialisht.

Por, në të njëjtën kohë nuk mund të mohojmë se edhe sikur të përmbushen të gjitha bazat e drejtësisë në shoqërinë njerëzore – gjithashtu – njerëzit nuk mund të jenë të gjithë të barabartë për

nga përparësitë, mendimet, shijet, zgjuarsia, mprehtësia e deri në formën trupore të tyre.

Por, a është prania e këtyre ndryshimeve e diferencimeve në kundërshtim me parimin e drejtësisë, apo është e kundërta ku kjo është vetë drejtësia me kuptimin real të saj? Domethënë që parimi i vënies së çdo gjëje në vendin e saj çon në atë që individët të mos jenë të barabartë.

Nëse të gjithë individët në një shoqëri islame janë të barabartë e të ngjashëm në dhunti e aftësi, si kumashi e enët që dalin nga e njëjta fabrikë, atëherë, shoqëria njerëzore do të ishte një shoqëri e vdekur, e ngurtë dhe e zhveshur nga lëvizjet e plotësimet.

Shikoni bimën e trëndafil. Ajo ka rrënjë të forta e të qëndrueshme e trung të hollë, por është e fortë deri diku, ka degë më të buta, gjethe e lule ku disa janë me të buta se disa të tjera. Ky grup i shumëllojshëm në ndërtimin e tij e i ndryshëm në qëndrueshmërinë e butësinë e tij formon bimën e trëndafil të bukur që përmban qeliza të ndryshme që kanë funksione të ndryshme, ndryshojnë në të kapacitetet e përgatitjet sipas ndryshimit të funksioneve e detyrave.

E njëjta gjë vihet re edhe në botën njerëzore. Kështu që individët formojnë në përgjithësi një pemë të madhe ku çdo individ ka një mesazh të veçantë në këtë ndërtesë madhështore që ka një strukturë të veçantë që përshtatet me funksionet e tij.

Për këtë Kur'ani Fisnik thotë: Në të vërtetë këto dallime e diferencime janë mjet i provimit e i sprovimit të tyre sepse provimi e sprovimi i All'Ilahut, siç e thamë edhe më përpara, do të thotë "edukim".

Me këtë i përgjigjet çdo kundërshtie e problematike që e ka burimin tek kuptimi i gabuar i perceptimit të ajetit.

2- Mëkëmbësia e njeriut në tokë

Pika tjetër e rëndësishme është se Kur'ani Fisnik e përshkruan njeriun disa herë që ai është mëkëmbësi i All'Ilahut në tokën e Tij. Ky përshkrim dhe kjo shprehje, brenda sqarimit të pozitës së njeriut, gjithashtu, sqaron këtë realitet se: All'Ilahu i Lartësuar është Poseduesi i vërtetë i pasurive, shëndetit, kapaciteteve dhe të gjitha dhuntive të dhuruara njeriut. Njeriu nuk është gjë tjetër - në realitet - veçse mëkëmbës i All'Ilahut, i autorizuar nga ana e Tij, dhe i lejuar nga ana e Tij.

Është sigurtë se përfaqësuesi nga ana e Tij nuk është i pavarur në sjelljet dhe veprimet e tij, por duhet që veprat dhe sjelljet e tij t'i nënshtrohen Poseduesit të vërtetë e të kryhen në përputhje me lejen e Tij.

Nga këtu sqarohet se Islami – p.sh. – ndryshon me sistemin komunist, gjithashtu, edhe me sistemin kapitalist në çështjen e pronësisë, sepse grupi i parë e specifikon pronën për shoqërinë, ndërsa grupi i dytë me individin. Ndërsa Islami thotë se pasuria nuk është as e individit dhe as e shoqërisë, në realitet ajo është e All'Ilahut të Lartësuar dhe njerëzit janë përfaqësuesit e All'Ilahut dhe mëkëmbësit e Tij.

Me këtë argument Islami mbikqyr mënyrën e sjelljes së individëve me pasurinë, si i fitojnë dhe ku i shpenzojnë dhe për të gjitha këto vendos kritere e kushte që e bëjnë ekonominë islame një sistem të veçantë përballë sistemeve të tjera.

SURE "EL A'RAF"

**E zbritur në Mekë
206 ajete**

Kjo sure është zbritur në Mekë, me përjashtim të ajeteve 163-165 të kësaj sureje.

Numri i ajeteve të sures "A'raf" është 206, ose 205 siç thonë disa.

Përmbajtja e sures "El A'raf"

Siç e dimë, pjesa më e madhe e sureve të Kur'anit, rreth 80-90 prej tyre, kanë zbritur në Mekë. Duke patur parasysh rrethanat e Mekës së asaj kohe dhe gjendjen e myslimanëve gjatë 13 vjetëve e duke shqyrtuar faqet e historisë islame pas emigrimit, bëhet e qartë se ka dallim në përbërje ndërmjet sureve të zbritura në Mekë dhe atyre të zbritura në Medinë.

Në të shumtën e rasteve, në suret e Mekës flitet për fillimin e krijimit dhe Ringjalljen, konstatimin e Njësimit, Ditën e Ringjalljes, luftën ndaj politeizmit e paganizmit, forcimin e pozitës së njeriut dhe vendin e tij në botën e krijesave. Kjo, sepse periudha mekase përbën një periudhë formimi të myslimanëve për sa i përket ideologjisë, forcimit të bazave të besimit, si elementë thelbësorë për një "progres rrënjësor".

Kështu, që në periudhën e Mekës ishte detyrë e të Dërguarit të All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që të pastronte mendjet e njerëzve nga të gjitha idetë pagane mitologjike e të rrënjoste në vend të tyre shpirtin e Njësimit, adhurimin e All'llahut të Lartësuar, sjelljen e mirë e me përgjegjësi për individët e shtresës së shtypur në periudhën e epokës pagane, rrezatimin e tyre me personalitet qytetërues, identitetin e krenarinë e tyre njerëzore, realitetin e pozicionit të tyre në sistemin e botës së gjallë, në mënyrë që nga

ky popull i ulët e i mbushur me mitologji, të formonte më pas një ummet (bashkësi) me personalitet të fortë e të qëndrueshëm e me besim aktiv. Pikërisht ky formim i thellë ideologjik, që u plotësua me dorën e të Dërguarit të Islamit dhe me udhëzimin e Kur'anit në Mekë, është shkaku i përparimit të Islamit në Medine.

Me të vërtetë, ajetet e sureve mekase përshtaten të gjitha me këtë qëllim të veçantë.

Ndërsa periudha medinase ka qenë periudhë e themelimit të qeverisë islame, periudhë lufte (xhihadi) ndaj armiqve, periudhë e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë mbi bazën e vlerave njerëzore e të drejtësisë shoqërore.

Kështu, suret medinase i japin rëndësi në shumë ajete çështjeve të së drejtës, moralit, ekonomisë, kodit penal, e të tjera si këto, pra çështjeve që kanë të bëjnë me individin dhe me shoqërinë.

Nëse sot myslimanët dëshirojnë që të kthejnë madhështinë e humbur dhe lavdinë e tyre të vjetër, atëherë ata duhet ta zbatojnë këtë program, t'i shqyrtojnë këto dy periudha me një vizion të qartë. Nëse nuk forcohen bazat e besimit, nëse nuk ngrihet besimi mbi baza të forta, nuk mund të arrihet ndërtimi i një shoqërie të qytetëruar e të fortë.

Megenëse surja "El A'raf" është nga suret e zbritura në Mekë, ajo i ka të gjitha veçoritë e sureve mekase. Ndër këto veçori dallojmë:

- Në të flitet për fillimin e krijimit dhe për Ditën e Gjykimit.
- Me qëllim që të ringjallë e të forcojë personalitetin e njeriut, kjo sure i jep një rëndësi të madhe historisë së krijimit të Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*).
- Pas kësaj numëron besëlidhjet, të cilat i mori All'llahu i Lartësuar nga bijtë e Ademit në rrugëtimin e udhëzimit.

- Më tej argumentohet dështimi dhe humbja e grupeve që devijuan nga Njësimi, nga drejtësia e devotshmëria. Po ashtu flitet për suksesin dhe triumfin e besimtarëve të singertë.

Në këtë sure përmenden tregime të shumta të popujve të kaluar e të Profetëve të mëparshëm, si: Nuhu, Luti dhe Shuajbi (*Paqja qoftë mbi ta!*), duke i mbyllur këto me tregimin e hollësishëm të historisë së Beni Israilëve dhe luftës së Musait (*Paqja qoftë mbi të!*) kundër Faraonit.

Në fund të sures flitet edhe një herë tjetër rreth fillimit të krijimit e Ditën e Gjykimit.

Rëndësia e sures "El A'raf"

Në komentimin e "El Ajashij" përmendet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Ai që e këndon çdo muaj suren El A'raf, në Ditën e Ringjalljes do të jetë prej atyre që nuk do të kenë frikë e as nuk do të pikëllohen. Ai që e këndon këtë sure çdo të premte (xhuma), është prej atyre që nuk do të merret në llogari Ditën e Ringjalljes". Gjithashtu, ai ka thënë: "Nëse në të ka ajete me kuptim të drejtpërdrejtë (muhkem), atëherë le ta lexojë e të veprojë me të, sepse në Ditën e Ringjalljes, ajo do të dëshmojë për atë që e ka lexuar".¹

Transmetimet dhe hadithet e përcjella për mirësitë e sures nuk nënkuptojnë faktin se rezultatet dhe frytet e mëdha vijnë vetëm nga leximi i saj, por tregojnë se ajo që i jep leximit vlerën e plotë, është besimi në ato që përmban surja e më pas veprimi në përputhje me të.

¹ "Tefsiri Burhan", vëll. 2, f. 2. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 2

Ajo që kuptohet qartë në këtë hadith është se hadithet që kanë ardhur për mirësitë e sureve nuk kanë kuptimin vetëm të leximit a këndimit të tyre pa rezultat, por ajo që i jep vlerë leximit është besimi në përmbajtjen e sures pastaj të vepruarit sipas saj. Në këtë hadith lexojmë se aty përmendet leximi, këndimi me vëmendje dhe zbatimi i atij leximi. Po ashtu lexojmë në hadith se Imami ka thënë: “Ai i cili e këndon suren A’raf çdo muaj do të jetë Ditën e Ringjalljes nga ata të cilët nuk kanë frkë dhe as nuk zemërohen.”

Në të vërtetë, ky është një tregues interesant për ajetin 35 të kësaj sureje, ku All’lhu i Madhëruar thotë: **“Ata që ruhen nga të këqijat e kryejnë vepra të mira, nuk do të frikësohen e as nuk do të pikëllohen”**.

Siç vërehet, kjo pozitë është e veçantë për ata që janë të devotshëm e që ndjekin rrugën e veprave të mira. Në shtesë të kësaj, Kur’ani Fisnik është libër i “besimit” dhe i “veprave”. Këndimi e recitimi konsiderohen si hyrje dhe parathënie e kësaj tematike.

Ka thënë Er Ragib në librin “El Mufredat” në lëndën: “tilavetun”: Thënia e Tij: “E lexojnë atë me lexim të vërtetë”¹ do të thotë: Ndjekje e Kur’anit me dituri e vepër.

Kjo do të thotë se për leximin ka një kuptim më të madh se kuptimi i leximit të zakonshëm. Lexim i vërtetë është ai që shoqërohet me përceptim, mendim dhe veprim.

¹ Sure "Bekare", ajeti 121.

Ajetet 1 - 3

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْمَصّ ۝ كَتَبُ أَنْزَلَ إِلَيْكَ فَلَا يَكُنْ فِي صَدْرِكَ حَرَجٌ مِّنْهُ

لِتُنذِرَ بِهِ ۚ وَذَكَرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ ۝ أَتَّبِعُوا مَا أَنْزَلَ إِلَيْكُم

مِّن رَّبِّكُمْ وَلَا تَتَّبِعُوا مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ۚ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ ۝

**Me emrin e All'Ilahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

"Elif Lâm Mîm Sâd."

"Ky Libër të është shpallur ty; le të mos ketë kurrfarë shtrëngimi në zemrën tënde për shkak të tij! Ai të është shpallur, që nëpërmjet tij të paralajmërosh jobesimtarët dhe të këshillosh besimtarët."

"Ndiqni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj e mos ndiqni mbrojtës të tjerë, përveç Tij. Sa pak që i pranoni këshillat."

Komentimi

Në fillim të kësaj sureje ndeshemi edhe një herë me “shkronjat e ndërprera”, të cilat këtu janë: Elif, Lam, Mim dhe Sad. Edhe më parë, në fillim të sures “El Bekare” si dhe në suren “Ali Imran” kemi bërë komentimin e hollësishëm të këtyre germave.

Këtu hedhim vështrimin në një nga komentimet e parashtruar rreth kësaj çështjeje me qëllim plotësimin e hulumtimit. Ka mundësi se një nga qëllimet e këtyre germave mund të jetë tërheqja e vëmendjes së dëgjuesve dhe thirrja e tyre për heshtje e dëgjim me pëqëndrim, sepse prania e këtyre germave në fillim të sures është një gjë e çuditshme, që nuk është hasur më parë tek arabët. Roli i këtyre germave është që të nxisë tek ata dëshirën e eksplorimit e t’i ftojë në ndjekjen e fjalës deri në fund të saj.

Të gjithë komentuesit thonë se pjesa më e madhe e sureve që fillojnë me shkronjat e ndërprera, kanë zbritur në Mekë. Ne e dimë se myslimanët në Mekë kanë qenë pakicë dhe armiq të kundërshtarët e tyre kanë qenë të ashpër. Kokëfortësia e tyre u ashpërsua deri në atë masë sa që nuk kishin asnjë lloj gadishmërie që të dëgjonin fjalën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e All'Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), madje gjatë leximit të ajeteve të Kur'anit, ata nxisnin rrëmuja dhe i ngrinin zërat e tyre para të Dërguarit të All'Allahut kur ai lexonte ajetet e Kur'anit, në mënyrë që thirrja e tij të mbytej nga zhurmat. Këtë e tregojnë edhe disa ajete siç është ajeti 26 i sures "Fussilet" dhe "Sexhde".

Gjithashtu, në disa transmetime dhe hadithe të përcjella nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), lexojmë se këto shkronja janë simbole dhe tregues për emrat e All'Allahut. Kështu, germat “Elif,

Lam, Mim dhe Sad" në suren "El Ar'af", janë tregues të fjalisë: Unë jam All'llahu, i Plotfuqishmi dhe i Vërteti.¹

Në këtë mënyrë, çdonjëra nga këto katër germa është formë e shkurtuar e një prej emrave të All'llahut të Lartësuar.

Në kohët e vjetra, lejimi i formave të shkurtuara në vend të formave të plota të fjalëve, ka qenë i përhapur. Edhe në kohën tonë ndodh gjerësisht një gjë e tillë, ku shumë fraza përdoren me shkurtime. Gjithashtu, edhe institucionet e instancat më në zë përdorin fjalë dhe germa të shkurtuara.

Vlen të theksohet se komentimet dhe analizat e ndryshme të shkronjave të ndërprera nuk bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Të gjitha ato komentime mund të jenë brendësi (butun) të ndryshme nga brendësitë e Kur'anit.

Më pas, në ajetin vijues, i Lartësuari thotë: **"Ky Libër të është shpallur ty; le të mos ketë kurrfarë shtrëngimi në zemrën tënde për shkak të tij..."**

Në gjuhën arabe, fjala "*harexh*", ka kuptimin e ndjesisë së ngushtimit dhe të çdo lloji prej llojeve të vuajtjeve. Në rrënjën e saj, kjo fjalë do të thotë: Grumbull pemësh të vërtitura fillimisht e më pas të përhapura. Ajo përdoret edhe për çdo lloj ngushtimi.

Kjo fjalë e ngushëllon Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe ia qetëson mendjen e zemrën e tij se këto ajete kanë zbritur prej All'llahut të Lartësuar, kështu që ai nuk duhet të ndjejë shtrëngim e vështirësi, as nga rëndesa e mesazhit që i hidhet mbi shpatulla, as nga reagimi i kundërshtarëve dhe i armiqve të ashpër ndaj thirrjes së tij dhe as nga rezultati i pritur nga përhapja e asaj thirrjeje.

¹ "Biharul Anuar", vëll. 89, f. 373. Tefsiri "Safij", vëll. 2, f. 179.

Duke e ditur se surja "El Ar'af" është nga suret e zbritura në Mekë, atëherë mund të arrijmë t'i perceptojmë më së miri problemet me të cilat është ndeshur lëvizja e Profetit (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Por, edhe nëse nuk do të ishim në gjendje të përfytyronim të gjitha hollësitë që lidhen me jetën e të Dërguarit të All'llahut dhe bashkëkohësve të tij në mjedisin e Mekës e në fillim të thirrjes islame, duke e ditur se ai duhej të bënte një progres rrënjësor në të gjitha aspektet e këtij mjedisi të prapambetur e në një periudhë shumë të shkurtër, atëherë mund të përfytyrojmë në mënyrë të përmbledhur kufizimet e llojet e vështirësive me të cilat u hasën ata.

Kështu, është e natyrshme që All'llahui Lartësuar ta ngushillojë Profetin (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ta qetësojë atë, në mënyrë që të mos ndjejë ngushticë e vështirësi dhe të qetësohet për rezultatin e përpjekjes së tij.

Më pas, në fjalinë pasardhëse të ajetit All'llahu i Lartësuar shton se qëllimi i zbritjes së këtij Libri të lavdishëm është që t'i përkujtojë njerëzit e t'ua tërheqë vëmendjen për ndëshkimet e qëllimeve e të veprave të tyre të këqija si dhe ai është këshillë për besimtarët: **"...Ai të është shpallur, që nëpërmjet tij të paralajmërosh jobesimtarët dhe të këshillosh besimtarët."**

Tërheqja e vëmendjes në mënyrën urdhërore, që u drejtohet të gjithëve, si dhe specifikimi i këshillimit për besimtarët, kanë ardhur në ajet për shkak se thirrja në të vërtetën dhe lufta ndaj devijimeve duhet të plotësohet në mënyrë të përgjithshme e gjithpërfshirëse. Por është e qartë se besimtarët janë të vetmit ata që përfitojnë nga kjo thirrje; ata janë të gatshëm për ta pranuar të vërtetën, kanë hequr dorë nga armiqësia dhe arroganca dhe janë dorëzuar përpara të vërtetave.

E njëjta frazë ka ardhur në fillim të sures "El Bekare", ku thuhet: **"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit."**

*Për sqarime të mëtejshme, shih komentimin e ajetit të dytë të sures "El Hamd" (Fatiha).

Më pas, Allahu, i Lartësuari i drejtohet njerëzve në përgjithësi dhe u thotë:

"Ndiqni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj..." Me këtë mënyrë, Ai fillon të flasë për të Dërguarin e All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për misionin dhe mesazhin e tij duke përfunduar me detyrat dhe obligimet e njerëzve në drejtim të mesazhit.

Për ta përforcuar atë që u tha më lart, i Lartësuari shton: **"...e mos ndiqni mbrojtës të tjerë, përveç Tij..."**, pra mos ndiqni urdhra të tjerë përveç urdhrave të All'llahut dhe mos zgjidhni mbrojtës e kujdestar tjetër përveç All'llahut.

Megenëse të nënshtruarit ndaj së vërtetës dhe pranuesit e këshillave janë të pakët, në mbyllje të ajetit thuhet: **"...Sa pak që i pranoni këshillat."**

Nga ky ajet kuptohet se njeriu gjendet përballë dy rrugëve (ose dy zgjedhjeve): ose pranimin e urdhrave të All'llahut dhe të udhëheqjes së Tij, ose hyrjen nën urdhrat e të tjerëve. Në këtë mënyrë, nëse ai ndjek rrugën e parë, pronari i tij do të jetë All'llahu. Nëse zgjedh rrugën e dytë, atëherë, ai çdo ditë i nënshtrohet një zoti dhe do të zgjedhë një zot të ri.

Fjala *"eulijaun"*, e cila është shumësi i fjalës *"uelijun"*, tregon për këtë kuptim.

Ajetet 4 - 5

وَكَمْ مِّن قَرْيَةٍ أَهْلَكْنَاهَا فَجَاءَهَا بَأْسُنَا بَيِّنًا أَوْ هُمْ قَائِلُونَ ﴿٤﴾
فَمَا كَانَ دَعْوَاهُمْ إِذْ جَاءَهُمْ بَأْسُنَا إِلَّا أَنْ قَالُوا إِنَّا كُنَّا
ظَالِمِينَ ﴿٥﴾

"Sa shumë qytete kemi rrënuar Ne! Dënimi Ynë u erdhi natën ose ditën kur ata pushonin."

"Kur iu erdhi dënimi, thirrja e tyre e vetme ishte: 'Ne kemi qenë vërtet të padrejtë.'"

Komentimi

Popujt që u shkatërruan e që u zhdukën

Këto dy ajete tregojnë për dënime të dhimbshme, si pasojë e kundërshtimit të urdhrave të cilët u sqaruan në ajetet e mëparshme. Po ashtu, këto dy ajete në realitet konsiderohen si përmbajtja e përgjithshme e historisë së popujve të ndryshëm, si: populli i Nuhut, i Faraonit, i Adit dhe i Themudit si dhe populli i Lutit.

Në këtë ajet, Kur'ani Fisnik paralajmëron e qorton me forcë të gjithë ata që rebelohen ndaj udhëzimeve të Profetëve dhe që

mbjellin shfrenimin e shkatërrimin në vend të ndreqjes së vetave të tyre e ndreqjes së të tjerëve, në mënyrë që të meditojnë pak në jetën e popujve të mëparshëm e të shohin se sa nga vendbanimet e ndërtuara All'llahu i zhduku dhe i shkatërroi banorët e tyre të shthurur: **"Sa shumë qytete kemi rrënuar Ne..."**

Më pas, në ajet sqarohet mënyra e shkatërrimit të tyre, ku ndëshkimi i dhimbshëm u erdhi atyre në gjysëm të natës, kohë kur ata kalonin orët e rehatisë e të qetësisë, ose në mes të ditës, kur ata kalonin çastet e pushimit e të çlodhjes pas punës e aktivitetit ditor të mundimshëm: **"Dënimi Ynë u erdhi natën ose ditën kur ata pushonin."**

Më pas, në ajetin pasardhës thuhet: **"Kur iu erdhi dënimi, thirrja e tyre e vetme ishte: "Ne kemi qenë vërtet të padrejtë."".** Kur u zhytën në bela dhe kur u rrënuar jeta e tyre nga stuhitë e ndëshkimit, e lanë mendjemadhësinë e arrogancën e tyre dhe e pranuan padrejtësinë e tyre duke thënë: Me të vërtetë, ne ishim të padrejtë.

Hulumtime

Këtu ka disa çështje që janë të domosdoshme për t'u trajtuar:

1- Fjala *"el karjetu"*, është marrë nga fjala *"kura"* (e ngjashme me formulën "neha"), e cila do të thotë: grumbullim. Përderisa *"el karjetu"* është vendgrumbullimi i individëve, është quajtur me këtë emër. Nga kjo bëhet e qartë se fjala *"el karjetu"* nuk nënkupton vetëm katundin, por çdo vend të banuar ku mbledhen njerëzit. Ky term është përdorur në shumë ajete të Kur'anit Fisnik për qytet e vendbanim, fshat ose qytet.

Fjala “*káilun*” është emër vepror, që rrjedh nga fjala “*kajlule*”, që ka kuptimin e gjumit në mes të ditës. Origjina e këtij emri është rehatia e qetësia. Për këtë thuhet “*el ikaletu*” në shitblerje, sepse është rehati e qetësi kur prish kontratën me palën tjetër.

Fjala “*el bejat*” ka kuptimin gjatë natës.

2- Ajo që lexojmë nga këto ajete është se dënimi i All'llahut të Lartësuar i goditi të padrejtët natën, ose në mes të ditës, në mënyrë që ta përjetonin shijen e dënimit e të ndëshkimit, duke iu prishur rehatia dhe qetësia e tyre plotësisht, ashtu siç u është prishur qetësia e atyre që kanë qenë para tyre e që përbaltën radhët e tyre. Në këtë mënyrë, ndëshkimi i tyre është i përshtatshëm me mëkatet e bëra.

3- Nga ajeti në fjalë përftohet, gjithashtu, se të gjithë popujt mëkatarë e kriminelë kur përballen me ndëshkimin dhe kur u zbulohet nga sytë e tyre mbulesa e pavetëdijes dhe e mendjemadhësisë, të gjithë i pranojnë mëkatet e tyre. Por ky pranim nuk vlen, sepse është një lloj pranimi “i detyruar” nga i cili detyrohen madje edhe njerëzit më arrogantë e më mendjemëdhenj.

Thënë ndryshe, ky lloj zgjimi është i rremë e kalimtar. Ai nuk ndikon dhe nuk shoqërohet me asnjë shenjë të kthesës e të ndryshimit shpirtëror, kështu që nuk ka asnjë rezultat. Sigurisht, nëse do ta shfaqnin këtë të vërtetë në gjendje të lirë e me zgjedhje, do të ishte argument i shndërrimit të tyre shpirtëror dhe shkak i shpëtimit të tyre.

4- Nga kërkimet e parashtruara tek komentuesit për ajetin në fjalë është: Përse fillimisht Kur’ani ka thënë: “Ne e shkatërruam atë”, e pas saj vjen një fjali tjetër që fillon me germën “*fe*”, e cila zakonisht tregon për renditje kohore ku thotë: “**Dënimi Ynë u**

erdhi natën”, ndërkohë që ky dënim (pra ardhja e këtij dënimi në mes të natës) ndodhi para shkatërrimit dhe jo pas tij.

Por duhet të dimë se fjalja që fillon me germën “*fe*” mund të jetë shpjegim dhe sqarim i fjalisë së mëparshme dhe jo e një ndodhie tjetër. Në fillim All'Ilahu tregon shkatërrimin në mënyrë të përgjithshme dhe më pas e shpjegon këtë me thënien e Tij: **“...Dënimi Ynë u erdhi natën ose ditën kur ata pushonin.”** **“Kur iu erdhi dënimi, thirrja e tyre e vetme ishte: “Ne kemi qenë vërtet të padrejtë.”** Të tilla thënie ka shumë në letërsinë arabe.

5- Këto ajete nuk duhet të konsiderohen vetëm si shpjegime të tregimeve të popujve të kaluar, si fjalë që lidhen vetëm me kohën e shkuar e për popuj të kaluar. Në të vërtetë, këto ajete janë paralajmërime të rrufeshme edhe për këtë kohë dhe për kohrat e mëpasshme, për ne, për popujt e për kombet e ardhshme, sepse në rrugën e All'Ilahut nuk ka kuptim copëzimi e ndarja.

Ndonëse njeriu është i pajisur me teknologjinë e përparuar dhe i është dhënë një forcë e madhe, ai sërish është i paaftë para tërmeteve e fatkeqësive natyrore, para përmbytjeve e shirave të rrëmbyeshëm, ashtu siç ishin të paaftë e të dobët edhe popujt e mëparshëm.

Bazuar mbi këtë, ato ndëshkime të këqija e të dhimbshme, me të cilat u goditën natën e u rrënuan të padrejtët e kombeve të mëparshme, tiranët e tyre, arrogantët, shthurësit e rebeluesit, nuk janë larg njeriut të sotëm. Madje, forca e njeriut të sotëm dhe aftësitë e mëdhaja të tij, mund të jenë një burim i madh sprove për të dhe mund ta çojnë në nisjen e luftrave shkatërrimtare, që nuk sjellin veçse shkatërrimin e brezit të tij. A nuk duhet t’i marrim në konsideratë këto ndodhi e të zgjohemi nga gjumi i shkujdesur?!

Ajetet 6 - 9

فَلَنَسْأَلَنَّ الَّذِينَ أُرْسِلَ إِلَيْهِمْ وَلَنَسْأَلَنَّ الْمُرْسَلِينَ ﴿٦﴾
 فَلَنَقْصُصَنَّ عَلَيْهِمْ بِعِلْمٍ ۖ وَمَا كُنَّا غَائِبِينَ ﴿٧﴾ وَالْوَزْنُ يَوْمَئِذٍ
 الْحَقُّ ۚ فَمَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٨﴾
 وَمَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنْفُسَهُمْ بِمَا كَانُوا
 بِعَايَتِنَا يَظْلُمُونَ ﴿٩﴾

"Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar, e patjetër që do t'i pyesim edhe të dërguarit."

"Dhe do t'jua paraqesim gjithçka kanë bërë, sepse i dimë plotësisht dhe kemi qenë të pranishëm."

"Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar."

"Kurse ata që e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona."

Komentimi

Hetim gjithpërfshirës

Ajetet e mëparshme përmbanin tregues për njohjen e All'Ilahut dhe zbritjen e Kur'anit Fisnik. Ajetet e mësipërme flasin për Ringjalljen dhe janë plotësuese të ajeteve të mëparshme. Këtu shtojmë se ajetet e mëparshme folën për ndëshkimin në këtë botë të të padrejtëve, ndërsa këto ajete flasin për ndëshkimin e dënimit e tyre në Botën Tjetër. Me këtë sqarohet lidhja ndërmjet tyre.

Fillimisht, All'Ilahu, i Lartësuar vendos një ligj të përgjithshëm e thotë: **"Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar..."** Sigurisht, në Ditën e Ringjalljes, Ne do të pyesim secilin që e kemi dërguar të dërguar për misionin e tij të udhëzimit.

Madje do t'i pyesim Profetët edhe se çfarë kanë bërë në rrugën e përcjelles së mesazhit të tyre: **"...e patjetër që do t'i pyesim edhe të dërguarit."**

Kështu, të gjithë janë përgjegjës, kushdo qofshin: komandantë e ushtarë, Profetë e ndjekës të Profetëve. Mirëpo, marrja në llogari dhe përgjegjësitë ndryshojnë nga një grup tek tjetri.

Edhe hadithi i transmetuar nga Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) e përforcon këtë kuptim. Në të thuhet: *"Të dërguarit ngrihen dhe pyeten për përcjelljen e mesazheve tek popujt e tyre dhe do të lajmërojnë se ua kanë përcjellë ato mesazhe popujve të tyre."*¹

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 428. "Biharul Anuar", vëll. 90, f. 101.

Gjithashtu, këtë e ka thënë shumë qartë në një hadith tjetër në komentimin e Ali ibn Ibrahim.¹

Në ajetin pasardhës – në mënyrë që të mos mendojë ndokush se pyetja e All'llahut ndaj Profetëve do të thotë se urdhëri i është fshehur All'llahut dhe është jashtë dijes së Tij – All'llahu i Madhëruar e thotë mjaft qartë, me një thënie të përzier me betim, se ne do t'u shpjegojmë atyre të gjitha veprat e veta me diturinë Tonë, sepse Ne nuk na fshihet asgjë nga veprat e tyre dhe as ata vetë nuk janë të fshehur, por Ne kemi qenë me ata në çdo kohë e në çdo vend: **"Dhe do t'jua paraqesim gjithçka kanë bërë, sepse i dimë plotësisht dhe kemi qenë të pranishëm."**

"Le nekussene", rrjedh nga fjala *"el kissatu"*, që ka kuptimin e diçkaje që rrëfëhet nga dikush për dikë ose për disa. Përderisa çështjet gjatë shpjegimit të tyre përmenden njëra pas tjetrës, për këtë është përdorur termi *"el kissatu"*, tregim, rrëfim. Po kështu është përdorur termi *"el kisasu"* për dënimin që vjen pas krimit. Dhe prej tij *"el mikasu"*, gërsheja, sepse ajo i pret flokët pjesë-pjesë. Fjala *"kasse"* përdoret edhe për atë që kërkon diçka sepse ai i kërkon e i hulumton ngjarjet njëra pas tjetrës.

Meqenëse kjo fjali ka katër përforcues: *Lamin* e betimit, *Nunin* përforcues dhe fjalën *"ilmun"*, dije, që ka ardhur e pashquar, qëllimi i së cilës është sqarimi i madhështisë së Kur'anit, ajo ka kuptimin: Ne ua shpjegojmë atyre detajet e veprave të tyre, një e nga një pa ndërjerje, në mënyrë që ta dinë se Ne nuk na fshihet asnjë qëllim apo vepër. ²

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 4.

² Tefsiri "Mexhmaul Bejjan". Tefsiri "Tibjan", rreth kuptimit të fjalës *"el kisasu"*, fundi i ajetit në fjalë.

Marrja në pyetje, përse?

Gjëja e parë që të shkon në mendje këtu është se ne e dimë që All'illahu i Lartësuar di gjithçka. Ai është i pranishëm në çdo kohë e në çdo vend; Ai shikon çdo gjë, qëllim apo vepër qoftë ajo. Atëherë, lind pyetja: Pse është e nevojshme të merren në pyetje të gjithë të Dërguarit dhe popujt?

Përgjigjja për këtë pyetje është e qartë, sepse nëse pyetja është për informacion dhe për sqarim, me qëllim qëndrimi tek e vërteta, kjo pyetje nuk vlen për një të ditur e njohës.

Por, nëse synimi i pyetjes do ishte rikujtimi i diçkaje që ka bërë një njeri, ose për plotësim argumenti ndaj tij, apo e ngjashme me këtë, këtu nuk ka ndonjë të keqe apo dëm, sepse kjo është e ngjashme plotësisht sikur t'i ofrojmë dikujt shërbime të shumta dhe ai na bën keq e na tradhëton, dhe e gjithë kjo ishte e ditur dhe e njohur për ne, me gjithë këtë ne e pyesim atë dhe i themi: A nuk të ofruam ty këtë e atë shërbim? Ky ishte shpërblimi i mirësisë që bëmë për ty?!

Të tilla pyetje nuk janë për fitim diturie dhe për zbulimin e së vërtetës së panjohur, por ajo është për t'ia bërë të qartë të vërtetën palës tjetër. Ose ndodh që për të vlerësuar shërbimin e kryer nga një përgjegjës dhe për ta stimulimular, e pyesim atë: Çfarë bëre gjatë këtij udhëtimi, në të cilin u ngarkove për përmbushjen e një misioni? Megjithëse, ne e dimë më përpara me detaje punën e tij.

Përputhshmëria midis ajeteve të marrjes në pyetje në Kur'an

Mund të supozohet se ajetet në fjalë, të cilat dëshmojnë qartë se All'llahu do t'i pyesë të gjithë se çfarë kanë vepruar, bien ndesh me disa ajete të tjera kur'anore, siç janë ajetet 39-41 në suren "Er Rahman": **"Atë ditë ku nuk pyetet për mëkatin e tij as njeri e as xhin", Njihen kriminelët nga shenja e tyre"**, e të tjera ajete si këto. Atëherë, si është e mundur përputhshmëria midis ajeteve të mohimit dhe ajeteve që vërtetojnë dhe pohojnë çështjen e marrjes në pyetje në Ditën e Ringjalljes?!

Në të vërtetë, thellimi te këto ajete zbulon çdo paqartësi. Kështu, nga të gjitha ajetet që lidhen me marrjen në pyetje, kuptohet se në atë Ditë, njerëzit do të kalojnë në etapa të ndryshme e të llojllojshme. Në disa etapa, ata nuk do të pyeten për asgjë, madje gojët e tyre do t'u mbyllen dhe do të flasin gjymtyrët e organet, që i kanë ruajtur gjurmët e veprave të tyre. Ato do të shërbejnë si dëshmitare të gjalla dhe do t'i përcjellin me saktësi veprat e tyre.

Në një etapë tjetër do t'u lirohen gojët e gjuhët, kështu që ata do të flasin, do të pyeten, pas shikimit të të vërtetave që zbulohen prej dëshmisë së organeve, ata do t'i pranojnë veprat e tyre kriminale dhe nuk do të gjejnë dot shpëtim në momentin e shikimit të fakteve të gjalla. Këta janë njësoj si kriminelin i cili pohon çdo gjë pasi sheh faktet dhe argumentet e sakta.

Gjithashtu, disa komentues pretendojnë në komentimin e këtyre ajeteve se ajetet mohuese të të pyeturit, janë tregues i mohimit të marrjes në pyetje me gojë, kurse ajetet që pohojnë të pyeturit, tregojnë për pyetjen e organeve dhe ato përgjigjen me

gjuhën e gjendjes – si për shembull skuqja e fytyrës së njeriut nga turpi pas zbulimit të krimit të tij me fakte të vërteta.

Në këtë mënyrë bie kundërshtia ndërmjet këtyre dy grupe ajetesh.

Në ajetin pasardhës, për të plotësuar kërkimin rreth Ringjalljes, All'Ilahu i Lartësuar tregon për çështjen e “peshimit të veprave”, e cila është përmendur edhe në sure të tjera të Kur'anit, siç ka ardhur p.sh. në suren "El Mu'minun", ajetet 102,103, si dhe në suren "El Karia", ajetet 6,8.

Në fillim thuhet se peshimi i veprave në Ditën e Ringjalljes është çështje e vërtetë që s'ka dyshim në të: **"Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë..."**

Çfarë është peshorja e veprave në Ditën e Ringjalljes?

Ndërmjet komentuesve e teologëve ka shumë diskutime rreth mënyrës së peshimit të veprave në Ditën e Ringjalljes. Disa mendojnë se peshimi i veprave dhe peshorja e tyre në Ditën e Ringjalljes janë të ngjashme me peshimin dhe peshoren e kësaj bote. Nga ana tjetër disa të tjerë mendojnë se nuk ka për veprat e njeriut peshë, e lehtë dhe e rëndë, që mund të njihen me peshore.

Për këtë, duhet patjetër që të zgjidhet ky problem përmes idesë së materializimit (trupëzimit) të veprave ose përmes rrugës që vetë personat peshohen në vend të veprave të tyre në atë Ditë.

Për këtë është transmetuar nga “Ubejd ibn Umejr” se ka thënë: “Sillet një burrë i gjatë e madhështor e nuk peshon as sa krahu i mushkonjës”, që tregon se ata njerëz në aparençë kanë

qenë personalitete të mëdhaja, ndërsa në brendi nuk kanë qenë asgjë.¹

Por nëse e lëmë çështjen e krahasimit mes jetës në këtë botë dhe jetës në atë Botë, dhe mësojmë se gjithçka në atë Botë ndryshon plotësisht me ato që gjenden në jetën tonë, njësoj siç ndryshojnë etapat e periudhës së fetusit nga etapat e jetës së kësaj bote. Gjithashtu, mësojmë – se nuk është mirë që të kërkojmë përherë – në njohjen e kuptimeve të termave – rreth vërtetësive të tanishme e të caktuara, por patjetër që duhet të studiojmë konceptet duke patur parasysh rezultatet, atëherë sqarohet dhe zgjidhet problemi i peshimit të veprave Ditën e Ringjalljes.

Sqarimi i çështjes është: Nëse në të shkuarën shqiptonim fjalën kandil, mendja jonë do të shkonte tek forma e një ene të veçantë, brenda së cilës ka pak vaj, ku në të është vendosur një fitil pambuku. Ndoshta, përfytyrojmë një enë qelqi të vendosur mbi zjarr për ta mbrojtur atë nga fikja për shkak të erës. Ndërkohë që sot për termin kandil, në ditët e sotme na shkon mendja tek një aparat i veçantë që nuk ka vend as për vaj në të dhe as për fitil, që është llampa. Ajo që e bashkon kandilin e djeshëm me kandilin e sotëm është qëllimi dhe rezultati i tyre, pra që të dy janë mjete me anë të cilave largojmë errësirën.

Përsa i përket çështjes së “peshores”, vërejmë se si peshoret evoluojnë me një shpejtësi të madhe me ecurinë e kohës ku termi peshore përdoret edhe për mjete të tjera peshimi si përshembull: matësi i nxehtësisë, matësi i shpejtësisë së erës e të tjera si këto.

¹ Ky transmetim është përcjellë nga Ubejd ibn Umejr në tefirin "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 220. Në tefsirin "Xhamiul Bejjan", vëll. 8, f. 162. Nga jashtë duket se janë fjalët e Ubejdut e jo të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Kështu që, është e vërtetë se në Ditën e Ringjalljes veprat e njeriut do të peshohen me një mjet të veçantë, jo me anë të peshoreve të ngjashme me ato të kësaj bote. Ato mund të jenë vetë prania e Profetëve dhe e prijësve punëmirë. Kjo përftohet, gjithashtu, nga hadithet e transmetuara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Në librin "Biharul Enuar", duke komentuar mbi thënien e All'Ilahut: **"Dhe vendosim peshoret e sakta të drejtësisë"**¹, Imam Sadiku ka thënë: *"Peshoret janë Profetët, zëvendësit e tyre dhe krijesat, që hyjnë në Xhennet pa dhënë llogari."*²

Ka ardhur në një transmetim tjetër se Prijësi i besimtarëve dhe Imamët nga gjeneza e tij (*Paqja qoftë mbi ta!*), ata janë peshoret.³

Në të vërtetë, burrat dhe gratë shembullore në botë janë matës të vlerave të robëve. Ai që u përngjan atyre ka një peshë të ngjashme me ta, ndërsa ai që është larg tyre ka peshë të lehtë, ose nuk ka fare peshë.

Gjithashtu, edhe të dashurit e All'Ilahut në këtë botë janë matës për peshë dhe vlerësim. Por meqenëse shumica e të vërtetave në këtë botë mbesin prapa perdeve të errësirës e paqartësisë, ato shfaqen haptazi në Ditën e Ringjalljes, siç thotë All'Ilahu i Lartësuar: **"të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjësit All'Ilah..."**⁴.

Nga këtu sqarohet se përse në këtë ajet, termi "peshore" ka ardhur në numrin shumë: **"meuazijn"** - **peshoret** - sepse të dashurit e All'Ilahut që peshojnë veprat janë të shumtë.

¹ Sure "Enbija", ajeti 47.

² "Biharul Anuar", vëll. 7, f. 251-252.

³ "Biharul Anuar", vëll. 7, f. 251-252.

⁴ Sure "Ibrahim", ajeti 48.

Ka edhe një interpretim tjetër, sipas të cilit çdonjëri prej atyre të dashurve të All'llahut është i veçantë dhe me një cilësi të caktuar. Bazuar në këtë, çdonjëri prej tyre është peshore për vlerësim të një prej cilësive dhe veprave njerëzore. Përderisa veprat e njerëzve dhe cilësitë e tyre janë të ndryshme, për këtë edhe kriteret dhe matësit duhet të jenë të shumtë.

Gjithashtu, këtu sqarohet se ajo që ka ardhur në disa transmetime, siç ka ardhur nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kur e pyetën në lidhje me peshoren, ai u përgjigj se peshorja është drejtësia, nuk e mohon atë që përmendëm, sepse të dashurit e All'llahut, burrat dhe gratë shembullorë në këtë botë janë pamje të drejtësisë për nga mendimi, ideologjia, cilësitë dhe veprat (medito)¹

Më pas, All'llahu i Lartësuari, thotë: **"...Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar. 'Kurse ata që e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona."**

Sigurisht, qëllimi i të lehtës e të rëndës në pesha nuk është e lehta dhe e rënda e vetë peshores, por vlera dhe pesha e gjërave që peshohen me të.

Më tej, fjalia **"do të humbin veten e tyre"**, është një tregues interesant për këtë të vërtetë: Ata u goditën me humbjet më të mëdha, sepse njeriu mund ta humbasë pasurinë ose postin e tij, por mund të humbasë edhe origjinën e ekzistencës së vet pa arritur diçka në këmbim të kësaj; kjo është humbja e madhe dhe dëmi më i madh.

Në thënien **"...për shkak se mohuan shpalljet Tona..."** që ndodhet në fund të ajetit, tregohet se ata nuk i kanë bërë padrejtësi

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 5. Tefsiri "El Mizan", vëll. 8, f. 16.

vetëm vetes së tyre, por edhe programeve udhëzuese të All'lahut, sepse këto programe duhet të jenë rrugët udhëzuese e mjete për shpëtim. Nëse dikush i neglizhon dhe i injoron ato programe nuk arrin në udhëzim dhe për këtë është i padrejtë ndaj tyre.

Në disa transmetime thuhet se qëllimi i këtyre ajeteve është për Imamët udhëzues (*Paqja qoftë mbi ta!*). Siç e kemi thënë edhe më parë, kjo mënyrë komentimi nuk e kufizon konceptin e ajetit tek ata, porse ata janë konfirmuesit dhe vërtetuesit më të plotë e më të dukshëm të ajeteve të All'lahut.

Disa komentues e kanë komentuar padrejtësinë në këtë ajet me mosbesim e mohim dhe ky kuptim nuk është i largët nga koncepti i padrejtësisë, sepse në disa ajete të Kur'anit fjala padrejtësi ka ardhur me këtë kuptim.

Ajeti 10

وَلَقَدْ مَكَّنَّاكُمْ فِي الْأَرْضِ وَجَعَلْنَا لَكُمْ فِيهَا مَعِيشَةً قَلِيلًا مَّا

تَشْكُرُونَ ﴿١٠﴾

"Ne ju kemi vendosur në tokë dhe aty ju kemi dhënë çfarë ju nevojitet për jetesë. Eh, sa pak mirënjohës që jeni."

Komentimi

Pozita e njeriut dhe madhështia e tij në këtë botë

Pas ajeteve që folën për krijimin e parë dhe për Ringjalljen, vjen ky ajet në të cilin flitet rreth madhësisë së njeriut dhe rëndësisë së pozitës së tij, rreth mënyrës së krijimit të kësaj qenieje, për krenaritë që All'llahu i dhuroi atij, për premtimet që i mori All'llahu atij në këmbim të këtyre dhuratave e begative, të gjitha këto për përforcimin e shtyllave e bazave të edukimit e për plotësimin e tij.

Në fillim këto çështje i ka përmbledhur në në këtë ajet e më pas, në ajetet pasardhëse, i shpjegon me detaje.

Në fillim të ajetit thuhet: Ne jemi Ata që ju kemi dhuruar pronësi, pushtet dhe fuqi mbi tokë: "**Ne ju kemi vendosur në tokë...**" Dhe

ju dhamë juve mjetet e jetesës të të gjitha llojeve: **“...dhe aty ju kemi dhënë çfarë ju nevojitet për jetesë...”**

Por, megjithatë, vetëm një pakicë prej jush falënderoni për këto begati: **“...Eh, sa pak mirënjohës që jeni.”**

Dhe “mundësia” këtu nuk do të thotë që njeriu të rrijë në një vend çfarëdo, por që atij t’i jepet çdo gjë për plotësimin e nevojave të tij, mjetet e punës së tij dhe ngritja e pengesave dhe shmangia e tyre nga rruga e tij; për të gjitha këto përdoret termi “mundësim”. Kështu, në Kur’anin Fisnik lexojmë rreth Jusufit (Paqja e All’llahut qoftë mbi të!): “E kështu Ne e mundësuam Jusufin në tokë”¹ pra, Ne i vendosëm të gjitha mundësitë nën kontrollin e tij.

Ky ajet, ashtu si disa ajete të tjera të Kur’anit, pas përmendjes e numërimit të begative e dhuntive të All’llahut, i fton njerëzit që të falënderojnë për to dhe qorton mohimin e begative. Është e padiskutueshme se nxitja e shpirti të falënderimit dhe të vlerësimit tek njerëzit në këmbim të begative të All’llahut, bëhet që ata t’i nënshtrohen Dhuruesit të këtyre begative siç fton edhe natyra e krijuar (fitretu), në mënyrë që ta njohin Atë e t’i binden plotësisht Atij me bindje të plotë dhe të udhëzohen në rrugën e Tij. Kjo nuk ka kuptimin se i falënderuari ndikohet nga falënderimi i njeriut. Ndikimi i falënderimit është njësoj si ndikimi i adhurimeve të tjera dhe dobia e tij i kthehet njeriut dhe askujt tjetër.

¹ Sure "Jusuf", ajeti 56.

Ajetet 11 - 18

وَلَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ ثُمَّ صَوَّرْنَاكُمْ ثُمَّ قُلْنَا لِلْمَلَكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ
فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ لَمْ يَكُن مِّنَ السَّاجِدِينَ ﴿١١﴾ قَالَ مَا
مَنَعَكَ أَلَّا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ ^ط قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ خَلَقْتَنِي مِن
نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ ﴿١٢﴾ قَالَ فَاهْبِطْ مِنْهَا فَمَا يَكُونُ لَكَ
أَنْ تَتَكَبَّرَ فِيهَا فَاخْرُجْ إِنَّكَ مِنَ الصَّاغِرِينَ ﴿١٣﴾ قَالَ أَنْظِرْنِي إِلَى
يَوْمٍ يُبْعَثُونَ ﴿١٤﴾ قَالَ إِنَّكَ مِنَ الْمُنظَرِينَ ﴿١٥﴾ قَالَ فَبِمَا
أَغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿١٦﴾ ثُمَّ لَأَنزِلَنَّهُمْ مِّنْ
بَيْنِ أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ ^ط وَلَا تَجِدُ
أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ ﴿١٧﴾ قَالَ أَخْرَجْ مِنْهَا مَذْءُومًا مَّدْحُورًا ^ط
لَّمَن تَبِعَكَ مِنْهُمْ لَأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنْكُمْ أَجْمَعِينَ ﴿١٨﴾

"Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë engjëjve: 'Përlujuni në sexhde Ademit!' - Të gjithë iu përlulën, përveç Iblisit. Ai nuk ishte nga ata që u përlulën."

"All'Ilahu tha: 'Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?' Ai u përgjigj: 'Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijoje nga zjarri, kurse atë e krijoje nga balta.'"

"All'Ilahu i tha: 'Atëherë, zbrit prej andej! Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të. Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve.'"

"Iblisi tha: 'Më jep afat deri në Ditën kur ringjallen njerëzit!'"

"All'Ilahu i tha: 'Ti je nga ata që u është dhënë afati.'"

"Ai tha: 'Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.'"

"E do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës."

"All'Ilahu i tha: 'Dil prej andej i përbuzur dhe i përjashtuar! Pa dyshim, Xhehennemin do ta mbush me ty dhe me të gjithë ata që shkojnë pas teje.'"

Komentimi

Tregimi i mosbindjes së Iblisit

Çështja e krijimit të njeriut dhe e mënyrës së ardhjes së tij në këtë botë tregohet në shtatë sure të Kur'anit Fisnik. Siç e treguam edhe në ajetin e mëparshëm, qëllimi i përmendjes së kësaj teme, është sqarimi i personalitetit të njeriut, grada dhe pozita e tij në mesin e qenieve të kësaj bote dhe nxitja e shpirtit të mirënjohjes e të falënderimit në të.

Në këtë sure, me fraza të ndryshme, është përmendur krijimi i njeriut nga balta, përlja (sexhdja) e melekëve për të, rebelimi i shejtanit dhe mosbindja e tij e më pas qëndrimi i tij në drejtim të njeriut.

Në ajetin e parë prej ajeteve në fjalë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë engjëjve: 'Përljuni në sexhde Ademit!'..."**. Nga ata që u urdhëruan për t'u përlur ishte edhe Iblisi, i cili ka qenë në radhët e tyre, edhe nëse nuk është prej tyre. Të gjithë e zbatuan këtë urdhër dhe u përlën për Ademin, me përjashtim të Iblisit: **"...Të gjithë iu përlën, përveç Iblisit. Ai nuk ishte nga ata që u përlën."**

Ka mundësi që përmendja e "krijimit", në këtë ajet, para "formësimit" tregon se: Ne, në fillim krijuam lëndën bazë të njeriut dhe më pas i dhamë asaj formën e njeriut.

Po ashtu, në fund të ajetit 34 të sures "El Bekare" kemi thënë: Përlja e melekëve për Ademin nuk ishte një përlje adhurimi, sepse adhurimi është i veçantë për All'llahun e Lartësuar; përlja këtu ka kuptimin e modestisë (pra përlje para madhësisë së Ademit e pozitës së tij të lartë në botën e

krijesave), ose ka kuptimin e përljes ndaj All'Ilahut, i Cili krijoi një krijesë të tillë të ekuilibruar e të drejtpeshuar.

Me të vërtetë, siç e thamë edhe në fund të atij ajeti, Iblisi nuk ishte prej melekëve, por sipas qartësimit të ajeteve të Kur'anit, ai është prej qenieve që quhen "Xhindë". (Për sqarime të mëtejshme mund t'i referoheni fundit të ajetit 34 të sures "El Bekare").

Në ajetin pasardhës, i Lartësuari e pyet Iblisin për mosbindjen dhe kundërshtimin e tij: **"All'Ilahu tha: 'Çfarë të pengoi ty të mos përuleshe, kur të urdhërova?'..."** Për përgjigje, Iblisi përdori si pretekst një justifikim jo të pranueshëm e jologjik: **"...Ai u përgjigj: 'Unë jam më i mirë se ai. Mua më krijoje nga zjarri, kurse atë e krijoje nga balta.'"**

Me sa duket Iblisi ka menduar se zjarri është më i mirë se balta. Ky ishte nga gabimet e fajet më të mëdhaja të tij. Këtë nuk e ka thënë gabimisht, por gënjeu me vetëdije, sepse ne e dimë se balta është origjina e llojeve të bereqetit, burimi i të gjitha lëndëve jetike dhe mjeti më i mirë për vazhdimësinë e jetës së qenieve të gjalla; ndërsa zjarri nuk është i tillë.

Është e vërtetë se zjarri është një prej faktorëve të pjesshëm e të përbërjes në krijesat e këtij universi, por roli bazë e themeltar është i lëndëve që ekzistojnë tek dheu dhe zjarri konsiderohet vetëm mjet për plotësimin e saj.

Gjithashtu, është e vërtetë se në fillimet e saj, toka e rrumbullakët u nda nga dielli dhe ka qenë në formën e një topi të zjarhtë, që u ftoh gradualisht. Por duhet të dimë se toka vazhdonte të ishte e ndezur dhe e nxehtë kur nuk kishte mbi të asnjë gjallesë të gjallë, kështu që jeta u shfaq mbi sipërfaqen e globit në momentin që dheu dhe balta zëvendësuan zjarrin.

Për më tepër, çdo zjarr që shfaqet mbi sipërfaqen e tokës, ka si origjinë të tij lëndët e përfutuara nga dheu; pastaj dheu është origjina e rritjes së pemëve, pemët janë origjina e shfaqjes së zjarrit; madje edhe lëndët e naftës e vajrat e djegshëm kthehen gjithashtu tek dheu ose tek kafshët që ushqehen nga lëndë bimore.

Veçoria e njeriut – pa marrë parasysh të gjitha këto çështje – nuk është në qenit e tij nga dheu, por veçoria e tij bazë ndodhet tek “shpirti i humanizmit” dhe te mëkëmbësia e tij nga ana e All'Ilahut.

Edhe po të supozohet se lënda bazë e shejtanit ka qenë më e mirë se lënda e njeriut, kjo nuk nënkupton justifikimin e mospërruljes ndaj njeriut, i cili u krijua me këtë shpirt, që All'Ilahu i dhuroi këtë madhësi dhe e bëri atë mëkëmbës në tokë.

Është e qartë se shejtani i ka ditur të gjitha këto çështje, por mendjemadhësia dhe egoizmi janë ato që e ndaluan atë në mospërmbushjen e urdhrit të All'Ilahut. Ato justifikime që solli ishin të kota e të pabaza.

Anallogjia e parë është anallogjia e shejtanit

Në hadithet e shumta të transmetuara nga Ehli Bejti (*Paqja qoftë mbi ta!*), anallogjia (*el kijasu*) në dispozitat dhe të vërtetat fetare është e refuzuar në formë të prerë. Në to lexojmë se i pari që bëri anallogji ishte shejtani.

Imam Sadiku i ka thënë Ebu Hanifes: “Mos bëj anallogji, sepse i pari që ka bërë anallogji ka qenë Iblisi.”¹

Kjo thënie është transmetuar në tefsiret e Ehli Syneetit, në të shkruarën e në të tashmen, si komentimi i “Et Tabarij” nga “Ibn

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 6.

Abbas", në komentimin "El Menar", "Ibn Sirijni" dhe "Hasan El Basrij"¹

Kuptimi i analogjisë është që të krahasojmë një temë me një tjetër të cilat ngjasojnë në nga disa aspekte e të gjykojmë për të dytën me të njëjtin gjykim që gjendet tek e parë, pa e njohur plotësisht filozofinë e gjykimit dhe sekretet e tij. Është njësoj si të krahasojmë "urinën" e njeriut të gjykuar me papastërti dhe domosdoshmërinë e shmangjes prej saj, me djersën e njeriut e të themi: Përderisa këto dy gjëra janë të ngjashme në disa drejtime e pjesëzime, për këtë gjykim për "urinën" është i njëjtë me atë të djersës. Dhe, dalim në përfundimin se që të dyja janë të ndyta, ndërkohë që ato të dyja edhe pse ngjasojnë në disa drejtime, ato janë të diferencuara e të ndryshme në drejtime të tjera; njëra prej tyre është më e hollë e tjetra më e trashë; shmangia nga njëra prej tyre është e lehtë ndërsa nga tjetra është e vështirë e shumë e mundimshme. Për më tepër, filozofia e gjykimit të së parës nuk është e njohur për ne plotësisht dhe një analogji si kjo nuk është gjë tjetër veçse hamendësim.

Imamët tanë (*Paqja qoftë mbi ta!*), duke u bazuar në fjalën e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e kanë ndaluar analogjinë dhe e kanë hedhur poshtë atë, sepse ajo bëhet shkak që gjithsecili të mbështetet në studimet e tij të kufizuara dhe në mendjen e tij të shkurtër, e thjesht të konsiderojë dy tema të barabarta nga disa anë, të bazohet në dhënien e gjykimit të parë mbi të dytin, duke rënë kështu në kundërshtim me ligjet e me dispozitat fetare.

Hedhja poshtë e analogjisë logjikisht nuk kufizohet vetëm te ligjet fetare. Edhe mjekët sigurohen në këshillat e tyre që të mos

¹ Tefsiri "Menar", vëll. 8, f. 321. Tefsiri "Kurtubij", vëll. 4, f. 2067.

japin përshkrimin e një të sëmuri për një të sëmure tjetër, sado që të jenë të ngjashëm nga disa aspekte. Filozofia e këtij ndalimi është e qartë, sepse në këndvështrimin tonë, dy të sëmure mund të ngjajnë në disa aspekte, por ato kanë dallim nga anë të tjera, për shembull nga mënyra se si reagojnë ndaj ilaçit, nga grupi i gjakut, nga sasia e glukozës në gjak etj. Njerëzit e zakonshëm nuk mund t'i specifikojnë këto çështje, por kjo gjë bëhet prej mjekëve profesionistë. Nëse ata do t'i jepnin një të sëmuri ilaçet e një të sëmuri tjetër, pa i marrë parasysh specifikat e secilit, atëherë kjo gjë do të shkaktonte dëme të pariparueshme.

Dispozitat e Allahut janë më të hollësishme në këtë drejtim, dhe për këtë ka ardhur në hadithe se po të zbatohet analogjia zhduket feja, ose dëmi që shkakton është më i madh se dobia e saj.¹

Përdorimi i analogjisë për zbulimin e dispozitave dhe njohjen e tyre është argument i vizionit të shkurtër të fesë, sepse nëse për çdo temë ka një dispozitë në fe, atëherë nuk ka asnjë nevojë për analogji. Për këtë, Shiitët, që i marrin të gjitha dispozitat fetare nga shkolla e Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), trashëgimtarët e Profetit më fisnik (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk e shohin të nevojshme t'i drejtohen analogjisë e të strehohen në të.

Mirëpo, juristët e Ehli Synetit e anashkaluan medresenë e Ehli Bejtit, të cilët sipas thënieve të Profetit, ata janë streha e dytë për myslimanët pas Kur'anit, dhe u përballën me mangësi në nxjerrjen e dispozitave e rregullave fetare dhe në argumentet e tyre. Kështu që nuk kanë parë problem t'i drejtohen analogjisë.

¹ "Usulul Kafij", vëll. 1, f. 57. "Uesailu Shija", vëll. 27, f. 41.

Pse ka qenë shejtani i pari, ai që ka përdorur analogjinë?

Në tregime e transmetime të ndryshme, kemi lexuar se shejtani ka qenë i pari që ka bërë analogji, dhe anekdota e tij është se ai krahasoi krijimin e tij – nga aspekti material – me krijimin e Ademit dhe u kap me përparësinë e zjarrit mbi atë të dheut në disa drejtime. Ai e konsideroi këtë argument për përparësinë e zjarrit në të gjitha aspektet, pa marrë parasysh aspak veçoritë e dheut, madje pa parë as veçoritë shpirtërore e morale të Ademit. Ai gjykoi me anë të metodës që quhet analogji primare, por e përdorur mbi bazën e hamendjes, supozimit e studimeve sipërfaqësore të kufizuara me përparësinë e tij mbi Ademin. Madje kjo analogji e pavërtetë e nxiti atë drejt mosnjohjes së urdhrit të All'llahut.

Si në botimet e shiitëve ashtu edhe në ato të synitëve, të tërheq vëmendjen ajo që është transmetuar nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë nbi të!*), i cili thotë: *“Atë që krahason një çështje të fesë me mendimin e tij, All'llahu i Lartësuar e krahason në Ditën e Ringjalljes me Iblisin.”*¹

Kështu, mund të thuhet në mënyrë të përmbledhur se analogjia e një tematike me një tematikë tjetër, pa patur dituri për të gjitha sekretet e filozofinë e saj, nuk është argument i bashkimit të një rregulli për të dyja tematikat. Nëse analogjia përdoret për çështjet fetare e legjislative, për rregullat nuk do të gjendej rregullator konstant ku një njeri e krahason një tematikë me diçka tjetër dhe nxjerr rregullin e ndalimit të asaj tematike dhe një person tjetër, po të njëjtën tematikë e krahason me diçka tjetër dhe nxjerr rregullin e lejimit të saj.

¹ Tefsiri "Menar", vëll. 8, f. 331. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll.2, f. 7.

Analógjia e kushtëzuar nga shkaku

Rastin e vetëm që mund ta përjashtojmë nga kjo çështje është kur vetë ligjvënësi ose mjeku përmend argumentin e gjykimit dhe filozofinë e ligjit të tij. Në këtë rast, është e lejuar që nëse një argument e një filozofi të tillë e shohim edhe te një temë tjetër, mund të gjykojmë me të. Kjo njihet si analogji e kushtëzuar nga shkaku; për shembull: nëse mjeku i thotë të sëmurit se duhet ta shmangë ngrënien e filan fruti, sepse në të ka acid, i sëmuri e kupton se acidi e dëmton atë dhe ai duhet t'i shmanget domosdoshmërisht acidit edhe te frutat e tjera.

Po kështu, nëse Kur'ani Fisnik ose Syneti i ndritur thonë qartë se: Rrini larg verës, sepse ajo është dehëse, atëherë mësojmë se çdo pije dehëse është e ndaluar (edhe nëse s'është verë) dhe se duhet t'u shmangemi atyre.

Kjo analogji nuk është e kotë dhe as e ndaluar, sepse për të ka argument të njohur dhe ka tekst të prerë për shkakun. Analogjia është e ndaluar atëherë kur ne nuk e dimë plotësisht argumentin e dispozitës dhe filozofinë e tij.

Meqenëse studimi i analogjisë është i gjerë, për sqarime të mëtejshme mund t'u referoheni librave "Usulul Fikh" dhe "Kutul Akhbar" në kapitullin e analogjisë. Studimin tonë e mbyllim duke përmendur një tregim në lidhje me këtë çështje:

Në librin *"I'lelush-Sherai"*, thuhet se një herë Ebu Hanifja shkoi tek Imam Sadiku. Ky i fundit i tha: *"O Ebu Hanife, më kanë thënë se ti bën krahasime. A është e vërtetë kjo?"* Ebu Hanifja u përgjigj: *"Po, e vërtetë është"*. Imam Sadiku i tha: *"Mos bëj krahasime, sepse i pari që bëri krahasim ishte Iblisi, i cili tha: Mua më krijove nga zjarri, ndërsa atë nga balta, duke e krahasuar kështu zjarrin me baltën."*

Sikur ta krahasonte nurin e Ademit me atë të zjarrit, atëherë ai do ta dallonte mirësinë ndërmjet dy nureve e dëlirësinë e njëres mbi tjetrën.”¹

Si i ka folur shejtani All'llahut të Lartësuar?

Lind pyetja: Si ka folur shejtani me All'llahun dhe a i ka zbritur shpallje atij?

Përgjigjja: Fjala e All'llahut nuk përcillet përherë me shpallje. Shpallja konsiston në mesazhin profetik, kështu që nuk ka ndonjë pengesë që All'llahu t'i flasë dikujt në një formë të ndryshme nga mesazhi, siç mund të jetë rruga shpirtërore (batinij), ose përmes disa melekëve, qoftë ai që flet me All'llahun prej njerëzve punëmirë, si Merjemja ose nëna e Musait, apo prej jopunëmirëve, sikurse shejtani.

Le të kthehemi te komentimi i ajeteve të mbetura:
Refuzimi i shejtanit për t'iu përlurur Ademit (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk ka qenë një refuzim i thjeshtë dhe i zakonshëm, por ishte një rebelim i shoqëruar me kundërshtim e mohim të urdhrit të All'llahut, sepse ai tha: *Unë jam më i mirë se ai*. Për këtë, kundërshtimi i tij do të thotë mosbesim dhe mohim i diturisë e urtësisë së All'llahut, çka e bëri atë të humbiste të gjitha pozitat e gradat e tij. All'llahu e përzuri nga pozita e lartë që gëzonte në radhët e melekëve, duke i thënë: **"All'llahu i tha: 'Atëherë, zbrit prej andej!...'"**

Një grup komentuesish thonë se përemri "*minha*", është për "qiellin" ose për "Xhennetin". Disa të tjerë thonë se është për "pozitën e gradën". Të dy këto grupe nuk ndryshojnë shumë për nga rezultati.

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll.2, f. 7. "Ilelu Sheraiu", vëll. 1. f. 86.

Më pas, All'llahu i Lartësuar i shpjegon atij fillin e kësaj zbritjeje me frazën pasardhëse: **“Ti nuk ke të drejtë që të krenohesh në të...”**

Këtë frazë e përforcon edhe më tepër, duke thënë: **“Shporru, me të vërtetë, ti je prej të poshtëruarve.”** Pra, me këtë vepër e me këtë qëllim tëndin, ti nuk bëhesh i madh; përkundrazi, me të, ti u bërë i vogël dhe i poshtëruar.

Kjo fjali sqaron se fatkeqësia e shejtanit ka ardhur për shkak të kryelartësisë së tij. Egoizmi që kishte, e bëri atë ta shihte veten e tij si më të mirë se Ademi. Ai jo vetëm që nuk u mjaftua me mospërluljen ndaj Ademit, por madje e mohoi diturinë e mençurinë e All'llahut, e kundërshtoi urdhrin e Tij dhe e kritikoi atë, kështu që e humbi pozitën e gradën e tij. Me qëndrimin e tij, ai nuk korri gjë tjetër veçse poshtërim e zvogëlim në vend të madhështisë. Kjo do të thotë se ai jo vetëm që nuk ia arriti qëllimit, por u ngrys me të kundërtën e tij.

Në librin “Nehxhul-Belaga” në hytben “El Kasiatu” të Prijësit të besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) në të cilën qorton mendjemadhësinë dhe vetëpëlqimin, thuhet: *“Mësoni nga ç’pësoi Shejtani, të cilit Zoti ia harroi dhe mohoi të gjithë punën e tij të gjatë e përpjekjet e tij të mëdha për shkak të krenarisë së një çasti të vetëm, ndonëse Shejtani e kishte adhuruar për gjashtë mijë vite me radhë, që ende s’dihet në janë llogaritur sipas kësaj apo asaj bote. Kush mund të mbetet i sigurt, pas Shejtanit, nëse shfaq një mosbindje të tillë? Kurrë Zoti s’mund ta lejojë një qenie njerëzore të hyjë në Parajsë, nëse bën atë,*

për të cilën Ai dëboi prej saj një melek.¹ Me të vërtetë, gjykimi i Tij për banorët e qiellit dhe banorët e tokës është një i vetëm...”

Gjithashtu, Imam Ali ibn Huseni (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Me të vërtetë për mosbindjet ka degëzime. I pari është mosbindja ndaj All'Ilhut dhe mendjemadhësia dhe ajo është mosbindja e Ibliisit kur refuzoi, tregoi mendjemadhësi dhe ishte nga jobesimtarët...”²

Imam Sadiku ka thënë: “Bazat e mosbesimit janë tre: Lakmia, mendjemadhësia dhe smira. Lakmia u shfaq atëherë kur Ademi u ndalua nga pema dhe hëngri prej saj; mendjemadhësia u shfaq kur Ibliisi u urdhërua me përlulje ndaj Ademit dhe refuzoi; ndërsa smira u shfaq kur njëri prej bijve të Ademit vrau të vëllanë”³

Por tregimi i shejtanit nuk mbaron këtu, sepse kur shejtani mori vesh se u dëbua nga All'Ilahu i Lartësuar, ai e shtoi edhe më shumë tiraninë e arrogancën e tij. Në vend që të pendohej, të pranonte gabimin e tij dhe për këtë të shpërblehej nga All'Ilahu, e vetmja gjë që i kërkoi All'Ilhut ishte që t'ia ngadalësonte e t'ia vononte vdekjen e tij deri në Ditën e Ringjalljes. **"Ibliisi tha: 'Më jep afat deri në Ditën kur ringjallen njerëzit!'"**

All'Ilahu iu përgjigj kësaj kërkesë, duke i thënë: “(All'Ilahu) Tha: ‘Ti je i afatizuar!’”

Ndonëse në këtë ajet nuk shpjegohet qartazi aspekti kohor i kërkuar nga shejtani, kjo çështje përmendet në ajetet 37, 38 të

¹ Përdorimi i fjalës "*melek*" për shejtanin është se ai kishte pozitë në radhët e melekëve dhe ka qenë në një rresht me ta. Përdorimi i saj, siç e kemi thënë edhe më parë, nuk do të thotë se shejtani ka qenë prej tyre dhe prej llojit të tyre.

² "Sefinetul Bihar", lënda "*kebere*".

³ "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 219, kreu "Usulul Kufri".

suress "El Hixhr", ku All'llahu i Lartësuar ka thënë: **"All'llahu i tha: 'Ti je nga ata që u është dhënë afati.'"** Kjo do të thotë se kërkesa e shejtanit nuk ka marrë një përgjigje vendimtare e të plotë, por mori përgjigje deri në një kohë të cilën e di vetëm All'llahu i Lartësuar (Me lejen e Zotit, frazën "deri në ditën e kohës së ditur" do ta trajtojmë tek komentimi i ajetit 38 të sures "El Hixhr").

Me kërkesën e tij (për afatizim të gjatë), shejtani nuk kërkoi mundësinë për të kompensuar gjërat e humbura apo për të jetuar sa më gjatë, por qëllimi i tij ishte mashtrimi i njerëzve: **"Ai tha: 'Për shkak se Ti më flake tej, unë do t'u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.'"** Pra, do t'i çoj në humbje ata, ashtu siç më humbe mua si dhe do t'i shpie në rrugë të gabuar, ashtu siç humba edhe vetë.

Iblisi, i pari deklarues për imponim (detyrim)

Nga ajeti që është objekt studimi kuptohet se për shfajësimin e vetes, shejtani ia atribuon All'llahut imponimin dhe thotë: **"Ai tha: 'Për shkak se Ti më flake tej'"**, unë do t'i humb ata.

Disa komentues ngulin këmbë në komentimin e fjalisë: **"Ai tha: 'Për shkak se Ti më flake tej'"**, se prej saj nuk kuptohet detyrimi, pavarësisht se në dukje nuk është e nevojshme një këmbëngulje e tillë. Dëshmi e kësaj thënieje është ajo që transmetohet nga Prijësi i besimtarëve (Paqja qoftë mbi të!) ku thuhet: "Pas largimit të tij nga Sifijni, Prijësi i besimtarëve, ndërsa ishte i ulur në Kufe, u takua me një burrë në moshë, i cili pasi i ra në gjunjë, i tha: "O Prijësi i besimtarëve! Na lajmëro për ecurinë tonë drejt banorëve të Shamit. A ishte me caktimin dhe vendimin

e All'llahut?" Prijësi i besimtarëve iu përgjigj: "Sigurisht që po, o Sheh. Ju nuk ngjiteni në një kodër dhe as nuk zbrisni në brendësi të një lugine veçse me urdhër dhe caktim nga All'llahu".

Shehu i tha: "Tek All'llahu do e sakrifikoj pritjen e shpërblimit për rraskapitjen time, o Prijësi i besimtarëve!"

Prijësi i besimtarëve ia ktheu: "O Sheh, pasha All'llahun, All'llahu i Lartësuar e ka bërë shpërblimin të madh në ecjen tuaj dhe ju jeni duke ecur; në qëndrimin tuaj dhe ju jeni duke qëndruar; në largimin tuaj dhe ju jeni duke u larguar. Ju nuk jeni të dhunuar dhe të detyruar në asgjë".

Pas këtyre fjalëve, Shehu e pyeti: "Si nuk qenkemi të detyruar dhe si qenka me gjykim e caktim ecja, kthimi dhe largimi ynë?"

I tha atij (Paqja qoftë mbi të!): "A mendon se ishte vendim i patjetërsueshëm dhe caktim i domosdoshëm? Po të ishte kështu, nuk do të kishte shpërblim e ndëshkim, as ndalim dhe as lejim nga All'llahu i Lartësuar, nuk do të binte Xhennet e as Xhehennem, nuk do të fajësohej mëkatari e as nuk do të falënderohej punëmiri, punëmiri do të ishte më parësor se mëkatari për t'u dënuar. Këto janë thënie të vëllezërve që adhurojnë putat, armiqve të Mëshiruesit, pjesëtar të partisë së shejtanit, kadirijeti i këtij ummeti dhe zjarrputistët e tij ..."¹

Nga kjo sqarohet se i pari që ra në telashin e bindjes te imponimi ishte shejtani.

Më pas, duke përforcuar thënien e tij, shejtani shtoi se nuk mjaftohet me qëndrimin në pritje të tyre, por do t'u vijë atyre nga të gjitha drejtimitet e do t'ua pengojë rrugën nga çdo anë: **"E do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbrapa, nga e djathta dhe nga**

¹ "Hakul Jekijn", vëll. 1, f. 72.

e majta, e kështu Ti do të vëresh se shumica prej tyre nuk të janë mirënjohës.”

Ky përshkrim mund të tregojë se shejtani e kufizon njeriun nga të gjitha anët, duke synuar humbjen e tij me të gjitha mjetet e mundshme. Ky përshkrim zë vend edhe në jetën e përditshme. Kështu për shembull, themi se filani është i bllokuar prej borxheve ose sëmundjeve nga të katër anët.

Mospërmendja e termave sipër e poshtë është për arsyen se njeriu zakonisht lëviz në katër anët e përmendura dhe aktivitetet e tij janë shpeshherë në këto anë.

Në një hadith të transmetuar nga Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) përcillet nje tefsir më i thellë për këto katër anët, ku thuhet: “Më pas tha: Do t’u vij atyre nga përpara, ka kuptimi se do t’ua quaj të lehtë çështjen e Botës Tjetër; dhe nga mbrapa, do t’i urdhëroj të grumbullojnë pasurisë e do t’i urdhëroj të jenë koprracë ndaj nevojtarëve që ajo pasuri t’u mbetet trashëgimtarëve të tyre; nga e djathta, do t’ua shkatërroj atyre fenë duke ua zbukuruar humbjen e duke ua bërë të mirë dyshimin; dhe nga e majta e tyre, do t’i bëj që t’i duan kënaqësitë dhe epshi të jetë triumfues ndaj zemrave të tyre.¹

Në fund të ajeteve që janë objekt studimi lëshohet edhe një herë tjetër urdhri për daljen e shejtanit nga mejdani i afërt i All'Ilahut dhe nga pozita e lartë me një dallim të vetëm. Këtu, urdhri për përzënien e tij ka marrë një formë më përbuzëse e më të urryer, një qëndrim e një shtypje më të ashpër, dhe ndoshta kjo është prej armiqësisë e arrogancës që shfaqti shejtani me nxitje dhe cytje për njeriun dhe humbjen e tij. Në fillim, qëndrimi i tij ishte i kufizuar në rebelimin ndaj urdhrit të All'Ilahut dhe mosbindjen

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 404.

ndaj Tij. Për këtë u lëshua urdhri vetëm për nxjerrjen e tij. Por kur ai shtoi një gabim edhe më të madh, me vendosmërinë për t'i humbur të tjerët, atëherë erdhi urdhri i ashpër, ku thuhet: **"All'llahu i tha: 'Dil prej andej i përbuzur dhe i përjashtuar...'**

Më pas, All'llahu u betua se do ta mbushë Xhehennemin me të dhe me ata që do ta ndjekin atë. **"Pa dyshim, Xhehennemin do ta mbush me ty dhe me të gjithë ata që shkojnë pas teje."**

Dy hulumtime

1- Filozofia e krijimit të shejtanit dhe urtësia e shtyrjes së afatit të tij

Në vazhden e studimit të ajeteve që janë objekt studimi, lindin dy pyetje të rëndësishme:

E para: Përse e krijoi All'llahu shejtanin, kur e dinte se ai do të ishte përhapës i shumë cytjeve e humbjeve?

E dyta: Pasi shejtani e bëri këtë mëkat të madh, përse e pranoi All'llahu kërkesën e tij për shtyrjen e afatit dhe për vonimin e fundit të tij?

Pyetjes së parë i jemi përgjigjur në vëllimin e parë të komentimit tonë duke dhënë sqarimet e mëposhtme:

Së pari: Në fillim, krijimi i shejtanit ka qenë diçka e mirë, pa probleme dhe për këtë ka gëzuar pozitë në radhët e të afërmeve të All'llahut e në mesin e melekëve madhështorë, edhe pse nuk ishte nga lloji i tyre. Më pas, me sjelljen e keqe të tij, në lirinë e tij, ai ngriti tiraninë e rebelimin, kështu që u dëbua dhe u specifikua me emrin e shejtanit.

Së dyti: Prania e shejtanit nuk është e dëmshme për ndjekësit e rrugës së drejtë, madje konsiderohet si simbol i përsosjes së tyre, sepse prania e këtij armiku të fortë përballë njeriut e edukon dhe e përsos më tepër atë (njerun). Në thelb, çdo përsosje e përsosmëri vjen nga kundërshtitë dhe reagimet sekondare dhe asnjë qenie nuk ndjek rrugën e përsosjes, e përkryerjes dhe të udhëzimit të saj pa u përballur me një kundërshtar të fortë e me një rebelim armiqësor.

Pra, shejtani edhe pse me gjykimin e dëshirës së tij të lirë, është përgjegjës për veprat e tij të gabuara. Cytjet e tij nuk i dëmtojnë robërit e All'llahut, të cilët dëshirojnë të ndjekin rrugën e vërtetë; madje në mënyrë të tërthortë, ai është i dobishëm për ta.

Përgjigjja për pyetjen e dytë: Sqarohet nga sa thamë në përgjigjen e kundërshtimit të parë se prania e shejtanit si një çështje negative, e bën ekzistencën e tij të domosdoshme për forcimin e pikave pozitive dhe të mos jetë vetëm i dëmshëm por, gjithashtu, të jetë edhe ndikues pozitiv dhe i dobishëm. Pa marrë parasysh që ai është shejtani, në brendinë tonë gjejmë një grup prej instikteve të ndryshme. Duke qëndruar në anën tjetër të fuqive tona mendore dhe shpirtërore, formojnë mejdanin e fortë të kundërshtimit e të konfliktit. Në të tillë medjdan realizohet përparimi i njeriut dhe përsosja e tij, edukimi dhe udhëzimi i tij. Vazhdimësia e pranisë së shejtanit është për të forcuar faktorët e këtij kundërshtimi të dobishëm e frytdhënës.

Thënë ndryshe: Rruga e drejtë dallohet përherë duke parë nga rrugët e devijuara. Sikur mos të ishte kjo analogji e ky krahasim, atëherë nuk do të ishte i mundur dallimi i rrugës së drejtë nga rruga e devijuar.

Në disa hadithe lexojmë se shejtani pasi e bëri këtë mëkat, rrezikoi plotësisht lumturinë dhe shpëtimin e tij në një Botë Tjetër.

Për këtë ai i kërkoi All'llahut të Lartësuar që t'i japë jetë të gjatë në këtë botë në këmbim të adhurimeve të tij të bëra më parë. E drejtësia e All'llahut gjykoi me pranimin e kësaj kërkesë.

Pika tjetër e rëndësishme që meriton vëmendje, është se All'llahu i Lartësuar, ndonëse e la shejtanin të lirë që të kryejë cytjet e tij, Ai nuk e lënë njeriun të paaftë për të mbrojtur veten e tij nga cytjete e djallit, sepse:

Së pari, All'llahu i dhuroi njeriut forcën e mendjes, me të cilën mund t'i bëjë ballë e rezistencë të fortë cytjeve të shejtanit.

Së dyti, All'llahu e ka vendosur natyrën e pastër të njeriut (el fitratu) dhe dashurinë e përsosurisë në brendësi të njeriut si faktorë të rëndësishëm për arritjen e lumturisë.

Së treti, All'llahu dërgon melekët, të cilët frymëzojnë të mirat tek ata që dëshirojnë të jetojnë të sigurtë nga cytjet e shejtanit, ashtu siç thuhet në Kur'anin Fisnik: "**Me të vërtetë, atyre që thonë: 'Zoti ynë është Allahu', e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin melekët...**"¹ Melekët zbresin tek ata për forcimin e spiritualitetit të tyre duke u inspiruar atyre ngjyrat e ndryshme të përgëzimeve dhe qetësimeve.

Në një vend tjetër lexojmë: "(Kujto o Muhamed) **kur Zoti yt i frymëzoi engjëjt: 'Unë jam me ju, andaj forcojini ata që besojnë...**'"² dhe ata i forcuan këmbët e tyre në rrugën e së drejtës.

¹ Sure "Fussilet", ajeti 30.

² Sure "Enfal", ajeti 12.

2- Hipoteza e evolucionit të llojeve dhe krijimi i Ademit

A përputhet ajo që thotë Kur’ani Fisnik për krijimin e Ademit, me atë që thuhet në hipotezën e evolimit të llojeve në kërkimet shkencore?

Dhe realisht, a ka arritur hipoteza e evolimit dhe e plotësimit në fazën bindëse e të prerë nga këndvështrimi i shkencëtarëve, apo jo?

Të gjitha këto çështje kanë nevojë për studime të hollësishme, të cilat do t’i bëjmë në ajetet përkatëse, si për shembull në ajetet 26-33 të sures “El Hixhr”.

Ajetet 19 - 22

وَيَنَادِمُ أَسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَكُلَا مِنْ حَيْثُ شِئْتُمَا وَلَا
تَقْرَبَا هَذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿١٩﴾ فَوَسَّسَ لَهُمَا
الشَّيْطَانُ لِيُبْدِيَ لَهُمَا مَا وُورِيَ عَنْهُمَا مِنْ سَوْءَاتِهِمَا وَقَالَ مَا
نَهَاكُمَا رَبُّكُمَا عَنْ هَذِهِ الشَّجَرَةِ إِلَّا أَنْ تَكُونَا مَلَكَيْنِ أَوْ
تَكُونَا مِنَ الْخَالِدِينَ ﴿٢٠﴾ وَقَاسَمَهُمَا إِنِّي لَكُمَا لَمِنَ النَّاصِحِينَ
﴿٢١﴾ فَدَلَّهُمَا بِغُرُورٍ ۚ فَلَمَّا ذَاقَا الشَّجَرَةَ بَدَتْ لَهُمَا سَوْءَاتُهُمَا
وَوَطَّفَقَا يُخَفِّصَانِ عَلَيْهِمَا مِنْ وَرَقِ الْجَنَّةِ ۖ وَنَادَاهُمَا رَبُّهُمَا أَلَمْ
أَنْهَاكُمَا عَنْ تِلْكَ الشَّجَرَةِ وَأَقُلْتُ لَكُمَا إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمَا عَدُوٌّ

مُبِينٌ ﴿٢٢﴾

"Ndërsa Ademit i tha: 'O Adem! Bano ti dhe bashkëshortja jote në Xhennet dhe hani ç'të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni prej të padrejtëve!'"

"Djalli u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre dhe u tha: 'Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.'"

"Dhe iu betua atyre (duke thënë): 'Vërtet, Unë jam për ju këshillues i singërtë!'"

"Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhennetit dhe Zoti i tyre i thirri: 'A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?'"

Komentimi

Nxitjet djallëzore me pamje magjepsëse

Këto ajete paraqesin dhe sqarojnë një kapitull tjetër nga tregimi i Ademit. Në fillim thotë se All'llahu i Lartësuar e urdhëroi Ademin dhe bashkëshorten e tij që të banojnë në Xhennet: **"Ndërsa Ademit i tha: 'O Adem! Bano ti dhe bashkëshortja jote në Xhenet...'"**

Nga kjo thënie kuptohet se në fillim të krijimit Ademi dhe Havaja nuk kanë qenë në Xhennet, por në fillim ata u krijuan, e më pas u drejtuan për në Xhennet. Nga argumentet kuptohet, ashtu siç e kemi thënë edhe më parë në fundin e ajeteve që lidhen me tregimin e krijimit të Ademit në suren "El Bekare", se ky Xhennet nuk ishte Xhenneti i Ringjalljes, por siç është transmetuar në hadithet e Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!), ai ka qenë Xhenneti i kësaj bote. Pra, ai ka qenë një kopsht i bukur dhe i gjelbëruar nga

kopshtet e kësaj bote, të cilin All'llahu i Lartësuar e mbushi me të gjitha të mirat e begatitë.¹

Gjatë kësaj kohe doli obligimi i parë, urdhërimi dhe ndalimi për Ademin dhe për Havanë nga ana e All'llahut të Lartësuar, ku thuhet: **"...dhe hani ç'të dëshironi, por mos iu afroni kësaj peme, se bëheni prej të padrejtëve!"**. Pra, ngrënia e frutave nga të gjitha pemët e këtij Xhenneti është e lejuar për ju, me përjashtim të një peme të vetme, së cilës nuk duhet t'i afroheni, sepse përndryshe do të jeni nga të padrejtët.

Shejtani, i cili u dëbua nga mëshira e All'llahut për shkak se nuk iu përul Ademit dhe për shkak se vendosi të hakëmerrej ndaj atij dhe bijve të tij e t'i çonte ata në humbje, e dinte mirë se ngrënia e kësaj peme e nxirrte Ademin nga Xhenneti. Kështu, qëllimisht, ai e cyti Ademin dhe bashkëshorten e tij dhe thuri kurthe të llojllojshme në rrugën e tyre.

Në fillim, siç thotë edhe Kur'ani Fisnik, ai filloi me zhveshjen e rrobave të bindjes e të adhurimit ndaj All'llahut nga të dy dhe ua nxorri pjesët e turpshme, që i kishin të fshehura e të mbuluara: **"Djalli u pëshpëriti, për t'ua zbuluar pjesët e turpshme të mbuluara të trupit të tyre..."**

Për të arritur këtë qëllim, ai e kuptoi se rruga më e mirë ishte të shfrytëzonte dashurinë dhe dëshirën e njeriut për përsosje, për lartësim dhe për jetën e përvetshme. Me këtë t'i siguronte atyre një justifikim që të justifikohen e ta përdorin si mjet për shfajsimin e kundërshtimit të urdhrit të All'llahut nga ana e tyre: **"...dhe u tha..."** Ademit dhe bashkëshortes së tij: **"Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm."**

¹ Shih xhuzin e parë të këtij komentimi në fund të ajetit 35 të sures "Bekare".

Në këtë mënyrë, ai ua përfytyroi ndryshe atyre urdhrin e All'lahut, duke u thënë se ngrënia nga “pema e ndaluar”, jo vetëm që nuk ishte e dëmshme, por të dhuronte jetën e përhershme dhe gradat e melekëve.

Dëshmi e kësaj fjale është fraza që ka thënë Iblisi në suren “Ta Ha”, ajeti 120: **“...O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”**

Në një transmetim të përcjellë në komentimin e "El Kumij" nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në librin “Ujun Ahbar Er Rida” nga Imam Ali ibn Musa Er Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) thuhet: Iblisi u afrua dhe tha: *“Në të vërtetë, nëse ju të dy hani nga kjo pemë që jua ka ndaluar All'llahu, atëherë do të bëheni melekë, e do të qëndroni në Xhennet përherë. Dhe nëse nuk hani prej saj, All'llahu do t’ju nxjerrë prej tij.”*¹

Kur Ademi i dëgjoi këto fjalë, u zhyt në mendime. Por, me qëllim që ta kontrollonte prenë e tij e të thellonte edhe më tepër cytjen në shpirtin e Ademit e të Havasë, shejtani i përgjërohet me betim solemn, duke i argumentuar se ai dëshironte të mirën e tyre! **“Dhe iu betua atyre (duke thënë): ‘Vërtet, Unë jam për ju këshillues i singertë!’”**

Ademi nuk kishte eksperiencë të mjaftueshme për jetën. Ai nuk kishte rënë ende në kurthet e shejtanit dhe në dredhinë e tij, si dhe nuk dinte gjë për gënjeshtren dhe humbjen e tij para kësaj. Gjithashtu, ai nuk e kishte aftësinë që të vërtetonte se ky betim i fortë i shejtanit është gënjeshtër dhe se ai vendos pengesa në rrugën e tij.

Për këtë ai ra në kurthet e shejtanit dhe u mashtrua nga cytjet e tij. Në fund, ai ra në kurthin e mashtrimit të tij, në pusin e

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 11. "Ujun Akhbaru Rida", vëll.1, f. 196.

cytjeve të shejtanit për të fituar ujin e jetës së përhershme e të mbretërisë së pamposhtur. Por ai jo vetëm që nuk e fitoi ujin e jetës siç mendoi, por ra në telashin e kundërshtimit e të mosbindjes ndaj urdhrave të All'llahut. Këtë, Kur'ani e përmbledh me një frazë të shkurtër, ku thotë: **"Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij..."**¹

Ademi - duke marrë parasysh armiqësinë e mëparshme të shejtanit për të, duke e njohur urtësinë e All'llahut, mëshirën e Tij të gjerë, dashurinë dhe mirësinë e Tij - duhet t'i përballonte të gjitha cytjet e të mos dorëzohej para shejtanit. Mirëpo, ndodhi ajo që ndodhi.

Kur Ademi dhe Havaja e shijuan këtë pemë të ndaluar, prej tyre ranë rrobat dhe i'u zbuluan pjesët e të turpshme: **"...Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme..."**

Nga fraza e mësipërme mësohet se nga shijimi i frutit të pemës së ndaluar, ata thjesht u goditën me këtë ndëshkim të turpshëm dhe u zhveshën nga rrobat e Xhenetit, që janë rrobat e fisnikërisë hyjnore.

Nga ky ajet kuptohet qartë se përpara kryerjes së këtij kundërshtimi të urdhrit të All'llahut, ata nuk ishin lakuriq, por kanë qenë të mbuluar me rroba të cilat Kur'ani nuk e përmend të vërtetën e tyre.

Ndërkohë, Teurati i devijuar thotë se Ademi e Havaja kanë qenë plotësisht lakuriq në atë kohë, por ata të dy nuk e perceptonin të keqen e lakuriqësisë. Në momentin që e shijuan

¹ Fjala "del'la" rrjedh nga lënda "et tedlijetu" që ka kuptimin e dërgimit gradualisht të kovës në pus me litar. Në të vërtetë ky është një krahasimi i bukur figurativ dhe interesant se shejtani me anë të intrigave dhe mashtrimeve të tij e zbriti Ademin dhe bashkëshorten e tij nga vendi i tyre i lartë dhe i zbriti në pusin e problemeve dhe larg mëshirës së All'llahut.

dhe e hëngrën pemën e ndaluar, e cila ishte pema e diturisë dhe e njohurisë, atyre iu hapën sytë e mendjes dhe atëherë i panë pjesët e turpshme të tyre dhe u njohën me të keqen e kësaj gjendjeje.

Ademi që përshkruan Teurati nuk ka qenë në të vërtetë njeri, por ishte shumë larg diturisë e njohurisë deri në atë gradë saqë nuk i dinte as pjesët e turpshme të tij.

Por, Ademi që e përshkruan Kur'ani Fisnik jo vetëm që e njihte veten e tij, por qëndronte edhe mbi sekretet e zinxhirit (diturisë së emrave) dhe konsiderohej si mësuesi i melekëve. Ajo që u përpoq shejtani të hidhte në të, nuk ndodhi për shkak të paditurisë së Ademit, por për shkak se shejtani e shfrytëzoi dëlirësinë e qëllimit dhe mirësinë e tij.

Këtë gjë e dëshmon ajeti 27 i kësaj sureje, ku thuhet: **"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrresi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xhenneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme..."**

Ajo që kanë shkruar disa shkrimtarë myslimanë, se Ademi ka qenë lakuriq që në fillim, është e gabuar dhe vërteton atë që transmetohet në Teuratin e devijuar.

Sidoqoftë, Kur'ani thotë: Në të vërtetë, kur e panë veten e tyre të zhveshur lakuriq, Ademi dhe Havaja u mbuluan menjëherë me gjethet e Xhennetit: **"...dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit..."**

Në të njëjtën kohë, atyre u vjen një thirrje nga All'Ilahu që u thotë: A nuk ju paralajmërova juve për afrimin nga kjo pemë dhe ngrënien prej saj? A nuk ju thashë ju se me të vërtetë, shejtani është armiku juaj?! Pse e harruat urdhrin Tim dhe ratë në një fatkeqësi si kjo? **"...dhe Zoti i tyre i thirri: 'A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?'"**

Nga krahasimi midis frazës së këtij ajeti dhe ajetit të parë, në të cilin All'llahu e lejoi Ademin dhe Havanë që të banonin në Xhennet, kuptohet qartazi se pas këtij mëkati, ata u larguan nga pozita e afrimitetit me All'llahun aq shumë, saqë edhe pemët e Xhennetit u larguan prej tyre. Në ajetin e mëparshëm tregohet për pemën me përemrin tregues nga afër "*hadhihi shexheretu*", kësaj peme, ndërsa në këtë ajet në shtesë të fjalës "*nada*", e cila përdoret për të folur nga larg.

Hulumtime

Në këtë ajet ka disa çështje të rëndësishme të cilat do t'i trajtojmë në vijim:

1- Mënyra e cytjes së shejtanit

Nga fraza "e cyti atë", duke parë germën "*lam*" (e cila vjen zakonisht në gjuhën arabe për dobi), kuptohet se shejtani ka marrë cilësinë e këshilltarit e të dashurit për Ademin; ndërsa fraza "e cyti drejt tij", nuk e shpalos këtë kuptim, por nënkupton vetëm thjesht ndikimin dhe depërtimin e fshehtë në zemrën e dikujt.

Sidoqoftë, nuk duhet të mendojmë se cytjet djallëzore sado të forta të jenë, ia heqin të drejtën e zgjedhjes njeriut. Përkundrazi, njeriu mundet që me forcën e mendjes e të besimit, të qëndrojë përballë këtyre cytjeve e t'i sfidojë ato.

Thënë ndryshe: Cytjet djallëzore nuk e detyrojnë njeriun të mëkatojë, sepse forca e dëshirës dhe gjendja e zgjedhjes janë prezente edhe kur janë cytjet dhe sfidimi i tyre ka nevojë për më

shumë rezistencë e qëndresë e ndoshta deri dhe përballimin e dhimbjes e të torturës. Gjithashtu, cytjet djallëzore nuk zhveshin askënd nga përgjegjësia, siç e vërejmë këtë edhe tek Ademi. Për këtë, shohim se megjithëse ato faktorë e nxitën Ademin dhe e çuan atë që të kundërshtojë urdhërin e All'llahut dhe ndalimin e Tij, All'llahu i Lartësuar e konsideroi atë përgjegjës për veprën e tij dhe për këtë e ndëshkoi atë, siç do të sqarohet në vijim.

2- Çfarë ka qenë pema e ndaluar?

Pema e ndaluar është përmendur gjashtë herë në Kur'anin Fisnik, por pa u cilësuar as natyra, as forma, as emri e as fruti i saj. Në burimet islame janë përmendur dy komentime për të, njëri prej tyre "**material**" dhe që është "*el hantah*", gruri"¹ siç është e njohur në transmetime.

Duhet theksuar fakti se arabët e përdorin termin "*shexheretun*", pemë edhe për bimët. Për këtë arsye, në Kur'anin Fisnik, ky term përdoret për bimën e kungullit, ku All'llahu i Lartësuar thotë: "**Dhe bëmë që sipër tij të mbinte një bimë kungulli** (për t'i bërë hije)."²

Dhe komentimi tjetër është "**figurativ**". Siç thuhet edhe në transmetime, kjo pemë përshkruhet si "pema e zilisë, e smirës dhe e lakmisë", sepse, sipas transmetive, thuhet se pasi vështroi vendin dhe pozitën e tij, Ademi mendoi se nuk ekziston ndonjë pozitë tjetër mbi pozitën e tij dhe as vend tjetër mbi vendin e tij. Por, All'llahu i Lartësuar i paraqiti atij pozitën e një grupi nga

¹ Për t'u njohur më shumë me këto transmetime shih: Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 1, f. 59 dhe 60, vëll. 2, f. 11. Komentimin e ajeteve në suren "Bekare" dhe në suren "A'raf".

² Sure "Saffat", ajeti 146.

eulijatë prej pasardhësve dhe bijëve të tij (të Dërguarin e Islamit dhe *Ehli Bejtin* e tij), dhe tek ai ndodhi diçka e ngjashme me smirën dhe ishte kjo pemë e ndaluar për të cilën u urdhërua Ademi që t'i mos afrohej.

Sipas këtyre transmetimeve, Ademi hëngri nga dy pemë, njëra prej të cilave ishte më poshtë në pozitë e më e ulët në grada, duke e udhëhequr atë drejt botës materiale, që ishte "gruri"; ndërsa tjetra ishte pema figurative, e cila përfaqësonte pozitën e grupit të *eulijave* të All'Ilahut, që ishte më e lartë dhe më me emër nga pozita dhe grada e tij. Përderisa e kaloi kufirin e tij, ai u sprovua me këtë përfundim të dhimbshëm.

Meqë ajetet kur'anore mund të kenë kuptime të shumta, siç e kemi thënë edhe më parë, ky ajet mund t'i ketë të dyja kuptimet që u përmendën.

Me mirëkuptim është pranuar se fjala "pemë" përdoret në Kur'anin Fisnik me të dyja kuptimet. Kështu, ajo është përdorur një herë me kuptimin material të njohur për pemën, si: **"si dhe pemën që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë, atyre që e hanë."**¹, e cila tregon për pemën e ullirit, ndërsa një herë tjetër përdoret me kuptim figurativ, si: **"...ashtu si dhe pemën e mallkuar në Kuran..."**², me të cilën është qëllimi për një grup politeistësh, për jehudinjtë apo popuj të tjerë tiranë, si për shembull Beni Umeje.

Megjithëse komentuesit kanë dhënë mundësi të shumta rreth kuptimit të pemës së ndaluar, ajo që thamë është më i dukshëm e më i qartë.

¹ Sure "Mu'minun", ajeti 20.

² Sure "Isra", ajeti 60.

Në Teuratin e devijuar, për pemën e ndaluar, për atë që sot njihet nga të gjithë kristianët dhe jehudinjtë e botës si pema e diturisë, e njohjes dhe e jetës¹, thuhet: Me të vërtetë, Ademi nuk ishte i ditur dhe nuk kishte njohuri përpara se të hante nga pema e diturisë dhe e njohurisë. Ai nuk njihte dhe nuk dallonte as pjesët e turpshme të tij. Pasi hëngri nga kjo pemë dhe u bë njeri me plot kuptimin e fjalës, ai u dëbua nga Xhenneti nga frika se mos ha përsëri nga pema e jetës dhe bëhet i përjetshëm siç është rasti i zotave.

Ky është ndër argumentet e qarta që dëshmon se Teurati i sotëm në qarkullim nuk është libër qiellor, por është thurje e mendjes së shkurtër e të kufizuar njerëzore, i cili e konsideron diturinë dhe njohjen të turpshme dhe e të fliqur për njeriun dhe e konsideron Ademin, për shkak të kryerjes së mëkatit të marrjes së diturisë e njohurisë, se e meritonte dëbimin e tij nga Xhenneti i All'Ilahut. Duket sikur Xhenneti nuk ishte vendi i mendimtarëve që kuptojnë dhe as pozita e dijetarëve të njohur!!

Në librin e tij me titull "Çfarë është Kristianizmi?", Dr. William Myler, një ndër komentuesit më të shquar të Teuratis e të Ungjillit, thotë: *"Në të vërtetë, shejtani hyri në Xhennet në formën e një gjarpri dhe e bindi Havanë që të hante nga fruti i asaj peme. Më pas, Havaja ia dha këtë frut edhe Ademit. Vepra e dy prindërve tanë të parë nuk ka qenë vetëm gabim i thjeshtë apo i dalë nga mosmendimi, por ishte mëkat i qëllimshëm kundër Krijuesit. Thënë ndryshe: Me këtë veprë Ademi dhe Havaja donin të bëheshin zota. Ata nuk donin t'i bindeshin All'Ilahut por donin të punoni sipas dëshirës dhe qejfit të tyre personal. Cili ishte rezultati? Ata i qortoi ashpër All'Ilahu dhe i nxorri të dy nga Xhenneti që të jetojnë në botën e mbushur me torturë, dhimbje e fatkeqësi."*

¹ "Seferu Tekuinul Is'hahu thanij", paragrafi numër 17.

Komentuesi i Teuratit dhe i Ungjillit ka dashur të shfajësojë pemën e ndaluar të Teuratit, por ai i ka mveshur Ademit mëkate më të mëdha që janë kundërshtimi dhe luftimi i All'Ilahut. A nuk do ishte më mirë që – në vend të dhënies së këtyre komentimeve – të pohonte se këto libra që i quajnë të shentë janë të devijuar?!

3- A ka bërë mëkat Ademi?

Nga librat e shenjtë të jehudinëve dhe të krishterëve, përfitohet se ata besojnë se Ademi ka mëkatuar. Madje në librat e tyre lexon se mëkati i tij nuk ka qenë i zakonshëm por ka qenë mëkat dhe gjynah i madh dhe ajo që ai bëri ka qenë kundërshtim i All'Ilahut dhe lakmi për të qenë zot e sundues.

Mirëpo, burimet islame, qofshin logjike apo të transmetuara, thonë se Profetët nuk bëjnë as gjynahe e as mëkate dhe se misioni i udhëheqjes dhe i udhëzimit të njerëzve nuk i jepet atij që bën mëkate. Ne e dimë se Ademi ka qenë nga Profetët e All'Ilahut. Bazuar në këtë, çdo gjë që thuhet në këto ajete e në të tjera si këto, nga përshkrimet që kanë ardhur në Kur'an rreth Profetëve të ndryshëm, të cilëve ju atribuohen atyre mëkatet, të gjitha këto nënkuptojnë “mëkat relative” dhe “lënia e më të mirës” dhe nuk është mëkat absolut.

Për sqarim: Mëkati është dy llojesh: mëkat absolut dhe mëkat relativ.

Mëkati absolut është kundërshtimi i urdhërit të ndalimit absolut dhe injorimi i urdhrit të prerë të All'Ilahut. Ky përfshin çdo lloj prej llojeve të lënies së asaj që duhet vepruar dhe veprimi i asaj që është e ndaluar.

Ndërsa mëkati relativ është ai që kryhet nga një personalitet i madh, një vepër jo e ndaluar (haram), por që nuk përshtatet me të dhe as nuk ka lidhje me pozitën e tij; madje mund të jetë kryerja e një vepre të lejuar, ndoshta edhe e pëlqyer (*mustehab*), e që nuk i përshtatet personaliteteve të mëdha. Në këtë rast kryerja e kësaj vepre konsiderohet “mëkat relativ”, siç ndodh në rastin kur një besimtar i pasur ndihmon me një shumë qesharake një të varfër, për ta shpëtuar atë nga kthetrat e varfërisë. Nuk ka dyshim se kjo ndihmë, sado e vogël qoftë, nuk mund të jetë e ndaluar rreptësisht, madje ajo është një vepër e pëlqyer, por kushdo që dëgjon për këtë, e poshtëron të pasurin sikur ai të kishte bërë ndonjë gabim apo mëkat; kjo ndodh për shkak se nga ky i pasur besimtar pritej një ndihmë më e madhe.

Kështu, namazi i falur nga një individ i zakonshëm mund të konsiderohet si i shkëlqyer, por ai nuk konsiderohet i tillë nëse falet nga *eulijatë* (të dashurit, të afërmit) e All'llahut, sepse një çast i vetëm mosvëmendjeje gjatë adhurimit, nuk i përshtatet pozitës dhe gradës së tyre. Por, duke parë veprat e tyre, devotshmërinë e tyre, pozitën e tyre të afërt, duhet që në adhurimin e All'llahut të jenë të zhytur në cilësitë absolute të All'llahut e të nënshtruar plotësisht përballë madhësisë dhe prezencës së Tij.

E tillë është gjendja në të gjitha veprat e tyre të ngjashme me adhurimet e tyre. Ata duhet të krahasohen me pozitën dhe gradën e tyre. Nëse prej tyre veprohet “lënie e më të mirës”, All'llahu i qorton ata. Kuptimi me “lënien e më së mirës” është që njeriu të lejë një vepër që është më e mirë e të bëjë në një vepër të mirë ose të pëlqyer që është më poshtë se më e mira.

Në transmetimet islame mësojmë se ajo që e goditi Jakubin, pra prova e rëndë dhe përvoja e hidhur e ndarjes së djalit të tij, Jusufit, ndodhi për shkak të pavëmendjes së tij gjatë kohës kur po

ushqente një të varfër agjërues, i cili qëndronte tek porta e shtëpisë së tij në perëndim të diellit e kërkonte ushqim. Kështu, Jakubi u tregua i pavëmendshëm për ta ushqyer atë dhe ky i varfëri u kthye i uritur, i thyer dhe i lodhur.

Sikur kjo vepër të bëhej nga një njeri i zakonshëm nuk do të gëzonte këtë rëndësi dhe rrezik. Porse kryerja e kësaj vepre nga një i Dërguar i All'Ilahut, apo nga udhëheqësi i ymetit, konsiderohet si një çështje e rëndësishme dhe e rrezikshme, e cila pasohet me ndëshkim të ashpër nga ana e All'Ilahut të Lartësuar.¹

Në të vërtetë, ndalimi i Adem-it nga pema e ndaluar nuk ka qenë ndalim absolut, por lënie e më të mirës. Por duke parë pozitën e Adem-it dhe gradën e lartë të tij, kryerja e kësaj vepre konsiderohet çështje e rëndësishme dhe e rrezikshme. Kundërshtimi i këtij ndalimi e meriton dënimin dhe qortimin nga ana e All'Ilahut të Lartësuar.

Disa komentues mendojnë se ndalimi i Adem-it nga pema e ndaluar ka qenë "ndalim udhëzues". Sqarimi i kësaj është: All'Ilahu mund të ndalojë nga diçka duke u nisur nga të qenit e Tij Sundues i njeriut, Kujdestari dhe Urdhërues i tij. Bindja ndaj këtij lloji ndalimi është obligim për çdo njeri. Ky lloj ndalimi quhet ndalim i obliguar.

Por, ai mund ta ndalojë diçka thjesht për t'i tërhequr vëmendjen njeriut se bërja e këtij ndalimi përmban ndikim jo të mirë, siç është ndalimi i mjekut nga ushqimet e dëmshme. Nuk ka dyshim se në qoftëse i sëmuri e kundërshton mjekun, kjo nuk do të thotë se ai e ofendon mjekun dhe nuk e kundërshton atë si

¹ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 411, marrë nga libri "Ilelu Sheraiu", vëll. 2, f. 45.

mjek, por me mosnjohjen e ndalimit të mjekut s'ka njohur udhëzimin e tij duke i shkaktuar vetes së tij lodhje e plogështi.

Gjithashtu, në tregimin e Ademit All'llahu i Lartësuar i thotë atij: Rezultati i ngrënies nga pema e ndaluar është dalja nga Xhenneti dhe rënia në mundim e lodhje. Ky ka qenë thjesht udhëzim e jo urdhërim, kështu që me këtë Ademi ka kundërshtuar vetëm një ndalim udhëzues, jo se ai bëri një gabim e mëkat real.

Por komentimi i parë është më i saktë, sepse ndalimi udhëzues nuk ka nevojë për falje, ndërkohë që Ademi, siç do të lexojmë në ajetet e mëpasshme, i kërkon falje All'llahut. Periudha e qëndrimit në Xhennet është konsideruar periudhë ushtrimore e mësimore për Ademin. Ka qenë periudha e njohjes me ngarkimet, me detyrat dhe urdhërat e All'llahut; periudha e njohjes së mikut nga armiku; periudha e qëndrimit në pritje të rezultateve të kundërshtimit dhe në pritje të frytit nga kundërshtimi i urdhërit të All'llahut dhe të ndjekjes së shejtanit... Ne e dimë se ndalimi udhëzues në realitet nuk përmban premtim dhe as nuk trashëgon përgjegjësi.

Në fund të këtij studimi, i kujtojmë lexuesit se në pamje të parë, fjalët: “ndalim”, “gabim”, “falje” dhe “padrejtësi” duket sikur japin kuptimin e gabimit absolut, të mëkatit të vërtetë dhe gjurmëve të tij, por duke marrë në konsideratë pagabueshmërinë e Profetëve, e cila është konstante me tekst e me logjikë, atëherë të gjitha këto fraza nëkuptojnë "mëkat relativ". Kjo çështje nuk është e largët, nga ana e jashtme e termit, duke parë pozitën madhështore të Ademit dhe lartësinë e postit të tij.

Ajetet 23 - 25

قَالَا رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ
الْخَاسِرِينَ ﴿٢٣﴾ قَالَ أَهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ وَلَكُمْ فِي
الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ ﴿٢٤﴾ قَالَ فِيهَا تَحْيَوْنَ وَفِيهَا
تَمُوتُونَ وَمِنْهَا تُخْرَجُونَ ﴿٢٥﴾

"Ata të dy thanë: O Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetave tona, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi prej të humburve."

"Ai (All'llahu) tha: 'Zbritni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar.'"

"Aty do të jetoni, aty do të vdisni dhe prej saj do të ringjalleni."

Komentimi

Kthimi i Ademit tek All'llahu dhe pendimi i tij

Kur Ademi dhe Havaja u njohën me kurthin e Iblijsit, planin e tij dhe dinakërinë e tij djallëzore dhe panë rezultatin e

kundërshtimit të tyre, menduan të ndreqin atë që kaloi. Hapi i parë që ata të dy ndërmorën ishte pohimi përpara All'llahut i padrejtësisë që i bënë vetave të tyre: **"Ata të dy thanë: O Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetave tona, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi prej të humburve."** Hapi i parë në rrugën e pendimit dhe kthimit tek All'llahu për ndreqjen e të këqijave, është që njeriu të heqë dorë nga mendjemadhësia dhe arroganca e të pranojë gabimin e tij.

Të tërheq vëmendjen fakti se Ademi dhe Havaja tregojnë një edukatë të lartë ndaj All'llahut, në pendimin dhe kërkesën e tyre për falje prej Tij. Kështu, ata nuk thanë: *"Zoti ynë, na fal"*, por thanë: **"...nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi prej të humburve."**

Nuk ka dyshim se kundërshtimi i rregullave, dispozitave dhe ndalesave të All'llahut, është padrejtësi që njeriu i bën vetes së tij, sepse të gjitha programet dhe urdhërat e All'llahut synojnë të mirën e njeriut dhe marrin përsipër sigurimin e lumturisë dhe të progresit të tij. Duke u bazuar mbi këtë, çdo kundërshtim nga ana e njeriut është kundërshtim ndaj integritetit të tij dhe shkak i prapambetjes së tij. Ademi dhe Havaja, edhe pse nuk bënë gabim e mëkat, por moszbatimi i më të mirës, i zbriti ata të dy nga pozita e tyre e lartë.

Sigurisht, pendimi i singurtë i Ademit dhe Havasë edhe pse u pranua nga ana e All'llahut të Lartësuar, siç e lexojmë këtë në ajetin 37 të sures "Bekare **"Ai ia pranoi pendimin"**, mirëpo ata nuk mundën në asnjë mënyrë që t'i jepnin fund ndikimit dhe rezultatit natyror të veprës së tyre, kështu që u urdhëruan të largohen nga Xhenneti, dhe ky urdhër, gjithashtu, përfshiu edhe shejtanin: **"Ai (All'llahu) tha: 'Zbritni! Ju do të jeni armiq me**

njëri-tjetrin. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar."

Siç është përmendur nga të gjithë komentuesit, në tokë ata do të përballen me vdekjen, më pas do dalin nga toka edhe një herë tjetër për të dhënë llogari: **"Ai (All'Ilahu) tha: 'Zbritni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar.'"**

Mesa duket, atyre që u drejtohet fjala në këtë ajet janë Ademi, Havaja dhe Iblisi. All'Ilahu I Lartësuar thotë: **"Ai (All'Ilahu) tha: 'Zbritni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin...'"**. Por ka mundësi që në ajetin pasardhës, fjala të jetë vetëm për Ademin dhe Havanë, sepse ata të dy do të nxirren nga toka.

Hulumtime

Tregimi i Ademit dhe e ardhmja e kësaj bote

Disa komentues, të cilët u ndikuan nga disa ide perendimore ateiste, u përpoqën që të shtonin tek historia e Ademit dhe Havasë nga fillimi i saj e deri në fund, ngjashmërinë, anën figurative e metaforike, ose siç e quajnë sot "mënyra simbolike", duke i mbartur të gjithë terma që lidhen me këtë histori – në kundërshtim me aparencën – në figuratizëm e në abstraksion.

Por, ajo në të cilën s'ka dyshim, është se këto ajete na rrëfejnë një ngjarje të vërtetë, që u ndodhi babait dhe nënës sonë të parë: Ademit dhe Havasë. Përderisa kjo histori nuk përfshin asnjë pikë që nuk pranon komentim, sipas pamjes së jashtme, si dhe nuk gjendet në të prej tyre që kundërshtojnë kriteret logjike, (që të

jetë argument për ta konsideruar kuptim figurativ), për këtë, nuk kemi asnjë argument që të kundërshtojmë aparencën e ajeteve.

Por, kjo histori mund të mbartë tregues të jetës së llojit njerëzor në të ardhmen e kësaj bote. Që do të thotë se njeriu, i përbërë nga forca “e mendjes” dhe nga “epshe të shfrenuara” ku secila prej tyre e tërheq atë në një drejtim, përballet në këtë jetë të zhurmshme me thirrës gënjeshtarë e me konkurrentë të këqinj si shejtani, të cilët përpiqen t’ia mbulojnë mendjen me qëllim mashtrimin e tij, humbjen e tij e lënien e tij konfuz në labirinthe të jetës në kërkim të vegimit.

Rezultati i parë i dorëzimit të njeriut përballë cytjeve është rrënimi i murit të devotshmërisë, zhdukja e saj dhe zbulimi i pjesëve të turpshme.

Rezultati i dytë është largimi i njeriut nga afrimiteti me All'llahun, rënia e tij nga pozita njerëzore fisnike dhe nxjerrja nga Xhenneti i sigurtë dhe i qetë.

Në këtë rast mundet që forca e mendjes, gjithashtu, ta ndihmojë njeriun e ta përkrahë atë për t’u zgjuar e të mendojë menjëherë për ndreqjen e së kaluarës dhe ta nxisë që të kthehet tek All'llahu në mënyrë që të pohojë me guxim e pastërti mëkatet e tij me një pohim konstruktiv, të dobishëm në jetën e tij.

Në këtë kohë, atij i shtrihet edhe një herë tjetër dora e mëshirës së All'llahut, duke e shpëtuar atë nga rënia e përhershme, edhe nëse nuk mundet që t’i japë fund ndikimeve të gjynaheve të tij dhe rezultateve të tyre të natyrshme, sado të paktë e të kufizuar qofshin ato gjynahe. Por kjo ngjarje do të jetë për të një mësim dhe eksperiencë dhe do ta mundësojë atë që të marrë nga ky dështim një rregull bazë e të qëndrueshëm për triumfin e tij në të ardhmen e jetës, duke përfituar nga ky dëm një dobi të madhe për etapat e ardhshme të jetës së tij.

Ajetet 26 - 28

يٰبَنِي ٓءَادَمَ قَدْ اُنْزِلْنَا عَلَيْكُمْ لِبَاسًا يُورِي سَوَءَاتِكُمْ وَرِثًا ^ط
 وَلِبَاسُ التَّقْوٰى ذٰلِكَ خَيْرٌ ^ج ذٰلِكَ مِّنْ ءَايٰتِ اللّٰهِ لَعَلَّهُمْ
 يَذَّكَّرُوْنَ ﴿٢٦﴾ يٰبَنِي ٓءَادَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطٰنُ كَمَا اَخْرَجَ
 اٰبَوَيْكُمْ مِّنَ الْجَنَّةِ يَنْزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوَءَاتِهِمَا ^ط اِنَّهُ
 يَرٰكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِّنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ ^ط اِنَّا جَعَلْنَا الشَّيْطٰنَ
 اَوْلِيَاءَ لِلَّذِيْنَ لَا يُؤْمِنُوْنَ ﴿٢٧﴾ وَاِذَا فَعَلُوْا فَحِشَةً قَالُوْا وَجَدْنَا
 عَلٰیهَا ءَاۡبَاءَنَا وَاللّٰهُ اَمَرْنَا بِهَا ^ط قُلْ اِنَّ اللّٰهَ لَا يَأْمُرُ بِالْفَحْشَآءِ ^ط
 اَتَقُوْلُوْنَ عَلٰی اللّٰهِ مَا لَا تَعْلَمُوْنَ ﴿٢٨﴾

"O bijtë e Ademit, Ne ju kemi zbritur ju rroba që të mbuloni vendet e turpshme, si edhe për zbukurim; por, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë nga argumentet e All'lahut, ashtu që ata të përkujtojnë "

"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kursesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xhenneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme!' Ai dhe shpura e tij ju sheh,

prej nga ju nuk i shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë."

"Kur ata bëjnë një vepër të shëmtuar, thonë: 'Ne i kemi gjetur prindërit tanë që i bënin, por edhe All'Ilahu na ka urdhëruar kështu'. Thuaj: 'All'Ilahu nuk urdhëron të bëhen vepra të pahijshme! Përse thoni për All'Ilahun atë që nuk e dini?'"

Komentimi

Paralajmërim për të gjithë bijtë e Ademit

Në të vërtetë, historia e Ademit dhe problemi i tij me shejtanin, ashtu siç e përmendëm në fund të ajeteve të mëparshme, shfaq pamjen reale të jetës së të gjithë njerëzve në tokë. Për këtë, në këto ajete dhe në ato që vijnë më pas, All'Ilahu i Lartësuar vendos një sërë dispozitash e programesh të vyera për të gjithë bijtë e Ademit, që konsiderohen si vazhdimësi e programeve të Ademit në Xhennet.

Në fillim, All'Ilahu na tregon për veshjen dhe mbulimin e pjesëve të turpshme të trupit, të cilat kanë patur një rol të rëndësishëm në historinë e Ademit: **"O bijtë e Ademit, Ne ju kemi zbritur ju rroba që të mbulonin vendet e turpshme..."**

Por dobia e rrobave që ju kemi dërguar, nuk kufizohet vetëm te mbulimi i trupit dhe fshehja e pjesëve të turpshme, por ato shërbejnë edhe si zbukurim, duke i bërë trupat tuaj edhe më të bukur.

Në rrënjën e saj, fjala **"riyshun"** - **pendë** - është ajo që mbulon trupat e shpendëve. Përderisa pendët e shpendëve janë

rrobat natyrore të trupave të tyre, kjo fjalë përdoret edhe për rrobat. Në të shumtën e rasteve, penda e shpendit ka ngjyra të ndryshme e të bukura. Kjo është edhe arsyeja që kjo fjalë përfshin konceptin e zbukurimit e të bukurës. Për më tepër, fjala “pendë” përdoret edhe për copën që hidhet mbi shalën e kalit ose të devesë.

Disa komentues dhe njohës të gjuhës (arabe) kanë thënë se ky term ka kuptim më të gjerë. Ai përdoret edhe për llojet e orendive dhe të nevojave të tjera materiale për të cilat kanë nevojë njerëzit. Megjithatë, më afër kuptimit të këtij ajeti janë veshjet e bukura dhe rrobat e zbukurimit.

Pas kësaj fjalie, e cila flet për rrobat e dukshme e të jashtme, Kur'ani flet për kufirin e rrobave morale që kanë lidhje me sjelljet e tij që përfshijnë anët, materiale dhe shpirtërore, të jashtme dhe të brendshme, ku thotë: **“...por, petku i devotshmërisë është më i miri...”**

Ngjasimi devotshmërisë me petkun është një ngjasim shumë domethënës, sepse ashtu siç e mbron rroba trupin nga i nxehti dhe i ftohti, mbron trupin nga shumë rreziqe, mbulon të metat që gjenden në trup, dhe, për më tepër ajo është zbukuruese për njeriun dhe burim i bukurisë, po ashtu edhe shpirti i devotshmërisë e mbron atë nga shumë rreziqe individuale e shoqërore. Ai konsiderohet një zbukurim i madh për njeriun, që të tërheq vëmendjen, që ia lartëson personalitetin, duke i dhuruar atij bukuri e lavdi.

Ndër komentuesit ka mendime të ndryshme në lidhje me përcaktimin e kuptimit të petkut të devotshmërisë se çfarë është ai. Disa e kanë komentuar me “veprën e mirë”, disa me “turpin”, disa me “petku i adhurimit”, disa me “petku i luftës” si prazmoria

dhe helmeta¹, sepse termi devotshmëri është marrë nga termi "uikaje" që do të thotë: mbojtje e ruajtje. Me këtë kuptim ka ardhur po ashtu në Kur'anin Fisnik, siç e lexojmë në ajetin 81 të sures "En Nahl": **"...ka bërë për ju rroba që t'ju mbrojnë nga nxehtësia; ka bërë për ju veshje prej metali për t'ju mbrojtur në luftë..."**

Por, ashtu siç e kemi thënë edhe herë të tjera, në të shumtën e rasteve ajetet kur'anore kanë kuptime të gjera, dhe vërtetësi e pohime të shumta e ndryshme. Edhe në ajetin në fjalë, gjithashtu, mund të përftohen të gjitha këto kuptime.

Përderisa rroba e devotshmërisë në këtë ajet është përballë me rrobën e mbulimit të trupit, kjo është arsyeja se kuptimi i saj është "shpirti i devotshmërisë", e cila e mbron njeriun dhe shpalos edhe kuptimin e "turpit", "të veprës së mirë" e të ngjashme me këto.

Më pas, në mbyllje të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Këto janë nga argumentet e All'llahut, ashtu që ata të përkujtojnë"**; pra këto rroba që bëri All'llahu për ju, pavarësisht nëse janë rroba materiale apo shpirtërore, rroba të trupit apo të devotshmërisë, që të gjitha janë argumente të All'llahut, në mënyrë që njerëzit t'i përkujtojnë begatitë e Zotit të Lartësuar.

Zbritja e rrobave!

Në ajete të shumta të Kur'anit Fisnik vëmë re se All'llahu i Lartësuar thotë për rrobat **"kemi zbritur"** që ka kuptimin e dërgimit nga një vend i lartë në një vend të ulët. Ajeti thotë: **"Ne ju kemi zbritur juve rroba"**, ndërkohë që dihet se rrobat

¹ "Biharul Anuar", vëll. 34, f. 66 dhe 67. "Usulul Kafij", vëll. 5, f. 4.

përftohen ose nga leshi, ose nga lëndët bimore e të ngjashme me to.

Në ajetin 6 të sures “Ez Zumer” lexojmë: **“Dhe kemi zbritur për ju nga bagëtitë tetë çifte”**, ndërsa në suren “El Hadid”, ajeti 25, lexojmë: **“Dhe e kemi zbritur hekurin.”** Çfarë kuptimi kanë këto ajete?

Shumë komentues në komentimin e këtyre ajeteve, këmbëngulin te zbritja vendore, pra nga lart poshtë. Për shembull, ata thonë: Uji i shiut zbret nga qielli në tokë e kështu që nga ai pijne bimët dhe kafshët. Nga këtu del se lëndët e rrobave kanë zbritur – me këtë kuptim – nga qielli në tokë.

Në aspektin e hekurit thonë: Gurët dhe shkëmbinjtë madhështorë qiellor, të cilët përmbajnë elemente hekuri, janë tërhequr drejt tokës.

Përderisa begatitë e All'llahut vijnë nga një pozitë e lartë hyjnore tek njerëzit, për këtë arsye është përshkruar ky koncept me këtë term dhe ky është një përshkrim që e përcepton njeriu pa problem e pa vështirësi.

Rrobat në të kaluarën dhe në të tashmen

Siç e dëshmon edhe historia, njeriu vazhdon akoma që nga e kaluara të veshë rroba, por ato kanë ndryshuar dhe janë bërë shumë të larmishme me kalimin e kohës. Më parë, rrobat visheshin në të shumtën e rasteve për arsye të mbrojtjes së trupit nga i nxehti dhe nga i ftohti dhe për zbukurim e bukuri. Aspekti mbrojtës vinte në një gradë të mëpasshme. Por nën hijen e përparimit teknologjik e prodhues në kohën e sotme, aspekti mbrojtës është në vend të parë për nga rëndësia në shumë fusha.

Kështu, astronautët, zjarrfikësit, punëtorët e metaleve, zhytësit e shumë të tjerë, përdorin rroba të veçanta për t'u mbrojtur nga rrezique të ndryshme.

Mjetet e prodhimit të veshjeve në epokën tonë janë zhvilluar së tepërmi dhe nuk mund të krahasohen me të shkuarën. Në vëllimin e tetë të tefsirit "El Menar", kur komentohet ajeti në fjalë, thuhet: "Industria e prodhimit të rrobave ka arritur në nivele të larta. Në një rast, mbreti i fundit gjerman hyri në një fabrikë veshjesh për të parë cilësinë e prodhimit. Gjatë kohës që ai ishte i pranishëm aty, punonjësit e fabrikës prenë leshin e disa bagëtime dhe kur mbreti e mbaroi inspektimin e tij, para se të largohej ata i dhuruan një pallto që ta kishte si kujtim, duke i thënë se ajo ishte bërë me leshin e prerë në fillim të hyrjes së tij në fabrikë. Ata e pastruan leshin në makineritë pastruese, i bënë tjerren me makineritë tjerrese, e thurën me makineritë thurëse, e prenë dhe e qepën atë brenda kësaj periudhe të shkurtër. Pra, brenda një ose dy orëve, leshi kaloi nga kurrizi i deles në atë të mbretit."¹

Por – për fat të keq – janë shtuar edhe aspektet anësore negative, madje jo të pëlqyera e të turpshme për veshjet e rrobat deri në atë gradë saqë po humbet dita-ditës edhe filozofia bazë e rrobave.

Sot, rrobat janë bërë mjet i llojeve të ndryshme demonstrative, i përhapjes së shthurjes, i nxitjes së epsheve, shpenzimeve e teprimeve, e të ngjashmeve me to. Kjo ka arritur deri në atë masë saqë ne mund të shohim veshje që veshin grupe njerëzish – e veçanërisht të rinjtë perëndimor – ku natyra e marrëzisë është mbi natyrën logjike. Ato mund të jenë çdo gjë por rroba e veshje nuk janë.

¹ Tefsiri "Menar", vëll. 8, f. 359.

Ajo që kanë zbuluar studimet rreth kësaj dukurie është se kompleksiteti psikik luan një rol të rëndësishëm në veshjet e këtyre rrobave të çuditshme e të habitshme. Individët të cilët nuk mund të bëjnë një vepër të rëndësishme për përforcimin e pranisë së tyre në shoqëri, strehohen tek përpjekja për të veshur rroba të çuditshme e të pakëndshme për të vërtetuar praninë e tyre. Për këtë vëmë re se personalitetet e respektuara, ose ata të cilët nuk vuajnë nga kompleksiteti psikik nuk e dëshirojnë veshjen e këtyre rrobave.

Sot shpenzohen dhe shpërdorohen shuma marramendese dhe pasuri madhështore në tregëtinë e veshjeve të llojllojshme dhe të modave të ndryshme. Nëse do të ndalonte ky lloj shpërdorimi, atëherë do të mundësohej zgjidhja e problemeve shoqërore e do të gjendej shërimi për shumë plagë të shtresave të lëna në mëshirë të fatit e të grupeve të varfra në shoqëritë njerëzore.

Nga historia e jetës së të Dërguarit të All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të prijësve të tjerë të mëdhenj, jepen shembujt të shumtë, ku tregohet se ata e kanë kundërshtuar me forcë mburrjen me veshjet dhe teprimin në zbukurimin me to. Në njërin nga këto transmetime përcillet se një herë, një delegacion nga kristianët erdhi tek i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medine. Ata kishin veshur rroba shumë të bukura mëndafshi, të cilat arabët nuk i kishin parë deri atë ditë. Pasi u prezantuan te Profeti dhe e përshëndetën atë, pritën që ai t'u fliste. Po ai nuk u tha asnjë fjalë dhe u largua. Duke dashur të dinë për shkakun e largimit të Profetit, ata pyetën Aliun. Ai u tha: *"Hiqini këto rroba e këto unaza e shkoni prapë tek ai!"*

Të krishterët bënë siç u tha Imami e më pas hynë te Profeti (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). E përshëndetën dhe ai ua ktheu përshëndetjen e bisedoi me ta. Pastaj, Profeti tha: *"Pasha Atë që më ka dërguar mua me të drejtën! Herën e parë që më erdhën, bashkë me ta ishte edhe Iblisi."*

Në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar i paralajmëron të gjithë trashëgimtarët e Ademit nga kurthi e intriga e shejtanit, e u thotë të ruhen prej tij, sepse ai e shfaq hapur armiqësinë e tij ndaj babait të tyre, Ademit, kështu që ashtu siç i zhveshi prej tij rrobat e Xhennetit me cytjet e tij, mund t'ua zhveshë edhe atyre rrobat e devotshmërisë. Për këtë, All'llahu i Lartësuar thotë: **"O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga Xhenneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur vendet e turpshme..."**

Ajo çka e lidh ajetin e mëparshëm me ajetin që është objekt studimi, është se i pari flet për rrobat e dukshme dhe shpirtërore të njeriut (rrobat e devotshmërisë), ndërsa i dyti përfshin paralajmërimin dhe thirrjen për mbikëqyrjen e shejtanit, duke ua tërhequr vëmendjen që ai të mos ua zhveshë atyre rrobën e devotshmërisë.

E jashtëmja e frazës: **"le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli"** është ndalimi i shejtanit nga kjo vepër. Por të tilla fraza konsiderohen nënkuptime interesante për ndalimin e atij njeriu që i flet. Kjo është e ngjashme kur i flasim një miku që e duam duke i thënë: Nuk është e drejtë të godasë ty filani, pra mbikqyre atë në mënyrë që të mos përballesh me goditjen dhe dëmin e tij. Më pas, All'llahu i Lartësuar siguron se shejtani dhe ndihmësit e tij ndryshojnë nga armiqte e tjerë: **"Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i shihni ata..."**, kështu që duhet të jeni shumë vigjilentë ndaj një armiku të tillë.

Në të vërtetë, në momentin kur ti mendon se je vetëm, ka mundësi që ai të jetë me ty, prandaj është detyra jote që të kesh kujdes nga ky armik i fshehur, sulmet e të cilit nuk mund të dihen. Për këtë arsye, ne duhet të marrim masa të përhershme mbrojtëse ndaj tij.

Në fund të ajetit, All'illahu i Lartësuar vjen me një fjali që në fakt është përgjigje e një pyetjeje të rëndësishme. Dikush mund të pyesë: Si i dha pushtet All'illahu i Drejtë dhe i Mëshirshëm, një armiku me këtë forcë kundër njeriut? Ai është një armik ku fuqia e tij nuk mund të krahasohet me fuqinë e njeriut. Është një armik që shkon kudo pa i ndjerë askush lëvizjet e tij. Madje, siç ka ardhur në disa transmetime, lëviz tek njeriu ashtu siç lëviz gjaku në damarët e tij. A përputhet kjo me drejtësinë e All'illahut të Lartësuar?!¹

Në fund të ajetit jepet kjo përgjigje: **"...Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë."**

Pra, shejtanëve nuk u lejohet të depërtojnë e të veprojnë në zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve, të cilët nuk janë të gatshëm ta pranojnë shejtanin e të bashkëpunojnë me të.

Thënë ndryshe, hapat e para drejt shejtanit i merr vetë njeriu; vetë ai e lejon shejtanin të hyjë në mbretërinë e trupit të tij. Kështu, shejtani nuk mund të shkëlqejë në kufijtë e shpirtit e t'i përshkojë ato, vetëm nëse njeriu pajtohet vetë me këtë gjendje. Nëse njeriu ia mbyll shejtanit dritaret e zemrës së tij, atëherë ky i fundit nuk do të ketë forcë për të vepruar.

Këtë të vërtetë e dëshmojnë edhe ajete të tjera kur'anore. Kështu, në suren "En Nahl", ajeti 100, lexojmë: **"Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë**

¹ "Usulul Kafij", vëll. 2, f. 440, hadithi 1. Tefsiri "Ajashij", vëll. 1, f. 276 dhe 309.

veç All'llahut." Kështu, ata që e duan shejtanin, që dorëzohen tek ai dhe e adhurojnë atë, përballen me pushtetin dhe cytjet e tij. Në ajetin 42 të sures "El Hixhr" lexojmë: **"Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty..."**

Me fjalë të tjera: Është e vërtetë që ne nuk i shohim shejtanët dhe ushtrinë e tij, por ne mund të shohim gjurmët e tyre. Në çdo tubim mëkatar, në ç'do vend ku janë përgatitur mjetet e mëkateve, në çdo vend ku ndodhen stolitë e kësaj bote dhe sharmi i saj, tek tirania e epsheve, tek ndezja e prushit të zemërimit, është prezenca e shejtanit në mënyrë të padiskutueshme. Në këto vende duket sikur njeriu zërin e cytjes së shejtanit e dëgjon me veshët e zemrës së tij, dhe i shikon gjurmët e tij me sytë e tij.

Në lidhje me këtë çështje, është transmetuar një hadith nga Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili thotë: "Në momentin që Nuhu (*Paqja e All'llahut qoftë mbi të!*) iu lut Zotit të Lartësuar për popullin e tij, i erdhi Iblisi, All'llahu e mallkoftë, dhe i tha: O Nuh, ti tek mua ke një dorë! Dua që të shpërblej me të.

Nuhu i tha: Vërtet, është e urryer për mua që ti të kesh një dorë tek unë, por çfarë është ajo?

I tha: Po, sigurisht, ti e lute All'llahun për popullin tënd dhe i përmyte ata. Nuk ka mbetur njeri që ta mashtroj. Unë jam i qetë deri sa të vijë shekulli tjetër dhe t'i mashtroj ata.

I tha Nuhu: Çfarë është ajo që do të më shpërblesh mua me të?

Ai tha: "Më përmend në tre gjendje, sepse unë jam shumë afër robit nëse ai është në njërën prej tyre: kur zemërohes, kur gjykon ndërmjet dy personave dhe kur je me një grua e s'ka një të tretë me ju."¹

¹ "Biharul Anuar", vëll. 11, f. 318.

Ajo që duhet patur parasysh këtu është se një grup komentuesish kanë thënë se njeriu nuk mund ta shohë kurrësi shejtanin, ndërkohë që nga disa transmetime të tjera tregohet se kjo gjë është e mundur në disa raste.¹

Por me sa duket se këto dy drejtime nuk janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, sepse rregulli bazë është se ai nuk shihet. Por, edhe për këtë rregull – ashtu si të tjerët – ka përjashtime.

Në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar na tregon për një nga cytjet e rëndësishme të shejtanit, e cila qarkullon edhe në gjuhët e disa njerëzve shejtanë. Këtu bëhet fjalë për rastin kur njeriut i kërkohet argumentim për kryerjen e veprës së keqe dhe ai përgjigjet duke thënë: Kjo është ajo që vepruan edhe prindërit tanë: **"Kur ata bëjnë një vepër të shëmtuar, thonë: 'Ne i kemi gjetur prindërit tanë që i bënë...'"** Pastaj, këtij argumenti i shtojnë një tjetër argument të rremë: **"...por edhe All'llahu na ka urdhëruar kështu..."**

Me të vërtetë, imitimi i verbër i prindërve si dhe shpifja ndaj All'llahut, janë dy justifikime të ndryshme dhe dy argumente të kundërta pas të cilave, në të shumtën e rasteve, kapen mëkatërrët e djallëzuar për justifikimin e veprave të tyre të këqija.

Të tërheq vëmendjen fakti se Kur'an i Fisnik nuk e merr në konsideratë argumentin e parë (pra imitimin e verbër të prindërve e të parëve) e nuk i jep rëndësi atij dhe nuk u jep përgjigje për këtë, sepse mendja e shëndoshë e kupton kotësinë e tij, e për më tepër ai i është përgjigjur kësaj tematike në shumë vende në Kur'anin Fisnik. Prandaj, është mjaftuar të përgjigjet për argumentin e dytë, ose më saktë (justifikimit të dytë) ku thotë:

¹ "Biharul Anuar", vëll. 11, f. 111.

"...Thuaj: "All'llahu nuk urdhëron të bëhen vepra të pahijshme..."

Sipas sqarimeve të ajeteve kur'anore, urdhri për të shëmtuarën është vepër e shejtanit dhe jo e All'llahut, sepse All'llahu i Lartësuar nuk urdhëron veçse më të bukurën e të mirën.¹ Më pas, ajeti mbyllet me këtë frazë: **"...Përse thoni për All'llahun atë që nuk e dini?"**

Më e përshtatshme do ishte që të thoshte: *Përse i mvishni All'llahut atë që është gënjeshtër?* Por, në vend të kësaj, All'llahu i Lartësuar ka thënë: *Përse thoni atë që nuk dini për All'llahun?*

Në të vërtetë, kjo është bazuar në kufirin më të vogël të pranimit të palës tjetër ku thuhet: Nëse nuk jeni të sigurtë për gënjeshtren e kësaj thënieje, të paktën ju nuk keni në dorë asnjë argument për ta vërtetuar atë. Atëherë, përse e akuzoni All'llahun duke thënë për Atë ato që nuk i dini?!

Çfarë synohet me "të shëmtuarën"?

Cili është qëllimi i të shëmtuarës këtu? Një grup i madh komentuesish kanë thënë se ajo është tregues për një imitim që bëhej nga arabët në epokën e injorancës, që ishte rrotullimi rreth Qabesë lakuriq, "burra dhe gra", duke menduar se me rrobat që kanë bërë mëkate nuk duhej të rrotulloheshin rreth Qabesë së Shenjtë.

Në transmetime të shumta thuhet se qëllimi i të shëmtuarës këtu, është për udhëheqësit e shthurur, të cilët i ftojnë njerëzit drejt vetes së tyre, duke pretenduar se All'llahu ua ka obliguar njerëzve bindjen ndaj tyre.

¹ Sure "Bekare", ajetet 268 dhe 269.

Disa komentues, për shembull në tefsirin “El Menar” dhe “El Mijzan”, e kanë interpretuar këtë ajet në një kuptim më të gjerë, duke thënë se e shëmtuara përfshin çdo vepër të keqe e të shëmtuar. Duke vënë re gjerësinë e kuptimit të termit shthurje, është më e përshtatshme të thuhet se ajeti ka një kuptim të gjerë si kuptimi i gjerë i fjalës. Çështja e “rrotullimit rreth Qabesë lakuriq” dhe “ndjekja e udhëheqësve dhe parisë së padrejtë” konsiderohen vërtetuese të qarta për këtë kuptim dhe nuk ka kundërshtime ndërmjet dy grupeve të transmetimeve.

Ne kemi dhënë një sqarim të mjaftueshëm rreth dorëzimit absolut ndaj traditave të të parëve dhe zakoneve të tyre në komentimin e ajetit 170 të sures "El Bekare".

Ajetet 29 - 30

قُلْ أَمَرَ رَبِّي بِالْقِسْطِ ^ط وَأَقِيمُوا وُجُوهَكُمْ عِندَ كُلِّ مَسْجِدٍ
وَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ ^ع كَمَا بَدَأَكُمْ تَعُودُونَ ﴿٢٩﴾ فَرِيقًا
هَدَىٰ وَفَرِيقًا حَقَّ عَلَيْهِمُ الضَّلَالَةُ ^ق إِنَّهُمْ أَتَّخَذُوا الشَّيَاطِينَ أَوْلِيَاءَ
مِنْ دُونِ اللَّهِ وَيَحْسَبُونَ أَنَّهُمْ مُّهْتَدُونَ ﴿٣٠﴾

"Thuaj: 'Zoti im urdhëron drejtësi. Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami e lutjuni Atij sinqerisht, me besim të pastër e të vërtetë! Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t'ju ringjallë'."

"Disa Ai i ka udhëzuar në rrugë të drejtë, kurse disa të tjerë e kanë merituar humbjen. Ata kanë zgjedhur djajtë për mbrojtës në vend të All'Ilahut dhe mendojnë se janë në rrugë të drejtë."

Komentimi

Në ajetin e mëparshëm, diskutimi u soll rreth "*el fahshau*", e cila përfshin kuptimin e çdo lloj vepre të shëmtuar. Aty u përforcua se All'Ilahu nuk urdhëron absolutisht për vepra të shëmtuara. Në ajetin në fjalë, me një fjali të shkurtër, tregohet për bazat dhe parimet e mësimave të All'Ilahut në fushën e detyrave dhe obligimeve praktike e që pasohet më pas me sqarimin e

parimet e besimit, pra, fillimi i krijimit dhe Ringjallja në mënyrë të shkurtër e të përmbledhur.

Në fillim thuhet: O Profet: **“Thuaj: ‘Zoti im urdhëron drejtësi...”**

Ne e dimë se drejtësia ka kuptim të gjerë, i cili përfshin të gjitha veprat e mira, sepse realiteti i drejtësisë është përdorimi i çdo gjëje në vendin e tij dhe vendosja e gjithçkaje në vendin e vet.

Në gjuhën arabe mes fjalë “el adlu” dhe fjalës “el kistu”, që të dyja në shqip vijnë me kuptimin e drejtësisë, ka dallim. Kur përmendet fjala “el adlu”, qëllimi me të është dhënia e së drejtës atij që e meriton. E kundërta e kësaj fjale është “edh dhulmu”, padrejtësia, që ka kuptimin e mosdhënies së të drejtës atij që i takon. Kurse, kur përmendet fjala “el kistu” do të thotë që të mos i japësh të drejtën e një personi dikujt tjetër.

Por kuptimi i gjerë i këtyre dy fjalëve, të cilat mund të përdoren edhe të ndara, pothuajse është i njëjtë. Ato kanë kuptimin e vënies së drejtësisë dhe të ekuilibrit në çdo gjë e në çdo vepër, e për më tepër vendosjen e çdo gjëje në vendin e vet.

Më pas, All'llahu i Lartësuar urdhëron në besimin e një Zoti të Vetëm dhe luftimin e çdo ngjyre të politeizmit, duke thënë: **“...Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami..”,** pra, drejtojini zemrat tuaja drejt All'llahut Një, që s'ka tjetër si Ai, **“...e lutjuni Atij singerisht, me besim të pastër e të vërtetë...”**

Pas përmendjes, së njësimit në fund përmend Ringjalljen dhe thotë: **“...Siç ju ka krijuar së pari, ashtu do t'ju ringjallë.”**

Dy hulumtime

Në vijim do të ndalemi në trajtimin e dy çështjeve të rëndësishme:

1- Ç'kuptim ka fraza: "Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami.."?

Në lidhje me frazën e ajetit: "...Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami..", disa komentues kanë thënë se qëllimi këtu është drejtimi nga Qabeja.

Disa komentues të tjerë kanë thënë se me këtë frazë është për qëllim pjesëmarrja gjatë namazeve ditore që kryhen në xhamia.

Një grup i tretë komentuesish mendojnë se qëllimi me këtë frazë mund të jetë prania e zemrës dhe qëllimi i sinqertë gjatë adhurimit.

Megjithatë, komentimi që përmendëm më lart, pra drejtimi nga All'Ilahu dhe lufta ndaj të gjitha ngjyrave të politeizmit e ndaj atyre që i luten tjetërkujt përveç All'Ilahut, duket se është më i saktë sesa të tjerët, ndonëse as komentimet e tjera nuk janë larg kuptimit të ajetit.

2- Argumentet më të shkurtra për Ringjalljen

Janë bërë shumë kërtime për çështjen e Ringjalljes. Përftohet nga ajetet e Kur'anit Fisnik se kjo çështjeje ka qenë e vështirë për shumë njerëz në kohët e mëparshme. Madje ka arritur deri në atë gradë saqë nganjëherë këtë çështje e kanë marrë si argument për mosqenien e saktë thirrja e tyre. Jo vetëm kaq, këtë e konsideronin (All'Ilahu na ruajtë) edhe si argument të çmendurisë

së Profetëve duke thënë: **"A po trillon gënjeshtër për All'Ilahun apo është i çmendur?"**¹

Ajo për të cilën ata janë çuditur më së shumti, është çështja e kthimit trupor, sepse nuk besonin që pas shndërrimit të tyre në dhë e në grimca të shpërndara gjithandej, trupat do të formoheshin sërish, atomet e shpërndara në tokë, në det e në ajër, do të mbledheshin prapë e njeriu do të ringjallej edhe një herë tjetër.

Këtij supozimi të gabuar, Kur'ani Fisnik i është përgjigjur në ajete të shumta. Ajeti në fjalë është shembulli më i qartë e më i bukur për këtë, ku thuhet: Shikoni në fillimin e krijimit, shikoni tek trupi juaj, i cili përbëhet nga një sasi e madhe uji e sasi më të pakta të lëndëve minerale e të ngjashmeve me to. Ku kanë qenë ato më parë? Çdo pikë e ujit që gjendet në trupin tuaj është marrë nga një oqean prej oqeanëve të tokës. Më pas, ai avulloi e u shndërrua në re e pastaj zbriti në formën e pikave të shiut mbi tokë. Edhe grimcat që u përdorën në endjen e trupit tuaj nga lëndët e tokës së ngurtë, kanë qenë dikur në formën e farës së grurit apo frytit të pemës, apo jeshillëqe të ndryshme të grumbulluara nga pjesë të ndryshme të tokës.

Duke u bazuar në shpjegimin e mësipërm, nuk ka vend për t'u habitur e për t'u mahnitur kur dëgjojmë se pas shpërbërjes së trupit të njeriut dhe kthimit të tij në gjendjen fillestare, këto atome bashkohen për së dyti, duke u lidhur e duke formuar trupin e parë. Nëse një gjë e tillë duket si e pamundur, atëherë pse ndodhi në fillim të krijimit?!

¹ Sure "Sebe'", ajeti 8.

Kështu: "Ashtu siç ju krijoi juve All'llahu" "do ktheheni"; pra ju ringjall juve në Jetën Tjetër, dhe kjo është tema që përfshin fraza e shkurtër.

Në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar përshkruan reagimet që kanë shfaqur njerëzit ndaj kësaj thirrjeje (thirrja për Njësism, mirësi e Ringjallje), duke thënë: **"Disa Ai i ka udhëzuar në rrugë të drejtë, kurse disa të tjerë e kanë merituar humbjen..."**

Në mënyrë që të mos përfytyrojnë dikush se All'llahu udhëzon një grup e devijon një grup tjetër pa shkak, ajeti vijon: **"...Ata kanë zgjedhur dajhtë për mbrojtës në vend të Allahut..."**; pra të humburit janë ata që zgjedhën shejtanët si pronarë të tyre në vend që të hynin nën mbrojtjen dhe kujdestarinë e All'llahut, kështu që humbën.

Është e çuditshme se, pavarësisht se çfarë u ndodhi, duke rënë në humbje e devijim, ata prapë kujtonin se ishin të udhëzuarit e vërtetë: **"...dhe mendojnë se janë në rrugë të drejtë."**

Ky rast është specifik për ata që janë të zhytur në tirani e në mëkate. Zhytja e tyre në shkatërrim, humbje, devijim e paganizëm ishte aq e thellë, saqë shqisa dalluese e tyre u kthye së prapthi; kështu, ata e konsideruan të keqen si të mirë dhe shtrembërimet si udhëzime. Në këtë mënyrë, atyre iu mbyllën portat e udhëzimit dhe kjo është ajo që gjetën e përfatuan për veten e tyre.

Ajetet 31 - 32

﴿يَبْنِيْٓ اٰدَمَ خُذُوْا زِيْنَتَكُمْ عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ وَكُلُوْا وَاشْرَبُوْا
 وَلَا تُسْرِفُوْا ۚ اِنَّهٗ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِيْنَ ۝ۙ﴾ قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِيْنَةَ اللّٰهِ
 الَّتِي اُخْرِجَ لِعِبَادِهٖۙ وَالطَّيِّبَتِۙ مِنَ الرِّزْقِ ۚ قُلْ هِيَ لِلَّذِيْنَ ءَامَنُوْا
 فِي الْحَيٰوةِ الدُّنْيَا خَالِصَةٌ يَوْمَ الْقِيَمَةِ ۚ كَذٰلِكَ نُفَصِّلُ الْآيٰتِ
 لِقَوْمٍ يَعْلَمُوْنَ ﴿٣٢﴾

"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."

"Thuaj: 'Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?' Thuaj: 'Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në Botën Tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.'"

Komentimi

Në këto dy ajete, biseda përputhet me tregimin e Ademit në Xhennet. Gjithashtu, në to flitet për veshjen dhe për dhuratat e tjera të jetës si dhe për mënyrën e duhur të përfitimit prej tyre.

Në fillim, All'llahu i urdhëron të gjithë bijtë e Ademit me një ligj të përgjithshëm e të përhershëm, i cili vlen për të gjitha kohët. Ai u thotë që të vishen me rroba të bukura kur të shkojnë në xhami: **"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni..."**

Kjo fjali mund të jetë tregues për çdo "bukuri trupore", e cila përfshin veshjen e rrobave të pastra e të bukura, krehjen e flokëve, përdorimin i parfumeve e të aromatikëve. Fjalja e mësipërme mund të ketë për qëllim edhe çdo "zbukurim shpirtëror", pra cilësitë njerëzore dhe virtytet morale, besnikërinë, pastërtinë dhe singëritetin.

Nëse shohim se disa transmetime islame tregojnë vetëm për rrobat e mira dhe krehjen e flokëve, apo nëse shohim se disa transmetime të tjera flasin vetëm për rastet e faljeve të bajramevev dhe namazit të xhumasë, kjo nuk vërteton kufizimin, por qëllimi është sqarimi i vërtetësive të tyre të qarta.¹

Po ashtu, nëse shohim një grup tjetër nga transmetimet të cilat e komentojnë zbukurimin me udhëheqësit punëmirë², e gjitha kjo tregon për kuptimin e gjerë të ajetit, i cili përfshin zbukurimet e jashtme e të brendshme.

Kjo dispozitë, megjithëse ka lidhje me të gjithë bijtë e Ademit në ç'do kohë e vend, mirëpo ai përmban qortimin e veprës së keqe që bënë një grup beduinësh në kohën e injorancës kur hynin në Xhaminë e Shenjtë dhe bënë tavaf rreth Qabes së madhërishtme, të cilët bënë tavaf rreth saj lakuriq pa i mbuluar pjesët e turpshme të tyre. Po ashtu, përmban, gjithashtu, këshillë për ata të cilët veshin rroba të pista, të grisura, apo me rroba

¹ Për t'u njohur më shumë me këto transmetime shih tefsirin "El Burhan", vëll. 2, f. 9 dhe 10; Tefsirin "'Nuruth Thekalejn'", vëll. 2, f. 18 dhe 19.

² I njëjti burim.

shtëpie kur shkojnë për të falur namaz. Fatkeqësisht, këtë gjendje e shohim edhe sot në mesin e disa të paditurve prej myslimanëve, ndërkohë që ne, sipas ajetit në fjalë e haditheve të transmetuara për këtë temë, jemi të ngarkuar që të vishemi me rrobat dhe veshjet më të mira kur të shkojmë në xhami.

Më tej, All'llahu i Lartësuar tregon për dhunti të tjera, domethënë për ushqimet e pijet e pastra, duke thënë: **"...Hani e pini..."**

Por përderisa njeriu, sipas natyrës së tij njerëzore, është lakmues, mund t'i keqpërdorë këto dy mësimet. Dhe, në vend që të përfitojë nga rrobat dhe ushqimet e shëndetshme në mënyrë të dobishme, ai ndjek rrugën e shpenzimit e të shpërdorimit. Për këtë, All'llahu i Lartësuar ka shtuar menjëherë fjalët: **"...por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."**

Fjala *"israf"*, përmbledh çdo shpërdorim në sasi e në cilësi. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret edhe për veprat e kota e të dëmshme, apo të ngjashme me to. Kjo është metodika e veçantë e Kur'anit, i cili kur nxit për të përfituar nga dhuntitë e jetës e të natyrës, paralajmëron menjëherë keqpërdorimin e atyre dhuntive dhe këshillon për kujdesje ndaj ekuilibrit.

Në ajetin pasardhës, me një ton më të ashpër, u jepet përgjigje atyre që pretendojnë se ndalimi i llojeve të stolive e të zbukurimit, shmangja nga ushqimet e mira e të lejuara është shenjë e asketizmit dhe shkak për afrimin tek All'llahu. Ajeti thotë: O i Dërguar: **"...Thuaj: 'Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?...'"**

Nëse këto gjëra do të ishin të këqija, atëherë All'llahu i Lartësuar nuk do t'i kishte krijuar. All'llahu i krijoi, që me to të kënaqen robtë e Tij. Pra, si mundet t'i ndalojnë ata?

Më pas, ajeti vijon me fjalët përforcuese: **“Thuaj: ‘Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në Botën Tjetër do të jenë vetëm për besimtarët...”** Pra, këto begati e dhunti u krijuan për besimtarët në këtë jetë, edhe pse ka edhe të tjerë që përfitojnë prej tyre, pavarësisht se ata nuk e meritojnë këtë. Por në Ditën e Ringjalljes, në një jetë më të lartë e më të mirë, ku ndahet e keqja nga e mira, këto dhunti e begati do të vendosen vetëm nën kontrollin e drejtimin e besimtarëve të singertë e do të jenë absolutisht të ndaluara për të tjerët.

Duke u bazuar në këtë arsyetim, ajo që është për besimtarët në këtë botë dhe në tjetrën dhe e veçantë për ta në Botën tjetër, si mund t’u ndalohet atyre? Në të vërtetë, e ndaluara është ajo që sjell shkatërrim dhe jo ajo që sjell begati e dhunti.

Ka mundësi, gjithashtu, në komentimin e kësaj fraze të thuhet: Këto dhunti, edhe pse janë në këtë botë të përziera me dhimbje, fatkeqësi e sprova, mirëpo në Jetën Tjetër ato u jepen besimtarëve duke qenë të pastra nga të gjitha këto përzierje. Por komentimi i parë duket se është më i saktë.

Për përforcim, në fund të ajetit All'llahu thotë: **“...Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.”**

Dy hulumtime

1- Stolisja dhe zbukurimi në këndvështrimin islam

Islami, si çdo gjë tjetër, ka zgjedhur një limit të mesëm e të ekuilibruar në aspektin e përfitimit prej llojeve të stolive. Jo siç supozojnë disa se kënaqësia dhe përfitimi nga stolitë dhe zbukurimi – sado që të jenë të ekuilibruara – ato janë në

kundërshtim me asketizmin. Po ashtu, jo siç e shohin shpërdoruesit përdorimin e stolive dhe zbukurimit, të cilët ua lejojnë vetave të tyre kryerjen e çdo veprë për të arritur qëllimin e tyre të ulët.

Po të marrim në konsideratë strukturimin e trupit dhe të shpirtit, do të shohim se udhëzimet islame në këtë kontekst përputhen plotësisht me veçoritë e shpirtit, me ndërtimin e trupit njerëzor, me kërkesat dhe me nevojat e tij personale.

Sipas psikologëve, dashuria ndaj së bukurës është një nga katër dimensionet e shpirtit njerëzor, e cila, në shtesë të instiktit të dashurisë për të mirën, të instiktit të dashurisë për njohjen dhe të instiktit të besimit, ajo përbën dimensione bazë të qenies njerëzore. Psikologët besojnë se të gjitha dukuritë e bukura edukative e ndjesore, produktet e bukura, arti me kuptimin real të tij, të gjitha këto janë rezultat i këtij instikti dhe kësaj ndjenjeje.

Megjithë këtë, si mundet që një ligj i saktë ta bëjë qëllimisht mbytjen e kësaj ndjenjeje burimore e të rrënjosur në thellësitë e shpirtit njerëzor, e të hiqet sikur nuk i di pengesat e këqija në rast mosngopjeje në mënyrën e duhur të kësaj ndjenjeje?

Për këtë, Islami nuk është mjaftuar vetëm me lejimin e të kënaqurit me bukuritë e natyrës, me përfitimin nga veshjet e bukura e të përshtatshme dhe me përdorimin e të gjitha llojeve të parfumeve, por ai porositi dhe nxit për to. Rreth kësaj çështjeje janë transmetuar hadithe të shumta nga dijetarët e fesë në burime e libra të besueshëm.

Për shembull, në historinë e jetës së imam Hasan Muxhtebasë, lexojmë se kur çohet për të fal namazin, ai vishte rrobat më të mira. Kur u pyet se pse vepronte ashtu, ai u përgjigj:

*"All'llahu është i bukur dhe e do të bukurën. Kështu, unë zbukurohem për Zotin tim, i Cili thotë: Vini stolitë tuaja në çdo xhami (namaz)."*¹

Në një transmetim tjetër thuhet se në një rast, një nga asketët me emrin Ubbad ibn Kethijr El Basrij, e pa imam Sadikun që kishte veshur rroba të shtrenjta e të kushtueshme dhe iu drejtua atij me këto fjalë: *"O Ebu Abdullah, me të vërtetë ti je nga Ehli Bejti i Profetit e babai jot ishte asket. Ç'janë këto rroba të bukura që ke veshur?"* Ebu Abdullahu ia ktheu: *"Mjerë ti, o Ubbad! Kush është ai, që e ka ndaluar stolinë që All'llahu ka lejuar për robtë e Tij e të mirat nga furnizimet?!"*² E të tjera hadithe.

Vërtet, thënia se All'llahu është i bukur dhe e do të bukurën dhe Ai është burimi i bukurisë tregon për këtë të vërtetë se: Përfitimi nga të gjitha llojet e stolive e bukurive sikur të ishte i ndaluar, All'llahu nuk do t'i kishte krijuar këto stoli. Krijimi i gjërave të bukura në botën ekzistuese, është argument që tregon se Krijuesi i tyre e do të bukurën.

Por, e rëndësishme këtu është se njerëzit – shpeshherë – në të tilla raste si këto ndjekin rrugën e shpërdorimit e ekzagjerimit duke shpenzuar tej mase bazuar në argumente e justifikime të ndryshme.

Për këtë, Kur'ani Fisnik menjëherë pas përmendjes së dispozitës islame – siç thamë më përpara – i paralajmëron myslimanët nga shpenzimet e shpërdorimet e tepërta në veshje e në zbukurim. Në më shumë se njëzet vende në Kur'anin Fisnik flitet për çështjen e shpërdorimit, duke e dënuar atë me forcë. (Në lidhje me këtë temë kemi folur gjerësisht në komentimin e ajeteve të tilla.)

¹ "Uesailu Shija", vëll. 3, kapitulli: rregullat e veshjes; Tefsiri "Ajashij", vëll. 2, f. 14.

² I njëjti Burim

Mbi të gjitha, metodika e Kur'anit Fisnik dhe e Islamit në këtë kontekst, karakterizohet nga ekuilibri dhe ballanca. Në atë metodikë nuk ka ngurtësim që të shtypë dëshirën njerëzore të vendosur në shpirtin e njeriut për të bukurën. As nuk e përkrah rrugën e ndjekur nga shpërdoruesit e të shfrenuarit që përdorin në rrugën e kënaqësisë, stolisë e zbubukurimit.

Madje, ai e ndalon stolisjen e zbukurimin mesatar në shoqëritë të cilat jetojnë në varfëri e skamje.

2- Këshillë e rëndësishme shëndetësore

Edhe pse në pamje të parë duket e thjeshtë, fraza “**...Hani e pini, por mos e teproni...**”, e cila ka ardhur në ajetin që është objekt studimi, sot është vërtetuar të jetë një ndër çështjet më të rëndësishme shëndetësore. Kërkimet shkencore të bëra nga shumë shkencëtarë, kanë dalë në përfundimin se burimi i shumë sëmundjeve e dhimbjeve është ushqimi i tepërt që mbetet në trupin e njeriut. Këto ushqime të tepërta janë një rëndesë për zemrën dhe për aparatin e tretjes. Nga ana tjetër ato janë një burim i gatshëm për infeksionet dhe sëmundjet. Për këtë, hapi i parë për shërimin e shumë sëmundjeve është djegia e këtyre ushqimeve të tepërta të cilat në realitet përbëjnë mbetjet e trupit dhe duhet bërë pastrimi praktik i trupit prej tyre.

Faktori bazë i pranisë së këtyre lëndëve shtesë është shpërdorimi e teprimi në të ushqyer. Rruga më e mirë për t'i vënë ato nën kontroll është të ushqyerit e ekuilibruar, veçanërisht në kohën e sotme në të cilën janë shtuar shumë sëmundje të ndryshme si diabeti, trombozat, infraktet, e të ngjashme me këto sëmundje, për të cilat tepria në ushqyerje e shoqëruar me mos

lëvizje trupore në sasi të mjaftueshme, konsiderohet një nga faktorët bazë të këtyre sëmundjeve. Nuk ka rrugë për largimin dhe shmangjen e këtyre sëmundjeve përveçse lëvizjeve trupore të mjaftueshme dhe balancimi në ushqim e në pije.

Në librin e tij *"Mexhmaul Bejjan"*, komentuesi i njohur "Et Tabrasij", gjendet një tregim i mrekullueshëm që lidhet me çështjen në fjalë. Thuhet se Harun Rrashidi ka patur një mjek kristian shumë të aftë. Një ditë prej ditësh i thotë Ali ibn El Husejn ibn Uakid: Në librin tuaj nuk ka asgjë për shkencën e mjekësinë. Shkenca është në dy lloje: Shkenca e religjioneve dhe shkencat e trupave.

Ndërkohë, Aliu i përgjigjet: *All'llahu e ka përmbledhur të gjithë mjekësinë vetëm në një gjysëm ajeti në Librin e Tij, ku thotë: "...Hani e pini, por mos e teproni..."* Gjithashtu, edhe i Dërguari i All'llahut (*Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka përfshirë mjekësinë në thënien e tij: *"Stomaku është shtëpia e çdo sëmundjeje dhe dieta (regjimi) është kreu i çdo ilaçi. Jepja çdo trupi atë me të cilën është mësuar."* Pasi i dëgjoji këto fjalë, mjeku i tha: Libri juaj dhe Profeti juaj nuk ka lënë mjekësi për Galenusin.¹

Ai që mendon se kjo këshillë është sipërfaqësore, le ta zbatojë atë në jetën e tij dhe do ta shohë dobinë e madhe që do t'i sjellë ajo në shëndetin e trupit të vet.

¹ "Biharul Anuar", vëll. 62, f. 123; Tefsir "Kurtubij", vëll. 7, f. 192.

Ajeti 33

قُلْ إِنَّمَا حَرَّمَ رَبِّيَ الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ وَالْإِثْمَ
وَالْبَغْيَ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَأَنْ تُشْرِكُوا بِاللَّهِ مَا لَمْ يُنْزَلْ بِهِ سُلْطَانًا
وَأَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَعْمُونَ ﴿٣٣﴾

"Thuaj: 'Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t'i shoqërohet All'llahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për All'llahun atë që nuk e dini."

Komentimi

Ndalesat e All'llahut

Kemi parë shpesh se sa herë që Kur'ani flet për një çështje të lejuar ose të domosdoshme, ai përmend menjëherë të kundërtën e saj nga çështjet e këqija ose të ndaluara, në mënyrë që secila çështje të plotësojë tjetrën.

Edhe këtu, në kontekstin e lejimit të kënaqësisë e përfitimit nga dhuntitë e All'llahut si dhe lejimit të çdo stolie e të bukure,

flitet gjithashtu për të ndaluarat në mënyrë të përgjithshme. Më pas përmenden në veçanti disa pika të rëndësishme.

Në fillim flitet për ndalimin e gjërave të turpshme: **“Thuaj: ‘Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta...”**

Fjala *“feuahish”*, është shumësi i *“el fahishetu”*, dhe ka kuptimin e veprave shumë të këqija dhe jo të gjitha mëkatet. Ndoshta përforcimi për tematikën e të këqijave (të hapta qofshin apo të fshehura), është se arabët në kohën para Islamit nuk e quanin të keqe e të shëmtuar veprën e kurvërisë nëse kryhej në fshehtësi dhe e ndalonin atë nëse bëhej haptazi.

Më pas All'llahu e përgjithëson temën duke treguar për të gjitha mëkatet dhe tha: **“...dhe gjynahet...”** pra ç' do mëkat.

Në thelb, mëkat quhet çdo vepër e dëmshme, çdo gjë që e degradon pozitën e njeriut dhe e ul shkallën e tij, që e pengon dhe që e ndalon atë nga arritja e bamirësisë dhe e shpërblimit të mirë.

Por, disa komentues kanë thënë se mëkati këtu është vetëm për “alkoolin” dhe e argumentuan këtë thënie të tyre me poezinë e njohur.

E kam pirë mëkatin derisa më humbi mendja ime. Kështu vepron mëkatit tek mendjet.¹

Është e dukshme se ky kuptim nuk është plotësisht kuptimi i fjalës por është një prej të vërtetave të tij.

¹ Tefsiri "Tibjan", vëll.4, f. 390. Fundi i ajetit në fjalë. "Tuxhul Arus", vëll. 8, f. 179, lënda "ithmun"

Edhe njëherë tjetër, në mënyrë të veçantë, ajeti tregon për disa prej mëkateve të mëdhaja duke thënë: **"...dhunimin pa të drejtë..."** pra çdo lloj prej llojeve të padrejtësisë dhe të shkeljes së të drejtave të tjerëve.

Fjala *"el bagiju"*, ka kuptimin e përpjekjes për arritjen e diçkaje. Por shpeshherë, kjo fjalë përdoret për përpjekjet e shpenzuara në marrjen e të drejtave të të tjerëve. Kjo është arsyeja ku në të shumtën e rasteve, kuptimi i saj është i njëjtë me kuptimin *"e padrejtësisë"*.

Është e qartë se përshkrimi i *"el bagiju"* në këtë ajet me përshkrimin e *"padrejtësisë"* është për të sqaruar e përforcuar kuptimin e kësaj fjale.

Më pas, All'illahu i Lartësuar flet për çështjen e politeizmit dhe thotë: **"...t'i shoqërohet All'illahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte..."**

Është e qartë se fjalia **"...për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte..."** është për përforsim dhe për të tërhequr vëmendjen drejt të vërtetës se politeistët nuk posedojnë asnjë argument logjik apo fakt të arsyeshëm. Fjala *"Sulltan"* nënkupton çdo argument e fakt që e çon një njeri të sundojë e të triumfojë ndaj kundërshtarit të tij.

Nga të ndaluarat e fundit që përmend ajeti është atribuimi i diçkaje All'illahut pa u mbështetur në dituri e njohuri: **"...dhe të thoni për All'illahun atë që nuk e dini."**

Thënien “duke thënë për All'llahun atë nuk dini” e kemi trajtuar në komentimin e ajetit 28 të po kësaj sureje.

Në ajetet e Kur'anit dhe në hadithet islame është folur shumë mbi këtë çështje, duke i ndaluar myslimanët nga thënia e gjërave që nuk i dinë. Për këtë çështje, në një hadith të të Dërguarit të All'llahut, thuhet: *“Atë që jep një mendim me padituri, e mallkojnë melekët e qiellit e të tokës.”*¹

Po t'i studiojmë me vëmendje situatat e shoqërive njerëzore, fatkeqësitë dhe vuajtjet e tyre, do të shohim se arsyeja kryesore e një gjendjeje të tillë janë thashethemet, të thënit e gjërave pa dije, dëshmitë e rreme dhe krijimi i këndvështrimeve pa fakte e argumente.

¹ "Ujun Akhbaru Rida", vëll. 2, f. 46. "Uesailu Shija", vëll. 27. f. 190.

Ajeti 34

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ أَجَلٌ ۖ فَإِذَا جَاءَ أَجْلُهُمْ لَا يَسْتَأْخِرُونَ سَاعَةً ۖ وَلَا

يَسْتَقْدِمُونَ

"Çdo popull ka afatin e vet. Kur t'i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë."

Komentimi

Për çdo komb ka një afat

Në këtë ajet, All'Ilahu i Lartësuar tregon për një nga ligjet e universit e të jetës, pra për shkatërrimin e kombeve dhe për fundin e tyre. Gjithashtu, këtu hidhet më shumë dritë për jetën e njerëzve mbi sipërfaqen e tokës e për fundin e gabimtarëve, për të cilin kemi folur në ajetet e mëparshme.

Në fillim të ajetit thuhet: **"Çdo popull ka afatin e vet..."**

Më pas, ajeti tregon se ky afat as nuk shpejtohet dhe as nuk vonohet: **"...Kur t'i vijë koha e fundit, ata nuk mund ta shtyjnë, qoftë edhe për një çast dhe as nuk mund ta shpejtojnë."**

Pra, kombet dhe popujt janë si individët. Për ata ka vdekje dhe jetë; ata e jetojnë kohën e vet mbi sipërfaqen e tokës e më pas vendin e tyre e zënë kombe të tjera. Vdekja dhe ligji i shkatërrimit nuk janë të veçantë vetëm për njeriun, por përfshijnë gjithashtu

edhe shoqëritë, popujt dhe kombet, me një dallim që në të shumtën e rasteve, vdekja e popujve dhe e kombeve ndodh për shkak të devijimit të tyre nga rruga e drejtë dhe e drejtësisë, për shkak të pajtimit me padrejtësinë e dhunën, të zhytjes në epshe dhe të teprimit në stoli e luks.

Kur kombet e botës i ndjekin këto rrugë dhe devijojnë nga ligjet e universit e të krijimit, ata i humbasin burimet e tyre njëri pas tjetrit dhe shkojnë drejt fundit.

Në të vërtetë, studimi i shuarjes së qytetërimeve të mëdha, si për shembull ai i Babilonasve, i faraonëve të Egjiptit, popullit të Sebes, Kildanëve, Ashurëve, myslimanëve të Andaluzisë e të ngjashmëve me ta, tregon faktin se atëherë kur jepet urdhri për shuarjen e një qytetërimi, qeveria e tij nuk mundet t'i mbrojë as edhe një orë të vetme themelet e saj të lëkundura.

Këtu, fjala “*es sa’atu*”, ka kuptimin e njësisë më të vogël kohore. Kështu, ka mundësi që ajo të ketë kuptimin e çastit, ose të një pjese më të vogël të kohës.

Përgjigje gabimit

Disa medh’hebe të ndryshme, të cilat u dukën në shekujt e fundit, me synim arritjen e qëllimeve të tyre, menduan të lëkundin bazat e përmbylljes së profetësisë me Profetin e Islamit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Për këtë u bazuan në disa ajete kur’anore, të cilat nuk argumentojnë qëllimin e tyre, por ata u mbështetën në komentimin e tyre sipas mendimit personal, në konkluzione të zhdrejta e në gënjeshtër për të arritur synimin e tyre.

Një ndër ato ajete është edhe ajeti në fjalë. Sipas atyre, Kur’ani thotë se për çdo komb ka një afat dhe një fund, dhe se

qëllimi me kombin është feja dhe kushtetuta. Kështu, sipas tyre, edhe për fenë islame ka një kufi e një fund!.

Mënyra më e mirë për të vlerësuar një argumentim të tillë, është të studiojmë kuptimin e vërtetë të termit *"ummetun"*, në gjuhë, e më pas në Kur'an.

Nga librat e gjuhës, si dhe nga vendet e përdorimit të këtij termi në Kur'anin Fisnik, në të cilin përmendet 64 herë, përfitohet se fjala *"ummetun"* do të thotë "grup".

Përshebull, në tregimin e Musait lexojmë: **"E kur arriti ujin e Medjenit, aty gjeti një grumbull njerëzish që po i jepnin bagëtisë ujë"**¹; pra po nxirrnin ujë nga pusi për veten dhe për bagëtitë e tyre.

Gjithashtu, kur flitet për urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, thuhet:

"Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme."²

Në Kur'an thuhet: **"Dhe kur një grup prej tyre thanë: Përse këshilloni një popull që All'illahu do ta shkatërrojë?"**³ **Fjala ummet në këtë ajet janë banorët e Medines Ijletu prej bijëve të Izraelit.**

Rreth Beni Israilëve lexojmë: **"Ne i ndamë ata në dymbëdhjetë grupe fisesh."**⁴

Nga këto ajete sqarohet më së miri se fjala *"ummetun"* ka kuptimin e "grupit" e jo të fesë, as të ndjekësve të saj.

¹ Sure "Kasas", ajeti 23.

² Sure "Ali Imran", ajeti 104.

³ Sure "A'raf", ajeti 164.

⁴ Sure "A'raf", ajeti 160.

Mbi këtë bazë, kuptimi i ajetit të trajtuar këtu është se për çdo grup njerëzor ka një fund. Pra, nuk vdesin e shuhen vetëm individët, por edhe kombet.

Në thelb, termi "*ummetun*" nuk përdoret asnjëherë për fenë. Kështu që ajeti nuk ka lidhje me çështjen përmbylljes së profetësisë.

Ajetet 35 - 36

لَا يَنْبَغِي ءَادَمَ إِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ رُسُلٌ مِّنْكُمْ يَقُصُّونَ عَلَيْكُمْ ءَايَاتِي
فَمَنِ اتَّقَى وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿٣٥﴾
وَالَّذِينَ كَذَّبُوا بِءَايَاتِنَا وَاسْتَكْبَرُوا عَنْهَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ
هُم فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٣٦﴾

"O bijtë e Ademit, kur nga gjiri juaj të vijnë të Dërguar që ju shpjegojnë shpalljet e Mia, atëherë ata që ruhen nga të këqijat dhe kryejnë vepra të mira, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen."

"Kurse ata që i mohojnë shpalljet e Mia dhe sillen me mendjemadhësi ndaj tyre, do të jenë banorë të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë."

Komentimi

Mësim tjetër për bijtë e Ademit

All'Ilahu i Lartësuar u drejtohet edhe një herë tjetër bijve të Ademit dhe trashëgimtarëve të tij e u thotë: "O bijtë e Ademit, kur nga gjiri juaj të vijnë të Dërguar që ju shpjegojnë shpalljet e Mia, atëherë ata që ruhen nga të këqijat dhe kryejnë vepra të

mira, nuk do të frikësohen e as do të pikëllohen." Pra, nëse juve ju vijnë të Dërguarit e Mi e ju përcjellin ajetet e mia, ju ndiqini ata, sepse ai që frikësohet prej jush dhe i ndjek ata, riparon veten e të tjerët, është i sigurtë nga ndëshkimi i dhimbshëm i All'llahut, kështu që të mos frikësohet e as të mos pikëllohet.

Në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kurse ata që i mohojnë shpalljet e Mia dhe sillen me mendjemadhësi ndaj tyre, do të jenë banorë të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë."**

Pra, ky është shpërblimi i besimtarëve dhe ky është shpërblimi i gënjeshtarëve.

Kthim përgjigjeje ndaj një sofizmi tjetër

Një grup kundërshtarësh të fesë e të medh'hebeve të ndryshme në kohët e fundit, siç e thamë në komentimin e ajeteve të mëparshme, u bazuan në një grup ajetesh kur'anore për t'i hapur rrugën realizimit të qëllimeve të tyre dhe pretenduan se ato ajete janë argument për mohimin e vulës së profetësisë së të Dërguarit të Islamit, ndërkohë që këto ajete nuk kanë lidhje fare me këtë çështje e me këtë tematikë.

Nga këto ajete është edhe ajeti që po trajtohet. Ata, pa e vënë re se çfarë u paraprin këtyre ajeteve dhe çfarë vjen pas tyre, thanë: Me të vërtetë, *"ju vijnë juve"* është folje në kohën e tashme dhe ky është tregues se ka mundësi që All'llahu të dërgojë të Dërguar të tjerë në të ardhmen.

Por, nëse kthehemi pak mbrapa dhe shohim ajetet që flasin për krijimin e Ademit dhe për banimin e tij ne Xhennet, e më pas nxjerrjen e tij dhe të bashkëshortes së tij prej aty, vëmë re se atyre që u drejtohet fjala në këto ajete nuk janë myslimanët, por

bashkësia njerëzore dhe të gjithë bijtë e Ademit, atëherë sqarohet përgjigjja e këtij dyshimi. Nuk ka dyshim se All'llahu ka dërguar shumë të Dërguar nga bijtë e Ademit emrat e një grupi prej tyre janë përmendur në Kur'anin Fisnik e disa të tjerë janë përmendur në librat e historisë.

Çështja është se ky grup nga rryma e fe të ndryshme, i injorojnë ajetet e mëparshme për t'i humbur njerëzit e për t'i mashtruar ata, duke thënë se në këtë ajet, fjala u drejtohet myslimanëve në veçanti. Në këtë mënyrë, ata konkluduan mundësinë e ekzistencës së të Dërguarve të tjerë.

Në të vërtetë, shembuj të ngjashëm me sofizma të tilla ka edhe në të kaluarën, e veçanërisht kur bëhet fjalë për ndarjen ndërmjet një ajeti dhe një tjetri, si dhe të mosnjohjes së qëllimit të ajeteve të mëparshme dhe atyre pasardhëse, nga kjo nxjerrin kuptimin që përshtatet me dëshirat e tyre edhe pse është në kundërshtim me realitetin e ajetit.

Ajeti 37

فَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنِ افْتَرَى عَلَى اللَّهِ كَذِبًا أَوْ كَذَّبَ بِآيَاتِهِ^ج
 أُولَئِكَ يَنَازِعُهُمْ نَصِيحُهُمْ^ط مِّنَ الْكِتَابِ^ط حَتَّىٰ إِذَا جَاءَهُمْ رُسُلُنَا
 يَتَوَفَّوهُمْ^ط قَالُوا أَإِنَّ مَا كُنْتُمْ تَدْعُونَ^ط مِّن دُونِ اللَّهِ^ط قَالُوا
 ضَلُّوا عَنَّا وَشَهِدُوا عَلَىٰ أَنفُسِهِمْ أَنَّهُمْ كَانُوا كَافِرِينَ ﴿٣٧﴾

"Kush është më i padrejtë se ai që trillon gënjeshtria kundër All'lahut ose që mohon shpalljet e Tij? Atyre do t'u jepet çfarë u është caktuar (në Leuhi Mahfudh). E, kur t'u vijnë të dërguarit Tanë (engjëj), për t'ua marrë shpirtin, do t'u thonë: "Ku janë idhujt që i adhuronit në vend të All'lahut?" Ata do të thonë: "Na braktisën." Kështu ata dëshmojnë kundër vetes, që kanë qenë mohues."

Komentimi

Ky ajet dhe ato pasardhës sqarojnë llojet e ndryshme të përfundimit të keq që i pret shpifësit e gënjeshtarët ndaj argumenteve të All'lahut të Lartësuar. Në fillim tregohet situata e tyre gjatë vdekjes: "Kush është më i padrejtë se ai që trillon gënjeshtria kundër All'lahut ose që mohon shpalljet e Tij?..."

Siç kemi thënë në suren "En'am" në fund të ajetit 21, thënia "njeriu më i padrejtë" është përmendur me fraza të ndryshme në shumë ajete të Kur'anit Fisnik. Por cilësitë që i përmenden atyre kanë një zanafillë të vetme që është: politeizmi, adhurimi i idhujve dhe përgënjeshtrimi i ajeteve të All'llahut të Lartësuar. Në ajetin në fjalë përmendet çështja e shpifjes ndaj All'llahut të Lartësuar si cilësia më e dukshme e tyre, duke shtuar edhe përgënjeshttrimin e argumenteve të Tij.

Në këndvështrimin e Kur'anit, zanafilla e të gjitha padrejtësive është politeizmi, ndërsa kapitali i të gjitha lumturive është Njësimi. Në këto ajete sqarohet se përse humbësit janë njerëzit më të padrejtë. Në të vërtetë, ata i bënë padrejtësi vetes së tyre, ashtu edhe shoqërisë në të cilën jetojnë. Ata mbjellin hipokrizinë e përçarjen në çdo vend dhe bëhen pengesë e madhe në rrugën e bashkimit të radhëve, të progresit dhe përmirësimeve të vërteta.¹

Më pas, All'llahu i Lartësuar e përshkruan situatën e tyre në kohën e vdekjes dhe thotë: **"...Atyre do t'u jepet çfarë u është caktuar** (në Leuhi Mahfudh). **E, kur t'u vijnë të dërguarit Tanë** (engjëj), **për t'ua marrë shpirtin...**". Pra, ata do të marrin pjesën e tyre dhe atë që është caktuar e shkruar nga begatitë e ndryshme deri në momentet e fundit të kësaj jete, pastaj atyre u vijnë melekët e ngarkuar nga Ne dhe ua marrin shpirtrat.

Kutpimi i fjalës "el kitabu" është për begatitë që All'llahu i Lartësuar i ka caktuar për robtë e Tij në këtë botë, ndonëse disa komentues mendojnë se kuptimi i tij është për ndëshkimin e

¹ Për sqarime më të shumta shih komentimin e ajetit 21 të sures "En'am".

All'lahut, ose për atë që është më gjithëpërfshirëse sesa këto dy kuptime.

Por duke parë fjalën "*hatta*", derisa", e cila zakonisht tregon fundin e diçkaje, bëhet e qartë se qëllimi është vetëm për begatitë e ndryshme të kësaj bote, ku ka pjesë për secilin prej nesh, pavarësisht nëse bëhet fjalë për besimtarë apo jobesimtarë, punëmirë apo punëkëqinj, që mbarojnë me vdekjen, dhe, nuk janë ndëshkimet e All'lahut, të cilat nuk përfundojnë me ardhjen e vdekjes. Përshkrimi i këtyre begatave të caktuara me fjalën "*kitab*", është për arsye të ngjashmërisë së tyre me çështjet të cilat i nënshtrohen ndarjeve e që shkruhen.

Mbi të gjitha, dënimet e tyre fillojnë që në çastin e mbërritjes së vdekjes. Në fillim, ata përballen me paralajmërimin dhe qortimin e melekëve të ngarkuar me marrjen e shpirtave të tyre, duke i pyetur ata: Ku janë idhujt tuaj, që ju morët përveç All'lahut, për të cilët keni folur e keni shpenzuar duke mos patur dituri?! **"...do t' u thonë: 'Ku janë idhujt që i adhuronit në vend të All'lahut?...'"**

Pasi e shohin veten e tyre të shkëputur nga gjithçka, duke parë se si shpërndahen të gjitha iluzionet e supozimet e tyre të gabuara rreth zotave të tyre, ata thonë: Nuk shohim prej tyre ndonjë ndihmë për të na mbrojtur dhe i gjithë adhurimi që kemi bërë për ta paska qenë i kotë dhe i padrejtë: **"...Ata do të thonë: 'Na braktisën...'"**

Kështu pra, ata dëshmojnë se janë jobesimtarë dhe të humbur: **"...Kështu ata dëshmojnë kundër vetes, që kanë qenë mohues."**

Ana e jashtme e çështjes, edhe pse inspiron se melekët i pyesin dhe ata përgjigjen, mirëpo në realitet është një lloj dënimi psikik për ata duke i tërhequr vëmendjen për situatën e keqe në të cilën ndodhen përshkak të veprave të tyre. Ata shohin se si kanë humbur e kanë rënë në greminat e humbjes për një periudhë të gjatë të jetës së tyre. Ata kanë humbur të gjithë kapitalin e tyre të shtrenjtë, pa korrur asgjë gëzuese e nderuese, ndërkohë që mbyllet para tyre rruga e kthimit. Ky është kamxhiku i parë i Xhehennemit dhe është prej kamzhikëve të dënimit All'lahut me të cilin do të përballen shpirtrat e tyre.

Ajetet 38 - 39

قَالَ ادْخُلُوا فِي أُمَمٍ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِكُمْ مِنَ الْجِنَّ وَالْإِنْسِ
 فِي النَّارِ ۖ كُلَّمَا دَخَلَتْ أُمَّةٌ لَعَنَتْ أُخْتَهَا ۖ حَتَّىٰ إِذَا آدَارَكُوا
 فِيهَا جَمِيعًا قَالَتْ أُخْرَبُهُمْ لِأُولَهُمْ رَبَّنَا هَؤُلَاءِ أَضَلُّونَا فَكَاتِمٌ
 عَذَابًا ضِعْفًا مِّنَ النَّارِ ۖ قَالَ لِكُلِّ ضِعْفٌ وَلَكِن لَا تَعْلَمُونَ
 وَقَالَتْ أُولَهُمْ لِأُخْرَبُهُمْ فَمَا كَانَ لَكُمْ عَلَيْنَا مِنْ
 فَضْلٍ فَذُوقُوا الْعَذَابَ بِمَا كُنْتُمْ تَكْسِبُونَ ﴿٣٨﴾

"(All'Ilahu) do t'u thotë: 'Hyni në zjarr me popujt - xhindet dhe njerëzit - që kanë qenë para jush'. Kurdo që një popull do të hyjë në zjarr, do të mallkojë të tjerët që kanë hyrë para tij. Dhe, kur të tubohen të gjithë atje, atëherë i fundmi i tyre do t'u thotë të parëve: 'O Zoti ynë, këta na kanë sjellë në humbje, prandaj jepu atyre një dënim të dyfishtë zjarri!' All'Ilahu do t'u thotë: 'Për secilin (nga ju) ka dënim të dyfishtë, por ju nuk e dini.'"

"Të parët do t'u thonë të fundmëve: 'Ju nuk keni qenë më të mirë se ne, prandaj shijoni dënimin për atë që keni punuar.'"

Komentimi

Konflikti i udhëheqësve dhe i ithtarëve në Xhehennem!

Në këtë ajet, Kur'ani Fisnik vazhdon të flasë për fundin e turpshëm të atyre që përgënjeshtrojnë dhe mohojnë argumentet e All'Ilahut.

Ajetet e mëparshme na përfytyruan gjendjen e tyre në momentin e vdekjes dhe pyetjen e melekëve që ua marrin atyre shpirtrat, ndërsa në ajetet që janë objekt studimi përshkruhet se çfarë ndodh në Ditën e Ringjalljes ndërmjet grupeve mashtruese e të humbura dhe ndërmjet atyre që u mashtruan.

Në Ditën e Kiametit, All'Ilahu u drejtohet atyre me këto fjalë: Ndiqini ata që ju ngjasojnë juve nga njerëzit e xhindët që kanë qenë para jush dhe shijoni të njëjtin fund, zjarrin: "(All'Ilahu) **do t'u thotë: 'Hyni në zjarr me popujt - xhindet dhe njerëzit - që kanë qenë para jush...'**" Ky urdhër mund të jetë në formën e urdhërit krijimtar (*tekuini*), që do të thotë: T'i vendosë të gjithë në një vend të vetëm. Ose të jetë i ngjashëm me një urdhër legjislativ që lëshohet për ta dhe e dëgjojnë me veshët e tyre dhe janë të detyruar t'i binden atij urdhri.

Në momentin që hyjnë të gjithë në Zjarr, ata nisin të përplasen me shokët dhe të ngjashmit e tyre të së njëjtës rrugë. Ajo është një përplasje e çuditshme. Sa herë që futet një grup prej tyre në Zjarr, ai mallkon tjetrin dhe e konsideron atë shkaktar për këtë fatkeqësi si dhe përgjegjës të kësaj belaje e katastrofe: "**Kurdo që një popull do të hyjë në zjarr, do të mallkojë të tjerët që kanë hyrë para tij...**"

E kemi përmendur disa herë se arena e Ringjalljes dhe ajo çfarë ndodh në të, është një reflektim i thellë për ndodhitë e kësaj bote. Në këtë botë shohim grupe, fraksione e parti të devijuara që mallkojnë njëra-tjetrën dhe largohen nga njëra-tjetra. E kundërta ndodh me të Dërguarit e All'llahut, besimtarët e sinqertë dhe punërmirët, ku gjithsecili prej tyre e përkrah programin e tjetrit dhe shfaq lidhjen dhe bashkimin e tij me të në qëllime e synime.

Çështja nuk përfundon në këtë kufi, sepse kur të stabilizohen të gjithë, në kulmin e poshtërimit e të përçmimit në Xhehennem e në dënimin e dhembshëm, gjithsecili prej tyre fillon të ankohet tek All'llahu për tjetrin.

Në fillim nisin të tradhtuarit e të mashtruarit me hedhjen e ankesat e tyre. Duke mos gjetur alternativë tjetër, ata thonë: *"Zoti ynë, ata mashtrues na mashtruan e na çuan në humbje, prandaj shtojua dënimin atyre përshkak se na humbën e na mashtruan!".* Këtë e përmban edhe thënia e All'llahut të Lartësuar: **"...Dhe, kur të tubohen të gjithë atje, atëherë i fundmi i tyre do t'u thotë të parëve: 'O Zoti ynë, këta na kanë sjellë në humbje, prandaj jepu atyre një dënim të dyfishtë zjarri!...'"**

Nuk ka dyshim se kjo kërkesë është shumë e arsyeshme dhe logjike, madje ata që kanë humbur të tjerët do marrin dyfishin e dënimit edhe pa këtë kërkesë, sepse ata mbartin përgjegjësinë e devijimit të atyre që çuan në humbje, pa iu zbritur nga ndëshkimi asgjë. Por e çuditshme është se në përgjigje të kërkesës së tyre do t'u thuhet se dënimi do të jetë i shtuar jo vetëm për ata që kanë çuar të tjerët në humbje, por për të dyja palët do të ketë dyfishin e ndëshkimit. **"...All'llahu do t'u thotë: 'Për secilin (nga ju) ka dënim të dyfishtë, por ju nuk e dini.'"**

Po të thellohemi më shumë, do të bëhet e qartë arsyeja se pse të humburit, ashtu edhe të mashtruarit, do të marrin dyfishin

e ndëshkimit. Kjo sepse prijësit e padrejtë dhe udhëheqësit e devijimit e të humbjes nuk mundën që ata vetë të zbatojnë programet e tyre, por janë ithtarë kokëfortë e fanatikë ndaj padronëve të tyre të cilët i mbështesin udhëheqësit e humbur e të devijuar me fuqi e numër për realizimin e qëllimeve të tyre të këqija. Për këtë, edhe ithtarët duhet të marrin dyfishin e dënimit, gjithashtu, një dënim për humbjen e tyre dhe një dënim për ndihmën dhe përkrahjen e të padrejtëve dhe të udhëheqësve devijues.

Në një hadith të njohur të Imam Kadhimit (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se njëri prej ndjekësve të tij që quhej Safuan, dëshironte të bashkëpunonte me Harun Reshidin por Imami e ndaloi atë duke i thënë: “O Safuan! Çdo gjë tek ti është e mirë dhe e bukur me përjashtim të një gjëje të vetme.”

I thashë: U bëfsha kurban për ty. Çfarë është ajo gjëja?

Imami i tha: Dhënia me qera e deveve tuaja këtij burri (Harun Reshidit).

I thashë: Pasha All'llahun, nuk ja kam dhënë me qera për të keq, as për arrogancë, as për gjueti, as për dëfrim, por ja dhashë me qera për këtë rrugë (pra për të shkuar në Mekë)

Imami më tha mua: O Safuan! A nuk ta paguajnë ata qeranë? I thashë: Po, t'u bëfsha kurban.

Më tha: A e dëshiron qëndrimin e tyre se të japin qeranë? I thashë: Po.

Tha: “Ai që e dëshiron qëndrimin e tyre, është prej atyre dhe ai që është prej tyre do të jetë në zjarr.”¹

Në ajetin pasardhës Kur'ani Fisnik përcjell përgjigjen e udhëheqësve të humbur e të devijuar që thonë se nuk ka ndonjë

¹ "Uesailu Shiia", vëll. 11, f. 259.

dallim mes nesh dhe mes jush. Kur flisnim, ju e përkrahnit, kur gabonim ju u gëzonit, kur bënim padrejtësi, ju bashkëpunonit, kështu që si rrjedhojë e veprave tuaja shijoni ndëshkimin e dhembshëm të All'llahut: **"Të parët do t'u thonë të fundmëve: 'Ju nuk keni qenë më të mirë se ne, prandaj shijoni dënimin për atë që keni punuar.'"**

Synimi me frazën *"el uula"*, është për udhëheqësit (udhëheqësit e humbjes e devijimit), dhe synimi me frazën *"ukhra"*, është për ithtarët dhe përkrahësit.

Ajetet 40 - 41

إِنَّ الَّذِينَ كَذَبُوا بِآيَاتِنَا وَاسْتَكْبَرُوا عَنْهَا لَا تُفَتِّحُ لَهُمْ أَبْوَابُ
السَّمَاءِ وَلَا يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ حَتَّى يَلِجَ الْجَمَلُ فِي سَمِّ الْخِيَاطِ ۚ
وَكَذَلِكَ نَجْزِي الْمُجْرِمِينَ ﴿٤٠﴾ هُمْ مِّنْ جَهَنَّمَ مِهَادٌ وَمِّنْ
فَوْقِهِمْ غَوَاشٍ ۚ وَكَذَلِكَ نَجْزِي الظَّالِمِينَ ﴿٤١﴾

"Me të vërtetë, atyre që i mohuan shenjat Tona me mendjemadhësi, nuk do t'u hapen dyert e qiellit dhe as që do të hyjnë në Xhennet, derisa të kalojë deveja nëpër vrimë të gjilpërës. Kështu i ndëshkojmë gjynahqarët."

"Për ata janë përgatitur shtretër zjarri dhe sipër tyre do të ketë mbulesa zjarri. Kështu i ndëshkojmë Ne të padrejtët."

Komentimi

Edhe një herë tjetër, Kur'ani na flet për fundin e mendjemëdhenjve dhe të kundërshtarëve, pra për ata të cilët nuk u nënshtrohen argumenteve të All'llahut dhe nuk dorëzohen ndaj së drejtës: "Me të vërtetë, atyre që i mohuan shenjat Tona me mendjemadhësi, nuk do t'u hapen dyert e qiellit..."

Në një hadith nga Imam Bakiri (Paqja qoftë mbi të!) thuhet: "Përsa u përket besimtarëve, punët dhe veprat e tyre ngrihen në qiell dhe atyre u hapen dyert e tij. Kurse jobesimtari, ngrihet me veprën e shpirtin e tij derisa arrin në qiell dhe thërret dikush: Zbriteni atë në sixhxhijn."¹

Në këtë kontekst janë transmetuar hadithe nga Profeti ynë i dashur (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) në komentimin e "Et Tabariut" dhe nga komentues të tjerë në fund të ajetit në fjalë.

Ka mundësi që kuptimi i fjalës "semaun", qiell të jetë kuptim aparenial. Po ashtu, mund të jetë figuativ për pozitën e afër të All'llahu, siç e lexojmë në ajetin 10 të sures "El Fatir": "Drejt Tij ngrihet fjala e mirë dhe vepra e mirë, e ngre Ai atë."

Më pas thuhet: **"...dhe as që do të hyjnë në Xhennet, derisa të kalojë deveja nëpër vrimë të gjilpërës..."**, pra ata kurrë nuk hyjnë në Xhennet.

Ky përshkrim është një konfirmim për pamundësinë e kësaj çështjeje. Shembulli në fjalë është përzgjedhur për të lajmëruar pamundësinë e hyrjes së këtyre personave në Xhennet. Ashtu sikurse çdokush është i bindur për pamundësinë e depërtimit të devesë me gjithë atë trup të madh përmes vrimës së gjilpërës, po ashtu nuk duhet të dyshojmë në pamundësinë e hyrjes së mendjemëdhenjve në Xhennet.

Në origjinën e saj, fjala "xhemel" ka kuptimin e devesë, së cilës sapo i kanë dalë dhëmbët. Gjithashtu, kjo fjalë ka edhe kuptimin e një litari të fortë dhe solid, me të cilin lidhen anijet.²

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 254, fundi i ajetit në fjalë. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 30. "Sixhxhijn" është emri i një lugine në Xhehennem.

² Shih "Taxhul Arus", lënda "el xhemelu".

Meqenëse mes litarit dhe gjilpërës ka një lidhje më të fortë, për këtë disa kanë shkuar tek ky kuptim në komentimin e ajetit, por shumica e komentuesve mendojnë se kuptimi i parë është më i saktë për shkak të arsyeve të mëposhtme:

Së pari: Edhe në hadithet e prijësve islami ka përshkrime që përshtaten me komentimin e parë.¹

Së dyti: Një kuptim i ngjashëm në lidhje me të padrejtët (mendjemëdhenjtë e arrogantët) gjendet edhe në Ungjill. Kështu, në Ungjillin e Lukës, kapitulli 18, fjalia 24 dhe 25 lexojmë se Isai ka thënë: "Sa e vështirë është hyrja e të pasurve në mbretëritë e All'lahut! Sepse hyrja e devesë në vrimën e gjilpërës është më e lehtë sesa të hyjë i pasuri në mbretërinë e All'lahut".

Nga kjo frazë mësohet se ky shembëlltim figurativ ka qarkulluar ndërmjet popujve që në kohërat e lashta.

Këtë shembull mund ta përdorim edhe në bashkëbisedimet tona. Kështu, për njerëzit shumë të rreptë e shumë tolerantë nganjëherë thuhet: Ka raste kur filani nuk hyn nga porta e qytetit dhe ka raste kur hyn nga vrima e gjilpërës.

Së treti: Fjala "el xhemel" përdoret më shumë në kuptimin e parë (deve), ndërsa në kuptimin e dytë (litar) përdoret më rrallë. Kjo është arsyeja që komentimi i parë është më i saktë.

Në përfundim të ajetit, për të përforcuar e sqaruar më tepër, All'llahu i Lartësuar shton: "**...Kështu i ndëshkojmë gjynahqarët.**"

Ajeti pasardhës tregon për një grup tjetër dhe për ndëshkimin e tyre të dhimbshëm dhe thotë:

"Për ata janë përgatitur shtretër zjarri dhe sipër tyre do të ketë mbulesa zjarri..."

¹ "Biharul Anuar", vëll. 4, f. 45.

Më pas, ajeti vazhdon: “...**Kështu i ndëshkojmë Ne të padrejtët.**”

Të tërheq vëmendjen fakti se All'llahu i Lartësuar i përshkruan zullumqarët, herë si “kriminelë”, herë si “të padrejtë”, e herë si “gënjeshtarë” ndaj argumenteve të All'llahut dhe herë tjetër si “mendjemëdhenj”. Në realitet, të gjitha këto kanë një realitet të përbashkët.

Ajetet 42 - 43

وَالَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ لَا نُكَلِّفُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا
 أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ ﴿٤٢﴾ وَنَزَعْنَا مَا فِي
 صُدُورِهِمْ مِّنْ غِلٍّ تَجْرَىٰ مِنْ تَحْتِهِمُ الْأَنْهَارُ ۖ وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ
 الَّذِي هَدَانَا لِهَٰذَا وَمَا كُنَّا لِنَهْتَدِيَ لَوْلَا أَنَّ هَدَانَا اللَّهُ ۖ لَقَدْ
 جَاءَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ ۖ وَنُودُوا أَن تِلْكَمُ الْجَنَّةُ أَوْرَثْتُمُوهَا
 بِمَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٤٣﴾

"Kurse ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira - Ne nuk ngarkojmë askënd më tepër nga sa ka mundësi - ata janë banorë të Xhennetit, në të cilin do të qëndrojnë përgjithmonë."

"Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre. Te këmbët e tyre do të rrjedhin lumenj dhe ata do të thonë: 'Qoftë lavdëruar All'llahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte All'llahu. Pa dyshim, të Dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën'. Dhe një zë do t'i thërrasë: 'Ky është Xhenneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar.'"

Komentimi

Rehatia e plotë dhe lumturia e përjetshme

Siç e kemi thënë edhe më parë, metodika e Kur'anit është prezantimi i grupeve të ndryshme dhe qartësimi i fundit të tyre, shpjegimi i situatave të tyre përmes metodës së krahasimit dhe drejtpeshimi i tyre.

Në ajetet e mëparshme u fol në lidhje me gënjeshtarët ndaj argumenteve të All'llahut, mendjemëdhenjve dhe të padrejtëve.

Ndërsa në ajetet që janë objekt studimi shpjegohet e ardhmja e ndritur e besimtarëve, ku thuhet: **"Kurse ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira ... ata janë banorë të Xhennetit..."**

Ndërmjet kryefjalës dhe kallëzuesit ka ardhur një parantezë¹, që sqaron shumë prej paqartësive ku thuhet: **"...Ne nuk ngarkojmë askënd më tepër nga sa ka mundësi..."**

Kjo fjali përforcon e siguron se askush nuk duhet të mendojë se besimi në All'llahun, kryerja e veprave të mira dhe ndjekja e rrugës së besimtarëve, është një gjë e vështirë dhe e pamundur, dhe është vetëm për disa individë të caktuar. Sepse detyrat e All'llahut janë në kufijtë e fuqive njerëzore e jo më shumë. Me këtë i hapet rruga çdokujt, i ditur apo i paditur qoftë, i vogël apo i madh, duke i ftuar të gjithë të ndjekin këtë rrugë; kështu, nga gjithsecili kërkohej vepra me masën e mundshme mendore e trupore e sipas mundësive të tij.

Me të vërtetë, ky ajet, si të gjitha ajetet e tjera të Kur'anit, e kufizon mjetin e shpëtimit e të lumturisë së përhershme në besim e vepër të mirë. Gjithashtu, me të përgënjeshtrohet ideologjia kristiane e devijuar, e cila pretendon kryqëzimin e Isait në

këmbim të mëkateve njerëzore dhe si mjet shpëtimi, duke thënë: Ai ishte kurban i gabimeve njerëzore.

Kur'ani Fisnik, në ajete të ndryshme të tij, e nxit besimin dhe kryerjen e veprave të mira.

Në ajetin pasardhës, All'lahu i Lartësuar tregon për një nga begatitë më të rëndësishme që u dha Ai banorëve të Xhennetit, e cila bëhet shkak për qetësinë e tyre shpirtërore: **“Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre...”**

Fjala “el gil” ka kuptimin e zbatimit të diçkaje në mënyrë të fshehtë e sekrete; kjo fjalë përdoret për zilinë, urrejtjen e armiqësinë që depërtojnë tek qeniet njerëzore në mënyrë të fshehtë. Ndërsa fjala “el gulul” përdoret për rryshfetin, sepse ai merret në mënyrë të fshehtë, ose për kryerjen e një tradhëtie.¹

Në të vërtetë, faktorët më të mëdhenj të fatkeqësive nga të cilat vuajnë njerëzit në këtë jetë, si dhe burim i luftimeve shoqërore, që shkaktojnë humbje të papritura në pasuri e njerëz dhe lëkundjen e bazave shpirtërore, janë zilia dhe urrejtja.

Kështu, ne njohim shumë njerëz, të cilëve s’u mungon asgjë në këtë botë, por që vuajnë nga zilia dhe urrejtja për të tjerët; ajo është tortura e tyre e vetme që ua trazon jetën dhe ua ngushton zemrën, duke u lënë vend ushtarëve të zemërimit, të smirës e të zilizë që t'i shtojnë ata në sjellje rraskapitëse e të palogjikshme.

Banorët e Xhennetit janë të falur nga këto fatkeqësi e dëshpërime në përgjithësi, sepse ata nuk përshkruhen me këto cilësi të këqija. Në zemrat e tyre nuk ka as zili dhe as urrejtje e për këtë arsye, ata nuk përballen me pengesa mohuese; ata jetojnë së bashku në kufijtë e dashurisë, dëlirësisë dhe të qetësisë.

¹ Për më shumë sqarime shih komentimin e ajetit 161 të sures "Ali Imran" në këtë komentim.

Ata janë të kënaqur nga gjendja në të cilën ndodhen, madje edhe ata që jetojnë në gradët më të ulëta të Xhennetit nuk i kanë zili ata që janë sipër tyre dhe me këtë zgjidhet problemi më i madh që del në rrugën e bashkëjetesës së shëndoshë.

Disa komentues kanë transmetuar një hadith nga Es Sudejj për pozitën, ku thuhet: “Me të vërtetë, kur shkojnë në Xhennet, banorët e Xhennetit do të gjejnë tek porta e tij një pemë, në trungun e së cilës janë dy burime; kështu, ata pijnë te i pari dhe pastrohen nga zilia e urrejtja, pastaj lahen te tjetri dhe mbi ta bie një shëndet e bollëk i begatë; pas kësaj, ata as nuk çatrifilohen dhe as nuk zbehen kurrën e kurrës.¹

Vërtet, ky hadith edhe pse zinxhiri i tij nuk përfundon tek Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe as tek Imamët (Paqja qoftë mbi ta!), por e ka transmetuar një nga komentuesit që është “Es Sudejj” por nuk është e largët që në thelb, të jetë transmetuar nga Profeti (Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), sepse këto çështje nuk janë prej atyre që Sudejji, e të tjerë si ai, mund t'i njohin mirë ato.

Gjithsesi, kjo është një dëshmi për të vërtetën që vjen më pas. Banorët e Xhennetit u pastruan në brendësi e në sipërfaqe, në trup e në shpirt. Ata pajisen me një bukuri trupore e shpirtërore njëherësh. Kjo është edhe arsyeja se ata nuk vuajnë aspak nga zilia dhe nga urrejtja.

Sa lumturi është që të ngresh për veten tënde në këtë botë një Xhennet duke pastruar zemrën nga zilia dhe urrejtja e t'i zhdukësh ndikimet e tyre të dhimbshme!

¹ Tefsiri "Manar", vëll. 8, f. 421. Tefsir "Xhamiul Bejjan", vëll. 8, f. 241.

Pas përmendjes së kësaj begatie shpirtërore, Kur'ani Fisnik tregon për begatitë e tyre materiale dhe trupore e thotë: **"...Te këmbët e tyre do të rrjedhin lumenj..."**

Më pas, në Kur'an pasqyrohet kënaqësia e banorëve të Xhenetit, të cilët e falënderojnë dhe shprehin mirënjohje ndaj All'Ilahut të Vetëm, Atij që i udhëzoi dhe u dhuroi atyre begati të shumta: **"...dhe ata do të thonë: 'Qoftë lavdëruar All'Ilahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte All'Ilahu. Pa dyshim, të Dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën.'"**

Këtu, atyre u thuhet se begatitë e trashëguara u janë dhuruar për shkak të veprave që kanë bërë: **"...Dhe një zë do t'i thërrasë: 'Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar.'"**

Edhe një herë tjetër arrijmë tek e vërteta se shpëtimi është peng i veprës së mirë dhe nuk është me shpresa e supozime boshe.

Në rrënjën e saj, fjala "irth", ka kuptimin e kalimit të pasurisë apo të të mirave materiale nga një njeri tek një tjetër, pa pasur ndonjë marrëveshje apo kontratë mes tyre (pra kalim i pasurisë në rrugë të natyrshme e spontane dhe jo përmes shitblerjes). Kjo është edhe arsyeja se pse kalimi i pasurisë së të vdekurit tek pasardhësit e tij quhet trashëgimi.

Përse u perifrazua si "trashëgimi"?

Lind pyetja: Si u thuhet banorëve të Xhenetit: Këto janë begatitë që i trashëguat në këmbim të veprave tuaja?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje ka ardhur në një hadith të të Dërguarit të All'Ilahut, të transmetuar si nga synitët, ashtu edhe nga shi'itët, ku

thuhet: *“Për çdo njeri është ndërtuar një shtëpi në Xhennet dhe një tjetër në Zjarr. Jobsimtari trashëgon shtëpinë e besimtarit në Zjarr, ndërsa besimtari shtëpinë e jobsimtarit në Xhennet. E kjo është thënia e Tij: E trashëguat atë për ato vepra që punuat.”*

Ky hadith tregon se portat e lumturisë e të pikëllimit janë të hapura për të gjithë njerëzit pa përjashtim dhe se në ditën e krijimit, asnjë njeri nuk është krijuar për të qenë nga banorët e Xhennetit apo të Zjarrit. Secili ka mundësi të arrijë njëren prej këtyre dy pozitave, por është dëshira e tyre, ajo që përcakton dhe që vendos fundin e tyre.

Është e çuditshme se kur besimtari hyn në Xhennet, ndërsa jobsimtari në Zjarr, vendi dhe shtëpia e secilit prej tyre, i kalon në mënyrë të natyrshme tjetrit.

Mbi të gjitha, ajeti dhe hadithi i përmendur janë dy nga faktet dhe argumentet e qarta për mohimin e dhunës dhe për lirinë e zgjedhjes te njeriu.

Ajetet 44 - 45

وَنَادَىٰ أَصْحَابُ الْجَنَّةِ أَصْحَابَ النَّارِ أَن قَدْ وَجَدْنَا مَا وَعَدَنَا
رَبُّنَا حَقًّا فَهَلْ وَجَدْتُمْ مَا وَعَدَ رَبُّكُمْ حَقًّا ۖ قَالُوا نَعَمْ ۚ فَأَذَّنَ
مُؤَدِّنُ بَيْنَهُمْ أَن لَّعْنَةُ اللَّهِ عَلَى الظَّالِمِينَ ﴿٤٤﴾ الَّذِينَ يَصُدُّونَ
عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ وَيَبْغُونَهَا عِوَجًا وَهُمْ بِالْآخِرَةِ كَفِرُونَ ﴿٤٥﴾

"Dhe banorët e Xhenetit do t'u thonë banorëve të zjarrit: 'Ne e gjetëm të vërtetë atë që na premtoi Zoti ynë. Po ju, a e gjetët të vërtetë atë që ju premtoi Zoti juaj?' Ata do të thonë: 'Po!' Atëherë, një lajmëtar midis tyre do të thërrasë: 'Mallkimi i All'Ilahut është mbi të padrejtët.'"

"Të cilët i kanë penguar të tjerët nga rruga e All'Ilahut, duke dashur ta shtrembërojnë atë dhe nuk kanë besuar në Jetën Tjetër!"

Komentimi

Pas përshkrimit në ajetet e mëparshme, të përfundimit të banorëve të Xhenetit dhe atyre të Zjarrit, në ajetet që janë objekt studimi jepet bashkëbisedimi ndërmjet këtyre dy grupeve në atë Ditë. Nga kjo përftohet se banorët e Xhenetit dhe banorët e

Zjarrit komunikojnë me njëri-tjetrin ndërkohë që janë në vendet e tyre në Xhennet, apo në Zjarr.

Fillimisht thuhet: **"Dhe banorët e Xhennetit do t'u thonë banorëve të zjarrit: 'Ne e gjetëm të vërtetë atë që na premtoi Zoti ynë. Po ju, a e gjetët të vërtetë atë që ju premtoi Zoti juaj?...'"**

Banorët e Zjarrit përgjigjen duke thënë: *"Po. I gjetëm të gjitha këto, me syrin e së vërtetës":*

"...Ata do të thonë: 'Po!' ..."

Duhet të tërheqim vëmendjen se folja *"nada"*, edhe pse është në kohën e shkuar, këtu vjen me kuptimin e së tashmes. Të tilla përshkrime ka shumë në Kur'anin Fisnik, ku përmenden ngjarje që do ndodhin në të ardhmen me folje në kohën e shkuar. Ky konsiderohet një lloj përforcimi, çka do të thotë se e ardhmja është shumë e qartë, sikur ajo ka ndodhur në të kaluarën dhe është realizuar.

Folja *"nada"* - **thërrasin**, e cila zakonisht përdoret për distanca të largëta, përfytyron largësinë e madhe të vendndodhjes e të pozitës ndërmjet këtyre dy grupeve.

Këtu mund të shtrohet pyetja: Cila është vlera e këtij dialogu ndërmjet dy grupeve, përderisa ata të dy e dinë përgjigjen?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e ditur, sepse pyetja nuk bëhet përherë për fitimin e më shumë njohurive, por nganjëherë mund të marrë cilësinë e paralajmërimit, këshillimit e qortimit dhe këtu, ajo është e tillë.

Ky është një nga ndëshkimet e mëkatarëve dhe mizorëve, të cilët shijonin të mirat e kësaj bote, i dënonin besimtarët me paralajmërime të hidhura e me qortime të bezdisshme, ndërsa në Botën Tjetër do të marrin dënimin e veprave të tyre. Për këtë temë

flitet në sure të ndryshme të Kur'anit, e në veçanti në fund të sures "El Mutaaffiin".

Më pas, All'llahu i Lartësuar shton se në këtë kohë thërret dikush me një thirrje që e dëgjojnë të gjithë: Mallkimi i All'llahut qoftë mbi mizorët! **"...Atëherë, një lajmëtar midis tyre do të thërrasë: 'Mallkimi i All'llahut është mbi të padrejtët.'"**

Më pas i prezanton të padrejtët dhe i përshkruan ata me thënien e Tij: **"Të cilët i kanë penguar të tjerët nga rruga e All'llahut, duke dashur ta shtrembërojnë atë dhe nuk kanë besuar në Jetën Tjetër!"**

Nga ajeti që është objekt studimi përforcohet edhe një herë tjetër fakti, se të gjitha devijimet e shkatërrimet përmbliohen në konceptin e padrejtësisë. Për të padrejtin ka një kuptim të gjerë. Në këtë term përfshihen të gjithë vepruesit e mëkateve e të gjynaheve, veçanërisht humbësit dhe të humburit.

Hulumtime

Kush është ai thirrës që do të thërrasë?

Kush do të jetë ai thirrës që do ta dëgjojnë të gjithë?

Nga ajeti nuk përfitohet asgjë për këtë. Por në hadithet islame që komentojnë dhe sqarojnë këtë ajet thuhet se thirrësi është Prijësi i besimtarëve, Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*).

El Hakim Ebul Kasim El Haskanij, që është nga dijetarët e Ehli Synetit ka transmetuar me zinxhirin e tij nga "Muhamed ibn El Hanefije", nga Aliu (*Paqja qoftë mbi të*), i cili ka thënë: *"Unë jam ai thirrës!"*¹

¹ "Biharul Anuar", vëll. 8, f. 331. Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 259.

Po kështu transmetohet me zinxhirin e tij nga ibn Abasi, se në Kur'anin Fisnik, për Aliun ka emra që nuk i njohin njerëzit. Prej tyre është emri "thirrësi" te thënia e All'llahut të Lartësuar: **"...Atëherë, një lajmëtar midis tyre do të thërrasë..."** Ai thërret ndërmjet dy grupeve, të banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Zjarrit, dhe thotë: *"Mallkimi i All'llahut qoftë mbi ata, të cilët e përgënjeshtroan udhëheqjen time të caktuar dhe e nënçmuan të drejtën time."*¹

Janë transmetuar shumë hadithe të ndryshme e të ngjashme, si këto që u përmendën, nga Shi'itët. Prej tyre është hadithi që ka përcjellë Es Saduk nga imam Bakiri, në të cilin thuhet se Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në momentin e largimit të tij nga Nehreuani, mbajti një fjalim në Kufe. Atë e lajmëruan se Muaviu e shante, e turpëronte atë dhe i vriste shokët e tij. Ndërkohë, Prijësi i besimtarëve tha: *"Unë jam thirrësi në këtë botë dhe në Tjetrën. All'llahu i Lartësuar ka thënë: **"...Atëherë, një lajmëtar midis tyre do të thërrasë: 'Mallkimi i All'llahut është mbi të padrejtët."** Unë jam ai thirrës".* Më pas, ai shtoi: **"...dhe një thirrje nga All'llahu dhe i Dërguari i Tij..."** *Unë jam ajo thirrje"*²

Ne mendojmë se Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), është zgjedhur si thirrës në këtë kohë, për shkak se:

Së pari, ai, gjithashtu, këtë pozitë të lartë e ka pasur nga All'llahu dhe i Dërguari i Tij edhe në këtë botë. Pas çlirimit të Mekës, ai u ngarkua nga ana e All'llahut që t'ua lexojë njerëzve ajetet e para të sures "Teube" me zë të lartë gjatë ritualeve të haxhit: **"Dhe një thirrje nga All'llahu dhe i Dërguari i Tij, drejtuar të gjithë njerëzve në ditën e Haxhit të madh, se**

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 259, fundi i ajetit në fjalë.

² "Biharul Anuar", vëll. 33, f. 283, hadithi 547.

All'llahu është tërhequr prej idhujtarëve, e njëkohësisht edhe i Dërguari i Tij..."

Së dyti: Qëndrimi i Imam Aliut gjatë gjithë jetës së tij të ndritur ka qenë një qëndrim kundërshtues ndaj padrejtësisë dhe të padrejtëve. Lufta e tij ndaj padrejtësisë dhe armiqësia ndaj mizorisë, në mënyrë të veçantë duke patur parasysh situatat e kohës, shfaqen dukshëm në faqet e ndritura të historisë së tij.

A nuk është jeta në Botën Tjetër, një mishërim i plotë i jetës njerëzore në këtë botë? Dhe për më tepër, a nuk janë të dyja ato si faqet e së njëjtës monedhë?

Meqenëse kjo është një e vërtetë prej të vërtetave, atëherë nuk ka pse të duket e çuditshme se thirrësi që do t'i lajmërojë mizorët në vendin ndërmjet Xhennetit e Zjarrit, me urdhër nga All'llahu dhe i Dërguari i Tij në atë ditë, të jetë Aliu.

Nga kjo sqarohet përgjigjja ndaj asaj që ka shkruar autori i komentimit "El Menar", i cili dyshoi në këtë pozitë të Aliut dhe në këtë virtyt, ku thotë: 'Po ta logjikoni veshjen e këtij lejimi atij (*Paqja qoftë mbi të!*), me kuptim, do të konsiderohej si virtyt apo shpërblim tek All'llahu i Lartësuar, do ta pranoni transmetimin edhe po të ishte pa zinxhir të saktë transmetimi.¹

Autorit të këtij komentimi duhet t'i themi: Ashtu sikurse përfaqësimi i të Dërguarit të All'llahut në përcjelljen e sures "Teube" në ritualin e Haxhit konsiderohet prej virtyteve më të mëdhaja të tij; ashtu sikurse sfida e tij ndaj mizorëve e të padrejtëve konsiderohet si një nga virtytet më të ndritshme të tij, po ashtu edhe mbartja e kësaj çështjeje prej tij në Ditën e Ringjalljes, konsiderohet si vazhdimësi e të njëjtave programe, si një tjetër virtyt i pastër i tij.

¹ Tefsiri "Manar", vëll. 8, f. 426.

Nga ajo që thamë, gjithashtu, sqarohet përgjigjja edhe ndaj asaj që ka shkruar “Alusij” në komentimin “Ruhul Meanij”, i cili ka thënë: 'Dhe transmetimi i imamitëve nga Er Rida dhe ibn Abasi se ai është Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk vërtetohet përmes rrugës së Ehli Synetit.¹

Siç e përmendëm edhe më lart, këtë hadith e kanë transmetuar dijetarët e të dy grupeve, Synitë dhe Shi'itë, në librat dhe botimet e tyre, kështu që në përmbajtjen e tij nuk ka vend për dyshime.

¹ Tefsiri "Ruhul Me'anij", vëll. 8, f. 123.

Ajetet 46 - 49

وَبَيْنَهُمَا حِجَابٌ ۚ وَعَلَى الْأَعْرَافِ رِجَالٌ يَعْرِفُونَ كُلًّا بِسِيمَانِهِمْ ۚ
 وَنَادَوْا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ أَنْ سَلِّمُوا عَلَيْنَا ۚ لَمْ يَدْخُلُوهَا وَهُمْ
 يَطْمَعُونَ ﴿٤٦﴾ وَإِذَا صُرِفَتْ أَبْصَارُهُمْ تِلْقَاءَ أَصْحَابِ النَّارِ قَالُوا
 رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٤٧﴾ وَنَادَى أَصْحَابُ الْأَعْرَافِ
 رِجَالًا يَعْرِفُونَهُمْ بِسِيمَانِهِمْ قَالُوا مَا أَغْنَىٰ عَنْكُمْ جَمْعُكُمْ وَمَا
 كُنْتُمْ تَسْتَكْبِرُونَ ﴿٤٨﴾ أَهَؤُلَاءِ الَّذِينَ أَقْسَمْتُمْ لَا يَنَالُهُمُ اللَّهُ
 بِرَحْمَةٍ ۚ أَدْخُلُوا الْجَنَّةَ لَا خَوْفٌ عَلَيْكُمْ وَلَا أَنْتُمْ تَحْزَنُونَ ﴿٤٩﴾

"Një mur do t'i ndajë ata, ndërsa në lartësitë e tij do të ndodhen njerëz, të cilët i njohin të dyja palët sipas tipareve. Ata do t'u thërrasin banorëve të Xhenetit: 'Paqja qoftë mbi ju!' Ata nuk do të kenë hyrë ende në Xhenet, ndonëse shpresojnë."

"E kur t'i kthejnë sytë nga banorët e zjarrit, do të thonë: 'O Zoti ynë! Mos na hidh midis këtyre njerëzve të padrejtë!'"

"Pastaj, njerëzit e Murit (A'râf) do t'u thërrasin disa njerëzve që i njohin nga pamja, duke u thënë: 'Nuk ju ndihmoi as grumbullimi i pasurisë suaj, as kryelartësia juaj (ndaj të Vërtetës).'"

"A janë këta për të cilët u betuat se nuk do t'i arrijë mëshira e All'Ilahut?' Ndërsa atyre do t'u thonë sërish: 'Hyni në Xhennet! Për ju s'ka frikë e as pikëllim!'"

Komentimi

A'rafi, Rrugëkalim i rëndësishëm drejt Xhennetit

Ajetet e mëparshme trajtuan dialogun mes banorëve të Xhennetit dhe atyre të Zjarrit, ndërsa në këto ajete flitet për *"El A'raf"*, e cila është një zonë në kufirin ndarës ndërmjet Xhennetit dhe Zjarrit, me veçoritë e saj të dallueshme.

Në fillim flitet për ndarësen që ngrihet ndërmjet banorëve të Xhennetit dhe banorëve të Zjarrit. Në ajet thuhet: **"Një mur do t'i ndajë ata..."**

Nga ajetet e mëpasme kuptohet se ndarësja e përmendur këtu është *"El A'raf"*, një vend i ngritur ndërmjet dy grupeve, i cili i pengon ata të shohin njëri-tjetrin. Megjithatë, prania e kësaj ndarjeje nuk pengon që secili prej atyre grupeve të dëgjojë zërin dhe thirrjen e tjetrit, ashtu siç e përmendëm edhe në ajetet e mëparshme.

Përderisa ne kemi parë komshinj duke folur pas murit, ku njëri i sqaron gjendjen tjetrit pa e parë, ata që qëndrojnë mbi *krifa*, pra në pjesët e ngritura të këtij vendi të lartë, shohin secilin prej këtyre dy grupeve.

Në disa ajete të Kur'anit Fisnik, si për shembull në ajetin 55 të sures *"Es Saffat"*, kuptohet se banorët e Xhennetit ndoshta i shohin banorët e Zjarrit. Por të tilla çështje të veçanta nuk

mohojnë në thelb pozitën e Xhennetit e të Zjarrit. Ajo që thamë pasqyron dhe përshkruan mënyrën e këtyre dy vendeve, edhe pse për këtë, gjithashtu, ka disa përjashtime dhe është e mundur që disa banorë të Xhennetit të shohin banorët e Zjarrit me kritere të veçanta.

Ajo që duhet të përmendim para se të thellohem në sqarimin e "A'rafit" është se frazat e e ardhura në Kur'an rreth Ringjalljes e Jetës Tjetër në asnjë mënyrë nuk mund të zbulojnë maskën e veçorive të asaj Jete, por, nganjëherë, frazat kanë cilësinë e krahasimit dhe shembëlltyrës.

Nganjëherë disa nga këto fraza thjesht zbulojnë vetëm disa hije në këtë fushë, sepse jeta në atë Botë do jetë në dimensione më të larta. Në krahasim me jetën e kësaj bote, ajo është më e gjerë në pozita të shumta. Ajo është njësoj e ngjashme me gjerësinë e jetës së kësaj bote në krahasim me botën e mitrës e të fetusit. Duke u bazuar në këtë, nuk është çudi se pse termat dhe konceptet në këtë botë, nuk mund të pasqyrojnë një pamje të plotë e të perifrashuar të kuptimeve.

Më pas, Kur'ani Fisnik thotë: **"...ndërsa në lartësitë e tij do të ndodhen njerëz, të cilët i njohin të dyja palët sipas tipareve..."** Ata i shohin të gjithë banorët e Xhennetit dhe banorët e Zjarrit dhe i njohin ata nga shenjat e tyre në fytyrë.

"El A'rafu" është shumësi i fjalës "Urfun" dhe ka kuptimin e vendit dhe të pozicionit të ngritur. Kjo fjalë përdoret edhe për flokët e kalit të dala mbi ballë e për pendën që gjendet mbi qafën e gjelit. Kështu thuhet: "krifa e kalit" ose "lafsha e gjelit". Me këtë logjikë, edhe për vendin e ngritur të një trupi përdoret termi "Urfun". (Pasi të mbarojmë me komentimin e ajeteve, do të flasim

me hollësi rreth veçorive të zonës së "A'rafit", e cila përmendet në këtë ajet).

Më pas thuhet: Me të vërtetë, ata burra i thërrasin banorët e Xhennetit dhe i përshëndesin ata, por ata nuk hyjnë në Xhennet, pavarësisht se e dëshirojnë një gjë të tillë: **"...Ata do t'u thërrasin banorëve të Xhennetit: 'Paqja qoftë mbi ju!' Ata nuk do të kenë hyrë ende në Xhennet, ndonëse shpresojnë."**

Por kur hedhin vështrimin nga ana tjetër, ata i shohin banorët e Zjarrit duke patur nxehtë në të dhe i luten All'lahut, duke i kërkuar që të mos i lërë me mizorët: **"E kur t'i kthejnë sytë nga banorët e Zjarrit, do të thonë: 'O Zoti ynë! Mos na hidh midis këtyre njerëzve të padrejtë!'"**

Ia vlen të përmendim se kur flitet për shikimin e banorëve të Zjarrit në ajet, përdoret fraza **"E kur t'i kthejnë sytë..."**, domethënë u shkon shikimi nga Xhehenemi për të parë banorët e tij. Ky është një tregues se ata e urrejnë pamjen e banorëve të Zjarrit dhe se shikimi i tyre shoqërohet me urrejtje e dhunë.

Në ajetin pasardhës thuhet: Zotëruesit e "A'rafit" thërrasin një grup nga banorët e Xhehennemit, të cilët i njohin nga shenjat në fytyrë dhe i qortojnë ata, duke u thënë: **"A nuk e shihni se grumbullimi i pasurive, i njerëzve, diktati dhe mendjemadhësia për pranimin e së vërtetës nuk ju sollën asnjë dobi? Ku janë ato pasuri dhe ata përkrahës? Çfarë korrët nga këto qëndrime e cilësi të këqija?! "Pastaj, njerëzit e Murit (A'râf) do t'u thërrasin disa njerëzve që i njohin nga pamja, duke u thënë: 'Nuk ju ndihmoi as grumbullimi i pasurisë suaj, as kryelartësia juaj (ndaj të Vërtetës).'"**

Edhe një herë tjetër u thonë, duke i qortuar e fajësuar, duke bërë me shenjë kah grupi i besimtarëve të dobët e duke qëndruar

mbi mur (A'raf): **"A janë këta për të cilët u betuat se nuk do t'i arrijë mëshira e All'llahut?..."**

Në të ardhmen, këtë grup besimtarësh të dobët e përfshin mëshira e All'llahut dhe atyre u thuhet: **"...Ndërsa atyre do t'u thonë sërish: 'Hyni në Xhennet! Për ju s'ka frikë e as pikëllim!'"**

Nga e gjitha ajo që thamë, bëhet e qartë se besimtarët e dobët janë ata që besuan dhe bënë vepra të mira, por për shkak të rënies së tyre në disa mëkate, ata qenë mospërfillës ndaj armiqve të së drejtës në këtë botë. Jobesimtarët përqëndroheshin tek ata dhe thonin: Si është e mundur që të tillë njerëz t'i përfshijë mëshira e All'llahut? Si është e mundur që të tillë njerëz të lumturohen? Por, shpirti i besimit dhe veprat e mira që ata kanë bërë dhe përfshirja nën hijen e mëshirës së All'llahut, bënë që ata të lumturohen dhe të hyjnë në Xhennet.

Hulumtime

Kush janë zotëruesit e "El A'rafit"?

Siç e thamë edhe më lart, *"El A'raf"*, është një zonë e ngritur. Ky term sqarohet në dritën e argumenteve të ardhura në ajetet e Kur'anit dhe në hadithet e prijësve myslimanë, ku thuhet se ai është një vend i veçantë ndërmjet dy poleve të lumturisë e të pikëllimit, pra Xhennetit dhe Zjarrit. *"A'rafi"* është si një perde madhështore ndërmjet Xhennetit e Xhehennemit, ose si një tokë e ngritur që i ndan këto dy vende, ai që qëndron mbi të, mbikqyr e sheh ata që qëndrojnë në Xhennet apo në Zjarr dhe i njohin ata nga fytyrat e tyre të bardha ose të zeza, të ndritura ose të zymta.

Por, kush janë ata që qëndrojnë mbi "A'raf" dhe kush janë zotëruesit e "A'rafit"?

Nga studimi i katër ajeteve në fjalë përftohet se Kur'ani Fisnik u përmend këtyre personave dy lloje të kundërta e të ndryshme cilësishë:

Kështu, që në ajetin e parë dhe të dytë, Kur'ani i përshkruan qëndruesit mbi "A'raf" si njerëz që ëndërrojnë të hyjnë në Xhenet, por në atë vend ka pengesa. Ata vështrojnë nga banorët e Xhenetit, i përshëndesin dhe u japin atyre Selam dhe kanë dëshirë që të jenë me ta, por nuk mund ta bëjnë këtë. Kur ata vështrojnë nga banorët e Zjarrit, i tremben atij fundi dhe i kërkojnë mbrojtje All'Ilahut që të mos përfundojnë si ata.

Nga ajeti i tretë dhe i katërt mësohet se ata janë individë ndikues e të fortë, i qortojnë banorët e Zjarrit dhe i shajnë ata, si dhe i ndihmojnë të dobët të kalojnë në shtëpinë e lumturisë. Edhe transmetimet e transmetuara në këtë fushë, gjithashtu, i kanë ndarë banorët e "A'rafit" në dy grupeve të ndryshme.

Kështu, në disa hadithe të transmetuara nga prijësit e Ehli Bejt (Paqja qoftë mbi ta!), lexojmë: "Ne jemi "A'raf"¹ ose shprehja: "Familja e Muhammedit janë "El A'raf"² e të ngjashme me këto fraza. Nga një grup tjetër thuhet: "Ata janë krijesat më fisnike të All'Ilahut të Lartësuar"³, ose "Ata janë dëshmitarë mbi njerëzit dhe Profetët, janë dëshmitarë të tyre"⁴ si dhe transmetime të tjera që thonë se "El A'raf" janë Profetët, Prijësit, punërmirët dhe të dashurit e All'Ilahut.

¹ Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 17, 18 dhe 19.

² Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 17, 18 dhe 19.

³ Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 17, 18 dhe 19.

⁴ Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 33.

Por një grup tjetër, siç është transmetuar nga Imam Sadiku, thotë: *"Ata janë njerëz, të cilëve u barazohen të mirat dhe të këqijat. Kështu, nëse ata hyjnë në Zjarr, atëherë kjo është për shkak të mëkateve të tyre, e nëse hyjnë në Xhennet, atëherë ky përfundim është për shkak të mëshirës së All'Ilahut."*¹

Në lidhje me këtë temë, ka transmetime dhe komentime të shumta edhe nga Ehli Syneti, si nga Hudhejfe, Abdullah ibn Abas, Said ibn Xhubejr, etj.²

Në këto komentime thuhet gjithashtu se banorët e "A'rafit" janë punërmirët, juristët, dijetarët ose melekët.

Edhe pse në pamje të parë, duket se këto ajete dhe transmetime janë kontradiktore, çka mund të jetë edhe shkak që i bëri komentuesit e kësaj fushe të jepnin mendime të ndryshme, por po të thellohemi në arsyetim, bëhet e qartë se nuk ka kundërshtim dhe kontradiktë as ndërmjet ajeteve dhe as ndërmjet haditheve, por që të gjitha ato tregojnë një të vërtetë të vetme.

Nga grupi i ajeteve dhe i transmetimeve tregohet se "A'raf" janë rrugëkalime të vështira drejt Xhennetit dhe lumturisë së përhershme. Të fortët, vepërmirët e të pastrit i kalojnë këto shtigje të vështira me shpejtësi, ndërsa të dobët, të cilët i kanë përzier veprat e mira me ato të këqija, e kanë të vështirë kalimin.

Gjithashtu, prijësit dhe udhëheqësit e grupeve të popullit qëndrojnë në këto rrugëkalime të vështira, ashtu sikurse komandantët e ushtarëve, të cilët në të tilla raste ecin në fund të ushtrisë së tyre; ata qëndrojnë atje për t'i ndihmuar njerëzit që janë me besim të dobët. Në këtë mënyrë, ia del të shpëtojë me begatinë e ndihmës e të përkrahjes së tyre.

¹ Tefsiri "Burhan", vëll. 2, f. 17.

² Tefsiri "Xhamiul Bejjan", vëll. 7, f. 137 dhe 138, fundi i ajetit në fjalë

Duke u bazuar mbi atë që u tha më lart, zotëruesit e "El A'raf" janë dy grupe: 1) ata që kanë besim të dobët, që janë të lidhur me mëkatet e që kanë nevojë për mëshirë, dhe 2) prijësit udhëheqës, të cilët i ndihmojnë të dobët në të gjitha rastet.

Kështu, grupi i parë i ajeteve dhe i haditheve flet për grupin e parë të atyre që qëndrojnë mbi *krifa*, të cilët janë të dobët; ndërsa grupi i dytë flet për zotëruesit e dytë të "El A'raf", që janë udhëheqësit, Profetët, Prijësit dhe vepërmirët.

Gjithashtu, në disa transmetime jepet një dëshmi e qartë për këtë grup. Një shembull për këtë është edhe hadithi i transmetuar nga imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), ku thuhet: *"El A'raf", janë dy distanca të shkurtra ndërmjet Xhennetit e Zjarrit, dhe prijësit qëndrojnë mbi A'raf me pasuesit e tyre dhe u paraprijnë besimtarëve për në Xhennet pa llogari*". Me termin "shi'itët" nënkuptohen ata që qëndrojnë me prijësit mbi A'raf, mëkatarët prej tyre.

Më pas, ai shton duke thënë: *"E thonë prijësit për pasuesit e tyre, për ata që kanë mëkatuar: Shikoni nga vëllezërit tuaj në Xhennet; ata ju kanë paraprirë juve pa llogari që është edhe thënia e All'llahut të Lartësuar: "Ata i thërrasin banuesit e Xhennetit: "...Ata do t'u thërrasin banorëve të Xhennetit: 'Paqja qoftë mbi ju!' Ata nuk do të kenë hyrë ende në Xhennet, ndonëse shpresojnë..."*. Më pas u thuhet: Shikoni nga armiqtë tuaj në Zjarr. Kjo lidhet me thënien e All'llahut: **"E kur t'i kthejnë sytë nga banorët e Zjarrit, do të thonë: 'O Zoti ynë! Mos na hidh midis këtyre njerëzve të padrejtë!'"** Më pas, për ata që janë në Zjarr nga armiqtë e tyre, ata thonë: *"Ata janë pasuesit (shiat) dhe vëllezërit e mi, me të cilët ishit në kontradikta (betoheshit) se nuk do i arrijë All'llahu me*

mëshirën e Tij; pas kësaj, prijësit thonë për pasuesit e tyre: “Hyni në Xhennet, nuk ka frikë për ju dhe as mos u zemëroni.”¹

Një përmbajtje e ngjashme me këtë është transmetuar në komentimet e Ehli Syneetit nga Hudhejfe i cili ka transmetuar nga Profeti (Paqja dhe bekimi i All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)²

Përsërisim edhe një herë tjetër se hadithi rreth detajeve të Ditës së Ringjalljes dhe veçorive të jetës së Botës Tjetër është sikur ne të donim të përshkruajmë një hije apo fantazmë nga larg, ndërkohë që ndërmjet kësaj hijeje dhe jetës sonë ka një dallim e ndryshim të madh.

Jeta në Botën Tjetër është e ndërtuar mbi bazë të modeleve e të burimeve të kësaj bote. E tillë është situata edhe për sa u përket "A'raf-it" sepse njerëzit në këtë botë janë tre grupe:

1- besimtarët e singertë, të cilët kanë arritur një rehati të plotë nën dritën e besimit dhe kanë bërë çdo përpjekje në rrugën e përkushtimit;

2- kundërshtarët dhe armiqtë e së drejtës, të kryqëzuar e të kapur pas arrogancës së tyre, të cilët nuk udhëzohen me asnjë mjet;

3- grupi i tretë janë ata që qëndrojnë mbi këtë trotuar të vështirë për t'u kaluar – në mes të dy grupeve. Për ta, përkujdesja më e madhe është ajo e udhëheqësve besnikë dhe e prijësve të drejtë, të cilët i drejtojnë e u qëndrojnë në krah, duke i marrë për dore për t'i shpëtuar e duke i dhënë fund etapës së “A'raf-it” me vendosjen e tyre në radhët e besimtarëve të vërtetë.

¹ "Biharul Anuar", vëll. 8, f. 335. Tefsiri "Safij", vëll. 2, f. 202.

² Tefsiri "Xhamiul Bejjan", vëll. 7, f. 249 e më pas.

Që këtu sqarohet se ndërhyrja e Profetëve dhe e Prijësve për shpëtimin e këtij grupi në Botën Tjetër, është si ndërhyrja e tyre për këtë qëllim në këtë botë. Kjo ndërhyrje nuk mohon asnjëherë fuqinë e All'llahut dhe mençurinë e Tij mbi çdo gjë. Përkundrazi, gjithçka që bëjnë ata, ndodh me lejen e All'llahut të Lartësuar dhe me urdhrin e Tij.

Ajetet 50 - 51

وَنَادَىٰ أَصْحَابُ النَّارِ أَصْحَابَ الْجَنَّةِ أَنْ أَفِضُوا عَلَيْنَا مِنَ
الْمَاءِ أَوْ مِمَّا رَزَقَكُمُ اللَّهُ ۚ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ حَرَّمَهُمَا عَلَى
الْكَافِرِينَ ﴿٥٠﴾ الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَهُمْ لَهْوًا وَلَعِبًا وَغَرَّتْهُمْ
الْحَيَاةُ الدُّنْيَا ۚ فَالْيَوْمَ نَنْسَلُهُمْ كَمَا نَسُوا لِقَاءَ يَوْمِهِمْ هَذَا
وَمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا يَجْحَدُونَ ﴿٥١﴾

"Banorët e Zjarrit do t'u thërrasin banorëve të Xhennetit:
'Derdhni pak ujë te ne ose diçka nga ajo që ju ka dhuruar
All'llahu!' Ata thonë: 'Në të vërtetë, All'llahu këto i ka ndaluar
për mohuesit.'"

"Të cilët e morën fenë për lojë dhe argëtim dhe u mashtruan nga
jeta e kësaj bote". Ne sot do t'i harrojmë ata, ashtu siç e patën
harruar ata takimin e kësaj Dite dhe siç i mohuan shpalljet
Tona."

Komentimi

Begatitë e Xhenetit janë të ndaluara për banorët e Xhehennemit

Pasi secili nga banorët e Xhenetit dhe të Zjarrit vendosen në vendet e veta, ndërmjet tyre bëhet një dialog, rezultati i të cilit është dënimi shpirtëror dhe moral për banorët e Zjarrit.

Fillimisht, ajeti nis me fjalën e banorëve të Zjarrit: **"Banorët e zjarrit do t'u thërrasin banorëve të Xhenetit: 'Derdhni pak ujë te ne ose diçka nga ajo që ju ka dhuruar All'illahu!...'";** kështu, ata kërkojnë që t'u japin ujë, ose diçka tjetër nga begatitë e Xhenetit.

Por banorët e Xhenetit ua refuzojnë këtë kërkesë, duke u thënë: **"Ata thonë: 'Në të vërtetë, All'illahu këto i ka ndaluar për mohuesit.'"**

Hulumtime

Këtu do të ndalemi në disa çështje, të cilat janë të rëndësishme për t'u trajtuar:

1- Kur'ani Fisnik e fillon bisedën e banorëve të Zjarrit me banorët e Xhenetit, me termin *"nada"* - **"thirrën"**, i cili zakonisht përdoret për të folur nga një vend i largët. Kjo tregon se ndërmjet dy grupeve ka një ndarje të madhe, e megjithatë zhvillohet ky dialog dhe gjithsecili prej tyre e dëgjon bisedën e tjetrit. Kjo nuk është e çuditshme, pasi edhe sikur distanca të arrijë miliona kilometra, do të mundësohej që secili prej tyre të dëgjonte fjalën e tjetrit, madje, ndonjëherë edhe ta shohë palën tjetër.

Sikur të ishte pranimi i kësaj çështjeje i vështirë në të kaluarën dhe të përbënte problem për dëgjuesit, atëherë transmetimi i zërit e i pamjes në kohën e sotme nga distanca shumë të largëta e ka zgjidhur këtë problem dhe ajeti në fjalë nuk konsiderohet i çuditshëm dhe i habitshëm.

2- Gjëja e parë që kërkojnë banorët e Xhehennemit është uji. Kjo është diçka e natyrshme, sepse njeriu që digjet në zjarrin e nxehtë kërkon ujë para çdo gjëje tjetër, në mënyrë që me të të ulet nxehtësinë e tij e të shuajë etjen.

3- Me të vërtetë, fraza **“...ose diçka nga ajo që ju ka dhuruar All'Ilahu”**, e cila është e përmbledhur, karakterizohet me paqartësi dhe tregon se banorët e Zjarrit nuk mund të dinë asgjë nga e vërteta e begative të Xhenetit dhe e llojeve të tyre. Kjo temë trajtohet në disa hadithe, ku thuhet: *“Me të vërtetë, në Xhenet ka mirësi të cilat as sytë nuk i kanë parë, as veshët nuk i kanë dëgjuar e as nuk u kanë ardhur në mendje njerëzve.”*¹

Lidhja e fjalisë me pjesëzën **“eu” – “ose, apo”** tregon se begatitë e tjera të Botës Tjetër, e veçanërisht frutat, mund të zëvendësojnë ujin e t'ia shuajnë etjen njeriut.

4- Fraza **“All'Ilahu këto i ka ndaluar për mohuesit”** tregon se nuk janë banorët e Xhenetit ata që e ndalojnë dhënien e diçkaje nga këto begati për banorët e Zjarrit, sepse atyre nuk u pakëson gjë nëse u japin diçka. Kjo nuk ndodh se ata kanë urrejtje apo inat për ndonjërin nga ata në gjokset e tyre, madje as për armiq të tyre, por pozita e banorëve të Zjarrit është e tillë që s'lejohej të përfitojnë nga begatitë e Xhenetit.

¹ "Uesailu Shija", vëll. 10 f. 476 dhe 478.

Në të vërtetë, ky ndalim është një lloj “*ndalimi krijimtar*”, ashtu sikurse ndalimi i shumë të sëmurëve nga ushqimet e shijshme e të llojllojshme.

Në ajetin pasardhës sqarohet shkaku i ndalimit të tyre me përmendjen e cilësive të banorëve të Zjarrit. Banorët e këtij fundi të zi janë ata që e kanë çuar veten e tyre në të. Fillimisht thuhet: Ata janë që fenë e tyre e morën si: **"Të cilët e morën fenë për lojë dhe argëtim..."**

Për më tepër, ata i mashtroi jeta e kësaj bote dhe u tradhëtuan në të: **"...dhe u mashtruan nga jeta e kësaj bote."**

Këto çështje u bënë shkak që të zhyten në epshe e të harrojnë gjithçka, madje edhe Botën Tjetër. Ata i mohonin thëniet e Profetëve dhe përgënjeshtrojnë argumentet e All'Ilahut. Për këtë, ajeti shton duke thënë: **"...Ne sot do t'i harrojmë ata, ashtu siç e patën harruar ata takimin e kësaj Dite dhe siç mohuan shpalljet Tona."**

Është e çuditshme se fjala “*nisjan*” – “**harresa**”, e cila këtu i atribuohet All'Ilahut, është me kuptimin se ne do të veprojmë me ta njësoj si harruesi, siç i thotë dikush shokut të tij: Ashtu siç më ke harruar mua, unë, gjithashtu, do të harroj ty.

Nga ky ajet mësohet se etapa e parë nga etapat e devijimit e të humbjes është kur njeriu nuk i merr seriozisht çështjet përfundimtare, por i sheh ato si zbavitje e argëtim, situatë e cila e çon atë në mosbesim të plotë dhe në mohimin e të gjitha të vërtetave.

Ajetet 52 - 53

وَلَقَدْ جِئْنَهُمْ بِكِتَابٍ فَصَّلْنَاهُ عَلَىٰ عِلْمٍ هُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ
يُؤْمِنُونَ ﴿٥٢﴾ هَلْ يَنْظُرُونَ إِلَّا تَأْوِيلَهُ ۚ يَوْمَ يَأْتِي تَأْوِيلَهُ يَقُولُ
الَّذِينَ نَسُوهُ مِنْ قَبْلُ قَدْ جَاءَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ فَهَلْ لَنَا
مِنْ شُفَعَاءَ فَيَشْفَعُوا لَنَا أَوْ نُرَدُّ فَنَعْمَلَ غَيْرَ الَّذِي كُنَّا نَعْمَلُ ۚ
قَدْ خَسِرُوا أَنْفُسَهُمْ وَضَلَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَفْتَرُونَ ﴿٥٣﴾

"Ne u kemi zbritur atyre një Libër, të cilin e kemi shpjeguar gjerësisht, që të jetë udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë."

"A mos vallë ata presin zbatimin e Tij? Kur t'u vijë dita e zbatimit, do të thonë për atë që e patën mohuar më parë: 'Të Dërguarit e Zotit tonë na kanë sjellë të vërtetën! A ka ndonjë ndërmjetësues që të ndërhyjë për ne? A mund të kthehemi sërish në jetën e tokës, që të veprojmë ndryshe nga ç'kemi punuar'. Me siguri që ata do t'i humbasin shpirtrat e tyre dhe ajo që trillonin do t'i braktisë."

Komentimi

Në radhë të parë, këto ajete tregojnë se ndalimi i jobesimtarëve dhe fundi i tyre fatkeq janë rezultat i kufizimit të vetvetes së tyre, sepse nga ana e All'Ilahut nuk ka asnjë kufizim në udhëzimin e drejtimin e tyre, në transmetimin e argumenteve tek ata dhe në sqarimin e mësimëve edukative për ta. Për këtë, All'Ilahu i Lartësuar thotë: "Me të vërtetë ne nuk kemi kursyer asgjë në aspektin e udhëzimit e këshillimit të njerëzve, madje dërguam për ta një Libër ku shpjeguam çdo gjë me mençuri e dituri: **"Ne u kemi zbritur atyre një Libër, të cilin e kemi shpjeguar gjerësisht..."**

Ai është një Libër, në të cilin ka mëshirë e udhëzim, jo për kundërshtarët egoistë, por për besimtarët: **"...që të jetë udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë."**

Ajeti pasardhës tregon për rrugën e gabuar të mohimit të mëkatarëve të devijuar nga udhëzimi i All'Ilahut dhe thotë: **"A mos vallë ata presin zbatimin e Tij?..."**; pra, sikur ata presin që të shohin rezultatin e premtimit dhe takimin hyjnor me sytë e tyre (pra, shohin banorët e Xhennetit dhe ata janë në të dhe banorët e Zjarrit dhe ata janë në të) derisa të besojnë.

Por ajo është një pritje e pretendim i ulët, sepse në momentin që shkoqiten premtimet hyjnore në kontekstin real, përfundon çështja dhe nuk mbetet hapësirë për t'u kthyer dhe as rrugë kthimi; atje, ata do të pranojnë se e kanë harruar librin e All'Ilahut dhe nuk i dinin direktivat hyjnore, të cilat i zbriti mbi të Dërguarit me të drejtë, thëniet e të cilëve ishin gjithashtu të drejta: **"...Kur t'u vijë dita e zbatimit, do të thonë për atë që e patën mohuar më parë: 'Të Dërguarit e Zotit tonë na kanë sjellë të vërtetën...'"**

Në këtë kohë, ata do të zhyten në pasiguri e çoroditje duke menduar për fundin që mund t'i shpëtojë nga ky problem dhe do të thonë: **"...A ka ndonjë ndërmjetësues që të ndërhyjë për ne?..."** Dhe nëse nuk ka ndërmjetës për ne, a nuk mund të kthehemi në dynja e të kryejmë vepra jo si ato që kemi kryer më parë, e të dorëzohemi ndaj së drejtës e të vërtetës? - **"...A mund të kthehemi sërish në jetën e tokës, që të veprojmë ndryshe nga ç'kemi punuar..."**

Por për fat të keq, ky rezultat erdhi shumë vonë. Për ta nuk ka rrugë kthimi dhe as nuk u ofrohet ndërmjetësim, sepse ata u zhytën në humbje: **"...Me siguri që ata do t'i humbasin shpirtat e tyre..."**

Atyre do t'u vërtetohet se idhujt dhe faltoret e tyre nuk kanë asnjë gradë për ta dhe se në realitet i humbën të gjitha: **"...dhe ajo që trillonin do t'i braktisë."**

Duket sikur dy fjalitë e fundit janë kundërpërgjigje e kërkesës së tyre; pra, nëse ata duan ndërmjetës për vete, atëherë mund të ndërmjetësojnë menjëherë me idhujt që u janë përrulur. Por ata idhuj e puta nuk kanë asnjë ndikim atje. Nga ky ajet përfitohet se:

Së pari: Njeriu është i lirë dhe i zgjedh vetë veprat e tij, përndryshe, pse duhet të kërkojë kthim në këtë botë për kompensuar ato që kanë kaluar?

Së dyti: Në të vërtetë, Bota Tjetër nuk është vend pune, as vendi i fitimit të mirësive e i shpëtimit.

Ajeti 54

إِنَّ رَبَّكُمُ اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ
ثُمَّ اسْتَوَى عَلَى الْعَرْشِ يُغْشَى اللَّيْلَ النَّهَارَ يَطْلُبُهُ حَثِيثًا
وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ وَالنُّجُومَ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ ۗ أَلَا لَهُ الْخَلْقُ
وَالْأَمْرُ ۗ تَبَارَكَ اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ ﴿٥٤﴾

"Në të vërtetë, Zoti juaj është All'Ilahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar All'Ilahu, Zoti i botëve!"

Komentimi

Ajeti në fjalë përshkruan të adhuruarin e vërtetë, me përmendjen e cilësive të Tij të veçanta, në mënyrë që ata që kërkojnë të vërtetën e që e hulumtojnë atë, të mund ta njohin Zotin me qartësi në këtë botë, para mbërritjes së Ditës së Ringjalljes. Ajeti fillon me fjalët: "Vërtet, Zoti juaj, All'Ilahu,

është Ai që krijoi qiejt dhe Tokën brenda gjashtë ditësh"; pra, i adhuruari nuk mund të jetë i tillë, vetëm nëse është krijues.

A është krijuar bota në gjashtë ditë?

Krijimi i botës dhe strukturimi i saj në gjashtë ditë është përmendur në shtatë vende të Kur'anit Fisnik¹. Por, në tre vende, frazës "qiejve dhe tokës" u shtohet edhe fraza **"dhe çfarë ka ndërmjet tyre"**, e cila është sqarim i fjalisë së mëparshme, sepse ne e dimë se qielli përmbledh gjithçka që gjendet lart dhe se toka është pika e kundërt e qiellit.

Këtu lind pyetja: Para se të krijohen qiejt dhe toka nuk kishte natë e as ditë që të thuhet se qiejt dhe toka u krijuan në këto të dyja (natën dhe ditën), sepse nata dhe dita lindin si rezultat i rrotullimit të tokës rreth vetes së saj e rreth diellit.

Për më tepër, shfaqja e universit në gjashtë ditë, pra më pak se një javë, bie në kundërshtim me shkencën, e cila thotë se krijimi i tokës dhe i qiejve ka zgjatur me miliarda vjet derisa ka mbërritur në gjendjen e tanishme.

Por duke patur parasysh kuptimin e gjerë të termit *"jeumun"* dhe ekuivalenten e saj në gjuhë të ndryshme, përgjigjja e kësaj pyetjeje është e qartë, sepse shpeshherë fjala *"jeumun"* përdoret me kuptimin "cikël", pavarësisht nëse zgjat për një vit, njëqind vjet, një milion vjet apo miliarda vjet. Dëshmitë që vërtetojnë se një nga kuptimet e fjalës *"jeumun"* është edhe "cikël" janë të shumta:

¹ Ato vende janë: Ajeti në fjalë, ajeti 3 i sures "Junus"; ajeti 7 i sures "Hud"; ajeti 59 i sures "Furkan"; ajeti 4 i sures "Sexhde", ajeti 38 i sures "Kaf" dhe ajeti 4 i sures "Hadid".

1- Në Kur'anin Fisnik, termi "jeumun" është përdorur qindra herë dhe në shumë vende jo në kuptimin e natës dhe të ditës, për shembull, kur përshkruhet Dita e Ringjalljes. Kjo dëshmon se i gjithë procesi i ringjalljes, që është një cikël që zgjat për një periudhë shumë të gjatë, quhet Dita e Ringjalljes.

Nga disa ajete kur'anore mësohet se Dita e Ringjalljes dhe llogaritja e veprave të njerëzve zgjat pesëdhjetë mijë vjet (surja "El Mearixh", ajeti 4).

2- Gjithashtu, në librat e gjuhës lexojmë se termi "jeumun" mund të përdoret për të treguar kohën ndërmjet lindjes së diellit dhe perëndimit të tij, por edhe për të treguar një hark kohor, pavarësisht gjatësisë së tij. Në librin "El Mufredat", Er Ragib ka thënë: *"Me fjalën "jeumun" përshkruhet koha nga lindja e diellit deri në perëndim të tij. Gjithashtu, ajo mund të thuhet për një periudhë kohe, pavarësisht gjatësisë së saj."*

3- Në transmetimet e imamëve të fesë e të hadithit thuhet se fjala "jeumun" përdoret edhe me kuptimin "ed dehru", siç është transmetuar nga Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) në librin "Nehxhul Belaga" se ka thënë: *"Epoka është dy ditë, një ditë për ty dhe një ditë kundra teje."*¹

Në tefsirin "El Burhan", për komentimin e këtij ajeti nga Ali ibn Ibrahim, lexojmë se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të*) ka thënë: *"... Në gjashtë ditë, pra në gjashtë kohë", pra në gjashtë cikle.*²

4- Shpeshherë, në bashkëbisedimet e përditshme dhe në poezitë e poetëve në gjuhë të ndryshme, shohim se fjala "jeumun" dhe ekuivalentja e saj përdoren me kuptimin "cikël" dhe "periudhë".

¹ Sherh "Nehxhul Belaga", i ibn Ebi el Hadijd, vëll. 18, f. 60.

² Tefsiri "Kumij", i Ali ibn Ibrahim: vëll. 1, f. 236. Tefsiri "Nuruth Thekalejn", vëll. 2, f. 38.

Për shembull, themi se një ditë toka ka qenë e nxehtë dhe e ndezur dhe një ditë e ftohtë e në të shfaqeshin gjurmët e jetës, ndërkohë që periudha e nxehtësisë dhe e ndezjes së saj ka zgjatur miliarda vjet. Ose kur themi Beni Umeje e uzurpuan "*jeumen*", për një periudhë, khilafetin islam dhe Beni Abas në një periudhë tjetër, ndërkohë që uzurpimi i khilafetit nga emevitët zgjati dhjetra vite dhe uzurpimi i abasitëve zgjati me qindra vjet.

Nga ajo çfarë u tha më lart, rezulton se All'Ilahu i Lartësuar i krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë cikle të njëpasnjëshme, edhe nëse çdo cikël prej tyre ka zgjatur miliona apo miliarda vjet. Shkenca moderne nuk sqaron asnjë çështje që bie në kundërshtim me këtë temë.

Sipas gjasave, këto cikle kanë këtë renditje:

1- Në një kohë, universi ka qenë në formën e një lëmshi të gaztë dhe prej tij u shkëputën pjesë si pasojë i rrotullimit të tij rreth vetes dhe nga lëndët e shkëputura u formuan sfera dhe yje.

2- Këto sfera u shndërruan në mënyrë graduale në formë lëmslesh nga lëndë shkrirëse të nxehta apo të ftohta të afta për banim.

3- Në ciklin tjetër u formua sistemi diellor dhe toka u nda nga dielli.

4- Në ciklin e katërt, toka u ftoh dhe u bë e gatshme për jetë.

5- Më pas, në tokë u shfaqen bimët e pemët.

6- Në fund, mbi sipërfaqen e tokës u shfaqën kafshët dhe njeriu.

Të gjitha ato që përmendëm më lart, pra gjashtë ciklet për procesin e krijimit dhe të përbërjes së qiejve e të tokës, përputhen

me ajetet 8 - 11 të sures “Fussilet”, komentimi i së cilës do të bëhet më vonë.

Përse All'Ilahu nuk e krijoi botën në një çast të vetëm?

Këtu shtrohet një pyetje tjetër: Përse All'Ilahu i krijoi qiejt dhe tokën në cikle të shumta e të gjata, kur Ai është i aftë t'i krijojë ato në një çast të vetëm?

Përgjigjja e kësaj pyetjeje qëndron në arsyetimin se nëse krijimi i krijesës do të përfundonte në një çast të vetëm, atëherë ky do të ishte një argument më i vogël për madhësinë e Krijuesit, për aftësinë dhe diturinë e Tij. Por kur procesi i krijimit dhe i formësimit kryhet në etapa të ndryshme e në forma të llojllojshme sipas një programi sistematik e të llogaritur, atëherë ky është një argument më i qartë për njohjen e Krijuesit.

Kështu për shembull, nëse sperma e njeriut do të shndërrohej në një të sapolindur të plotë, në një çast të vetëm, atëherë kjo nuk do të na tregonte madhësinë e krijimit e të formimit. Por, kur i sapolinduri lind pas 9 muajsh në përputhje me një program të hollësishëm dhe merr çdo ditë e muaj një formë e pamje të veçantë, atëherë secila nga etaprat është një argument i ri i madhësisë së All'Ilahut dhe e aftësisë së Krijuesit.

Më pas, Kur'ani Fisnik thotë: **“...e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë)...”**

Kjo është një përgjigje për atë që pretendon se universi është i nevojshëm për All'Ilahun e Lartësuar në krijim dhe jo në ekzistencë e vazhdimësi.

Çfarë është Arshi?

Në gjuhë, “*El Arsh*” është diçka që ka çati. Kjo fjalë mund të përdoret edhe për çatinë, për shembull, siç thuhet në fjalën e All'Ilahut të Lartësuar: **“... Ose si ai që kaloi pranë një fshati të rrënuar për tokë...”**¹

Një tjetër kuptim mund të jetë për të treguar një familje të madhe e të ngritur, si familjet e mbretërve e sulltanëve, ashtu siç ka ardhur në tregimin e Sulejmanit (*Paqja qoftë mbi të!*): **“...O parësi, kush prej jush do të më sjellë fronin e saj...”**²

Gjithashtu, termi “*Arsh*” përdoret për çatitë që ngrenë disa fermerë për mbrojtjen e disa bimëve, e veçanërisht të bimëve kacavjerrëse, siç e lexojmë në Kur'anin Fisnik: **“Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara...”**³

Por, kur ky term i atribuohet All'Ilahut të Lartësuar, thuhet “Arshi i All'Ilahut” dhe me të synohet e gjithë bota ekzistuese.

Mbi këtë bazë, fraza: **“... qëndroi mbi Arshin”** nënkupton pushtetin e një sundimtari në lidhje me çështjet e vendit të tij. Gjithashtu, nga fjalja “mbretëria e tij u shemb”, qëllimi është për ikjen e çështjeve nga dora e sundimtarit dhe humbja e pushtetit mbi të. Kjo alegori është përdorur shpeshherë në gjuhë ku thuhet: Një grup njerëzish u revoltuan në filan vend dhe e zbritën sundimtarin e tyre nga shtrati dhe nga arshi i tij, ndërkohë që ai sundimtar, ndoshta, nuk ka fare shtrat.

¹ Sure "Bekare", ajeti 259.

² Sure "Neml", ajeti 38.

³ Sure "En'am", ajeti 141.

Ose të thuhet: Një grup njerëzish e përkrahën filanin dhe e ulën atë mbi arsh. E gjitha kjo lidhet me marrjen në dorë të pushtetit ose me humbjen e tij.

Për këtë, shprehja “qëndroi mbi Arsh” nënkupton gjithëpërfshirjen e plotë të All'llahut në ekzistencë dhe gjithëpushtetin e Tij mbi universin.

Nga këtu sqarohet se ata të cilët e kanë marrë këtë fjali si argument për “trupëzimin e All'llahut” duket sikur nuk e kanë parë përdorimin e shumtë të kësaj fjalie me këtë kuptim figurativ. Për *Arshin* ka edhe një kuptim tjetër. Kjo fjalë transmetohet nganjëherë edhe si ekuivalente e fjalës “*Kursij*”. Në transmetime të tilla si këto, mund të jetë *kursija* që nënkupton botën materiale dhe *Arshi* nënkupton botën përtej materies (pra, bota e shpirtrave dhe melekëve), siç ka ardhur në komentimin e ajetit 255 të sures “Bekare”: “**...Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën**”

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë se Ai e hedh natën si mbulesë mbi ditën dhe e mbulon dritën e ditës me perde të zezë: “**...Ai me errësirën e natës e mbulon ditën...**”

Shprehja e përmendur përdoret vetëm për natën dhe nuk thuhet “mbulon dita natën”, sepse kapaku dhe mbulesa përshtatet vetëm me errësirën dhe jo me dritën.

Pas kësaj thuhet: Në të vërtetë, nata e ndjek ditën: “**...e cila e ndjek atë...**”

Duke parë gjendjen e natës e të ditës në globin tokësor, ky përshkrim është shumë i bukur, sepse nëse dikush shikon mënyrën e lëvizjes së tokës nga jashtë, rrotullimin e saj rreth vetes dhe qëndrimin e hijes së saj në formë konike mbi veten e saj, dhe, duke ditur se globi rrotullohet me shpejtësi të madhe rreth vetes (pra, në kufirin e 30 kilometrave në minutë), do të dallojë se hija

konike e zezë ecën me shpejtësi të madhe mbi këtë glob pas dritës së ditës.

Por, kjo çështje është e pavërtetë për sa i përket dritës së ditës, sepse drita e diellit është e përhapur në gjysmën e globit tokësor dhe në të gjithë hapësirën perimetrike të anëve të tokës, dhe nuk merr për veten e saj një formë të veçantë; vetëm errësira e natës është ajo që rrotullohet si hije e panjohur rreth tokës.

Më pas, All'llahu i Lartësuar shton se është Ai që i krijoi diellin, hënën dhe yjet, të nënshtruara ndaj urdhrit të Tij pas krijimit të tyre: **"...Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrit të Tij..."** (Me lejen e Zotit, rreth nënshtrimit të diellit, hënës, yjeve dhe kuptimeve të tyre, do të flasim në fund të ajeteve që kanë lidhje me këtë temë).

Pas përmendjes së krijimit të botës dhe sistemit të natës e të ditës, krijimit të diellit, hënës e yjeve, Zoti i Lartësuar thotë me siguri: *Dijeni se krijimi i universit dhe menaxhimi i çështjeve të tij, të gjitha janë në dorën e Tij. I Lartësuar është Ai, s'ka tjetër përveç Tij* **"...Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi..."**

Çfarë janë "krijimi" dhe "sundimi"?

Komentuesit kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me qëllimin e fjalëve "krijim" dhe "sundim". Duke parë krahasimet ekzistuese në këtë ajet dhe në ajetet e tjera të Kur'anit, mësojmë se qëllimi i fjalës "krijim" është krijimi dhe ekzistenca e parë, ndërsa qëllimi me fjalën "sundim" janë rregullat dhe ligjet sunduese në botën ekzistuese në tërësi, me urdhrin e All'llahut të Lartësuar, të cilat e udhëheqin universin në udhën e tij të diktuar.

Në realitet, ky përshkrim është përgjigje ndaj atyre që përfytyrojnë se All'Ilahu e krijoi universin e më pas e la atë në punë të vet dhe u ul në një anë. Pra, sipas tyre, bota ka nevojë për All'Ilahun në krijimin e saj e jo në qëndrueshmërinë e vazhdimësinë e saj.

Kjo fjali e ajetit thotë: Bota, ashtu siç ka nevojë për krijimin e saj nga All'Ilahu, gjithashtu, ajo ka nevojë për menaxhimin dhe vazhdimin e jetës së saj dhe drejtimin e çështjeve të saj nga All'Ilahu. Sikur All'Ilahu të hiqte përkujdesjen e Tij nga universi, qoftë edhe për një çast të vetëm, atëherë sistemi do të ç'rregullohej e do të shkatërrohej plotësisht.

Disa filozofë e kanë komentuar botën e “krijuar” me botën “materiale” dhe botën e “sundimit” me atë “metafizike”, sepse karakteristikë e të parës është aspekti gradual, ndërsa bota e sundimit ka një aspekt shtytës e të menjëhershëm, që është specifika e botës metafizike. Këtë e lexojmë tek thënia e All'Ilahut të Lartësuar: **“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj 'Bëhu!' - dhe ajo bëhet.”**¹

Duke parë burimet e përdorimit të termit “*emr*” – “**urdhër**” në ajetet e Kur'anit, madje edhe shprehjen **“Edhe Dielli, Hëna dhe yjet të nënshtruara me urdhrin e Tij”**, të transmetuar në ajetin që është objekt studimi, mësohet se kjo fjalë përdoret për çdo urdhër hyjnor, pavarësisht nëse bëhet fjalë për botën materiale apo atë metafizike.

Më pas, në mbyllje të ajetit thuhet: **“I madhëruar është All'Ilahu, Zoti i botëve”**.

Në realitet kjo fjali – pas përmendjes së krijimit të qiejve dhe tokës, natës dhe ditës, diellit, hënës dhe yjeve dhe

¹ Sure "Jasin", ajeti 82.

menaxhimit të botës ekzistuese – është një lloj lavdërimi i Vetës së Shenjtë dhe ka ardhur për mësimin e njerëzve.

Fjala *“tebareke”* rrjedh nga *“el bereke”* dhe origjina e saj është fjala *“berk”* që ka kuptimin e gjoksit të devesë, sepse kur dëshiron të përqendrohet diku, në një vend çfarëdo, deveja e ngjit gjoksin e saj mbi tokë. Kjo është arsyeja që kjo fjalë në mënyrë graduale ka marrë kuptimin e qëndrueshmërisë e të vendosmërisë. Më pas, me këtë fjalë u përshkrua dhe u quajt çdo begati e qëndrueshme dhe e përhershme, çdo qenie me jetë të gjatë, me ndikime dhe mirësi të vazhdueshme. Gjithashtu, kjo fjalë përdoret për vendin ku mblidhet uji në të, *“birketun”*, për qëndrimin e tij në këtë vend për një periudhë të gjatë.

Nga këtu bëhet e qartë se kapitali i begatë është ai i cili përshkruhet me vazhdimësi. Qënia e begatë është e pranishmja e vazhdueshme. Është mëse e sigurtë se ekzistenca më e përshtatshme për këtë cilësi është ekzistenca e All'Ilahut të Lartësuar. Ai është ekzistenca e Bekuar e përhershme dhe e përjetshme dhe për më tepër Ai është burim i të gjitha bereqeteve e të mirave, është burimi i të mirës së vazhdueshme **“...Qoftë bekuar All'Ilahu, Zoti i botëve!”**

Ajetet 55 - 56

أَدْعُوا رَبَّكُمْ تَضَرُّعًا وَخُفْيَةً ۚ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُعْتَدِينَ ﴿٥٥﴾
وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا وَادْعُوهُ خَوْفًا وَطَمَعًا ۚ
إِنَّ رَحْمَتَ اللَّهِ قَرِيبٌ مِّنَ الْمُحْسِنِينَ ﴿٥٦﴾

"Lutjuni Zotit tuaj përlshëm dhe fshehtazi! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin."

"Dhe mos bëni çrregullime në Tokë, pasi është vënë rregulli, ndërsa Atij lutjuni me frikë dhe shpresë. Vërtet, mëshira e All'Ilahut është afër punëmireve."

Komentimi

Kushtet e përgjigjes së lutjes

Ajeti i mëparshëm vërtetoi nën dritën e faktit të qartë, se Ai që e meriton adhurimin është vetëm All'Ilahu. Në këtë kontekst, këtu është transmetuar urdhri me thirrje, që është truri i adhurimit dhe shpirti i tij. Fillimisht, në ajet thuhet: "Lutjuni Zotit tuaj përlshëm dhe fshehtazi..."

Fjala “*et tedaru'u*” në origjinë vjen nga lënda “*dar'u*” dhe ka kuptimin e “**gjirit**”. Për këtë folja e fjalës “*et tederu'u*” është me kuptimin e mjeljes së qumështit nga gjiri. Përderisa gjatë mjeljes, gishtat lëvizin mbi thithkat e gjoksit nga anë të ndryshme të tij për të nxjerrë qumështin, është përdorur kjo fjalë, për të treguar një proces gjatë të cilit duken qartazi lëvizje të veçanta për përlulje e modesti.

Duke u bazuar mbi këtë, ajeti që është objekt studimi dhe fraza “**Lutjuni Zotit tuaj përlulshëm...**” kërkon që ne të pranojmë limitet e përluljes, nënshtrimit dhe të modestisë ndaj All'Ilahut, madje forca e lutjes duhet të pasqyrohet në thellësi të shpirtit të njeriut dhe në të gjitha limitet e ekzistencës së tij, e gjuha të jetë thjesht përkthyesja e saj e të flasë në vend të të gjitha organeve të tjera.

Urdhri i All'Ilahut të Lartësuar në këtë ajet, është që ta thërrasim Atë “*në fshehtësi*”, sepse në këtë mënyrë lutja është larg shtirjes dhe më afër singeritetit. Kështu, thirrja është e shoqëruar me përqendrim të mendimit dhe me praninë e zemrës.

Në një hadith transmetohet se i Dërguari i All'Ilahut (*Paqja dhe bekimet e All'Ilahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur ishte në një nga betejat e tij dhe kur ushtarët e Islamit arritën në një luginë dhe e ngritën zërin e tyre me brohoritje dhe ekzagjerim duke thënë “*La ilahe il'lall'Ilah*”, “*All'Ilahu Ekber*”, ai u tha: “*O njerëz! Uleni zërin për veten tuaj, sepse në të vërtetë, ju nuk po thërrisni një të shurdhër apo një që mungon, por një që dëgjon shumë dhe që është shumë afër. Në të vërtetë, Ai është me ju.*”¹

Po ashtu, është e mundur që në këtë ajet fjala “*tedaru'un*” të ketë kuptimin e lutjes së dukshme dhe fjala “*khufjetun*” të ketë

¹ Tefsiri “*Mexhmaul Bejjan*”, vëll. 4, f. 271.

kuptimin e lutjes së fshehtë, sepse për çdo vend ka një praktikë të posaçme. Kështu që mund të jetë e nevojshme që të bëhet lutja haptazi e mund të jetë e nevojshme që të bëhet lutja fshehtazi. Ka një transmetim që është transmetuar në fund të këtij verseti që e mbështet këtë temë.

Më pas, All'llahu i Lartësuar në mbyllje të ajetit, thotë: **"...Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin."** Pra, All'llahu nuk i do ata që i tejkalojnë kufijtë e caktuar.

Kjo frazë ka kuptime të shumta që përfshijnë çdo lloj armiqësie, kalim kufiri, qoftë me çirrje apo ngritje e zërit gjatë lutjes, apo me shtirje, ose të drejtuarit kah tjetërkush përveç All'llahut gjatë lutjes.

Në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar tregon për një dispozitë që është një prej kushteve të vlefshmërisë së lutjes: **"Dhe mos bëni çrregullime në Tokë, pasi është vënë rregulli..."**

Është e sigurtë se lutjet janë shumë më afër All'llahut në përgjigje, nëse realizohen kushtet e domosdoshme. Prej atyre kushteve është që lutja të jetë e shoqëruar me anë praktike dhe brenda kufinjve dhe të ruhen të drejtat e njerëzve dhe drita e lutjes ta mbulojë të gjithë qenien e lutësit. Kjo është arsyeja se pse shkatërrimtarët dhe mëkatarët nuk marrin përgjigje dhe nuk përfundojnë tek asnjë rezultat i pritur.

Qëllimi i frazës **"shkatërrim pas rregullimit"** mund të jetë rregullimi pas mosbesimit e padrejtësisë ose të dyjave së bashku. Në një transmetim të Imam Bakirit thuhet: *"Në të vërtetë, toka ka qenë e shkatërruar, por atë e rregulloi Profeti i Tij (i All'llahut)"*¹ Ajeti vazhdon duke iu kthyer sërish çështjes së lutjes e duke përmendur një kusht tjetër:

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 272. Tefsiri "Ajashij", vëll. 2, f. 19.

"...ndërsa Atij lutjuni me frikë dhe shpresë..."

Pra, mos jini të kënaqur me veprat tuaja e të mendoni se në jetën tuaj nuk ka asnjë pikë të zezë, sepse ky mendim është një nga faktorët e kthimit prapa e të rënies, ashtu siç nuk duhet të jeni të plogështuar deri në atë gradë, sa të mos e shihni veten tuaj të aftë për faljen e All'llahut dhe për përgjigjen e lutjes, pasi kjo plogështi dhe frikë është një shkak tjetër për fikjen e shkëndijës së mundimit e të përpjekjes. Ju duhet të ngriheni drejt All'llahut të Lartësuar me të dy krahët, të frikës dhe të shpresës, të frikës nga përgjegjësitë dhe rëniet fatale dhe të shpresës në mëshirën dhe mirësinë e Tij.

Në mbyllje të ajetit, për të përforcuar më tepër shkaqet e shpresës në mëshirën e All'llahut, ajeti thotë: **"...Vërtet, mëshira e All'llahut është afër punëmirëve."**

Kjo frazë mund të jetë një nga kushtet e pranimi të lutjes; domethënë, nëse dëshironi që lutja e juaj të mos jetë boshe dhe thjesht lëvizje e gjuhës, atëherë duhet ta shoqëroni atë me veprën e mirë, në mënyrë që t'ju përfshijë mëshira e All'llahut. Me këtë, ajeti përmbledh pesë kushtet e pranimi të lutjes dhe të përgjigjes ndaj saj, të cilat janë:

- 1- Lutja të bëhet me përrultësi e fshehtësi.
- 2- Mos ta kalojë kufirin e drejtësisë.
- 3- Mos të jetë e shoqëruar me shkatërrim e mëkat.
- 4- Të jetë e shoqëruar me frikë e me shpresë në të njëjtën kohë.
- 5- Të jetë e shoqëruar me mirësjellje, mirënjohje e me vepra të mira.

Ajetet 57 - 58

وَهُوَ الَّذِي يُرْسِلُ الرِّيحَ بُشْرًا بَيْنَ يَدَيْ رَحْمَتِهِ ^ط حَتَّىٰ إِذَا
 أَقَلَّتْ سَحَابًا ثِقَالًا سُقْنَهُ لِبَلَدٍ مَّيِّتٍ فَأَنْزَلْنَا بِهِ الْمَاءَ فَأَخْرَجْنَا
 بِهِ ^{هـ} مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ ^ج كَذَٰلِكَ نُخْرِجُ الْمَوْتَى لَعَلَّكُمْ
 تَذَكَّرُونَ ﴿٥٧﴾ وَالْبَلَدُ الطَّيِّبُ يَخْرِجُ نَبَاتُهُ بِإِذْنِ رَبِّهِ ^ط
 وَالَّذِي خُبْتُ لَا يَخْرِجُ إِلَّا نَكْدًا ^ج كَذَٰلِكَ نُصَرِّفُ الْآيَاتِ
 لِقَوْمٍ يَشْكُرُونَ ﴿٥٨﴾

"Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës

së Tij. Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi, i çojmë ato tek ndonjë vend i vdekur, ku lëshon shi dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash; po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit. Këta janë shembuj që t'ua vini veshin."

"Toka e mirë i jep frutat me lejen e Zotit të saj, ndërsa toka e keqe, zor se jep gjë. Kështu, në mënyra të ndryshme, Ne ia shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve mirënjohës."

Komentimi

Patjetër që duhet edukatori dhe aftësia:

Në ajetet e lartpërmendura u paraqitën shumë tregues të çështjes së “krijimit”, pra të Njësimit dhe të njohjes së All'llahut përmes sekreteve të universit. Në ajetet në fjalë së bashku me sqarimin e një grupi begatish të All'llahut, tregohet për çështjen e “Ringjalljes”, në mënyrë që këto dy kërkime të plotësojnë njëri-tjetrin.

Kjo është metodologjia e Kur'anit Fisnik në shumë vende, ku shoqëron “krijimin” me “Ringjalljen”. Ajo që tërheq vëmendjen është se për njohjen e All'llahut dhe gjithashtu për t'i drejtuar shikimet nga çështja e Ringjalljes, Kur'ani përdor si argumente sekrete të gjendura në krijimin e krijesave të kësaj bote. Fillimisht ajeti thotë: **“Ai i dërgon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij...”**

Më pas, në ajet thuhet: Këto erëra që fryjnë nga oqeanet bartin me vete re të rënda, të mbushura me ujë: **“...Kur erërat lëvizin retë e rënda me shi...”**

Më pas i mbart këto re drejt tokave të etura e të thata dhe i ngarkon ato që t'i njomin: **“...i çojmë ato tek ndonjë vend i vdekur...”**

Kështu, uji i jetës zbrazet në çdo vend: **“...ku lëshon shi...”**; dhe me ndihmën e këtij uji, nxjerrim për njerëzinë lloje të ndryshme frytesh e frutash: **“...dhe me anë të tij nxjerr lloj-lloj frutash...”**

Po, me të vërtetë, dielli shndrit në oqeane e detra, kështu që uji avullon e ngrihet lart dhe në shtresat e larta të ftohta të ajrit mblidhen avujt dhe formojnë pjesë të rënda resh. Më pas, ato re i

shpërndajnë erërat, duke i drejtuar në toka që janë të ngarkuara t'i lagin ato, nga e cila krijohet një vesë, prej nga kundërmon era e shiut, e dërguar për jetë e aktivitet.

Në të vërtetë, ato janë përgëzime për zbritjen e shiut. Në një fazë tjetër, pjesa e madhe e resë së shiut zbret pikat e shiut ndërmjet tyre; ato nuk janë shumë të mëdha, që të dëmtojnë bimët e tokën e as shumë të vogla, që të humbin në horizont e të mos mbërrijnë në tokë. Këto pika bien në tokë me qetësi e depërtojnë në të pak e nga pak, duke bërë që të mbijnë te rrënjët e farërat.

Toka e djegur dhe e thatë, e ngjashme me një varrezë të errët, të qetë e të vdekur, shndërrohet në një qendër aktive, me jetë e lëvizje dhe në të përhapen embrionet e gjelbra, të pasura me lule e fryte.

Më pas, në të njëjtin kontekst, në ajet thuhet: **"...po kështu do t'i ringjallë edhe të vdekurit..."**; Ne u veshim atyre veshjen e ekzistencës dhe të jetës edhe një herë tjetër.

Ne kemi ardhur me këtë shembull, në mënyrë që t'ju tregojmë për kthimin në jetën e kësaj bote, i cili përsëritet përpara syve tuaj çdo ditë: **"...Këta janë shembuj që t'ua vini veshin."**

Në ajetin pasardhës, në mënyrë që të mos mendojë ndokush se zbritja e shiut në një vend të vetëm, bën që të gjitha tokat të gjallërohen në të njëjtën kohë, ajeti shton: **"Toka e mirë i jep frutat me lejen e Zotit të saj..."** Pra, toka e vlefshme është ajo që përfiton nga shiu dhe me lejen e Zotit të saj, i mbijnë frutat më të mira.

Ndërsa në tokat e këqija e shterpë nuk mbijnë veçse disa drurë të padobishëm: **"...ndërsa toka e keqe, zor se jep gjë..."**¹

¹ Fjala "en nekdu" ka kuptimin "el bakhijl", kopraci nga i cili nuk mund të merret asgjë me lehtësi. Nëse jep diçka të pakët e të neveritshme. Tokat e kripura dhe ato jopjellore janë ngjasuar me me këtë person (kopracin)

Kështu do të jetë çështja e ringritjes, edhe nëse është shkak për kthimin e jetës së të gjithë njerëzve, veçse jo të gjithë ata kthehen në një mënyrë a në një formë të vetme; ata janë të ndryshëm e të dallueshëm, ashtu siç është dallimi ndërmjet tokës së ëmbël me tokën e kripur. Po, ata dallojnë dhe ky dallim është si rrjedhojë e veprave, bindjeve dhe qëllimeve të tyre.

Më pas, në mbyllje të ajetit, thuhet: Në të vërtetë, këto argumente i sqarojmë për ata që janë falënderues dhe që përfitojnë nga shembujt e argumentet e tyre, duke ndjekur në dritën e tyre rrugën e udhëzimit: **"...Kështu, në mënyra të ndryshme, Ne ia shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve mirënjohës."**

Në të vërtetë, ajeti që është objekt studimi tregon një çështje të rëndësishme, e cila shfaqet qartë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër, në çdo vend, ajo është: Veprimi i vepruesit nuk mjafton në produktivitet e në konkluzion të saktë, por duhet të gjendet patjetër aftësia pritëse. Ajo është kushti i produktit dhe i konkluzionit. Nuk ka gjë më të mirë e më ndikues për jetën se sa pikat e shiut, por vetë ky shi, për të cilin nuk ka dyshim për natyrën e butë të tij, e gjelbëron dhe e lulëzon një vend dhe bën që të mbijnë shkurre e ferra në një vend tjetër.

Ajetet 59 - 64

لَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يَتَقَوَّمِرَ أَعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ
 مِّنْ إِلَهِ غَيْرُهُ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٥٩﴾ قَالَ
 أَمْلَأْ مِنْ قَوْمِهِ إِنَّا لَنَرْنَكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ ﴿٦٠﴾ قَالَ يَتَقَوَّمِرَ
 لَيْسَ بِي ضَالَّةٌ وَلَكِنِّي رَسُولٌ مِّنْ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٦١﴾ أُبَلِّغُكُمْ
 رِسَالَتِ رَبِّي وَأَنْصَحُ لَكُمْ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٦٢﴾
 أَوْعَجِبْتُمْ أَنْ جَاءَكُمْ ذِكْرٌ مِّنْ رَبِّكُمْ عَلَىٰ رَجُلٍ مِّنْكُمْ لِيُنذِرَكُمْ
 وَلِتَتَّقُوا وَلَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿٦٣﴾ فَكَذَّبُوهُ فَأَنْجَيْنَاهُ وَالَّذِينَ مَعَهُ فِي
 الْفُلِّ وَأَغْرَقْنَا الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا ۚ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا
 عَمِينَ ﴿٦٤﴾

"Ne e dërguam Nuhun te popullit i tij e ai u tha: 'O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij! Unë kam frikë se do të bjerë mbi ju dënimi i një Dite të madhe!'"

"Paria e popullit të tij tha: 'Ne të shohim ty në humbje të qartë.'"

"Ai tha: 'O populli im! Unë nuk jam në kurrfarë humbjeje, por jam i dërguar nga ana e Zotit të gjithësisë!'"

"Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim, ju këshilloj dhe di nga All'llahu atë që ju nuk e dini."

"A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen, që të kini frikë (All'llahun), në mënyrë që të mëshiroheni (prej Tij)?"

"Ata e quajtën gënjeshtar Nuhun. Kështu që Ne shpëtuan me anë të barkës atë dhe të gjithë njerëzit që ishin me të, ndërsa ata që i mohuan shpalljet Tona, i fundosëm. Ata qenë vërtet një popull i verbër."

Komentimi

Mesazhi i Nuhut, Profet prej Profetëve të vendosmërisë së lartë

Më parë u tha se kjo sure, pas përmendjes së një zinxhiri çështjesh thelbësore e të përgjithshme në kontekstin e njohjes së All'llahut dhe të Ringjalljes, të udhëzimit të All'llahut për njerëzimin dhe çështjen e ndjenjës së përgjegjësisë, tregon historitë e disa Profetëve fisnikë e të Dërguarve madhështorë, si: Nuhu, Hudi, Salihu, Shuajbi, e më pas Musa ibn Imran (*Paqja qoftë mbi ta*), duke dhënë kështu shembuj të gjallë përmes historisë së tyre të mbushur me ngjarje.

Kështu, All'llahu i Lartësuar fillon nga historia e Profetit Nuh, duke na paraqitur një pjesë të dialogjeve me popullin e tij pagan e armiqësor.

Historia e Nuhut është transmetuar në shumë sure të Kur'anit, si në suret "Hud", "El Enbija", "El Mu'minun", "Esh Shu'ara" etj. Gjithashtu, në Kur'anin Fisnik është edhe një sure e shkurtër me emrin "Nuh", e cila është surja e shtatëdhjetë e njëte e Librit të lavdishëm.

Më tej do të vijë sqarimi, studimi dhe përpjekjet e Profetit Nuh, mënyra e ndërtimit të anijes, tufani i tmerrshëm dhe mbytja e popullit të tij egoist, shkatërrimtar e pagan. Këtu do të njaftohemi vetëm me paraqitjen përmbledhëse të atyre çështjeve në këto gjashtë ajete.

Në fillim të tyre thuhet: **"Ne e dërguam Nuhun te popullit i tij..."**

Gjëja e parë që u përmendi atyre ishte tërheqja e vëmendjes drejt realitetit të Njësimit dhe mohimi i çdo lloji të paganizmit: **"...e ai u tha: 'O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij...'"**

Motoja e Njësimit nuk është vetëm moto e Nuhut, por është e të gjithë Profetëve e të Dërguarve të All'llahut, çka dëshmohet në shumë sure të Kur'anit Fisnik. Ajo me të cilën e hapin thirrjen shumica e Profetëve është thënia: **"O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij..."** (referoju ajeteve 65, 73 dhe 85 të së njëjtës sure).

Nga këto fraza mësohet se paganizmi ka qenë pengesa më e keqe në rrugën e lumturisë së të gjithë njerëzimit. Mbartësit e filizave të monoteizmit, të parën punë që bënin për mbjelljen e këtyre fidanëve në fushën jetës së njeriut, ata punonin me seriozitet që ta pastronin jetën e njerëzve nga gjembat e ndryshëm

të paganizmit e të idhujtarisë me drapërat e mësimi e të edukimit. Në mënyrë të veçantë, nga ajeti 23 i sures "Nuh" mësohet se njerëzit në kohën e tij kanë adhuruar idhuj të ndryshëm, që quheshin "Uedd", "Seua'u", "Jaguth", "Jauk" dhe "Nesr", për të cilët do të flasim në komentimin e këtij ajeti.

Pasi Nuhu ua zgjoi ndërgjegjen dhe atyre u doli gjumi, i paralajmëroi ata për pasojën e paganizmit dhe ndëshkimin e dhimbshëm, duke u thënë: **"...Unë kam frikë se do të bjerë mbi ju dënimi i një Dite të madhe!"**

Qëllimi me frazën: **"...dënimi i një Dite të madhe!"** mund të jetë përmbytja e njohur si tufani i Nuhut, që pak janë parë dënime aq të mëdha si ai. Por kjo frazë mund të jetë treguese edhe për ndëshkimin e All'Ilahut në Ditën e Ringjalljes, sepse ky përshkrim është transmetuar në dy kuptime në Kur'anin Fisnik.

Në ajetin 189 të sures "Esh Shu'ara" lexojmë: **"Kështu që i kaploi ata ndëshkimi i ditës së zezë, me të vërtetë ka qenë një ndëshkim madhështor atë ditë"**. Ajeti është transmetuar rreth ndëshkimit që ka zbritur tek populli i Shuajbit në këtë botë për shkak të fajeve e mëkateve të tyre. Në ajetet 4 dhe 5 të sures "El Muttaffifijn" lexojmë: **"A nuk supozojnë ata se me të vërtetë do të ringrihen * Për një ditë madhështore."**¹

Fraza "kam frikë" (me kuptimin: "kam frikë se mos ju godet ky ndëshkim") pas përmendjes së çështjes së politeizmit në ajetin në fjalë, mund të jetë për arsyen se Nuhu do t'u thotë atyre: Nëse nuk bindeni për ardhjen e këtij ndëshkimi, të paktën duhet të keni frikë prej saj, prandaj nuk është logjike që të ndiqni këtë rrugë të shëmtuar e të pranoni një ndëshkim të madh e të dhimbshëm siç është ky.

¹ Fjala "*adhijm*" në ajet është cilësi për "Ditën" jo për dënimin.

Por populli i Nuhut, në vend që ta pranonin këtë ftesë të Profetit, të shoqëruar me synimin e mirë e të dobishëm për ta, e në vend që të bashkoheshin nën flamurin e Njësimit e të ndaleshin nga padrejtësia e shkatërrimi, një grup nga paria e të pasurve, të cilët kishin ndjerë rrezikun e interesave të tyre individuale, për shkak të zgjimit të njerëzve dhe vëmendjes së tyre, i thanë atij me paturpësinë më të madhe: Ne të shohim ty në humbje të qartë:

"Paria e popullit të tij tha: 'Ne të shohim ty në humbje të qartë.'"

Fjala "*meleun*", përdoret zakonisht për grupin që zgjedh një ideologji dhe një ide të vetme, duke e mbushur lavdinë e saj sipërfaqësore në sytë e shikuesve, sepse lënda "*el meleu*" në origjinë rrjedh nga fjala "*el mil'u*" dhe është përdorur në Kur'an për grupet egoiste, që shfaqin këtë pamje arrogante e brendësi shkatërrimtare e që i mbushin arenat e shoqërive të ndryshme me ekzistencën e tyre.

Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj këmbënguljes e ashpërsisë së tyre me qetësi dhe me një gjuhë të mbushur me dashuri e mëshirë, duke u thënë: Unë nuk jam i humbur, madje nuk kam asnjë shenjë humbjeje, por jam i dërguar nga All'llahu: **"Ai tha: 'O populli im! Unë nuk jam në kurrfarë humbjeje, por jam i dërguar nga ana e Zotit të gjithësisë!'"** Kjo tregon se zotat që adhurojnë e që u jepni rol udhëheqjeje e sundimi, si për shembull: zoti i detit, i qiellit, i paqes e i luftës, e të tjera si këto, nuk kanë bazë në të vërtetën. Zoti i botrave është vetëm All'llahu, i Cili i ka krijuar të gjitha dhe i bëri ato ekzistente nga asgjëja.

Për më tepër, qëllimi im është transmetimi i mesazhit me të cilin jam ngarkuar: **"Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim..."**. Nuk kërkoj shpërblim për këshillimin tuaj, synoj dobinë tuaj dhe arritjen e së mirës tek ju, "*ju këshilloj*".

Fjala “*ensahu*”, rrjedh nga lënda “*nus'hun*”, që do të thotë “t’i japësh fund hiles e gjërave të kota”. Kështu, për mjaltin puro thuhet “mjaltë i pastër”. Më pas, kjo fjalë është përdorur me kuptimin e fjalës që buron nga qëllimi i paqtë, me synim të mirën, pa mashtrim e tradhëti.

Më pas, All'llahu i Lartësuar shton: **“...ju këshilloj dhe di nga All'llahu atë që ju nuk e dini.”**

Kjo frazë mund të jetë si kërcënim ndaj kundërshtimit e kundravajtjes së tyre, sikur ai dëshiron t’u thotë: Unë jam më i ditur për ndëshkimet hyjnore që i pret mëkatarët, ndërsa ju nuk dini gjë për to. Ose është tregues i mirësisë e mëshirës së All'llahut të Lartësuar, që do të thotë: Nëse i bindeni All'llahut dhe mjaftoheni me kokëfortësinë tuaj, unë di shumë shpërblime madhështore për ju, që ju nuk i dini; ose është tregues se nëse jam ngarkuar me udhëzimin tuaj, unë di çështje nga All'llahu i Madhëruar dhe nga urdhrat e Tij që ju nuk i dini. Kështu, është e domosdoshme që ju të më bindeni dhe të më ndiqni mua.

Ka mundësi që kjo fjali t’i ketë të gjitha kuptimet e përmendura.

Në ajetin pasardhës për Nuhun lexojmë një thënie tjetër, e cila vjen si kundërpërgjigje ndaj çudisë së popullit të tij, për faktin se si mund të ishte një njeri mbartës i përgjegjësisë së transmetimit të mesazhit hyjnor. Në ajet thuhet: **“A po çuditëni që këshilla e Zotit tuaj t’ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen, që të kini frikë (All'llahun), në mënyrë që të mëshiroheni (prej Tij)?!”**

Pra, çfarë është ajo që ju çudit e ju mahnit kur bëhet fjalë për një njeri vepërmirë, që mund ta përcjellë këtë mesazh më mirë se çdo qenie tjetër?!

Por në vend që të pranojnë ftesën e këtij udhëheqësi të singertë e të vetëdijshëm, ata e gënjyen që të gjithë, kështu që All'Ilahu dërgoi tek ata tufanin, i mbyti gënjeshtarët dhe e shpëtoi anijen e Nuhut e ata që besuan: **"Ata e quajtën gënjeshtar Nuhun. Kështu që Ne shpëtuan me anë të barkës atë dhe të gjithë njerëzit që ishin me të, ndërsa ata që i mohuan shpalljet Tona, i fundosëm..."**

Në mbyllje të ajetit përmendet argumenti i këtij ndëshkimi të vështirë, që është verbëria e zemrës, e cila i pengoi ata të shihnin të vërtetën e ta ndiqnin atë: **"...Ata qenë vërtet një popull i verbër."**

Kjo verbëri e zemrës erdhi si rezultat i veprave të tyre të këqija dhe e armiqësisë së tyre të vazhdueshme, sepse eksperiencia ka treguar se nëse njeriu qëndron në errësirë për një periudhë të gjatë, apo nëse i mbyll sytë për një arsye çfarëdo, ai do ta humbasë aftësinë e tij shikuese në mënyrë graduale dhe në fund do bëhet i verbër.

Në të njëjtën mënyrë, nëse organet e trupit e ndalojnë aktivitetin dhe punën për një periudhë të gjatë kohe, ato bllokohen dhe e humbasin funksionin përfundimisht.

As largpamësia e njeriut nuk përjashtohet nga ky ligj. Kështu, mospërdorimi i logjikës dhe i mendimit në kuptimin e të vërtetave e ndodhive në mënyrë të vazhdueshme, e dobëson largpamësinë e njeriut gradualisht, e në fund ia verbon syrin e zemrës e të mendjes.

Kjo ishte një rezymë nga tregimi i Nuhut, ndërsa pjesën e mbetur të këtij tregimi dhe mënyrën e ndodhisë së tufanit e detajet e tjera të saj do t'i trajtojmë në suret që përmendëm në fillim të këtij studimi.

Ajetet 65 - 72

﴿وَإِلَىٰ عَادٍ أَخَاهُمْ هُودًا ۖ قَالَ يَبْقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ مِّنْ
 إِلَهِ غَيْرُهُ ۚ أَفَلَا تَتَّقُونَ ﴿٦٥﴾ قَالَ الْمَلَأُ الَّذِينَ كَفَرُوا مِن
 قَوْمِهِ إِنَّا لَنَرُّكَ فِي سَفَاهَةٍ وَإِنَّا لَنُظُنُّكَ مِنَ الْكَذِبِينَ
 ﴿٦٦﴾ قَالَ يَبْقَوْمِ لَيْسَ بِي سَفَاهَةٌ وَلَكِنِّي رَسُولٌ مِّن رَّبِّ
 الْعَالَمِينَ ﴿٦٧﴾ أُبَلِّغُكُمْ رِسَالَاتِ رَبِّي وَأَنَا لَكُمْ أَمِينٌ نَّاصِحٌ ﴿٦٨﴾
 أَوْعَجِبْتُمْ أَن جَاءَكُمْ ذِكْرٌ مِّن رَّبِّكُمْ عَلَىٰ رَجُلٍ مِّنكُمْ
 لِيُنذِرَكُمْ ۚ وَاذْكُرُوا إِذْ جَعَلَكُمْ خُلَفَاءَ مِن بَعْدِ قَوْمِ نُوحٍ
 وَزَادَكُمْ فِي الْخَلْقِ بَصْطَةً ۖ فَاذْكُرُوا ءَالَآءَ اللَّهِ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ
 ﴿٦٩﴾ قَالُوا أَجِئْتَنَا لِنَعْبُدَ اللَّهَ وَحْدَهُ وَنَذَرَ مَا كَانَ يَعْبُدُ
 ءَابَاؤُنَا ۖ فَاتِنَا بِمَا تَعِدُنَا إِن كُنْتَ مِنَ الصَّادِقِينَ ﴿٧٠﴾ قَالَ قَدْ
 وَقَعَ عَلَيْكُم مِّن رَّبِّكُمْ رِجْسٌ وَغَضَبٌ ۖ أَتُجَدِّلُونَنِي فِـ

أَسْمَاءٍ سَمَّيْتُمُوهَا أَنتُمْ وَءَابَاؤُكُمْ مَّا نَزَّلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ
 فَانْتَظِرُوا إِنِّي مَعَكُمْ مِنَ الْمُنتَظِرِينَ ﴿٧٦﴾ فَأَخْبَيْنَاهُ الَّذِينَ
 مَعَهُ بِرَحْمَةٍ مِنَّا وَقَطَعْنَا دَابِرَ الَّذِينَ كَذَبُوا بِآيَاتِنَا ۖ وَمَا كَانُوا
 مُؤْمِنِينَ ﴿٧٧﴾

"Fisit Ad i dërguam vëllanë e tyre - Hudin. Ai tha: 'O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. A nuk po i ruheni dënimit?'"

"Paria e popullit të tij që nuk besonte, tha: 'Ne shohim tek ti mendjelehtësi dhe mendojmë se je gënjeshtar.'"

"Ai tha: 'O populli im! Unë nuk jam mendjelehtë, por jam i dërguar nga Zoti i botëve.'"

"Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim dhe jam këshilltar besnik."

"A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen? Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut dhe ju dha trup e fuqi të madhe. Kujtoni dhuntitë e All'llahut, në mënyrë që të keni sukses!"

"Ata thanë: 'A mos na ke ardhur që të adhurojmë vetëm All'llahun e t'i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?! Atëherë na sill atë me të cilën na kërcënon, nëse je i sinqertë!'"

“Ai tha: ‘Tashmë, ju ka rënë dënimi dhe zemërimi i Zotit tuaj. A më kundërshtoni mua për emrat (e idhujve), të cilët ua keni vënë ju dhe prindërit tuaj e për të cilët All'illahu nuk ju ka sjellë kurrfarë diturie? Pra, pritni, se edhe unë po pres me ju!’”

"Me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuan Hudin dhe të gjithë besimtarët që ishin me të dhe i asgjësuan ata që i mohuan shpalljet Tona. Ata ishin të gjithë mosbesimtarë."

Komentimi

Vështrim mbi tregimin e popullit të Hudit

Përmes përmendjes së mesazhit të Nuhut dhe mësimëve të pasura me shembuj të fshehur në të, Kur'ani Fisnik synon dhënien e një rezymeje për historinë e një Profeti tjetër madhështor, që është Profeti Hud (*Paqja qoftë mbi të!*), duke treguar se çfarë ngjau ndërmjet tij dhe popullit të tij.

Ky tregim është përmendur edhe në sure të tjera të Kur'anit Fisnik, si për shembull në suret “Esh Shu’ara” dhe “Hud”, të cilat e tregojnë këtë histori në mënyrë më të detajuar, ndërsa në ajetet që janë objekt studimi përmendet shkurtimisht se çfarë ka ndodhur ndërmjet Hudit, kundërshtarëve të tij si dhe përfundimi i tyre.

All'illahu i Lartësuar thotë në fillim: **"Fisit Ad i dërguam vëllanë e tyre - Hudin..."**

Populli i Adit ka jetuar në tokën e Jemenit dhe ka qenë një komb i fortë në aspektin fizik dhe me burime të mjaftueshme, që i

siguronin nga bujqësia e blegtoria, por ishin të dhënë pas devijimeve. Ndër ta ishin veçanërisht të përhapura paganizmi e morali i ulët.

Kështu, Hudi, i cili ishte prej tyre, u ngarkua nga ana e All'lahut që t'i ftonte ata drejt së drejtës e të luftonte shthurjen. Ka gjasa që shprehja “vëllain e tyre” të tregojë lidhjen gjenetike ndërmjet Hudit dhe popullit të Adit.

Gjithashtu, ka mundësi që fjala “vëlla” e përdorur për Profetin Hud si dhe për shumë Profetë të tjerë të All'lahut, si për Nuhun (*Paqja qoftë mbi të!*) (surja "Esh Shu'ara", ajeti 106), Salihun (surja "Esh Shu'ara", ajeti 142), Lutin (surja "Esh Shu'ara", ajeti 161) dhe Shuajbin (surja “El A'raf", ajeti 85), mund të jetë përdorur për arsyen se ata silleshin me popujt e tyre me mëshirë e dashuri, si një vëlla i dashur, dhe bënë çmos për t'i udhëzuar, këshilluar e ftuar ata në të mirën.

Me të vërtetë, kjo fjalë përdoret për atë që sillet mirë me dikë apo me një grup njerëzish, me një mirësjellje të pashoqe, duke shtuar se ajo tregon një lloj barazie dhe mohimi të dëshirës për superioritet e supermaci. Kjo do të thotë se të Dërguarit e All'lahut nuk mbartnin në qeniet e tyre asnjë ambicie personale në kontekstin e udhëzimit të tyre, por përkundrazi, ata përpiqeshin dhe mundoheshin vetëm për të shpëtuar kombet dhe popujt e tyre nga rënia në fatkeqësi.

Gjithësesi, është shumë e qartë se fraza me “vëllain e tyre” nuk është absolutisht tregues i vëllazërisë fetare, sepse në të shumtën e rasteve, këta popuj nuk i janë përgjigjur thirrjes së profetëve reformatore.

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë se në thirrjen e tij, Hudi (*Paqja qoftë mbi të!*) legjitimoi çështjen e Njësimit dhe luftën ndaj politeizmit dhe paganizmit: **“...Ai tha: ‘O populli im! Adhuroni**

All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. A nuk po i ruheni dënimit?"

Por ky grup egoist e arrogant, e veçanërisht të pasurit e tyre, të humbur e të mahnitur me veten, të cilët Kur'ani i përshkruan si "paria", thanë të njëjtën gjë për Hudin, ashtu sikurse populli i Nuhut për Nuhun (*Paqja qoftë mbi të!*): **"Paria e popullit të tij që nuk besonte, tha: 'Ne shohim tek ti mendjelehtësi dhe mendojmë se je gënjeshtar.'"**

Mendjelehtësia dhe mendjengushtësia e tyre e kërkonte që të ngrihej dikush kundra traditave të mjedisit të tyre, sido që të ishin ato tradita boshe e të pavërteta, dhe të rrezikonte deri edhe me jetën e tij në këtë rrugë.

Mendjelehtësia në këndvështrimin e logjikën e tyre ishte një njeri që nuk përshtatej me traditat e shoqërisë dhe ligjet e tyre të shtrenjta, madje revoltohet me to, duke e pritur me gjoks të hapur të gjithë atë që fshihet nga kjo revoltë e përballje.

Por Hudi (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ishte i pajisur me dinjitetin e qëndrueshmërinë e Profetëve dhe të udhëzuesve të sinqertë e të pastër, pa u shqetësuar nga zemërimi e as pa e kapluar gjendja e plogështisë, u tha atyre: **"Ai tha: 'O populli im! Unë nuk jam mendjelehtë, por jam i dërguar nga Zoti i botëve.'"** Më pas, Hudi shton: Në të vërtetë, misioni im është transmetimi i mesazheve të All'llahut tek ata, udhëzimi në të mirën e në lumturinë e tyre, shpëtimi i tyre nga humnera e politeizmit dhe e shthurjes. Ky mision kryhet me sinqeritet të plotë, me këshillë, amanet e besnikëri: **"Unë ju sjell shpalljet e Zotit tim dhe jam këshilltar besnik."**

Si kundërpërgjigje për atë që çuditet se si All'llahu dërgon një njeri si të dërguar, Hudi (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë të njëjtën gjë që i tha Nuhu (*Paqja qoftë mbi të!*) popullit të tij:

"A po çuditeni që këshilla e Zotit tuaj t'ju vijë nëpërmjet një njeriu prej jush, i cili ju tërheq vërejtjen?..." pra, a po çuditeni se pse All'llahu dërgoi një burrë nga njerëzit si Profet, që t'jua tërheqë vërejtjen juve për rezultatin e veprave tuaja dhe për atë që ju pret nga ndëshkimet në të ardhmen?

Më pas, për t'u treguar ndjenjat e tyre të përgjumura e për të nxitur shpirtin e falënderimit tek ata, ai përmend një pjesë të begative që u dhuroi All'llahu i Lartësuar, duke u thënë: **"...Kujtoni që Ai ju bëri zëvendës pas popullit të Nuhut..."**; pra, e trashëguat tokën me gjithçka ka në të nga të mirat madhështore pasi u shkatërrua populli i Nuhut me tufan për shkak të tiranisë së tyre.

Dhe kjo nuk ishte begatia e vetme, por Ai ju dhuroi juve një forcë të jashtëzakonshme fizike **"...dhe ju dha trup e fuqi të madhe..."**

Siç e përmendëm, fjalia **"...dhe ju dha trup e fuqi të madhe..."** mund të jetë tregues i forcës fizike superiore të popullit të Adit, sepse ajo përmendet në shumë ajete kur'anore. Gjithashtu, edhe në tekstet historike thuhet se ata kanë qenë shtatlartë, të fortë e të mëdhenj, ashtu siç e kuptojmë edhe nga thënia e tyre në suren "Fussilet", ajeti 15: **"Kush ka forcë më të madhe se ne?"**.

Ndërsa në ajetin 7 të sures "El Hakka", kur përmendet fatkeqësia që u zbriti atyre nga mëkatet e veta, lexojmë: **"...Atëherë mund t'i vëreje njerëzit të përmbysur si trungjet e hurmave të kalbura."**, ku trupat e tyre krahasohen me trupin e hurmës së rënë mbi tokë.

Gjithashtu, kjo frazë mund të jetë tregues për madhështinë e burimeve të tyre, për mundësitë materiale dhe qytetërimin e tyre të përparuar, siç mësohet nga ajetet e Kur'anit e nga dëshmitë e

tjera historike. Megjithatë, kuptimi i parë duket se është më i sakti për këtë ajet.

Në mbyllje të ajetit i thuhet këtij grupi egoist që të kujtojnë begatitë e All'Ilahut, në mënyrë që të zgjojnë tek ata shpirtin e falënderimit e t'u nënshtrohen urdhrave të Tij se ndoshta ata janë të shpëtuar: **"...Kujtoni dhuntitë e All'Ilahut, në mënyrë që të keni sukses!"**

Por në këmbim të të gjitha këshillave e udhëzimeve logjike dhe përmendjes së begative e të dhuntive të All'Ilahut, ky grup njerëzish, që i panë përfitimet e tyre materiale në rrezik, dhe pranimin e thirrjes së Profetit e konsideruan si kundërshti ndaj shthurjeve e epsheve të tyre, i dolën kundër dhe i thanë atij haptazi: Në të vërtetë, ti erdhe të na ftosh në adhurimin e All'Ilahut, Një të Vetëm, dhe të lëmë besimin e stërgjyshërve tanë. Kjo nuk mund të ndodhë: **"Ata thanë: 'A mos na ke ardhur që të adhurojmë vetëm All'Ilahun e t'i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?!...'"**

Siç e vëmë re, ideologjia e këtij grupi ishte aq shumë e gabuar, sa që ata shfaqen të egërsuar nga adhurimi i All'Ilahut të Vetëm, ndërkohë që zotat e shumtë dhe faltoret i konsideronin si krenari të tyre.

Në këtë aspekt, argumenti i tyre s'ishte gjë tjetër veçse imitimi i verbër i baballarëve dhe i të parëve të tyre, se përndryshe si do të mund t'i justifikonin adhurimet e tyre ndaj shkëmbinjve e drurëve?!

Dhe në fund, në mënyrë që ta hiqnin plotësisht shpresën e Hudit për ta, ata thanë: Nëse është e vërtetë ajo për të cilën na paralajmëron si ndëshkim, atëherë le të vijë me të, sepse ne nuk u frikësohemi aspak kërcënimeve tuaja: **"...Atëherë na sill atë me të cilën na kërcënon, nëse je i sinqertë!"**

Kur dialogu mbërriti në këtë pikë dhe arrogantët thanë fjalën e tyre të fundit haptazi, duke e refuzuar ftesën e Hudit, ky i fundit u tha: Mirë pra, meqë puna është kështu, atëherë do të bjerë mbi ju ndëshkimi i Zotit tuaj: **“Ai tha: ‘Tashmë, ju ka rënë dënimi dhe zemërimi i Zotit tuaj...”**

Në origjinë, fjala *“rixhsun”*, ka kuptimin e diçkaje të papastër. Disa komentues mendojnë se kjo fjalë ka kuptim më të gjerë. Sipas tyre, ajo nënkupton çdo gjë që të shpie në urrejtje, në neveri e pështjellim, kështu që përdoret për të gjitha llojet e papastërtive dhe të ndëshkimeve, sepse të gjitha këto i sjellin neveri njeriut dhe ai u shmanget atyre.

Gjithsesi, në ajetin që është objekt studimi, kjo fjalë mund të jetë me kuptimin e ndëshkimeve të All'llahut dhe përmendja e saj bëhet me frazën *“ka rënë”*, e cila është folje në kohën e shkuar, që tregon se *“ju e merituat ndëshkimin përfundimisht e në mënyrë të prerë dhe se ai do të bjerë mbi ju e s’ka zgjidhje tjetër.”*

Gjithashtu, kjo fjalë mund të jetë përdorur edhe me kuptimin e ndotjes së shpirtit; pra, ju jeni zhytur në devijim e në shthurje deri në atë gradë, saqë shpirti juaj është varrosur nën peshën e rëndë të mëkateve të ndyra dhe ju e merituat zemërimin e All'llahut.

Më pas, në mënyrë që logjika e adhurimit të putave të mos mbetet pa kundërpërgjigje, Hudi (*Paqja qoftë mbi të!*) shtoi duke thënë: **“...A më kundërshtoni mua për emrat (e idhujve), të cilët ua keni vënë ju dhe prindërit tuaj e për të cilët All'llahu nuk ju ka sjellë kurrfarë diturie?...”** Këta idhuj që i ndërtuat ju dhe baballarët tuaj nuk kanë hyjni, me përjashtim të emrit bosh që ua kanë vënë të parët tuaj duke gënjyer e shpifur; për më tepër, ju vini e polemizoni me mua për adhurimin e tyre, ndërkohë që për këtë nuk ka zbritur asnjë argument nga ana e All'llahut.

Në të vërtetë, këta idhuj nuk kanë asgjë hyjnore, veçse emra të kotë, të cilët i ka thurur imagjinata e tyre dhe e të parëve të tyre; ato janë statuja guri e druri që s'kanë ndryshim nga gurët e tokës dhe drurët e pyjeve.

Më pas, Profeti Hud (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: *Nëse është puna kështu, atëherë le të presim të gjithë së bashku.* Ju prisni që t'ju sjellin dobi idhujt dhe faltoret tuaja e t'ju triumfojnë, ndërsa unë do të pres që të bjerë mbi ju zemërimi i All'llahut e ndëshkimi i Tij i dhimbshëm, si shpërblim i kokëfortësisë suaj. E ardhmja do ta tregojë se cila nga këto dy pritje është më afër së vërtetës: **"...Pra, pritni, se edhe unë po pres me ju!"** Në fund të ajetit, Kur'ani sqaron fundin e këtij populli kokëfortë me një frazë të shkurtër e të përmbledhur:

"Me mëshirën Tonë, Ne e shpëtuan Hudin dhe të gjithë besimtarët që ishin me të dhe i asgjësuan ata që i mohuan shpalljet Tona. Ata ishin të gjithë mosbesimtarë." Po, me mirësinë e mëshirën e Tij, All'llahu e shpëtoi Hudin dhe ata që e ndoqën atë nga populli, ndërsa ata që gënjyen me argumentet e All'llahut, që refuzuan bashkimin nën flamurin e thirrjes së tij dhe që e kundërshtuan të vërtetën, u shkatërruan përfundimisht.

Në gjuhën arabe, fjala "*dabir*", ka kuptimin e fundit të diçkaje dhe pjesës së prapme të saj. Duke u bazuar mbi këtë, kuptimi i ajetit është: *"Me të vërtetë, Ne e shkatërruam atë popull plotësisht dhe i ç'rrënjosëm ata".*

(Me lejen e Zotit, hollësitë rreth popullit të Adit, veçoritë e tjera të jetës së tyre, mënyrën e ndëshkimit si dhe dënimin që u zbriti atyre, do t'i trajtojmë në komentimin e sures Hud).

Ajetet 73 - 79

وَالِى ثَمُودَ أَخَاهُمْ صَالِحًا ۖ قَالَ يَتَقَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ
 مِّنْ إِلَهِ غَيْرُهُ ۖ قَدْ جَاءَتْكُمْ بَيِّنَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ ۚ هَذِهِ نَاقَةُ
 اللَّهِ لَكُمْ ءَايَةٌ ۖ فَذَرُوهَا تَأْكُلْ فِي أَرْضِ اللَّهِ ۚ وَلَا تَمْسُوهَا
 بِسُوءٍ فَيَأْخُذْكُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٧٣﴾ وَاذْكُرُوا إِذْ جَعَلَكُمْ خُلَفَاءَ
 مِن بَعْدِ عَادٍ وَبَوَّأَكُمْ فِي الْأَرْضِ تَتَّخِذُونَ مِنْ سُهُولِهَا
 قُصُورًا وَتَنْحِتُونَ الْجِبَالَ بُيُوتًا ۖ فَادْكُرُوا ءَالَاءَ اللَّهِ وَلَا تَعْتَوْا
 فِي الْأَرْضِ مُفْسِدِينَ ﴿٧٤﴾ قَالَ أَلْمَلَأُ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا مِن
 قَوْمِهِ لِلَّذِينَ اسْتَضَعِفُوا لِمَنْ ءَامَنَ مِنْهُمْ أَتَعْلَمُونَ أَمْ
 صَالِحًا مَّرْسَلٌ مِّن رَّبِّهِ ۚ قَالُوا إِنَّا بِمَا أُرْسِلَ بِهِءُ مُؤْمِنُونَ
 قَالَ الَّذِينَ اسْتَكْبَرُوا إِنَّا بِالَّذِي ءَامَنْتُمْ بِهِءُ
 كَفِرُونَ ﴿٧٥﴾ فَعَقَرُوا النَّاقَةَ وَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ وَقَالُوا
 يَصْلِحْ أَتَيْنَا بِمَا تَعِدُنَا إِنْ كُنْتَ مِنَ الْمُرْسَلِينَ ﴿٧٦﴾ فَأَخَذَتْهُمُ

الرَّجْفَةُ فَأَصْبَحُوا فِي دَارِهِمْ جِثْمِينَ ﴿٧٨﴾ فَتَوَلَّى عَنْهُمْ وَقَالَ
يَقَوْمِ لَقَدْ أَبْلَغْتُكُمْ رِسَالَةَ رَبِّي وَنَصَحْتُ لَكُمْ وَلَكِنْ لَا
تُحِبُّونَ النَّصِيحَ ﴿٧٩﴾

"Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllanë e tyre, Salihun. Ai tha: 'O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Në të vërtetë, juve ju është dhënë një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo deve e All'llahut për ju është një mrekulli. Lëreni të kullosë në tokën e All'llahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju pret ndëshkimi i ashpër!'"

"Dhe sillni në mend, kur Ai ju bëri zëvendës pas fisit Ad dhe ju dhuroi vendbanime në Tokë; në rrafshinat e saj po ngrini pallate e në kodrina po gdhendni shtëpi. Kujtoni të mirat e All'llahut dhe mos bëni çrregullime në tokë!"

"Por paria arrogante e popullit të tij u tha të shtypurve në radhët atyre që kishin besuar: 'A e pranoni që Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?' Ata thanë: 'Sigurisht që ne besojmë në gjithçka që i është shpallur atij.'"

"Ata që ishin kryelartë, thanë: 'Ne nuk besojmë në atë që besoni ju.'"

"Kështu, ata e therën devenë pa e përfillur urdhrin e Zotit të tyre dhe thanë: 'O Salih, sillna atë që na ke premtuar, nëse je vërtet i dërguar!'"

"Për këtë arsye ata i goditi një tërmet i rëndë në mëngjes dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre."

"Ai u largua prej tyre dhe tha: 'O populli im! Unë ju solla mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i donit ata që këshillojnë.'"

Komentimi

Tregimi i popullit të Salihut dhe shembujt që gjenden në të

Ajetet që janë objekt studimi tregojnë për dërgimin e Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*), Profetit të Zotit, tek populli i tij Themud, të cilët patën jetuar në një zonë malore ndërmjet Hixhazit e Shamit. Me këto ajete Kur'ani vazhdon tregimet e tij të mëparshme e të pasura me shembuj rreth popullit të Nuhut e të Hudit (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Gjithashtu, për këtë histori është folur edhe në suret: "Hud", "Esh Shu'ara", "El Kamer" dhe "Esh Shems", ndërsa më e detajuar, ajo ka ardhur në suren "Hud". Në ajetet që janë objekt studimi flitet shkurtimisht për atë çka ndodhi ndërmjet Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe popullit të tij Themudit, për përfundimin si dhe për ndëshkimin e tyre.

Fillimisht, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllanë e tyre, Salihun..."**

Shkakun e përdorimit të termit "vëlla" për Profetët, e kemi sqaruar në komentimin e ajetit 65 të po kësaj sureje tek historia e Hudit.

Hapi i parë që mori Profeti i tyre Salihu, ishte udhëzimi i tyre, thirrja në Njësim dhe në adhurimin e All'llahut, Një e të

Vetëm: "...O populli im! Adhuroni All'llahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij..."

Pastaj, ai shtoi se nuk thotë asgjë pa fakt e argument, madje u tha se atyre u erdhi sqarimi nga Zoti i tyre: **"...Në të vërtetë, juve ju është dhënë një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo deve e All'llahut për ju është një mrekulli..."**

"En Nakatu" është deveja femër. Për devenë e Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*) është treguar në shtatë vende në Kur'anin Fisnik.

Por si ka qenë e vërteta e kësaj deveje? Cila ishte mrekullia e Salihut të ndritur dhe si e përgënjeshtroi argumentin populli i tij? Këto janë temat që do të trajtojmë tek surja "Hud" në fund të ajetit që lidhet me popullin e Themudit.

Duhet të tërheqim vëmendjen se fjala "devesë", e shtuar tek "All'llahu" në ajetet që janë objekt studimi, është një lloj shtese fisnikërie e respekti. Ajo tregon se kjo deve e përmendur nuk ishte një deve e zakonshme, por kishte veçori që e dallonin.

Më pas, ajeti thotë se Profeti Salih u tha atyre: **"Lëreni të kullosë në tokën e All'llahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju pret ndëshkimi i ashpër!"**

Ndërsa shtimi i fjalës "tokë" tek "All'llahu" tregon se kjo deve nuk përzihet me askënd; ajo ushqehet vetëm nga ushqimi i shkretëtirës dhe për këtë, ata nuk duhet ta trazojnë.

Më pas, në ajetin pasardhës thuhet: **"Dhe sillni në mend, kur Ai ju bëri zëvendës pas fisit Ad dhe ju dhuroi vendbanime në Tokë"**; pra nga njëra anë, mos i harroni begatitë e shumta të All'llahut, ndërsa nga ana tjetër bëni kujdes se ju kanë paraprirë juve popuj (si populli i Adit) që bënë tirani dhe ata i zuri ndëshkimi i All'llahut për mëkatet e tyre dhe u shkatërruan.

Pastaj, ajeti përqendrohet në disa begati hyjnore, siç është toka, dhe thotë: **"...në rrafshinat e saj po ngrini pallate e në**

kodrina po gdhendni shtëpi..."; kështu, toka u krijua në atë mënyrë, ku pjesa e shtrirë dhe e rrafshët e saj kanë dhe' të dobishëm për ndërtimin e kështjellave madhështore, ndërsa kodrat e malet janë të dobishme, që në to të ndërtojnë shtëpi të forta për stinën e dimrit, duke iu përshtatur kushteve të ashpra atmosferike.

Nga ky perifrazim mësohet se ata i ndryshonin vendet e banimit të tyre në verë dhe në dimër, ndërsa në stinën e pranverës e të verës merreshin me punët e bujqësisë e të blegtorisë në fermat e mëdha pjellore; ata kishin kështjella të bukura në rrafshe dhe kur vinte stina e ftohtë dhe fundi i të vjelave, ata banonin në shtëpi të forta, të gdhendura në zemër të shkëmbinjve e në vende të sigurta, të mbrojtur nga përmbytjet, stuhitë dhe nga rreziqet e tjera.

Në fund të ajetit, me gjuhën e Profetit të Tij Salih (*Paqja qoftë mbi të!*), All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Kujtoni të mirat e All'llahut dhe mos bëni çrregullime në tokë!"**¹

Gjithashtu, nga këto ajete mësojmë se grupet e të pasurve dhe të aristokratëve, të cilët nga jashtë ishin të bukur e nga brenda të këqinj e të ndyrë e që u përshkruan me termin "Paria", e kundërshtuan këtë Profet të Zotit. Një numër i madh njerëzish me zemër të hapur e me mendje të shëndoshë, që ishin nën robërinë e pasanikëve e të aristokratëve, e pranuan thirrjen e Profetit Salih (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe e ndoqën atë. Kjo ishte edhe arsyeja se pse paria filloi t'i kundërshtonte këta besimtarë.

¹ Fjala "*ta'thuu*" rrjedh nga lënda "*athaa*" me kuptimin e bërjes së shkatërrimit. Por në të shumtën e rasteve kjo fjalë përdoret për shkatërrimin shpirtëror e moral. Ndërkohë që fjala "*abethun*" përdoret për shkatërrimet materiale. Për këtë fjalë "*mufsidijn*", shkatërrues, që ka ardhur pas frazës "mos bëni shkatërrim" është për përforsim sepse që të dyja kanë të njëjtin kuptim.

Një grup arrogantësh nga populli i Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*) thanë për të dobëtit që i besuan atij: *"A e dini me siguri se Salihu është i dërguar nga ana e All'llahut? "Por paria arrogante e popullit të tij u tha të shtypurve në radhët atyre që kishin besuar: 'A e pranoni që Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?...'"*

Qëllimi i kësaj pyetjeje nuk ishte zbulimi i së vërtetës, por ata donin të hidhnin dyshime e të lëkundnin besimin e besimtarëve si dhe të dobësonin moralin e tyre; ata menduan se besimtarët do t'u bindeshin atyre e do të hiqnin dorë nga ndjekja e Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe nga mbrojtja e tij, ashtu siç u ishin bindur kur kishin qenë nën sundimin e pushtetit të tyre.

Por paria u përball me kundërpërgjigjen e prerë të këtij grupi besimtarësh, me dëshirën e tyre të fortë e të hapur dhe me vendosmërinë e tyre për vazhdimësinë e rrugës. Ata thanë: Në të vërtetë, përveçse jemi të bindur se Salihu është i Dërguar prej All'llahut, ne besojmë gjithashtu në atë që ka ardhur me të: **"...Ata thanë: 'Sigurisht që ne besojmë në gjithçka që i është shpallur atij.'"**

Megjithatë, arrogantët e mendjemëdhenjtë e parisë nuk u ndalën nga veprat e tyre, por u përpoqën sërish për t'ua dobësuar moralin besimtarëve: **"Ata që ishin kryelartë, thanë: 'Ne nuk besojmë në atë që besoni ju.'"**

Kjo përpjekje e tyre u bë që të tërhiqnin për së dyti të dobëtit në radhët e tyre.

Meqë ishin të parët e shoqërisë dhe shembull për të tjerët e meqë kishin forcë e burime të shumta, ata menduan se njerëzit do t'i ndiqnin edhe në mosbesim, ashtu siç kishin vepruar më parë. Por ata e kuptuan gabimin e tyre kur panë se njerëzit kishin fituar besimin e All'llahut, pavarësi ideologjie dhe forcë, të udhëhequr nga një personalitet i ri civilizues.

Ia vlen të përmendim se në ajetet që janë objekt studimi, të pasurit dhe paria përshkruhen si të karakterizuar nga mendjemadhësia, ndërsa besimtarët si të dobët. Të parët ishin në supermaci, duke i shfrytëzuar të drejtat e njeriut deri në atë gradë, saqë me gjuhën e kohës u emërtuan si “shtresa shfrytëzuese”, ndërsa të dytët njiheshin me termin “të shfrytëzuarit”.

Kur paria dhe të pasurit mendjemëdhenj nuk mundën të lëkundnin besimin e besimtarëve të Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe kur panë se cytjet e nxitjet nuk u sollën dobi me ardhjen e devesë, që u konsiderua si mrekullia e Salihut, ata vendosën ta vrisnin devenë, duke kundërshtuar kështu urdhrin e Zotit të tyre: **"Kështu, ata e therën devenë pa e përfillur urdhrin e Zotit të tyre..."**

Ata nuk u mjaftuan me këtë, por erdhën tek vetë Salihu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe haptazi i thanë: **"...dhe thanë: 'O Salih, sillna atë që na ke premtuar, nëse je vërtet i dërguar!'"**; pra, me të vërtetë, ne nuk frikësohemi nga kërcënimet e tua, sepse ato nuk kanë bazë. Në fakt, kjo fjalë është një lloj lufte psikologjike kundër Salihut (*Paqja qoftë mbi të!*), që kishte për qëllim të dobësonte shpirtin e tij dhe të atyre që i besonin atij.

Kur kundërshtarët, me tiraninë dhe rebelimin e tyre, mbërritën në gradën e fundit dhe brenda tyre e shuan shkëndijën e fundit të shpresës për besim, atëherë ra mbi ta ndëshkimi i All'Ilahut: **"Për këtë arsye ata i goditi një tërmet i rëndë në mëngjes dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre."**

Në të vërtetë, ai tërmet ka qenë një tronditje e madhe që i shembi kështjellat dhe shtëpitë e tyre të forta; jeta e tyre e bukur u shkatërrua dhe prej tyre s'mbeti gjë tjetër veç trupave të vdekur. Fjala "*xhathim*", rrjedh nga lënda "*xhethmun*", që do të thotë: ulje në gjuhë dhe qëndrim në një vend të vetëm. Ka mundësi që ky

përshkrim të jetë tregues se tërmeti dhe lëkundja u erdhën atyre kur ata po flinin dhe nga efekti i tij, ata u ulën në mënyrë të papritur në gjuhë. Kur ishin ashtu, atyre nuk u vonoi lëkundja dhe vdiqën në atë pozicion, ose nga frika, ose për shkak të rrënimt të mureve mbi ta, ose nga ndikimi i oshëtimit që shoqëroi tërmetin.

Me çfarë u shkatërrua populli i Themudit?

Në ajetin që është objekt studimi thuhet se ajo çka e shkatërroi atë popull rebel, ishte tërmeti, ndërsa në ajetin 13 të sures "Fussilet", thuhet se ajo ka qenë një oshëtimë. Gjithashtu, në ajetin 5 të sures "El Hakka" thuhet: **"prandaj fisi Themud u shkatërrua nga një ulërimë e tmerrshme"**, çka do të thotë se populli i Themudit është shkatërruar me diçka shkatërrimtare.

Lind pyetja: A ka kundërshti ndërmjet këtyre frazave?

Përgjigja e kësaj pyetjeje mund të përmbliidhet në një fjali të vetme: Të gjitha këto fraza kthehen tek një kuptim i vetëm, ose janë të domosdoshme për njëra-tjetrën. Kështu, sa herë që ndodh një lëkundje toke në një zonë të caktuar, ajo shoqërohet me një oshëtimë të madhe; pra, fillimisht dëgjohet oshëtimi dhe pas saj tronditja e tokës.

Fjala *"et tagije"* ka kuptimin e një njeriu që e ka kaluar kufirin e tij dhe kjo fjalë përdoret për të treguar tërmetin, por edhe oshëtimën. Për këtë nuk ka asnjë kontradiktë ndërmjet ajeteve.

Në fund të grupit të ajeteve që janë objekt studimi thuhet:

"Ai u largua prej tyre dhe tha: 'O populli im! Unë ju solla mesazhin e Zotit tim dhe ju këshillova, por ju nuk i donit ata që këshillojnë.'"; pra pas kësaj, Salihu u zmbraps dhe tha: *Sapo e*

kreva mesazhin tim ndaj jush dhe ju këshillova, por ju nuk i doni ata që ju këshillojnë.

Këtu shtrohet një pyetje tjetër, që është: A i tha Salihu (*Paqja qoftë mbi të!*) këto fjalë pas shkatërrimit të rebeluesve të popullit të tij, apo ato ishin pjesë e dialogut të fundit ndërmjet tij dhe popullit të vet pak para shkatërrimit të këtyre të fundit, pra pas plotësimit të argumentit mbi ta?

Për të vërtetën e çështjes në fjalë ekzistojnë dy mundësi dhe mundësia e dytë është më e saktë; pra që bëhet fjalë për dialogun mes tyre, sepse biseda me popullin e Themudit tregon se ata kanë qenë të gjallë. Por edhe mundësia e parë nuk mund hidhet poshtë, sepse shpeshherë jepet bashkëbisedimi i shpirtrave të vdekur si shembull për ata që mbesin të gjallë. Ky shembull është i ngjashëm me atë që jepet në historinë e Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të*), i cili, pas betejës së Xhemelit, u ul afër trupit të Talhas dhe i tha: “Mjerë nëna jote o Talha! Ti ishe në një pozitë të mirë, por shejtani të humbi dhe të nguti për në zjarr.”¹

Gjithashtu, në fund të librit “Nehxhul Belaga” lexojmë se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), kur u kthye nga beteja e “Sifijnit”, qëndroi në hyrje të Kufes dhe u kthye nga varret e të vdekurve. Në fillim, ai i përshëndeti shpirtat e tyre e më pas tha: “Ju jeni paraardhësit, ndërsa ne jemi pasardhësit”.

¹ Sherh "Nehxhul Belaga", i Ibn Ebi El Hadijd, vëll. 1, f. 248.

Ajetet 80 - 84

وَلَوْطًا إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ أَتَأْتُونَ الْفَاحِشَةَ مَا سَبَقَكُمْ بِهَا مِنْ
 أَحَدٍ مِّنَ الْعَالَمِينَ ﴿٨٠﴾ إِنَّكُمْ لَتَأْتُونَ الرِّجَالَ شَهْوَةً مِّنْ
 دُونِ النِّسَاءِ ۚ بَلْ أَنْتُمْ قَوْمٌ مُّسْرِفُونَ ﴿٨١﴾ وَمَا كَانَ
 جَوَابَ قَوْمِهِ إِلَّا أَنْ قَالُوا أَخْرِجُوهُمْ مِّنْ قَرْيَتِكُمْ ۖ إِنَّهُمْ
 أَنَاسٌ يَّتَطَهَّرُونَ ﴿٨٢﴾ فَأَنْجَيْنَاهُ وَأَهْلَهُ إِلَّا امْرَأَتَهُ كَانَتْ مِنَ
 الْغَابِرِينَ ﴿٨٣﴾ وَأَمْطَرْنَا عَلَيْهِمْ مَطَرًا ۖ فَانْظُرْ كَيْفَ كَانَ
 عَنَقَبَةُ الْمُجْرِمِينَ ﴿٨٤﴾

"Kujtoni fjalët e Lutit, i cili i tha popullit të vet: 'Përse bëni paturpësi të tilla që askush nuk i ka bërë në botë?'".

"Ju u qaseni meshkujve me epsh - në vend të femrave. Me të vërtetë, ju jeni popull që e teproni me të këqija!"

"Përgjigjja e popullit të tij ishte: 'Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë.'"

"Kështu, Ne e shpëtuan atë me gjithë familje, përveç gruas së tij. Ajo ishte nga ata që mbetën pas (dhe u ndëshkuan)."

"Dhe mbi ta lëshuam rrebesh (gurësh), pra, shiko si përfunduan njerëzit e zvetënuar!"

Komentimi

Fundi i dhimbshëm i popullit të Lutit

Në këto ajete, Kur'ani Fisnik paraqet një kapitull tjetër të pasur me shembuj nga tregimet e Profetëve, duke e vazhduar kështu qëllimin e ajeteve të mëparshme e duke i plotësuar ato. Ky tregim që përmban një të vërtetë të hidhur, është tregimi i Profetit Lut.

Kjo histori është përmendur në shumë vende të Kur'anit Fisnik, si në suret "Hud, "El Hixhr", "Esh Shu'ara", "El Enbija", "En Neml" dhe "El Ankebut".

Në pesë ajetet që janë objekt studimi, Kur'ani Fisnik jep një përmbledhje të shpejtë të dialogut ndërmjet Lutit dhe popullit të tij.

Dhe duket se qëllimi i vetëm në këtë sure (El A'raf) është paraqitja shkurtimish e përballjeve të Profetëve dhe dialogjet e tyre me popujt e vet rebelues. Shpjegimi i plotë i tregimeve të tyre gjendet në suret e tjera të Kur'anit. (Tregimin e këtyre grupeve rebeluese do ta përmendim në mënyrë të detajuar në suren Hud dhe El Hixhr me shpresën e All'Ilahut.)

Në ajetin e parë të ajeteve që janë objekt studimi thuhet: **"Kujtoni fjalët e Lutit, i cili i tha popullit të vet: 'Përse bëni paturpësi të tilla që askush nuk i ka bërë në botë?'".**

Përveçse ishte në vetvete një mëkat i shëmtuar, atë nuk e kishte bërë dikush nga popujt e mëparshëm. Për këtë, e keqja e

asaj vepre të shëmtuar ishte e dyfishuar, sepse u bë bazë për një rrugë të keqe si dhe shkak për rënien e të tjerëve në mëkat herët apo vonë.

Në ajetin pasardhës shpjegohet mëkati që u përmend në një ajet më lart dhe thuhet: **"Ju u qaseni meshkujve me epsh - në vend të femrave..."**

A ka devijim më të keq sesa kur njeriu lë rrugën e trashëgimisë dhe të lindjes së fëmijëve, që realizohet nga afrimi i mashkullit me femrën, të cilin All'llahu e vendosi në qenien e çdo njeriu në mënyrë instinktive e të natyrshme?! A ka devijim më të keq sesa kur njeriu vepron atë që është në kundërshtim me instiktin e ndërthurjen natyrore të trupit e të shpirtit të njerëzve, në kundërshtim me instiktin ekuilibruar e të saktë?!

E thënë ndryshe, efekti i tij i vetëm është ngopja e gënjyer dhe e devijuar për nevojën e marrëdhënieve seksuale dhe dhënia fund e qëllimit thelbësor, që është vazhdimësia e riprodhimit njerëzor.

Më pas, në fund të ajetit, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...Me të vërtetë, ju jeni popull që e teproni me të këqija!"**; pra, ju e kaluat kufirin e All'llahut dhe ratë në greminën e devijimit e të teprimit të instinktit njerëzor.

Kjo frazë mund të jetë tregues i faktit se ata nuk e ndoqën rrugën e shfrenimit vetëm në aspektin e instinktit të marrëdhënieve seksuale, por ranë në devijim e shfrenim në çdo gjë e në çdo vepër.

Ajeti i parë e përmendi këtë temë në mënyrë të përgjithshme, ndërsa ajeti i dytë e trajton në mënyrë të qartë, që përbën edhe një nga artet e retorikës në sqarimin e çështjeve të rëndësishme. Kështu, nëse dikush bën një vepër të keqe,

udhëzuesi i tij, i vetëdijshëm dhe i mençur për sqarimin e rëndësisë së tematikës, i thotë: “Ti ke bërë një mëkat të madh”.

“Çfarë kam bërë – i thotë i pari. Udhëzuesi sërish i thotë: “Ti ke bërë një mëkat të madh”. Më pas, ai ia heq maskën veprës së të parit dhe ia shpjegon atë.

Ky lloj shpjegimi e sqarimi bën që pala mëkatare të largohet gradualisht nga fëlliqësia e veprës së keqe dhe nga rreziku i saj dhe kjo metodë ka një efekt më të madh.

Në ajetin pasardhës, Kur’ani Fisnik tregon përgjigjen e ngurtë e të palogjikshme të popullit të Lutit dhe thotë: *Ata nuk kishin asnjë përgjigje përballë thirrjes së këtij Profeti këshillues e vepërmirë, veçse të thonë: Nxirreni Lutin dhe ithtarët e tij nga qyteti juaj. Por, cili ishte mëkati i tyre? Mëkati i tyre ishte se ata ishin një grup i pastër, që nuk e njollosën veten e tyre me papastërtitë e mëkatit:*

“Përgjigja e popullit të tij ishte: ‘Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë.’”

Rasti i dëbimit të njerëzve të pastër nga mëkatarrët e shthurur nuk është për t’u çuditur. Kjo ndodh për shkak se populli mëkatar i sheh të pastrit, të cilët shmangen nga të ndaluarat, si rrezik për epshet e tyre. Në këndvështrimin e tyre, pikat e forta të të pastërve ishin pikat e dobëta të tyre.

Ka mundësi që fraza: “Me të vërtetë, ata janë njerëz që pastrohen” mund të nënkuptojë se me të, populli i Lutit ka dashur ta akuzojë këtë Profet të madh dhe ndjekësit e tij të pastër për hipokrizi, ashtu siç kemi lexuar në shumë poezi, ku pijanecët akuzojnë njerëzit e mirë për hipokrizi dhe vesin e tyre e konsiderojnë më të mirë sesa përuljen e asketit. Ky është një lloj lavdërimi i rremë i vetes që bëjnë mëkatarrët fatkeqë.

Duke vënë re të gjitha ato që u thanë në tre ajetet e mësipërme, mundet që çdo njeri i ekuilibruar të gjykojë me

drejtësi ndaj këtyre grupeve e kombeve, të cilët përdorin kërcënimin dhe akuzimin, përballë vepërmirëve, këshillës së këshilltarëve dhe thirrjes së Profetit të madh të All'llahut. Ata nuk njohin veçse gjuhën e forcës e shtypjes.

Për këtë, në ajetin pasardhës, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Kështu, Ne e shpëtuan atë me gjithë familje, përveç gruas së tij. Ajo ishte nga ata që mbetën pas (dhe u ndëshkuan)."**¹ Pra, kur situata u rëndua së tepërmi, All'llahu e shpëtoi Lutin, ndjekësit dhe banorët e tij të mirë, me përjashtim të bashkëshortes së tij që ishte me ideologjinë e popullit të tij të devijuar.

Disa komentues kanë thënë se fjala "*ehlun*", ndonëse në përgjithësi përdoret për familjen, në ajetin që është objekt studimi është përdorur për ndjekësit e sinqertë. Gjithashtu, thuhet se ata që e ndoqën Lutin ishin të paktë në numër. Në ajetin 36 të sures "Edh Dharijat" mësohet se Lutin dhe thirrjen e tij nuk e besoi askush nga populli i vet, përveç familjes dhe të afërmve të tij.

Duke u bazuar mbi këtë, termi "*ehlun*", këtu është përdorur me kuptimin e tij thelbësor, pra *familje*.

Në ajetin 10 të sures "Et Tahrim" thuhet se në fillim, bashkëshortja e Lutit ishte një grua e mirë, por ajo ndoqi rrugën e tradhëtisë, duke i vënë më pas armiqtë e Lutit kundër tij.

Në fund të grupit të ajeteve që janë objekt studimi jepet një tregues shumë i shkurtër, por me përmbajtje e kuptim të thellë për ndëshkimin e ashpër e të tmerrshëm që e kaploi atë popull. Kështu, All'llahu i Lartësuar thotë: **"Dhe mbi ta lëshuam rrebesh (gurësh)..."**; pra, ishte shi. Ai ishte një shi i çuditshëm që i sulmoi ata me gurë e meteorë si shi, duke i asgjësuar të gjithë.

¹ Fjala "*el gabiru*" përdoret për atë që i ikën dhe i zhduket familja dhe mbetet i vetëm siç iku familja e Lutit dhe gruaja e tij mbeti e vetme dhe e goditi ajo që goditi mëkatarët.

Ndonëse në ajet nuk shpjegohet lloji i shiut që zbriti mbi atë popull, nga përmendja e termit “*matarun*” – **shi**, bëhet e qartë se ky lloj shiu nuk ishte një shi i zakonshëm, por ishte një shi gurësh, ashtu siç thuhet edhe në suren “Hud”, ajeti 83: “**...pra, shiko si përfunduan njerëzit e zvetënuar!**”

Me të vërtetë, kjo fjali, ndonëse i është drejtuar Profetit (*Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ajo është thënë për t’u marrë në konsideratë nga të gjithë besimtarët. Tregimi i këtij populli, dëmet e ndryshme të homoseksualëve si dhe dispozita mbi këtë fenomen në jurisprudencën islame, do të trajtohen në komentimin e ajeteve të sureve “Hud” dhe “El Hixhr”.

Ajetet 85 - 87

وَالِى مَدْيَنَ أَخَاهُمْ شُعَيْبًا ۖ قَالَ يَنْقُومِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُمْ
 مِّنْ إِلَهِ غَيْرُهُ ۖ قَدْ جَاءَتْكُمْ بَيِّنَةٌ مِّن رَّبِّكُمْ ۖ فَأَوْفُوا
 الْكَيْلَ وَالْمِيزَانَ وَلَا تَبْخُسُوا النَّاسَ أَمْشِيَاءَهُمْ وَلَا تَفْسِدُوا
 فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا ۚ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنْتُمْ
 مُؤْمِنِينَ ﴿٨٥﴾ وَلَا تَقْعُدُوا بِكُلِّ صِرَاطٍ تُوعِدُونَ وَتَصُدُّونَ
 عَنِ سَبِيلِ اللَّهِ مِّنْ ءَامَنَ بِهِ ۖ وَتَبْغُونَهَا عِوَجًا ۚ وَاذْكُرُوا إِذْ
 كُنْتُمْ قَلِيلًا فَكَثَرْتُمْ ۖ وَانظُرُوا كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ
 الْمُفْسِدِينَ ﴿٨٦﴾ وَإِن كَانَ طَآئِفَةٌ مِّنْكُمْ ءَامَنُوا بِأَلَّذِى أُرْسِلْتُ
 بِهِ ۖ وَطَآئِفَةٌ لَّمْ يُؤْمِنُوا فَاصْبِرُوا حَتَّىٰ تَحْكُمَ اللَّهُ بَيْنَنَا ۚ وَهُوَ
 خَيْرُ الْحَاكِمِينَ ﴿٨٧﴾

"Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin, i cili u tha: 'O populli im! Adhuroni All'Ilahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Me të vërtetë, ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj, prandaj matni dhe peshoni saktë, mos u hani hakun

njerëzve dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregulli në të. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë!"

"Mos zini pusi në çdo rrugë, duke frikësuar dhe penguar nga rruga e All'Ilahut ata që besojnë tek Ai dhe duke kërkuar shtrembërimin e saj! Kujtoni atëherë kur ishit të paktë në numër e Ai ju shumoi. Shikoni si përfundojnë ngatërrestarët!"

"Nëse një grup mes jush beson në mesazhin me të cilin jam dërguar, ndërsa grupi tjetër nuk beson, duroni derisa All'Ilahu të gjykojë midis nesh! Ai është gjykatësi më i mirë."

Komentimi

Mesazhi i Shuajbit (Paqja qoftë mbi të!) tek populli i Medjenit

Në këto ajete, Kur'ani Fisnik prezanton kapitullin e pestë të tregimeve të popujve të vjetër dhe përballjen e Profetëve të mëdhenj me ta. Këtu flitet konkretisht për popullin e Shuajbit (Paqja qoftë mbi të!).

Shuajbi (Paqja qoftë mbi të!) u dërgua tek banorët e Medjenit, i cili ishte një nga qytetet e Shamit. Banorët e këtij qyteti ishin tregtarë e zengjinë dhe ndër ta ishte i përhapur paganizmi, hileja si dhe vjedhja në peshë e në masë.

Përballja e këtij Profeti të madh dhe popullit të Medjenit ka ardhur me detaje në sure të shumta të Kur'anit Fisnik, e veçanërisht në suren "Hud" dhe "Esh Shuara". Duke ndjekur Kur'anin Fisnik, ne do t'i trajtojmë detajet e kësaj historie në fund

të sures "Hud", por këtu do të përmendim shkurtimisht diçka nga kjo histori, në përputhje me ajetet e parashtruara këtu.

Në fillim, All'llahu i Lartësuar thotë: Ne kemi dërguar tek banorët e Medjenit vëllain e tyre Shuajbin:

"E në Medjen dërguam vëllain e tyre Shuajbin".

Një grup komentuesish, ndër të cilët El Alame Et Tabrasij në librin e tij "Mexhmaul Bejjan" si dhe Fakhrur Razij në komentimin e tij, kanë thënë se "*Medjen*" ka qenë emri i një prej fëmijëve të Ibrahimit dhe meqenëse fëmijët e nipërit e tij kanë banuar në tokën e Shamit, atëherë ajo është quajtur "*Medjen*."¹

Sekretin e përdorimit të termit "vëllain e tyre" e kemi trajtuar në ajetin 65 të kësaj sureje.

Më pas, All'llahu i Lartësuar thotë: *Në të vërtetë, Shuajbi, si të gjithë Profetët e tjerë, e filloi thirrjen e tij me çështjen e Njësimit: "...Shuajbin, i cili u tha: 'O populli im! Adhuroni All'llahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij...'"*

Më pas ajeti thotë: *"...ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj..."*

Po çfarë është kjo mrekulli? Në këto ajete nuk është thënë ndonjë fjalë për të, por në pamje të jashtme duket se bëhet fjalë për mrekullitë e Shuajbit (Paqja qoftë mbi të!).

Pas thirrjes së popullit të vet në Njësimit, Shuajbi (Paqja qoftë mbi të!) filloi të luftojë shturjet shoqërore, morale dhe ekonomike të përhapura tek ata. Në fillim, ai i ndaloi ata nga matjet e gënjeshtërtat, nga hiletë në marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe u tha: **"...prandaj matni dhe peshoni saktë, mos u hani hakun njerëzve..."** Është e qartë se depërtimi i çdo lloj mashtrimi në marrëdhëniet njerëzore, i trondit e madje i shkatërron bazat e

¹ Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 302. Tefsiri "Kebijr", vëll. 14, f. 172.

qetësisë e të sigurisë së masave, që është mbështetja më e rëndësishme e ekonomisë së popullit. Për këtë arsye, kjo ka qenë një nga çështjet e rëndësishme në të cilat është përqendruar Shuajbi.

Më pas tregohet për një vepër tjetër nga veprat mëkatore, që është shkatërrimi në tokë pas riparimit të saj me mundin e Profetëve e në dritën e besimit. Kështu, All'llahu i Lartësuar thotë: **"...dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregulli në të..."**

Dihet se nga shkatërrimi nuk përfiton askush, pavarësisht nëse bëhet fjalë për shkatërrim moral, humbje të besimit, apo mosekzistencë të tij. Për këtë, në fund të ajetit thuhet: **"...Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë!"**

Shtimi i frazës "nëse jeni besimtarë" është tregues se këto direktiva shoqërore e morale, zënë rrënjë e janë të frytshme nëse ato burojnë nga besimi e ndriçohen prej tij. Por nëse ato ngrihen mbi bazën e interesave materiale, atëherë ato nuk kanë për të qenë të qëndrueshme e të vazhdueshme.

Në ajetin pasardhës flitet për këshillën e katërt të Shuajbit (Paqja qoftë mbi të!). Ai i ndaloi njerëzit e popullit të tij që të uleshin në rrugë e të kërcënonin njerëzit, që t'i ndalonin ata nga rruga e All'llahut dhe t'i çonin në rrugë të gabuar me hedhjen e dyshimeve dhe me falsifikimin e rrugës së drejtë e të vërtetë në këndvështrimin e tyre. Kështu, Shuajbi (Paqja qoftë mbi të!) u tha: **"Mos zini pusi në çdo rrugë, duke frikësuar dhe penguar nga rruga e All'llahut ata që besojnë tek Ai dhe duke kërkuar shtrembërimin e saj!..."**

Por si kërcënoheshin ata që e donin besimin? Komentuesit e ajeteve të Kur'anit kanë përmendur mundësi të shumta. Disa kanë thënë se i kanë kërcënuar me vrasje; disa të tjerë thonë se

mundet të ketë qenë me zënien e pusisë dhe me grabitjen e mallrave të besimtarëve. Megjithatë, kuptimi i parë duket se është më i sakti.

Në mbyllje të ajetit vjen këshilla e pestë për Shuaibin (Paqja qoftë mbi të!), ku popullit të tij i përmenden begatitë hyjnore për të nxitur ndjenjën e falënderimit për to. Kështu, në ajet thuhet: Kujtoni kur ishit individë të pakët në numër dhe All'Ilahu ju shtoi juve duke e dyfishuar forcën tuaj: **"...Kujtoni atëherë kur ishit të paktë në numër e Ai ju shumoi..."**

Më pas, ajeti tërheq vëmendjen për ndëshkimin e shkatërrimtarëve, me fundin e çështjes së tyre, me përfundimin e tyre të dhimbshëm, në mënyrë që të mos ndjekin atë shembull e të goditen me atë që u goditën: **"...Shikoni si përfundojnë ngatërrestarët!"**

Në kundërshtim me përkrahjet e pastudiuara për kufizimin e shtimit të popullsisë në ditët tona, në fjalinë e fundit mësohet se shumimi i individëve të shoqërisë mund të jetë burim force, madhështie dhe përparimi të shoqërisë në shumë drejtime, sigurisht me kushtin që mirëqenia e tyre të përputhet me programe të rregullta në aspektin material e shpirtëror.

Ajeti i fundit nga grupi i ajeteve që janë objekt studimi vjen si përgjigje ndaj disa pikëpyetjeve të besimtarëve e jobesimtarëve të popullit të tij. Nën ndikimin e trysnisë që vinte nga ana e jobesimtarëve, ishte e natyrshme që besimtarët ta pyesnin Profetin e tyre, duke i thënë: Deri kur do rrimë në torturë e do të mbartim dëmin?

Gjithashtu, kundërshtarët mburreshin se ata nuk i godet ndëshkimi i All'Ilahut dhe thonin: Nëse je me të vërtetë nga ana e

All'lahut, atëherë përse ne nuk na godet gjë, pavarësisht nga ato që kemi bërë si dëmtim e kundërshtim?!

Kështu, Shuajbi (Paqja qoftë mbi të!) u thotë atyre: Nëse një grup prej jush beson në atë që jam dërguar, ndërsa një grup tjetër më kundërshton, ky nuk është shkak për arrogancën e jobesimtarëve dhe për plogështimin e besimtarëve. Duroi derisa All'lahu të gjykojë ndërmjet nesh e ndërmjet jush.

Në këtë mënyrë, e ardhmja do ta tregojë se kush është në të drejtën dhe kush është në të padrejtën:

"Nëse një grup mes jush beson në mesazhin me të cilin jam dërguar, ndërsa grupi tjetër nuk beson, duroi derisa All'lahu të gjykojë midis nesh! Ai është gjykatësi më i mirë."

PËRMAJTJA E LIBRIT

TEMA

Ajeti 111	5
Komentimi.....	5
Përse nuk pendohen kokëfortët?.....	5
Ajetet 112 - 113	8
Komentimi.....	8
Cytjet e djajve.....	8
Hulumtime.....	9
Ajetet 114 - 115	13
Komentimi.....	13
Ajetet 116 - 117	17
Komentimi.....	17
Hulumtime.....	19
Nuk ka rëndësi sasia numerike.....	19
Ajetet 118 - 120	22
Komentimi.....	23
Duhet të zhduken patjetër gjurmët e politeizmit.....	23
Ajeti 121	28
Komentimi.....	28
Ajetet 122 - 123	30
Shkaku i zbritjes.....	30
Komentimi.....	31
Besimi dhe vizioni i qartë.....	31
Ajeti 124	36
Shkaku i zbritjes.....	36

Komentimi.....	37
All'lahu e di më së miri se kujt ia jep mesazhin e Vet.....	37
Ajetet 125 - 127.....	40
Komentimi.....	41
Furnizimet Hyjnore.....	41
Hulumtim.....	41
1- Çfarë synohet me udhëzim dhe me humbje?.....	41
2- Cili është qëllimi i fjalës " <i>es sadr</i> "?.....	42
3- Çfarë është " <i>el harexhun</i> "?.....	42
4- Mrekulli shkencore kur'anore.....	43
5- Çfarë është zgjerimi i kraharorit?.....	43
Ajetet 128 - 129.....	46
Komentimi.....	47
Ajetet 130 - 132.....	50
Komentimi.....	51
Plotësimi i argumentimit.....	51
Ajetet 133 - 135.....	54
Komentimi.....	55
Ajeti 136.....	57
Komentimi.....	57
Ajeti 137.....	61
Komentimi.....	61
Ajetet 138-139.....	65
Komentimi.....	66
Ajeti 140.....	70
Komentimi.....	70
Ajeti 141.....	72
Komentimi.....	72
Mësim madhështor në rrugën e njësimit.....	72
Hulumtime.....	75
1- Lidhja e këtij ajeti me ajetet e mëparshme.....	75
2- Çfarë synohet nga "frutat e Tij"?.....	76

3- Çfarë synohet me të drejtën, e cila domosdoshmërisht duhet dhënë?.....	76
4- Cili është qëllimi i shprehjes me fjalën "ditë"?.....	77
Ajetet 142 - 144	78
Komentimi.....	79
Ajeti 145	84
Komentimi.....	84
Disa kafshë të ndaluara.....	84
Ajetet 146 - 147	90
Komentimi.....	91
Çfarë u ndalua për jehudinjtë?.....	91
Hulumtime.....	93
1- Çfarë kanë bërë beni izraelitët?.....	93
2- Çfarë do të thotë "Me të vërtetë ne jemi të sinqertë"?.....	93
Ajetet 148 - 150	96
Komentimi.....	97
Shmangia nga përgjegjësia me argumentin e detyrimit.....	97
Ajetet 151 - 153	104
Komentimi.....	105
Dhjetë urdhëresat:.....	105
1- Fillimi me njësim dhe fundi me heqjen dorë nga kontradikta.....	108
2- Përforcimet e njëpasnjëshme.....	108
3- Direktivat dhe urdhërat e përhershme.....	109
4- Rëndësia e mirësjelljes ndaj prindërve.....	110
5- Vrasja e fëmijëve për shkak të varfërisë e urisë.....	111
6- Çfarë synohet me fjalën " <i>feuahish</i> "?.....	111
7- Mos ju afroni këtyre mëkateve.....	112
8- Mëkatet e jashtme dhe të brendëshme.....	112
9- Dhjetë këshillat tek Jehudinjtë.....	112
10- Si i ndryshuan këto ajete imazhet në Medinen e Ndritur?.....	113
Ajetet 154 - 157	117
Komentimi.....	118

Kundërpërgjigje e prerë ndaj debatuesve dhe mutealilinëve.....	118
Ajeti 158	125
Komentimi.....	125
Pritje të kota dhe kërkesa të pamundura.....	125
Hulumtime	127
Nuk ka dobi besimi pa vepër.....	127
Ajetet 159 - 160	129
Komentimi.....	129
Refuzimi i përçarësve të rradhëve dhe mohimi i tyre.....	129
Hulumtime	130
1- Kush janë ata të cilët synohen në ajet?.....	130
2- Shëmtia e përçarjes dhe e mbjelljes së mosmarrëveshjes.....	132
3- Sulmet e padrejta të autorit të librit “El Menar” ndaj Shiizmit...	133
Shpërblim më shumë, ndëshkim më pak:.....	138
Hulumtime	138
1- Cili është qëllimi i thënies së Tij “xhae bihi”?.....	138
2- Shpërblimi i të mirës me dhjetëfish.....	139
3-Përse shpagimi i një dite të vetme është me gjashtëdhjetë ditë?.....	139
4- Pafundësia e mirësisë së All'lahut.....	140
Ajetet 161- 163	143
Komentimi.....	143
Kjo është rruga ime e drejtë.....	143
Si ka qenë Profeti i pari mysliman?.....	147
Ajeti 164	150
Komentimi.....	150
Dy hulumtime.....	151
1- Ndoshta kemi mbartur barrën e të tjerëve.....	151
2- Po veprat e mira të tjerëve a na sjellin dobi neve?.....	152
Ajeti 165	156
Komentimi.....	156
Dy hulumtime.....	158
1- Ndryshimi ndërmjet njerëzve dhe parimi i drejtësisë.....	158

2- Mëkëmbësia e njeriut në tokë.....	160
Sure "El A'raf"	161
Përmbajtja e sures "El A'raf"	161
Rëndësia e sures "El A'raf"	164
Ajetet 1 - 3	166
Komentimi.....	167
Ajetet 4 - 5	171
Komentimi.....	171
Popujt që u shkatërruan e që u zhdukën.....	171
Hulumtime	172
Ajetet 6 - 9	175
Komentimi.....	176
Hetim gjithpërfshirës.....	176
Marrja në pyetje, përse?.....	178
Përputhshmëria midis ajeteve të marrjes në pyetje në Kur'an.....	179
Çfarë është peshorja e veprave në Ditën e Ringjalljes?.....	180
Ajeti 10	185
Komentimi.....	185
Pozita e njeriut dhe madhështia e tij në këtë botë.....	185
Ajetet 11 - 18	187
Komentimi.....	189
Tregimi i mosbindjes së Iblisit.....	189
Analogjia e parë është analogjia e shejtanit.....	191
Pse ka qenë shejtani i pari, ai që ka përdorur analogjinë?.....	194
Analogjia e kushtëzuar nga shkaku.....	195
Si i ka folur shejtani All'lahut të Lartësuar?.....	196
Iblisi, i pari deklarues për imponim (detyrim).....	199
Dy Hulumtime.....	202
1- Filozofia e krijimit të shejtanit dhe urtësia e shtyrjes së afatit të tij.....	202
2- Hipoteza e evolucionit të llojeve dhe krijimi i Ademit.....	205
Ajetet 19 - 22	206

Komentimi.....	207
Nxijtjet djallëzore me pamje magjepsëse.....	207
Hulumtime.....	212
1- Mënyra e cytjes së shejtanit.....	212
2- Çfarë ka qenë pema e ndaluar?.....	213
3- A ka bërë mëkat Ademi?.....	216
Ajetet 23 - 25	220
Komentimi.....	220
Kthimi i Ademit tek All'llahu dhe pendimi i tij.....	220
Hulumtime.....	222
Tregimi i Ademit dhe e ardhmja e kësaj bote.....	222
Ajetet 26 - 28	224
Komentimi.....	225
Paralajmërim për të gjithë bijtë e Ademit.....	225
Zbritja e rrobave!.....	227
Rrobat në të kaluarën dhe në të tashmen.....	228
Çfarë synohet me “të shëmtuarën”?.....	235
Ajetet 29 -30	237
Komentimi.....	237
Dy hulumtime.....	239
1-Ç’kuptim ka fraza: “Drejtohuni vetëm nga Ai në çdo xhami”?...239	
2- Argumentet më të shkurtra për Ringjalljen.....	239
Ajetet 31 - 32	242
Komentimi.....	242
Dy hulumtime.....	245
1- Stolisja dhe zbukurimi në këndvështrimin islam.....	245
2- Këshillë e rëndësishme shëndetësore.....	248
Ajeti 33	250
Komentimi.....	250
Ndalesat e All'llahut.....	250
Ajeti 34	254
Komentimi.....	254

Për çdo komb ka një afat.....	254
Përgjigje gabimit.....	255
Ajetet 35 - 36.....	258
Komentimi.....	258
Mësim tjetër për bijtë e Ademit.....	258
Kthim përgjigjeje ndaj një sofizmi tjetër.....	259
Ajeti 37.....	261
Komentimi.....	261
Ajetet 38 - 39.....	265
Komentimi.....	266
Konflikti i udhëheqësve dhe i ithtarëve në Xhehennem!.....	266
Ajetet 40 - 41.....	270
Komentimi.....	270
Ajetet 42 - 43.....	274
Komentimi.....	275
Rehatia e plotë dhe lumturia e përjetshme.....	275
Përse u perifrazua si “trashëgimi”?.....	278
Ajetet 44 - 45.....	280
Komentimi.....	280
Hulumtime.....	282
Kush është ai thirrës që do të thërrasë?.....	282
Ajetet 46 - 49.....	286
Komentimi.....	287
A'rafi, Rugëkalim i rëndësishëm drejt Xhenetit.....	286
Hulumtime.....	290
Kush janë zotëruesit e A'rafit?.....	290
Ajetet 50 - 51.....	296
Komentimi.....	297
Begatitë e Xhenetit janë të ndaluara për banorët e Xhehennemit.....	297
Hulumtim.....	297
Ajetet 52 - 53.....	300
Komentimi.....	301

Ajeti 54	303
Komentimi.....	303
A është krijuar bota në gjashtë ditë?.....	304
Përse All'illahu nuk e krijoi botën në një çast të vetëm?.....	307
Çfarë është Arshi?.....	308
Çfarë janë “krijimi” dhe “sundimi”?.....	310
Ajetet 55 - 56	313
Komentimi.....	313
Kushtet e përgjigjes së lutjes.....	313
Ajetet 57 - 58	317
Komentimi.....	318
Patjetër që duhet edukatori dhe aftësia:.....	318
Ajetet 59 - 64	321
Komentimi.....	322
Mesazhi i Nuhut, Profet prej Profetëve të vendosmërisë së lartë....	322
Ajetet 65 - 72	328
Komentimi.....	330
Vështrim mbi tregimin e popullit të Hudit.....	330
Ajetet 73 - 79	337
Komentimi.....	339
Tregimi i popullit të Salihut dhe shembujt që gjenden në të.....	339
Me çfarë u shkatërrua populli i Themudit?.....	344
Ajetet 80 - 84	346
Komentimi.....	347
Fundi i dhimbshëm i popullit të Lutit.....	347
Ajetet 85 - 87	352
Komentimi.....	353
Mesazhi i Shuajbit (Paqja qoftë mbi të!) tek populli i Medjenit.....	353

أَمْثَلُ فِي تَفْسِيرِ كِتَابِ اللَّهِ الْمَنْزِلِ

مؤلف: العلامة الفقيه المفسر ناصر مكارم الشيرازي

الجزء الثامن

الترجمة الى اللغة الألبانية: وُلِّدْتُ مَرْيَا

تيرانا: 2016

نام کتاب: الامثل فی تفسیر کتاب الله المنزل (جزء هشتم)

نویسنده: فقیه مفسر حضرت آية الله العظمی ناصر مکارم شیرازی (دام ظلّه)

ترجمه به زبان آلبانی: وُلُئْتُ مَرِيًا

زیر نظر: وُلُئْتُ مَرِيًا

ویرایش: یریدا کولا

مقابله: ویولسا کارای

صفحه بندی و جلد: صبریه فرا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2016